

BIBLIOTEKA

8H-31

K 83

UILLKI KOLINZ

GURI I HËNËS

(ROMAN)



84-31
K 83

UILLKI KOLINZ

GURI I HËNËS

ROMAN



E përktheu: JORGJI DOKSANI

Shtëpia Botuese Private «JANI VRUHO»
Berat, 1993

Seria e romanit dedektiv

Variant i shkurtuar

Redaktor:

XHEVAHIR LLESHI

Kopertina:

GAZMEND MUKA

Korrektor:

GENT ARIANITI

DY FJALË

Uiljam Uillki Kolinz (1824-1889) është shkrimtar anglez, njëri nga pionierët e letërsisë dedektive, që, së bashku me Konan Dojlin (1859-1930), hodhiën bazat e kësaj letërsie jo vetëm në Angli por edhe në botë. Miqësia dhe bashkëpunimi krijues i Kolinit me Ç. Dikensin përcaktuan profilin krijues të shkrimtarit të dëgjuar, autor romanesh të përkthyer në shumë gjuhë të botës, si «Gruaja me të bardha» (1860), «Guri i Hënës» (1868) dhe i një vargu veprash në bashkautorësi me Dikensin, etj.

Romani dedektiv «Guri i Hënës» tanimë e ka siguruar vendlind e nderit përbri tregimeve famëmedha për dedektivin Sherlock Hollms të K. Dojllit, në bibliotekën e romanit dedektiv, aq shumë të dashur dhe të lexuar në botë. Romani është pjellë e një imagjinate krijuese të begatë e realiste, mbushur me ngjarje interesante dhe karaktere njerëzore të skalitur me art.

U parapëlqye ky variant i shkurtuar për arsyen se në të, falë ngjeshjes së kujdeshshme të ngjarjeve, është siguruar një dinamizëm më i madh subjekti dhe lakonizëm shprehjeje, pa cënuar tërësinë ideokompozicionale të veprës.

PËRKTHYESI

PROLOG

Tregimi i pazakontë për diamantin e verdhë, me ngjyrë të jashtëzakonshme, shkëlqim të jashtëzakonshëm dhe madhësi të jashtëzakonshme, zë fill në dorëshkrimet e vjetra indiane.

Më i vjetri prej tyre na bën të ditur që ky diamant ka zbuluar ballin e perëndisë indiane të Hënës. Edhe nga shkaku i ngjyrës së veçantë, po edhe nga legjenda për të, ky diamant iu nënshtroka ndikimit të hýjnisë që përfaqëson, ashtu shkëlqimi iu zmadhoka apo zvogëloka në vartësi të plotësisë apo paplotësisë së hënës, ai edhe sot e kësaj dite njihet me emrin **GURI I HËNËS**.

PJESA E PARË

HUMBJA E DIAMANTIT

Viti 1848

Ngjarje të treguara nga Gabriel Beterexhi, kryeshërbëtori i zonjës Xhuli Verinder.

1.

— Duhet të tregojmë gjithë sa dimë, — tha zoti Frenklin.
— Dhe duhet ta fillojmë qysh nga çasti kur diamanti ra në dorë të zotit Xhon Hernkastl, xaxhait tim, kur shërbente në Indi pesëdhjetë vjet të shkuara. Të dhëna për këtë ka: ruhet një kronikë e vjetër ku vetë ai ka shtjelluar me hollësi ngjarjet. Mandej duhet kallzuar si u gjend ky diamant në shtëpinë e tetos sime në Jorkshir dy vjet të shkuar dhe si u zhduk pastaj pas dymbëdhjetë orësh. Kërkush s'e di më mirë se ju, Beterexh, se ç'ndodhi atëherë në atë shtëpi. Ju dhe duhet t'i viheni punës për të hedhur drithë mbi këtë ngjarje.

I bëra pyetjen vetes, si t'i vihesha punës: duke qëmtuar në kujtesë gjithë c'qe ruajtur apo të ndiqja këshillën e time bije, Penelopës, pér t'iu drejtar ditarit të saj e pér të ndjekur kështu rrjedhën e ngjarjeve.

Penelopa thotë se duhet ta filloje nga dita kur mbërriti lajmi se do të vinte zoti Frenklin Blek. Pra në mëngjesin e së mërkurës, datë 24 maj 1848, më thirri zonja Verinder.

— Gabriel, — më tha, — ja një lajm që do të të habis: Frenklin Bleku qënka kthyer nga jashtë shtetit, paska qëndruar në Londër tek i ati dhe nesër do të vijë tek ne pér kremin e datëlindjes së Reçëllit.

Sikur të mbaja ndër duar kapelen, vetëm respekti pér zonjën do të mund të më pengonte ta hidhja e ta prisja fluturimthi. S'e kisha parë zotin Frenklin qysh kur kishte qënë djalh e kishte rrojtur tek ne.

Ishte në të gjitha drejtimet (nga c'më kujtohet) një fëmijë e dashur edhe kur lëshonte fluturake apo thyente ndonjë xham. Zonjusha Reçell, që ishte e pranishme në këtë bisedë, tha se e mbante mend si tiran të kukullave, si kalorës azgan që mbreh-te vajzat dhe i detyronte të vraponin, duke i drejtar ai me frerët.

— Sa e kujtoj, — tha më në fund zonjusha Reçell, — ziej përbrenda nga zemërimi dhe ndiej kapitje nga lodhja.

Vetveti të lind pyetja: pérse zoti Frenklin tërë këta vite i kaloi jashtë shtetit? Kjo sepse i ati ka pasur fatkeqësinë të jetë trashëgimtari më i afërt i një titulli hercogu, por që juridi-kisht nuk mundi ta vërtetonte.

Dhe ja, ditën e enjte, më 25 maj, ne duhej të shihnim pér herë të parë se q'burrë na ishte bërë ai djalh çamarrok. Ishte nga derë e mirë, guximtar e fisnik, sapo i kishte mbushur një-zetë e pesë vjeç. Qëlloi një ditë e bukur buzëvere; zonja me të bijën, që nuk e prisnin zotin Frenklin para drekës, shkuan të hanin mëngjes te ca miq fqinjë. Unë mora karrigen prej kash-te pér t'u shullëhur, kur ndala këmbët që të hetoja nga vinin ato të rrahura daulleje. Vura re se disa njerëz kishin qëndruar në tarracë para dhomave të zonjës.

Kur i dola tarracës nga ana tjetër, më zunë sytë tre india-në lëkurëzinj, me këmisha dhe shallvare të bardha liri, që shihnin shtëpinë.

Kur iu afrova, pash se ishin ata që u binin dauleve të vogla-të varura në qafë. Para tyre qëndronte një djalkë i vogël anglez, i dobët e flokëverdhë, me një thes në dorë. I mora përfallxhorë endacakë, ndërkokë që ai djalka mbante në thes veglat e zanatit të tyre. Njëri nga të tre, që fliste anglisht dhe mbahej tërë sqimë, ma vërtetoi hamendjen: më kërkoi leje të shtinte fall në prani të zonjës së shtëpisë.

U thashë se s'kishte njeri dhe i urdhërova të largohen. Ky m'u përkul tërë finesë dhe ata u larguan. S'kaloi shumë, më vjen vrap ime bijë, Penelopa, e më thotë se ata tre indianët duhen çuar në polici sepse ishin në dijeni të ardhjes këtu nga Londra të zotit Frenklin Blek dhe kishin ndërmend ta sulmonin. Bashkë me një shoqen e saj fare rastësisht kishte parë se si indianët, pasi qenë siguruar që s'i shihte njeri, qenë kthyer me fytyrë nga shtëpia jonë dhe e kishin parë përf një kohë të gjatë. Pastaj diç kishin dërdëllitur e s'di përsë qenë grëndur në atë gjuhën e tyre, duke dyshuar përf diçka. I qenë drejtuar për ndihmë atij djalkës anglez; kokësi i tyre e kishte urdhëruar:

— Nxirri duart përpëra!

Djalka kishte tundur kryet në shenjë mosdashjeje. Indiani e kishte pyetur (pa qenë fare i zemëruar), mos dëshironte ta ktherin në Londër, ta linin aty ku e kishin marrë, mes katër rrugësh, të urtuar, trokecopë, të pastrehë? Kundërshtimi që thyer. Djalka pa qejf kishte zgjatur duart përpëra. Indiani kishte nxjerrë një shishëzë nga gjiri dhe i kishte derdhur një lëng të zi, si mellan, në pëllëmbë të dorës. Pastaj i kishte vënë dorën në kokë, kishte bërë ca lëvizje e shenja në ajër dhe kishte thënë:

— Shiko!

Djalka kishte ngrirë si statujë, duke ia ngulur shikimin mellanit në pëllëmbë të dorës...

Indianët përsëri panë në i shihte njeri apo jo dhe kokësi i tyre e kishte pyetur sakaq djalin:

— A e sheh atë anglezin që ka ardhur nga dhë i huaj?

Djali i që përgjigjur:

— E shoh.

Indian i kishte thënë:

— Nëpër këtë rrugë apo nëpër ndonjë tjetër ka për të ardhur ai sot?

Djali i qe përgjigjur:

— Nëpër këtë dhe jo nga ndonjë rrugë tjetër ka për të ardhur sot anglezi.

Pasi kishte heshtur një çast, indian i kishte bërë një pyetje tjetër:

— A e ka ai anglezi atë me vete?

Pas një heshtjeje të shkurtër djali i qe përgjigjur:

— E ka.

Atëherë indian i kishte bërë pyetjen e katërt dhe të fundit:

— A do të vijë këtu ai anglezi, siç ka premtuar, në mbrëmje?

Djali i qe përgjigjur:

— Këtë nuk e them dot.

Indian i kishte pyetur përsë. Djali i qe përgjigjur:

— Jam i lodhur. Kam një mjegull para syve, ajo më penton të shohë. Sot asgjë s'mund të shohë tjetër gjë.

Me kaq pyetjet kishin marrë fund. Indiani diç i kishte thënë në gjuhën e tij bashkudhëtarëve, duke u bërë me shenjë nga djali dhe nga qyteti, ku (siç mësuam më pas) kishin ndaluar. Pas kësaj kishin bërë përsëri ca shenja e lëvizje mbi kokën e djalit, i kshin fryrë në ball; ky ishte rrënqethur dhe qe përmendur. S'e kishin bërë të gjatë, qenë nisur për në qytet dhe vajzave u patën humbur nga sytë.

Thonë se prej çdo ngjarjeje mund të nxjerrësh një përfundim po të mundohesh pak. E ç'perfundim mund të bëhej pas gjithë kësaj? Sidoqoftë më kryesore ishte ajo pyetja e tretë e indianit: «A e ka ai anglezi atë me vete?» Pas pak e mësova se me atë indiani nënkuptonte **Gurin e Hënës**.

3.

Them se ju, lexues, doemos duhet të viheni në dijeni edhe të historisë së «Rërës së Tallazitur» dhe të historisë së Rozanës,

përderisa ato lichen drejtpërsëdrejti me atë historinë e diamantit.

Rozana është shërbëtora e vetme që kemi marrë në shtëpi këto kohët e fundit. Nja katër muaj më parë zonja, kur kishte qënë në Lordër, në një shkollë edukimi, me rekomandimin e drejtoreshës kishte pranuar të merrete për shërbëtore në shtëpinë e saj Rozana Spirmanin. Neve ajo na e pat kallzuar historinë e dh'mbshme të kësaj vajze: kishte qënë vjedhacake nga e keqja, e kishte kapur policia, e kishin futur në burg, pastaj në shkollën e edukimit. Mendimi i drejtoreshës për Rozanën kishte qënë nga më të mirët (pavarësisht nga ç'i kish pas ndodhur), e kishte lavdëruar për sjelljen e mirë dhe pat përfunduar që lypsej vetëm t'i jepej rasti që ta tregonte veten të denjë për të bërë jetë bashkë me tërë njerëzit e mirë.

Zonja, si shpirt njeriu që është, i pat thënë:

— Do ia jap unë atë rast që ta tregojë veten.

Pas një javë Rozana erdhë tek ne shërbëtore e dytë. As edhe një s'ia dinte të kaluarën, përvèç meje dhe Recëllit.

Fati i buzëqeshi kësaj vajze. Dhe duhet thënë, se edhe ajo e tregoi veten të denjë për t'u respektuar. Edhe pse ishte shëndetligë aq sa herë-herë i binte edhe të fikët, punët i bënte pa fjalë, tregohej e zellshme dhe e kujdësshme, por s'di përse nuk u miqësua me askënd përvèç se me time bijë Penelopën.

Nuk e di se përse vajza s'u pëlqente shërbëtorëve. Nuk ishte e bukur që t'ia kishin zili, ishte më e shëmtuara në atë shtëpi, për më tepër që njërin sup e kishte më të lartë se tjetrin. Ndoshta shërbëtorëve s'u pëlqenin heshtja e saj e vazhdueshme dhe prirja për të qënë e vetmuar. Kur të gjithë kuvendorin, ajo lexonte ose bënte ndonjë punë tjetër. Shëtiste kurdcherë vetëm. Kurrë nuk grindej me njeri, kurrë s'i mbante kujt mëri, vetëm se qëndronte larg shoqeve pa ndonjë arsy. Shtojmë këtu që, edhe pse nuk qe e bukur, diç kishte ajo vajzë që e bënte të ngjante më tepër me një zonjë sesa me një shërbëtore. Dukej kjo sidomos në zërin që nxirrte, por edhe në fytyrë. Me të shkelur këmbë e saj tek ne, gratë që të gjitha thanë se Rozana Spirmani e heq lart,

S'mund të mos vë në dukje edhe një ekstravagancë të saj, që do më japë dorë për t'u hedhur menjëherë tek ajo historia e «Rërës së Tallazitur».

Shtëpia jonë gjendet në bregdetin e Jorkshirit, mu në buzë të detit. Rretherrotull ka vende të mrekullueshme për shëtitje, me përjashtim të njërit.

Ky është gjiri me duna rëre që zgresin deri poshtë në det. Rruga për aty kalon përmes ca mollokësh të thepisur që quhen disa Veriorë e disa Jugorë. Ndërmjet tyre të zë syri atë rërën e tmerrshme të tallazitur. Gjatë zbaticës, seç ndodh në thellësitetë e atij vendi që e bënë sipërfaqen e rërës të dallgëzohet në një mënyrë të pazakontë. Ndaj dhe banorët ia kanë vënë emrin «Rëra e Tallazitur». Një vend i vetmuar që të kall datën! As edhe një anije s'guxon t'i afrohet këtij gjiri. Kurrë s'të zë syri aty këmbë njeriu! Madje edhe zogjtë i qëndrojnë larg atij vendi. Që një vajzë e re në orët e lira, duke patur mundësi të zgjedhë nga sa e sa vende të këndshme pér shëtitje, ku fare lehtë mund të hasë edhe ndonjë bashkudhëtar të gatshëm pér t'i bërë shoqëri, të parapëlqejë një të tillë vendi dhe të merret me punëdore apo me lexime fill e vetme, kjo s'do mend, që nuk është diçka e zakontë. Veç, thoni ç'të doni, por pikërisht ky ishte vendi i zemrës i Rozana Spiranit. Vetëm një a dy herë i pat bërë vizitë një shoqes së vëtme që kishte në fshatin peshkatar të Kobs-Hollit, pér të cilën do të tregoj më vonë.

Pra u nisa në kërkim të vajzës pér ta thirrur të hante drekë. E gjeta në një shkëmb të «Rërës së Tallazitur», duke parë detin dhe rërën. U rrënqeth kur e preka dhe më ktheu krahët. Kur e detyrova të më shihë drejt në sy, vura re që i shkonin qurg lotët. Dukej fare e dërrmuar, fatkeqe.

— A s'më thoni, moj shpirte, — i thashë, — ç'janë këta lotë?

— M'u kujtuan vitet që shkuan e vanë, zoti Beterexh, — ma ktheu qetë-qetë Rozana.

— Mjaft me këto, moj vajzë! Vitet e shkuara ti i ke larë. Shkuli nga mendja!

Më tregoi me gisht vendin e njollës së yndyrës që ajo vete e kishte larë më një tretësirë të re, por që gjurma ende ruhej.

— Njolla s'është më, por vendi ku ajo ka qënë duket, zoti Beterexh! — më tha.

Nuk e ndjeva veten të zotë që ta ngushëllloja ato çaste,

ndaj dhe më mbetej të bëja vetëm një gjë: ta merrja më vete pér të ngrënë drekë.

— Kam ardhur t'ju marrë pér të ngrënë drekë, — i thashë. — Kësisoj ju do të pranoni më lehtë një qortim timin.

Më shtrëngoi heshturazi dorën dhe mezi po i mbante lottët, ia doli mbanë, e kjo mua më pëlqeu.

— Ju faleminderit, zoti Beterexh, — më tha. — S'më ha het fare sot, më lejoni të qëndroj këtu.

— E pse ju ka hyrë kaq në zemër ky vend? — e pyeta. — E pse bëni q'bëni dhe dilni në këtë anë aq të trishtë?

— Diç më tërheq pér këtu, — m'u përgjigj, duke vizatuar me gisht një figurë mbi rërë. — I them vetes që s'duhet ardhur e përsëri vij. Nganjëherë... — shtoi ultas si të trembej nga fantazia që i shkreppte vetiu, — nganjëherë, zoti Beterexh, më bëhet, se këtu është varri im.

— Të pret në shtëpi mishi i dashit të pjekur dhe budingu me gjalp! — i thashë. — Hajde, nisemi tan! Ja se ç'mendime të vërshojnë kur e ke stomakun bosh!

I fola rreptë tërë indinjatë kësaj vajze njëzetvjeçare që zinte ngoje vdekjen.

Sikur nuk i kishte dëgjuar fare ato që i kisha thënë. Ma vuri dorën në sup dhe vazhdoi:

— Më duket se ky vend këtu më ka lidhur me magji, — më tha. — Më del natëpërnatë në èndërr, këtu më tri mendja edhe kur qëndis. Se ju e dini që ju jam shumë falnderuese, zoti Beterexh, e dinë që bëj çmos të meritoj vëmendjen dhe besimin e zonjës. Veç rri-rri dhe e pyes veten: a nuk është si shumë e qetë dhe e mirë jeta e këtushme pér një të tillë njeriu si unë, pas gjithë asaj që hoqa? E ndiejet veten edhe më bonjake mes shërbëtorëve, sesa këtu, duke e ditur që s'jam si ata. Zonja vetë nuk e di, drejtoresha e shkollës së edukimit, as ajo nuk e di se ç'qortim i tmerrshëm janë njerëzit e ndershëm si të tillë në vetvete pér një njeri si unë. Mos më shani, i dashuri dhe i miri Peterexh. Jam duke vepruar ashtu si e kam bërë top mendjen. Ju lutem, as edhe një fjalë mos i thoni zonjës pér pakënaqësitë që ju shpreva. Se unë nga gjithçka jam e kënaqur. Vetëm nganjëherë seç më leqendiset shpirti, kjo është e gjitha... — E hoqi dorën nga supi im, dhe atë çast më tregoi me dorë në drejtim të «Rërës së Tallazitur». — Pa shihni, — më

E pranoj që toni i bisedës nuk qe aspak i hijshëm, por nga njeriu i shkretë s'ke ç'të presësh aq shumë, as nga unë s'ke ç'pret më shumë.

— Takova Penelopën, — vazhdoi zoti Frenklin, — dhe ajo më tregoi. Keni vajzë pér kokën e vajzës, Beterexh... E ç'erë i kishte sjellë ata në këto anë?

Ia kallzova gjithë sa dija pér ta zotit Frenklin. Ndërkaq s'kisha si të mos vija re se sa vinte e po i shuhej ai ngazëllimi i atyparshëm. Qëndronte kokulur dhe ngacmonte mjekrën. Pér-sëriti vetëm dy pyetje që indiani i kishte bërë djalit:

— «Nëpér këtë rrugë e jo nga ndonjë tjetër do të vijë sot anglezi? A e ka me vete atë?» Dyshoj, — vijoi zoti Frenklin, duke nxjerrë nga xhepi një paketë të vogël të mbështjellë me kujdes, — që ajo atë ja se ç'do të thotë; do të thotë, Beterexh, diamanti i famshëm i xhaxhait tim Xhon Hernkastlit.

— Zoti ju ruajt, zotéri! — bërtita. — Si u gjend tek ju diamanti i kolonelit fatkeq?

— Gjynahmadhi kolonel në testamentin që la ia caktoi këtë diamant si dhuratë kushurirës sime, Reçëllit, me rastin e ditëlindjes, — tregoi zoti Frenklin. — Im atë, si përmbarues i atij testamenti, ma ngarkoi mua detyrën që ta sillja këtu.

— Babai juaj qënka përmbarues i testamentit të kolonelit? Vë bast, zoti Frenklin, që babai juaj s'do të ketë dashur të ketë të bëjë me kolonelin!

— Ashtu vërtet, Beterexh! Po ç'mund të them unë pér kolonelin. Ai është njeri i brezit tuaj, më tregoni gjithë sa dini pér të, kurse unë do ju kallzoj si u bë im atë përmbarues dhe diçka më shumë. Se në Londër kam mësuar ca gjëra që s'i bëjnë under xhaxhait Hernkastl dhe diamantit të tij, desha të di në i pohoni edhe ju?

Kur e pashë të më fliste seriozisht, i rrëfeva gjithë sa dija.

S'është zog i mirë ai që lëshon gëlasa në folënë e tij. Familjen e konsideroj si folenë time, ndaj s'do i futem hollësive pér Xhonin nga derë e madhe. Jam plotësisht i bindur se ka qënë një nga maskarenjtë më të mëdhenj që kanë ekzistuar në botë. Nisi shërbimin ushtarak në regjimentin e gardës. U detyrua ta braktisë para se të mbushte njëzet e dy vjeçët, — s'kam pér ta thënë pérse. U nis pér në Indi pér të provuar fatin. Sa pér trimëri, mund të them se qe një përzierje e qenit

bulldog me kaphoshin sherrxhi. Mori pjesë nē sulmin e Seriņga-patamēs. Mē pas i ra pika e diellit dhe u kthyē nē Angli.

Kishte emēr aq tē keq, saqē iu mbyllēn tē gjitha dyert e sojme. Zorja jcnē (qē sapo ishte martuar) kishte qēnē ndér tē parat qē e shpalli atē ndalesēn pēr tē vēllanē (kuptohet nē mirēkuptim me tē shoqin). Kishte shumē njolla nē reputacionin e kolonelit, po ju kujtoj vetēm njérēn qē ka tē bējē me «Gurin e Hēnās». Kurrē, kērkujt nuk i pat rrēfyer si i ra nē dorē ky diamant me vlerē fantastike nga India. Nuk u orvat goftē edhe njē heiē, as ta shesē e as ta dhurojē. Qarkullonin zēra se kētē ai nuk e bēnte ngaqē e dinte se mund t'i kushtonte kokēn. Veç edhe nē Indi, edhe kētu nē Angli, e mbante vetē atē diamant, duke i treguar tē gjithēve se s'ia bēnte syri tērt nga kjo. Pēr tē ēshtē folur e c'nuk ēshtē folur; sido qē tē ishte, bēnte jetē vemitare, veseshumē, misterioze. Unē vetēm njē herē pata rastin ta shohē kur qe kthyer nē Angli.

Ndonja njē vit e gjysmē para se tē vdiste, koloneli pa pritur e pa kujtuar i bēri njē vizitē zonjēs nē shtēpinē e saj nē Londēr, me rastin e ditēlindjes sē Reçellit. Ishte orvatur disa herē tē pajtohej me tē motrēn nēpermjet letrave vetēm e vetēm qē t'i punonte ndonjē rrēng (pēr kētē jam plotēsisht i bīdur). Nē shtēpi tek ne ai vinte pēr herē tē parē. Kur ia njof-tova, mora nga zonja kētē pērgjigje:

— I theni kolonelit Hernkastl se zonja Verinder ēshtē e zēnē dhe nuk ka as dēshrēn mē tē vogēl qē ta takojē.

Bēra ta bindja zonjēn qē t'i jepte njē pērgjigje mē tē butē, duke e ditur qē ky koloneli s'para i pērmbahej ca rregulla-ve tē mirēsjelljes qē zakonisht i kanē nē gjak xhentēllmenēt. Por e pēsova. Rrēmbimi i saj, i trashēguar nga tē parēt, u zbraz mbi mua.

— Kur kam nēvojē pēr ndonjē kēshillē tuajēn, — mē tha, — e dini fort mirē qē jua kērkoj unē vetē. Tani nuk jua kēr-kova.

Zbrita poshtē dhe mora mbi vete pērgjegjēsinē t'i flas me njē tekst paksā tē zbutur.

— Zonja dhe zonjusha Reçell ju kērkojnē ndjesē se janē tē zēna, kolonel, — i thashē. — Ju vjen shumē keq qē s'do tē kenē nderin t'ju presin.

Thashë me vete se do të më përvishej, por për çudinë tímë të madhe kjo nuk ndodhi: koloneli më kalli datën me atë qetësinë e panatyrrshme që tregoi. Qeshi nën buzë dhe si të fliste vetë me veten, me zë të ulët e ligësi të tmerrshme, në-përdhëmbi:

— Ju faleminderit, Beterexh. S'kam për ta harruar kurë këtë ditën e lindjes së mbesolles sime.

U kthyesh rrëmbimthi dhe doli.

Para një gjysmë viti zonja mori një letër nga një pastor tepër i respektuar, në të cilën thuhej se, kur kishte qënë duke dhënë shpirt, koloneli ia kishte falur gjithçka së motrës por edhe të tjerëve, se kishte vdekur i paqtuar. Vetë unë ushqej respekt të mirëfilltë për kishën, por jam i bindur se ky Xhoni sojili, që ka qënë kurdoherë nën pushtetin e djallit, kish bërë edhe një tjetër veprim të ndyrë: e kishte mashtruar pastorin.

— Në gjithë sa më kallzuat, — më tha zoti Frenklin, — shoh tri gjëra që duhen svaruar: a ka qënë ky diamant objekt sherrë në Indi, a vazhdoi ky sherr të mbetet i hapur edhe këtu në Angli dhe a ka qënë në dijeni të këtij sherrri vetë koloneli dhe mos vallë me paramëndim ia la trashëgim këtë minë motrës dhe bijës së saj të pafajshme?

— Lidhur me pyetjen e parë, — vazhdoi të tregojë zoti Frenklin, — në kërkim të disa dokumenteve për të vërtetuar të drejtën e trashëgimit të titullit të hercogut, im atë iu drejtua edhe zotit Hernkastl. Si këmbim për shërbimin ky i kërkoi t'i ruante diamantin e sjellë nga India. Kohë mbas kohe do i bënte të ditur me letër në ishte gjallë apo jo. Para tetë muajsh ky i kishte shkruar: «Zotëri, me sa duket, po më afron fundi. Ejani më ndihmoni të formuloj testamentin». Në të ai la si amanet që **Guri i Hënës** t'i dhurohej së mbesës për ditëlindjen. Formalitetet e kërkonis që ky diamant të çmohej përpara se të dhurohej në testament. Sekserët njëzëri pohuan se ky na qënka njëri nga xhevahirët më të mëdhenj të botës. Madhësia atë e bënte fenomenal, shkëlqimi e bënte të jashtëzakonshëm, të vëçantë, veç, duhet thënë, se kishte edhe një cen: një njollë të bardhë mu në mes. Edhe me këtë cen kushtonte më e pakta njëzet mijë stërlina. Kur e mësoi im atë këtë, qe trembur, deshi të mos e pranonte detyrën e përmbaruesit. Mori masa që të ruhej në vend të sigurt.

U sqaaran dhe rrrethanat si pat rënë në dorë të kolonelit Hernkastl ky gur i çmuar. Besimtarët e tempullit të perëndisë së Hënës, pavarësisht nga vështirësitë dhe sakrificat, domosdø që do ia kthenin xhevahirin perëndisë së tyre dhe ju jeni krejt një mendje me mua për durimin dhe këmbënguljen e banorëve të lindjes, për ndikimin që ushtrojnë mbi ta besimet fetare. Me këtë shpjegohet edhe shfaqja në këto anë e atyre tre indianëve fallxhorë.

Lind pyetja, a ka qënë koloneli në dijeni të rrezikut të atij që i binte rë dorë **Guri i Hënës?** S'ka dyshim që po. Mua s'ma kishte ënda fare që ta sillja atë këtu, por qeshë i detyruar, dikush duhej ta conte në vend amanetin. Kur e mora diamantin nga barka, m'u duk se dikush po më ndiqte, ishte një korrozi zhelan. Mezi munda t'i rrëshqas pérndjekjes së tij dhe u nisa për këtu me trenin e mëngjesit. Mbërrita, siç më shihni, shëndoshë e mirë. Por ç'më dëgjuan veshi? Që paskan qënë tre indianë erdacakë. Sa për atë mellanin që derdhën në dorën e vogëlushit për të parë se ku ndodhet njeriu me diamantin, kjo s'është veçse fall. Kam patur rastin të shoh shpesh kësi numrash në Lindje. Fër ne ka rëndësi të sqaaromë ja se çfarë: në është thjesht rastësi kjo ardhja e tyre këtu, apo indianët kanë rënë në gjurmët e **Gurit të Hënës?**

Pamë sy ndër sy njeri-tjetrin, pastaj baticën që gjithë më tepër përmbytte rërën e tallazitur.

— Për çfarë mendoni? — më pyeti befas zoti Frenklin.

— Po ja, zotëri, ndiej një dëshirë të papërbajtshme që ta flak atë diamant në këtë rërë të tallazitur dhe t'i jepet kështu njëherë e përgjithmonë fund kësaj meseleje.

— Nëse ju gjenden në xhep aq para sa duhen për ta blerë këtë xhevahir, atëherë më thoni, Beterexh, jam gati ta flak atë në baticë.

— Zoti Frenklin qe i pari që iu kthye përsëri temës së bisëdës sonë. Nxori nga xhepi një zarf, e hapi dhe më zgjati letrën.

— Beterexh, — më tha, — për hir të tetos më duhet të merakosem për arsyen që e ka shtyrë kolonelin t'i lërë trashë-gim mbesës këtë diamant. Ndërmendni ato marrëdhënet e zgnjës Verinder me të vëllanë, fjalët e tij se s'kishte për ta harruar ditën e lindjes së mbesollez.



Në letër ishte kopjuar ajo pjesë e testamentit të kolonelit ku flitej për këtë dhuratë. Shtanga nga habija.

— Hë, — më pyeti zoti Frenklin. — Tani që e patë qđo gjë vetë, qđo më thoni. Duke sjellë këtu këtë Gurin e Hënës, jam duke i shërbyer hakmarrjes që ka pasur në mendje koloneli apo jam duke çuar në vend pendimin para vdekjes së një të krishteri.

— Është e rëndë ta përfytyrosh gjithë qđ po ndodh zotëri, — iu përgjigja. — Se ku i dihet si të ketë dhënë shpirt ai njeri; me hakmarrjen ndyraqë në zemër apo me mashtrimin ndyraq nё buzë. Vetëm një Zot e di të vërtetë. Mua mos më pyesni.

— Nuk dua ta trëmbë teton pa pasur për këtë shkaqe, — shtoi zoti Frenklin, — por nuk dua të mos i bëj edhe ndonjë paralajmërim. Të ishit ju nё këmbën time, Beterexh, qđo të bënë? A s'ma thoni dot me dy fjalë?

— Do të prisja.

— Do ta bëj me gjithë zemër, — më tha zoti Frenklin. — Po sa kohë?

Zura t'ia shpjegoj mendimin tim.

— Siç e kuptova unë këtë punë, zotëri, — i fola, — dikush duhej t'ia sillte këtë diamant të mallkuar zonjushës Reçell për ditëlindje, ju këtë e bëtë siç mund ta bënte edhe gjithkush tjetër. Bukuri. Sot jemi më 25 maj, ditëlindja i bie të jetë më 21 qershor. Kemi nё dispozicion rrëth katër javë. Të presim e të shohim, qđo të ndodhë gjatë kësaj kohe; pas kësaj ose e paralajmërojmë zonjën, ose shohim e bëjmë.

— Mrekullia vetë, Beterexh! — thirri zoti Frenklin.

— Po si t'ia bëjmë me diamantin deri atëherë?

— Të bëjmë atë që bëri ati juaj, zotëri, — iu përgjigja. — Ai e dorëzoi nё bankën e Londrés, ju dorëzojeni nё bankën e Frizingolit.

Frizingoli është qyteti që kemi më pranë dhe banka aty është po aq e sigurt si dhe bankat e tjera të Anglisë.

— Të qeshë nё vendin tuaj, zotëri, — shtova sakaq, — do i hipja kalit dhe do e çoja pa vonesë, para se të ktheheshin zonjat.

— Beterexh, ju jeni flori e jo njeri! — më tha. — Shkojmë dhe urdhëroni të shalojnë kalin më të mirë të stallës...

Po afronte ora e ngrënies së darkës, kur te porta ia behu zoti Frenklin që qe kthyer nga Frizingoli. I çova një legen me ujë të nxeh të në dhomë, me shpresën që të dëgjoja nga goja e tij ndonjë aventurë. Për çudinë time të madhe (por ndoshta edhe për tuajën) nuk kishte ndodhur asgjë. Nuk i kishte hasur indianët, **Gurin e Hënës** e kishte dorëzuar në bankë, duke thënë vetëm se ishte diamant shumë i shtrenjtë, dhe në xhep kishte dëftesën e dorëzimit. Zbrita poshtë me mendimin se pas gjithë ësaj trorditjeje të mëngjesit për diamantin, ky fund i tij do të ishte krejt i rëndomtë.

Po takimi i zotit Frenklin me teton dhe kushërirën si kishte shkuar? Iu drejtova me këtë pyetje zotit Frenklin, kur po bëheshim gati të flinim.

— Reçelli është vajza më hamgjitëse nga të tëra vajzat që kam takuar pasi jam kthyer në Angli! — ja kjo qe e gjitha që munda të shkëpusë nga goja e djaloshit.

Aty nga mesnata së bashku me ndihmësin bëmë si zakonisht kontrollin e dyerve të shtëpisë. Ishin që të gjitha të mbyllura. Kishte mbetur hapur vetëm derë anësore që të conte në tarracë, u ndava me ndihmësin dhe dola për të marrë pak ajër të pastër.

Ishët një natë e qetë, zagushi, hëna shkëlqente në kupën e qiellit. Ishët aq qetë saqë dëgjoheshin edhe dallgëzimet e detit. Tarraca qe e zhystur në errësirë, por drita e zbehtë e hënës e rëndështë fare mirë rruginën që shkonte përgjatë murit dhe fshihej në qoshe. Kur pashë në atë drejtim, më zuri syri hijen e një njeriu atje në qoshen e shtëpisë.

Si i vjetër e me përvojë në kësi punësh, nuk bëra të thërrës kush ishët, por ama, për fat të keq, si plak njeri dhe i rënduar, rëra më kërciste nën këmbë dhe më ndien. S'kisha mbërritur ende te qoshku, kur dëgjova ca hapa më të lehta se të mijat dhe, sic m'u duk jo, të një njeriu të vetëm, që u larguan me ngut, u fshehën prapa ca gëmushave dhe më humbën nga sytë. Që aty ata fare lehtë mund të kapërcenin gardhin dhe të delnin në rrugë. S'kisha takat t'i ndiqja, ndaj dhe u ktheva përtë cuar pas tyre ca këmbë më të shpejta. Ndihmësi dhe unë

morëm armë, i ramë rrretherrotull shtëpisë, kontrolluam nëpër gëmuşa dhe, kur u bindëm që brenda territorit tonë askush nuk fshihej, u kthyem. Kur po kalonim nëpër rruginën, ku kisha parë atë hijen, vura re mbi rërën e ndriçuar nga hëna diçka shkëlqimtare. E mora, ishte një shishe boje, që mbante erë të këndshme.

Të nesërmen (data 26 maj) ia kallzova zotit Frenklin dhe i rrëfeva për gjithë sa kishte ndodhur natën. Më besoni, — më tha zoti Frenklin, — indianët janë të bindur që diamanti gjendet këtu tek ne, ata sollën me vete djaloshin magjistar që t'u tregonte si duhej ta merrnin kur të futeshin në shtëpi.

— Mendoni, zotëri, se do ta përsërisin këtë orvatje të tyre? — e pyeta.

— Varet nga ajo që do t'u thotë djali. Në qoftë i zoti përtë parë diamantin në kasafortën e hekurt të bankës së Frizgolit, indiarët tani përtë tani nuk kanë përtë na shqetësuar me vizitat e tyre. Nëse ai këtë s'ë bën dot, s'kanë përtë kaluar as disa net e do të kemi rastin t'i trembim përsëri kur të jenë të fshehur në ato gëmuşat.

Isha i përgatitur përtë këtë, por, o çudi, ky rast nuk u përsërit më.

Se u kishte rënë në vesh lajmi që zotin Frenklin e kishin parë në bankë dhe kishin nxjerrë nga kjo përfundimet e tyre, se vërtet ai djali e kishte gjetur ku ndodhej tani diamanti (këtë unë asfare nuk e besoj) apo mos ishte kjo thjesht koincidencë, s'arrita ta di, por këmbë indiani nuk u duk në anët tonë ato ditë deri në ditëlindjen e zonjushës.

Më 19 qershor ndodhi një ngjarje që s'duhet lënë pa u zë në ngoje. Erdhi mijeku përtë t'i bërë vizitë Rozana Spirmanit. Kjo vajzë fatkeqe, që aq shumë na habiti me atë sjeljen e saj te «Rëra e Tallazit», po na habiste edhe më tepër gjatë gjithë kësaj kohe. Mendimi që më shfaqi Penelopa se Rozana kishte rënë në dashuri me zotin Frenklin, (me porosinë time ime bijë këtë e ruante në fshehtësi të madhe) si dhe më parë më dukej gjepur. Por s'kishte si të mos e vije re që sjellja e shërbëtores së dytë që bërë tejet misterioze, përtë mos thënë diçka më tepër.

Zonja e pikasi këtë sjellje të shërbëtores dhe më pyetë c'mendim kisha. Bëra çmos ti dilja krah vajzës, dhe i thashë se

më dukej që s'para ndihet mirë; dërguan të thérresin mjekun dhe ndodhi ajo pér çka u fol. Ky konstatoi çrregullime nervore dhe shtci se do të ishte mirë të mos shërbente në këtë shtëpi. Zonja mendoi ta dërgonte pér klimë në një fermën tonë të largët. Rçzana i ra në gjunjë dhe iu lut me lot ndër sy që ta lejonin të qëndronte këtu; dhe, o orë ogurzezë, qeshë unë ai që e këshillova zonjën ta provonim edhe pér njëfarë kohe. Ngjarjet e mëpastajme, siç do të kemi rastin ta shohim, treguan se këshillë më të këqe se kjo s'kisha si të jepja. Se sikur të kisha dhundi profeti, do të isha unë ai që do ta kisha larguar Rozanët një orë e më përparrë nga shtëpia jonë.

6.

Më 21 qershori, ditën e lindjes së zonjushës, moti gdhiu me re por në mesditë doli dielli.

Ne shërbëtorët e filluam këtë ditë gëzimi, siç e donte zakoni, duke i çuar dhurata të vogla zonjushës Reçell, kurse unë mbajta atë fjalimin që mbaj qdo vit si kryeshërbëtor. Ndjek atë metodë që e ka bërë zakon mbretëresha me rastin e fillimit të punimeve të parlamentit, domethënë, përsëris qdo vit të njëjtën gjë. Këtë fjalë timen, ashtu si edhe atë të mbretëreshës, e presin me padurim, si diçka kurrë ndonjëherë të padëgjuar. Kur e shohin që aty nuk përbahet asgjë e re, dëgjuesit, edhe pse mërmërisin ca të pakënaqur, prapë shpresojnë të dëgjojnë diçka të re vitin e ardhshëm. S'është zor të drejtosh si parlamentin, ashtu edhe guzhinën — ja se ç'përfundim mund të nxjerësh nga kjo.

Pas mëngjesit zoti Frenklin pati me mua një bisedë të shkurtër pér **Gurin e Hënës**: duhej marrë nga banka e Frizingtonit dhe t'i dorëzohej Reçellit.

Në kishte provuar përsëri t'i shfaqte ndjenjat e dashurisë mikeshës së tij apo pagjumësia e zgjatur ia kishte shtuar edhe më kundërtitë çudishumë dhe pavendosmërinë e karakterit, ruk e di. Veç zoti Frenklin fare keq po e rekomandonte veten atë mëngjes: brenda njëzetë minutave njëzetë herë e ndryshoi mendimin pér diamantin.

Sa pér mua, nuk qeshë i mendimit se duhej ndryshuar qëndrimi që tē dy e kishim pranuar si më tē drejtin. Nuk kishte ndodhur qoftë edhe diçka që tē na jepet shkas tē përligjnim shqetësimin e zonjës lidhur me diamantin, kurse ligji e kërkonte që zoti Frenklin duhej domosdo t'ia dorëzonite zonjushës. Kjo ishte pikëpamja ime edhe pse zoti Frenklin e ndryshoi disa herë qëndrimin e vet; më në fund ai u detyrua tē binte në një mendje me mua. Vendosëm që tē nisej kaluar pas drekës pér në Frizingol dhe ta sillte këtu diamantin.

Pas kësaj zotëria i ri shkoi pér tē vazhduar, së bashku me zonjushën Reçell, bojatisjen e dyerëve. Penelopa u qëndronte pranë, duke e përzier bojën, kurse zonjusha hynte e dilte duke vënë në hundë shaminë (e kishin tepruar me atë tretësirën që kutërbonte). Vetëm në orën tre i hoqën përparëset, e lanë tē lirë Penelopën dhe u lanë e u pastruan me merak. Veç atë që deshën e kishin arritur: dera qe lyer pér ditëlindjen dhe me këtë krenoheshin sa më s'bëhet.

Zoti Frenklin hëngri bukë shpejteshpejt dhe u nis pér në Frizingol, që tē merrte ca kushërrira (kështu i tha zonjës); që tē merrte **Gurin e Hënës** (këtë e dinim vetëm ne tē dy).

U mora me punët e shumta tē përgatitjes së darkës. Nga punët dhe mendimet më shkëputi troku i kalit që solli zotin Frenklin dhe dy kushërrira tē tij shtatlarta, faqekuqe e zhurmëmëdha.

Zgjodha çastin e volitshëm dhe këmbeva dy fjalë me zotin Frenklin.

— Cdo gjë në rregull është me diamantin, zotëri?

Tundi kryet dhe preku me dorë vendin në xhepin e brendshëm ku e kishte vënë.

— I patë gjékundi ata indianët?

— As edhe një.

Pas kësaj më pyeti ku qe zonjusha dhe, kur dëgjoi se ishte në dhomën e vogël tē pritjet, u nis pér atje. S'kaloi shumë dhe që andej u dëgjuan britma habije; mahnitjeje dhe entuziazmi. Kur hyra (me pretekstin diç tē pyesja pér punë tē darkës) pashë zojunshën Reçell që qëndronte e mahnitur me diamantin ogurzi tē kolonelit në dorë e rrethuar nga kushërritat që e shihnin si tē fandaksura dhe s'dinin si ta shprehnin entu-

ziazmin, kur vinin re se si e këmbente shkëlqimin sa herë që e lëvizje.

— I mrekullueshëm! I mahnitshëm!

Vetëm ca fjalë si këto dëgjoje nga të katër anët.

Zoti Frenklin rinte me kutinë përpara dhe trazonte i merakosur me dorë mjekrën, duke parë herë pas here tërë shqetësim nga dritarja. Aty qëndronte më këmbë zonja me shpinë nga gjindja dhe lexonte atë pjesë të testamentit që i kishte dorëzuar zotin Frenklin.

Kur më pa, më tha:

— Ejani tek unë pas një gjysmë ore. Duhet t'ju them diçka.

Në këtë e sipër doli nga dhoma e pritjes. Dukej sheshit që po e brenin po ato dyshime si edhe zotin Frenklin e mua, kur bisetonim te «Rëra e Tallazitur». Ç'kuptim të kishte vallë ky testamenti i kolonelit?

Para se të dilja nga dhoma, zonjusha Reçell, kürdoherë e vëmendshme më shërbëtorin e vjetër, që kishte qenë në atë shtëpi qysh nga dita kur ajo kishte lindur, më ndali me fjalët:

— Pa shiheni dhe ju, Gabriel!

Ndërkokë e çoi diamantin në rrezen e diellit që binte nga dritarja.

Zot, o perëndi! Ç'mrekulli! I madh sa vezë e kanarinës! Shkëlqimi që rrezatonte njante si vezullimi i hënës së plotë. Kur e shihje, të përpinte të tèrin ajo thellësia kaltëroshe, s'i shqisje dot më sytë. Ajo thellësi të dukej e pamatë; ky diamant që mund të mbahej ndërmjet gishtit të madh dhe atij tregues, dukej si të ishte pa fuind e anë, si vetë qelli. Në fillim mbi të binin rrezet e diellit, pastaj myllën grilat dhe ai rrezëllinte në atë gjysmëerrësirë me ngjyresat vetjake si shkëlqimi i hënës. S'kishe pse habiteshe që zonjusha Reçell kishte mbetur pa mend, që kushërirat s'i përmbanin dot thirrjet e adhurimit. Diamanti më joshi aq shumë, saqë s'bëra dot pa thirrur: «Ah...»

Pas një gjysmë ore shkova, siç më patën urdhëruar, në dhomën e zonjës. U përsërit gjithë sa kam treguar për bisedën me zotin Frenklin te «Rëra e Tallazitur», veçse s'i hapa përfallxhorët. Indianë sepse nuk kisha asnjë arsyë ta trembja zonjën përderisa mungonin shënjas. S'kisha si të mos vija re që

zonja ime këtë dhuratë të kolonejt e cilësonte ogurzezë dhe të rrezikshme dhe me veten e saj e kishte marrë vendimin ta largonte një orë e më parë nga e bija.

7.

Zunë të mblidhen miqtë. U bënë gjithsej njëzet vetë bashkë me të zotët e shtëpisë. C'pamje madhështore qe ajo, kur zunë vendet në tryezë dhe pehkopi nga Frizingoli nisi të shqiptojë lutjen me atë zërin mrekullisht të bukur.

Nuk dua t'ju lodhë me përshkrimin e të ftuarve. Ju nuk keni për t'i hasur kund; në këtë tregimin tim jo që jo, me përjashtjm të dy vetave.

Janë ata që kishin zënë vend në të dyja anët e zonjushës Reçell, e cila si mbretëreshë e gostisë, kuptohet që ishte fokusi i vëmendjes së krejt shoqërisë. Kësaj radhe ajo më shumë se kurdoherë ishte në qendër të vëmendjes edhe ngaqë në gjoks i rezellinte dhurata mahnitëse që errësonte gjithçka tjetër: Guri i Hënës. Dhurata nuk kishte pasur skelet, por zoti Frenkin, njeri me duar të arta, i sajoi një varëse sërmi përfustanin e lardhë. Kuptohet të gjithë i mahniti si madhësia ashtu edhe shkëlqimi krejt të pazakontë të diamantit. Vetëm dy prej myafirëve u shprehën në një mënyrë të veçantë: ishin ata, që kishin zënë vend në të dyja anët e zonjushës Reçell.

Mysafiri që rrinte në krahun e majtë ishte zoti Kandi, mjeku i Frizingolit. Ishte një burri shqipëtare, i këndshëm dhe i afuar me njerëzit, por që, s'kemi pse e fshehim, me një të metë në karakterin e tij: i pëlqente shumë, me vend dhe pa vend, të mburrej e të krekoj me shakatë e veta dhe të hynte ca si ters në bisedë me njerëz të panjohur. Jo rrallë lajthiste dhe si pa gjë të keq bënte të grindeshin mes tyre të tjerët. Veç në përcaktimin e diagnozave ishte tepër i kujdesshëm, dhe falë instinktit të zhvilluar (sipas fjalëve të kundërshtarëve të tij) që i saktë, ndërkokë që ca mjekë më të arsyetueshëm gabonin. Gjithë sa tha lidhur me atë diamantin e zonjushës Reçell, e tha në atë mënyrën e tij të zakonshme paksa të mistifikuar dhe paksa qesharake. Iu lut e iu fal (për hir të shkencës) t'ia

jepte diamantin pér pak kohë që ta provonte me anë të djes.

-- Në fillim e nxehim pak, zonjushë, — i thoshte doktori, — deri në një temperaturë të caktuar, pastaj e lëmë të veprojë mbi të ajri, dhe pak nga pak e bëjmë që ai të avullojë, duke ju çliruar kështu juve nga përkujdesi pér ruajtjen e një guri aq të qmuar.

Zonja e shihte me një merak të pafshehur në fytyrë, si të dëshironte që doktori tërë këto t'i thoshte seriozisht dhe të arrinte kësisoj të ngjallte te Reçëlli dëshirën pér ta sakrifikuar atë dhuratë në dobi të shkencës.

Mysafiri tjetër, që rrinte në krahun e djathtë të zonjushës Reçëll, ishte udhëtar i famshëm nëpër Indi, zoti Mertuet. Duke vënë kckën në rrezik, i veshur si indian kishte mundur të depërtonte aty, ku kurrë ndonjëherë nuk kishte shkelur këmba e ndonjë evropiani.

Ishte një burrë shtatlartë, korrozi, i heshtur, me një shikim të lodhur por të fortë dhe të vëmendshëm. Qarkullonin zëra se i kishte ardhur në majë të hundës ajojeta e rëndomtë mes njerëzve të këtyre anëve dhe i rrinte mendja tek vendet e egra të Lindjes. Me përjashtim të asaj që i tha zonjushës Reçëll lidhur me diamantin, zor se tha më shumë se gjashtë fjalë, ai nuk piu më tepër se një gotë verë gjatë tërë darkës. Guri i Hënës qe e vetmja gjë që në një farë mase e interesoi. Për të, me ç'dukej, ç'prej kohe diç kishte dëgjuar gjatë udhëtimeve nëpër Indi. Ia nguli fort shikimin dhe heshti aq gjatë, saqé zonjusha Reçëll mbeti e turbulluar, pastaj i tha me atë gjakftchtësinë e tij të zakonshme:

— Në ju çoftë rruga që të udhëtoni nëpër Indi, zonjusha Verinder, mos e merrni me vete këtë dhuratë të dajës. Diamanti indian mbahet në Indi si relikë kulti fetar. Di një qytet dhe një faltore në të ku, me të mbërritur, s'do të qëndronit dot as pesë minuta gjallë, në paçi me vete këtë stoli.

Zonjusha Reçëll, duke qënë jashtë çdo rreziku këtu në Angli, i priti e entuziazmuar fjalët pér rrezikun që i kanosej në Irди. Kushërirat fjalëshume zunë të hazdisen edhe më, duke hedhur e pritur tërë hare thikat e pirunjë e duke thirur me zë të lartë.

— Sa gjë interesante!

Zonja u mbrohd në karrigen e saj dhe e këmbeu temën e bisedës.

Nga ç'vura re, mund të them se kjo festë e ditëlindjes ka-loi më keq se të tjerat. Duke kujtuar tani gjithë ç'ka ndodhi më pas, mund të them se diamanti ogurzi përhapte mënxyrë e pikëllim. I qerasja miqtë me verë dhe u lutesha të provonin ato gatimet që u kishim shtruar, por fjalët më shkonin kot. Në në-ntë raste nga dhjetë mernin vetëm nga respekti për plakoshin Beterexh, por vetëm kaq. Biseda zhvillohej e zvargur, madje e sforcuar. Zoti Kandi shumë më tepër se zakonisht fliste me romuze.

Mos ju shkon në mendje që ishte zoti Frenklin ai që do bë-hej shpirti i shoqërisë dhe që do ta tjetërsonte këtë në darkë të këndshme? Aspak! Vërtet që s'qe keq me humor, por ndër dhjetë tema që kapi, nëntë qenë të pasuksesshme: disa i fyeu, të tjerët i bëri të mendohen. Edukata perëndimore që kishte marrë e tregoi veten në dritë të shtrembër në këtë tryezë mik-pritëse të zonjës Verinder.

Jo vetëm kaq, por kur ajo edukatë angleze zinte e nxirte krye, ky e humbiste atë lustrën perëndimore dhe, kur u ndez debati për profesionin e mjekut, i vuri aq shumë në lojë, saqë mend e çmendi babaxhanin zotin Kandi.

Debati mes tyre u ndez kur zoti Frenklin deshi s'deshi u detyrua ta pranonte që kohët e fundit vuante nga pagjumësia. Zoti Kandi i vuri në dukje se i qenë çkurdisur nervat dhe du-hej të kurohej. Zoti Frenklin ia ktheu se të kurohesh dhe të ecësh me hamendje mes territ, përmendimin e tij, éshtë e njëjta gjë. Zoti Kandi, duke iu përgjigjur me një flakërimë të saktë, i tha se vetë zoti Frenklin éshtë duke e kërkuar me ha-mendje gjumin mes territ dhe éshtë vetëm mjeksia ajo që do ta ndihmonte ta gjente ku ndodhej. Zoti Frenklin, duke u or-vatur ta shpérblejë me po atë monedhë, i tha se kishte dëgjuar shpesh të flitej se si një i verbër heq hosh një tjetër të verbër dhe se vetëm tani po e kuptonte me tamam se ç'donte të tho-shtë kjo. Kësisoj dhanë e morën pa e kuisyer m...jemp...htë-sinë, dhe qenë nxehur aq shumë, e sidomos zoti Kandi, duke dashur ta marrë në mbrojtje profesionin e tij, saqë zonja u detyrua të ndërhynte dhe t'u ndalonte vazhdimin e mëtej-shëm të debatit. Ky urdhër, i diktuar nga nevoja, e zhduku

përfundimisht gëzimin e darkës. Ndonjë vatër bisede që u ndez aty-këtu, nuk zgjati më shumë se dy-tri minuta, por edhe ato qenë fare pa jetë, pa zjarr. Satanaja (apo diamanti) u bë sundimtar i gjithfuqishëm dhe gjindja psherëtinë të lehtësuar, kur zonja e shtëpisë u çua dhe u bëri shenjë grave t'i linin burrat të vazhdonin të pinin verë.

Sapo kisha vënë gotat dhe garafët me verë mbi tryezë, kur në taracë u dëgjuan ca tinguj që më trembën aq shumë, saqë u detyrova të mos e ruaj dot atë sjelljen prej njeriu të shoqërisë së lartë. U pamë sly ndër sy me zotin Frenklin: ishin tingujt e daulleve të indianëve. Jam gati të vë çdo lloj basti në qoftë se fallxhorët nuk u kthyen tek ne ngaqë këtu u gjend **Guri i Hënës**.

Ata apo kishin hyrë në taracë, kur vrapova që t'i zboja. Por, për fat të keq, kushërirat fjalamane kishin dalë më përrapa, pas tyre po vinin edhe gra e burra të tjerë. Zoti Frenklin qëndronte pranë zonjushës Recëll, kurse unë prapa tyre. Dëshimet tonë tani s'ishin më dyshime, kurse ajo qëndronte para indianëve dhe në fustan i rrezellinte **Guri i Hënës**.

I mërzitur nga dreka zymtake dhe i zemëruar nga ata bataçinj që kishin mundur të vinin tamam kur u duhej përt ta parë diamantin me sytë e tyre, të them të drejtën, e kisha humbur pusullën fare. Më ndërmendet vetëm zoti Mertuet që, pasi la mënjanë grumbullin e ardhhanakëve dhe të atyre që kishin dalë nga salla e ngrënies, iu afroa nga pas fallxhorëve dhe zuari t'u flasë në gjuhën e tyre.

Sikur t'u kishte vënë në grykë kamën, them se s'do të ishin trembur asisoj ata njerëz, nuk do të ishin kthyer nga ai me atë shpejtësi që u kthyen, kur dëgjuan t'u flisnim në gjuhën amtare. Zunë t'i përkulen me shumë mirësjellje dhe nënshtrim. Pasi këmbeu me ta disa fjalë, zoti Mertuet u largua po aq qetë sic dhe kishte ardhur. Kokësi i tyre, që ishte edhe në rolin e përkthyesit, u kthye përsëri nga të pranishmit. Vura re që fytyra e kaftë iu hirnos pas bisedës me zotin Mertuet. Iu përkul zonijs dhe i tha se shfaqja kishte marrë fund. Djali kaloj sa te njëri te tjetri me kapelen e zgjatur përpara. Gratë u kthyen në dhomën e pritjes, kurse burrat (me përjashtim të zotit Frenklin dhe zotit Mertuet) u kthyen përtë pirë verë.

Unë me një shërbëtor tjetër u shkova pas indianëve që t'i nxirrja nga sinori i shtëpisë sonë.

Kur po kthehesha, pashë si bënин ecejake në kopsht zoti Frenklin dhe zoti Mertuet. Zoti Frenklin më bëri shenjë që t'u afrochesha.

— Është Gabriel Beterexhi; — më prezantoi me udhëtarin e njojur. — Kryeshërbëtori i shtëpisë, për të sapo ju fola. Ia thoni edhe këtij, kini mirësinë, gjithë sa më kallzuat mua.

Zoti Mertuet hoqi cigaren nga buzët dhe, me atë pamjen e vet prej njeriu të lodhur, zuri të flasë:

— Zoti Beterexh, këta tre indianë janë fallxhorë po aq sa ç'jemi edhe unë e ti.

Një e papritur e re! E pyeta në i kishte takuar edhe më parë.

— Kurrë ndonjëherë! — m'u përgjigj. — Por i di mirë ato fallet e indianëve unë. Ajo që patë, s'është veçse një imitim i keq i tyre. Në s'më mashtroftë përvoja, ata janë brahmanë të kastës së lartë. U thashë që s'janë aspak fallxhorë dhe u turbulluan keq, edhe pse indianët janë mjeshtër për të fshehur ndjenjat. Dic fshihet në tërë këtë sjellje të tyre, që s'jam në gjendje ta zbuloj; kanë bërë dy herë gjynah: që kanë kaptëcyer detin dhe që janë veshur si fallxhorë. Atje tek ata ky konsiderohet krim e shkuar krimit. Duhet të kenë një arsyë të fortë që e kanë bërë dhe një justifikim të jashtëzakonshëm për t'u pranuar rishtas në kastën e tyre, kur të kthehen në atdhe.

Shtanga i mahnitur. Më në fund zoti Frenklin e ndërpreeu heshtjen:

— Nuk do ta merrja guximin, zoti Mertuet, t'ju shqetësoja për një çështje që i takon vetëm familjes sonë, që juvë mund të mos ju interesojë fare dhe për të cilën unë thua jse s'flas jashtë rrëthit tonë familjar. Por, mbas asaj që na thatë, e quaj veten të detyruar, për hir të zonjës Verinder dhe vajzës së saj, t'ju rrëfej për diçka që ndoshta juva vë në dorë kyçin. Jua them tepër sekret dhe shpresoj që të mos ju dalë kjo kurë nga mendja.

Ia kallzoi tërë historinë këtij udhëtarit të shquar, ashtu si ma kish treguar mua te «Rëra e Tallazitur». Edhe Mertueti

flegmatik u intrigua aq shumë nga ajo që dëgjoi, saqë iu fik edhe cigarja.

— Ç'mund të thoni pas gjithë kësaj, nisur nga përvoja juaj e pasur? — pyeti zoti Frenklin.

— Mund t'ju them atëherë, — iu përgjigj udhëtari, — se tërë jétën time plot rreziqe unë s'kam qënë ndonjëherë aq afër vdekjes sa ju, zoti Blek.

— Të jetë këshfu vërtet?

— Për mendimin tim, po. S'kam as më të voglin dyshim se kthimi i Gurit të Hënës atje ku e ka vendin, në ballin e idhullit indian, është shkaku dhe justifikimi i shkeljes së nomit të kastës, pér çka sapo ju fola. Indianët do të presin rastin e volitshëm me durim maceje, dhe kanë pér të vepruar me egërsinë e tigrat. Si mundët që t'u shqëtonit, as që arrij dot ta kuptoj. Keni udhëtar sa dhe si ju ka dashur qejfi me diamantin me vete nëpër Londër, dhe jeni ende gjallë! Po përpinqemi ta shpjegojmë këtë. Atje në bankën e Londrës të dy herët keni shkuar ditën, apo jo?

— Po, — iu përgjigj zoti Frenklin.

— Dile rrugët kanë qënë plotepërplot me njerëz?

— Po.

— Ju, sigurisht, ia bëtë të ditur zonjës Verinder kohën e ardhjes këtu. Rruga deri në stacion është pak e rrahuar. Erdhët tamam sipas njoftimit?

— Jo, mbërrita katër orë më parë seç kisha njoftuar.

— Ju uroj nga zemra pér këtë! Po në bankën e Frizingolit kur e çuat?

— Ndonjë orë pasi mbërrita këtu dhe tri orë përpara kohës së caktuar të ardhjes.

— Më lejoni t'ju uroj edhe një herë nga zemra! Nëse do ju mbushet mendja të udhëtoni në ndonjë vend jashtë kufijve të civilizimit, zoti Blek, kini mirësinë të ma bëni të ditur, do të vij edhe unë me ju. Qënkeni njeri fatlum!

Në këtë e sipër ndërhyra unë. Pikëpamjet e mia, të anglezit, s'kishin si pajtoheshin me kësi gjërash.

— Mos doni të thoni, zotëri, — fola prerë, — se indianët do ta kishin vrarë zotin Frenklin, pér t'i rrëmbyer diamantin, në se ju jepej rasti?

— Pini duhan ju, zoti Beterexh? — më pyeti udhëtari.

— Po, zotëri.

— A e çmoni hirin që ju mbetet në llullë?

— Aspak, zotëri.

— Në atë vend nga kanë ardhur ata njerëz, jetën e njeriuut e çmojnë po aq pak sa çmoni ju hirin e çibukut tuaj. Edhe në qëndroftë para jeta e një mijë njerëzve pér të kthyer diamanatin, ata as që do mendoheshin fare, do i vdisnin që të gjithë. Sakrifikimi i kastës éshëtë diçka serioze në Indi, sakrifikimi i jetës nuk éshëtë ndonjë kushedi çfarë.

Lidhur me këtë s'vonova t'i quaj ata indianë bandë hajdutësh dhe vrasësish. Zoti Mertuet shprehu mendimin e tij dhe i quajti njerëz të çuditshém. Zoti Frenklin nuk shprehu asnjë lloj mendimi, por e çoi llafin përséri te çështja.

— Ata e panë **Gurin e Hënës** në fustanin e zonjushës Verinder, — tha. — Ç'duhet bërë?

— Atë që kërcënonte të bënte xhaxhai juaj, domethënë ta copë ori — iu përgjigj zoti Mertuet. — Koloneli Hernkastl e dinte fort mirë se me ç'njerez kishte të bënte. Qysh nesër çojeni diçmantin me njerëz të besuar në Amsterdam. Porositini të bëjnë nja një gjysmë duzinë me brilantë në vend të njërit. Atëherë ky nuk do të jetë më ai guri i shenjtë i Hënës, merr fund kësijoj edhe rreziku.

Zoti Frenklin pa nga unë.

— S'na mbetet tjeter vec të bisedojmë nesër me zonjën Verinder.

— Po sot si do ia bëjmë, zotërinj? — pyeta. — Po sikur të kthehen indianët?

Zoti Mertuet e mori fjalën para zotit Frenklin.

— Indianët sonte nuk kanë pér t'u kthyer. Se ata kurrë s'i bëjnë punët në rrugë të drejta, pa le pastaj kur éshëtë fjala pér këtë, se edhe gabimi më i vogël mund të rrezikojë misionin.

— Po sikur këta torovela të tregohen më të guximshëm nga ç'i pardehni ju, zotëri? — ngula këmbë unë.

— Atëherë lëshojini qentë nga zinxhirët, — tha zoti Mertuet. — Keni qenë stani këtu?

— Kemi dy zotëri.

— Janë më se të mjaftueshëm.

Sakaq u dëgjuan tingujt e fortepianos. Zoti Mertuet mori nga krahу zotin Frenklin që të ktheheshin te zonjat. Duke çapitut pas tyre, vura re se moti qe me re. Edhe zoti Mertuet e vuri re këtë. Pa nga unë dhe me atë tonin ironik të ngahershëm tha:

— Indianët që të vijnë duhet të jenë të pajisur me ombrella, zoti Beterexh!

Kollaj të bëje shaka në atë situatë.

8.

Kur edhe më i fundmi i mysafirëve kishte ikur, u ktheva në sallë dhe e gjeta njërin nga shërbëtorët duke përgatitur konjak me ujë sode. Zonja dhe zonjusha Reçell erdhën nga dhoma e pritjes të shoqëruara nga dy zoterinj: Zoti Godfri dhe zoti Frenklin. Zoti Godfri piu konjak me ujë sode, kurse zoti Franklin nuk deshi. Ky u ul; kishte një pamje njeriu të kapitut. Dukej sheshit që tërë ç'po ndodhët në këtë ditë të shënuar e kishte munduar për vdekje.

Zonja, duke iu drejtuar me urimin: «Natën e mirë», nuk mënoi t'ia qepë shikimin dhuratës së kolonelit rrëngaxhi, që shkëlqente në fustanin e së bijës.

— Reçell, — i tha, — ku mendon ta vësh diamantin?

Zonjusha Reçell ishte në humor të mirë, në një të tillë gjendje shpirtërore, kur njeriu thotë gjepura dhe i mbrojn me aq zjarr, si të qenë nga më të arsyeshmet, një humor ky që jo rrallë vihet re te vashat e reja, pas ditës së kaluar në vrunduj emocionesh. I tha se s'dinte ku ta vinte diamantin. Pas pak shtoi: «Epo, po e vë mbi tryezën e tualetit bashkë me arturinat e tjera». Pastaj u kujtua që diamanti mund ta trembte natën me atë shkëlqimin e çuditshëm si të hënës dhe i shkoi mendja tek ai dollapi indian që t'u jepte mundësi dy këtyre suvenirëve të mrekullueshëm të huaj të adhurojnë njëri-tjetrin. Zonja, që po e ndiqte me shumë durim tërë këtë dërdëllitje të së bijës, ia preu me këto fjalë:

— Moj shpirte, po dollapi indian nuk ka çelës!

— O Zot! — thirri zonjusha Reçell. — Po pse ku jemi këtu në hotel, pse mos kemi hajdutë në shtëpi.

Zonja e la pa përgjigje këtë replikë të së bijës dhe i uroi zotërinjve natën e mirë, pastaj u kthyte nga e bija dhe e puthi.

— Përse të mos ma japësh mua ta ruaj diamantin? — e pyeti.

Zonjusha Reçell këto fjalë i priti siç do ta priste para dhjetë vjetësh kérkesën për t'u ndarë me kukullën e dashur. Zonja u bind se të ngulje këmbë ishte e kotë.

— Eja tek unë në mëngjes, sapo të çohesh nga gjumi. Do të të them diçka, — i foli.

Zonja doli nga dhoma e vrenjtur, me ç'dukej aspak e kënaqur me rrjedhën e mendimeve që e kishin kapérthyer.

Fill pas saj u largua edhe zonjusha Reçell. Në fillim i shtrëngoi dorën zotit Godfri, që qëndronte në fundin tjetër të sallës, duke parë tablotë në mur. Pastaj iu drejtua zotit Frenklin, që ashtu i kapitur siç ishte, rrinte i heshtur në qoshen përballë.

Cifjalë këmbyen, s'mund ta them. Por duke qëndruar në një vend ku pasqyrimi në pasqyrë më lejonte të shihja qdo lëvizje të tyre, pashë se si zonjusha i tregoi me shenjë zotit Franklin medaljonin me diamantin dhe i buzëqeshi. Kuptohet, kjo kishte një domethënë të mirëfilltë. Thashë me vete se imë bijë, Penelopa, kushedi paska patur të drejtë kur më tregonte për ndjenjat e zonjushës Reçell ndaj zotit Franklin.

Sapo zonjusha pushoi së verbuari me praninë e saj zotin Franklin, ky më vuri re mua. Si njeri që është i paqëndrueshëm në mendime, e kishte ndryshuar pikëpamjen për indanët.

— Beterexh, — më tha. — Them se sikur i mbivlerësova ca gjithë sa na tregoi zoti Mertuet për indianët atje në kopsht. Ku i dihet, mos donte të na detyronte të pendohemi për gjithë sa kemi bërë, këtë e kanë fort për zemër këta udhëtarët. Pse, vërtet do i zgjidhni qentë sonte?

— Do i lë të lirë të shëtisin si ua ka ënda, zotëri, — i thashë. — Lë të bëjnë si dinë, në u dhëntë rasti të nuhasin gjurmë të huajsh.

— Epo mirë, nesër shohim e bëjmë. S'kam ndërmend ta trëmb teton, Beterexh, pa patur pér këtë ndonjë shkak. Natën e mirë!

Dukej aq shumë e këputur dhe i zbehtë, kur më përshëndeti me tundje koke dhe mori qiririn pér t'u ngjitur lart, saqé mora guximin ta këshilloj të pinte pak konjak me ujë sode para se të binte të flinte. E ngulita mirë në kujtesë këtë rrethanë ngaqë vura re me kënaqësi se të dy këta zotérinj, zoti Godfri dhe zoti Frenklin, favoritë të zonjushës Reçell, ishin në marrëdhënie të mira midis tyre. Rivaliteti pér punën e dorës së zonjushës Reçell, me ç'dukej, nuk i kishte çuar në prishje të miqësisë. Se që të dy ishin njerëz mondanë dhe kësisoj njerëzish kanë meritën të mos grinden me shoshoqin, siç bëjnë ca të rrëndomtë.

Zoti Frenklin nuk deshi të pinte konjak, dhe u ngjit lart bashkë me zotin Godiri, ngaqë dhomat e të dyve ishin ngjitur, por në shkallët ose shoku ia mbushi mendjen, ose ai vetë ndërrroi mendje, siç e kishte zakon, dhe zoti Frenklin më thirri:

— Ndoshata do të dua të pi natën. Më sillni ca konjak në dhomë.

Dërgova pér tek ai një shërbëtor me konjakun, kurse vetë shkova të coja qentë. Që të dy thuajse po qmendeshn nga habija që i lanë të lirë në këtë orë të natës dhe zunë të hidhesin e të spërdridheshin. Por shiu ua shoi zjarrësinë, pinë pak ujë dhe u kthyen përsëri në strofkull. Kur po kthehesha vura re se moti po vinte duke u përmirësuar, por shiu ende vazhdonte të binte.

Bashkë me një shërbëtor tjelër i ramë rretheqark shtëpisë, siguruam mirë dyertë, çdo gjë e bëja vetë me dorën time. Vetëm rrëth orës një munda të prehem në shrat. Por tensioni i ditës kishte qënë i madh, atë natë e ndjeva veten të infektuar nga sëmundja e zotit Frenklin. Kishte dalë dielli kur, më në fund, munda të myllë sy. Tërë atë kohë që s'po më zinte gjumi, në shtëpi asgjë nuk pipëtinte, mbretëronte një heshtje varri.

Në ora shtatë e gjysmë u zgjova dhe hapa dritaren. Dita që shumë e bukur, me diell. Kur ra ora tetë, shkova pér të lidhur qentë; më zuri veshi një fëshfërimë fustani nëpér shkallë. Ktheva kryet. Nëpér to vravonte si e çartur Penelopa.

— Baba! — bërtiti. — Shkoni lart me vrap! **Diamanti u zhduk.**

— Mos ke lojtur, moj bijë? — e pyeta.

— U zhduk! — përsëriti Penelopa. — U zhduk dhe askush nuk e ai se si. Shkoni, shikoni.

Më tërroqi osh për në dhomën e pritjes së zonjushës, pas së cilës ndodhej dhoma e saj e gjumit. Në prag të kësaj dhome qendronte zonjusha Reçell po aqë e bardhë në fytyrë sa edhe diamantet e këmishës së natës. Të dyja kanatat e dollapit indian ishin të hapura. Njeri nga sirtarët ishte i têrhequr deri në fund.

— E shihni?! — tha Penelopa. — E pashë me sytë e mi, kûr zonjusha Reçell e vuri aty diamantin mbrëmë.

Iu afrova dollapit: sirtari ishte bosh.

— Vërtet që është zhdukur, zonjushë? — e pyeta.

Me shikimin që s'ngjante fare me atë të zakonshmin dhe me zërin që thua nuk ishte i saji, zonjusha Reçell më dha atë përgjigje që e pata dëgjuar nga ime bijë:

— Diamanti u zhduk!

Pa shtuar më as edhe një fjalë, hyri në dhomë dhe e mbylli derën me kyç. Para se ne të mblidhnim mendjen dhe të ndërmerrnim dicka, hyri zonja; kishte dëgjuar zërin tim në dhomën e pritjes së zonjushës dhe pyeti c'kishte ndodhur. Lajmi për zhdukjen e diamantit e alaniti. Iu afrua derës së dhomës së gjumit dhe nguli këmbë që t'ia hapnin. Zonjusha Reçell ia hapi.

Alarmi që pushtoi shtëpinë solli aty para të gjithëve dy zotërinjtë.

Zoti Godfri doli i pari nga dhoma e tij. Kur dëgjoi c'kishëte ndodhur, vetëm tundi krahët i habitur, kjo habi e tij fliste shumë aspak në dobi të qetësisë së tij shpirtërore. Zoti Frenklin, te mendjeqartësia e të cilit viaj aq shumë shpresë, dukej jo më pak i huptë se ai zotëria i mëparshëm, kur dëgjoi lajmin. Ndryshe nga c'e kishte pritur, pati bërë një gjumë të thellë, dhe kjo gjendje beotie, e pazakontë për të, se si e kishte matufepsur. Por, pasi piu një filxhan kafe, koka iu kthjellua, zuri të gjykojë esëll, siç e kishte zakon, me vendosmëri e mençuri ndërmori ja se çfarë: urdhëroi shërbëtorët të mos preknin as dyert e as dritaret, na porositi të kontrollonim mos kishte rë-

në në ndonjë vend diamanti, dërgoi Penelopën te zonjusha Reçell pér ta pyetur si qëndronte puna, por kjo u kthyte tek ne fare e habitur dhe tha:

— Zhdukja e diamantit e ka tronditur aq shumë zonju-shën, saqë nuk dëshiron të flasë pér këtë me kërkënd.

— S'na mëbetet tjetër gjë veçse të thërrësim policinë, — thashë fare i qetë.

— Kurse policia duhet para së gjithash të ndalojë indianët, — tha Frenklini.

Zonjat dhe zoti Godfri, që s'dinin gjë pér atë punën e indianëve, u rrënqethën.

— S'kemi kohë pér shpjegime, — vazhdoi zoti Frenklin. — Unë mund t'u them se diamantin e kanë vjedhur indianët. Më lëshoni një autorizim që në emrin tuaj t'i drejtohem ndonjë gjyqtari të Frizingolit; i shkruani vetëm që jam duke vepruar në mbrojtje të interesave tuaja dhe me vullnetin tuaj, pastaj më lejoni të nisem sa më parë. S'duhet humbur as edhe një minutë, — i tha rrëmbimthi zonjës Verinder.

Vuri përpara tetos bojë, penë e letër, kjo zuri të shkruajë jo me shuinë èndje. Po të mos kish qënë ai sendi i zhdukur me vlerë njëzet mijë stërlina, them se me një lehtësim të madh në zemër do t'ua kishte lënë të hapur rrugën hajdutëve të fshihe-shin bashkë me Gurin e Hënës.

Shkova pas zotit Frenklin në stallë dhe shfrytëzova rastin ta pyes, si të kishin depërtuar vallë indianët në shtëpi?

— Njëri syresh mund edhe të fshihej në sallë kur ishin duke dalë mysafirët, — më tha zoti Frenklin. — Ka të ngjarë që të ketë qënë i fshehur nën divan, kur tetoja dhe Reçelli diskutuan se ku do ta vinin diamantin. I èshtë dashur vetëm të presë sa të binin në gjumë njerëzit dhe pastaj t'i afrohej dollapit dhe ta merrete diamantin.

Vetëm kaq më tha dhe ngau me të katra.

Po si të ketë dalë nga shtëpia? Kur hapa portën kryesore në mëngjes, ajo ishte e mbyllur me kyç, ashtu si e kisha lënë unë; sa pér dyert dhe dritaret e tjera, ato qenë të mbyllura mirë dhe ende vazhdonin të ishin mbyllur. Po qentë? Ata qenë shëndo-shë e mirë, hovnin të gëzuar edhe pse të lagur. S'po më kënaq-te ky shpjegimi i zotit Frenklin.

Pas mëngjesit më thirri zonja. I tregova për indianët. Si grua burrmeshë që është, e mblodhi shpejt e shpejt veten pas tronditjes së parë. Dukej tepër e merakosur për gjendjen e së bijës.

— Vërtet që Reçelli s'para ngjan me vërsniket, por zhdukja e këtij diamanti sikur e ka shastisur fare. E kush mund ta parasnikonte që ky xhevahir ogurzi do ta magjepste kësoso!

Kishte përse të çuditej! Por s'ishte vetëm ajo që çuditej. Edhe zoti Godiri, s'dinte ku të futej. Endej kot së koti sa në-për shtëpi e sa nëpër kopsht. S'po vendoste dot q'të bënte pas kësaj fatkeqësie: të largohej për të mos i bezdisur me praninë e tij njerëzit e shtepise, apo te rrinte për të ndihmuar sadopak me q'të mundte. Zgjodhi më në fund këtë të dytën. Kurse shërbëtorët, me përjashtim të Rozanës, zunë të përshpërisin në-për qoshe, sa për mua, unë ndihesha sa më s'bëhej i alarmuar. Ai i mallkuar **Gur i Hënës** na e përbëysi tërë shtëpinë.

Rreth orës njëmbëdhjetë u kthyte zoti Frenklin. Ajo vendosmëria e fillimit sa vinte e po avullonte nga shkaku i barrës së përgjegjësisë që kishte hedhur mbi shpatulla. Qe nisur me galop e u kthyte me hap.

— Hë si, do vijnë ata të policisë? — e pyeti zonja.

— Po, — iu perqigj. — Thanë se do vinin menjëherë. Inspektori kryesor i policisë së këtushme Sigrevi me dy ndihmësa. Sa për të larë gojën, shpresa nuk ka.

— Pse mos ia arritën t'i humbasin gjurmët ata indianët, zotëri? — e pyeta.

— Të gjorët e të mjerët indianë më kot i kanë rrasur brenda. Janë krejt pa faj ata, — tha zoti Frenklin. — Ajo hamendja që ju shpreha s'qëndronte gjékundi. U vërtetua se ishte krejt e pa mundur që dikush të mund të fshihej. Pastaj indianët i kishin parë atë mbrëmje në Frizingol, ku qenë kthyer fill pas asaj shfaqjes në taracën tonë. Edhe në mesnatë kishin qënë të gjithë bashkë në një han. Dyert në mesnatë ne i mbyllëm me duart tonë, pra hamendja për indianët nuk qëndron. Por nga padija paskan shkelur një rregull dhe me këtë i dhanë shkas policisë t'i fuste brenda. Gjyqtari qënkej mik me zonjën dhe i ka lënë nën mbikqyrje.

— Por nëse fallxhorët s'të janë me faj, atëherë si u zhduk diamanti?

Pas ndonja dhjetë minutash mbërriti inspektori Sigrev. Na bëri të ditur se kishte takuar në tarracë zotin Frenklin dhe ky e paska lajmëruar se çdo lloj ndjekjeje do të qe e padobishme. E pra, në një kohë kur çështja ende s'kishte filluar të ndiqej.

Inspektori Sigrev ia nisi punës duke kontrolluar me vëmendje shtëpinë, brenda dhe jashtë. Doli e qartë se nga jashtë hajdutët s'kishin si hynin, pra vjedhja ishte kryer nga ata që kishin qënë brenda. Merret me mendje se ç'panik i pushtoi shërbëtorët, kur u erdhë në vesh ky përfundim. Inspektori tha se do e fillonte me kontrollin e dhomës së zonjushës Reçell, pastaj do pyeste për shërbëtorët. Gratë u turrën për në dhomën e zonjushës, mes tyre edhe Rozana Spirman, që t'i kërkonin inspektorit t'u thoshte, për cilën dyshonin. Ky s'pranoi të fliste.

— Pa shihni këtu! — u ngërdhesh sakaq, duke u treguar shenjën e bojës së fshirë mu nën çelësin e derës së bojatisur para një dite të zonjushës Reçell. — Pa shihni, moj, ç'na bëtë me ato fundet tuaja! Dilni jashtë!

Rozana, që kishte qëlluar më pranë tij se të tjerat, dhe e kishte parë mirë vendin e fshirë, u largua e para dhe u kthyë në punë. Pas saj dolën dhe të tjerat.

Pas pak inspektori zuri të marrë në pyetje shërbëtorët: e para ishte Penelopa, ngaqë ajo e kishte mësuar e para lajmin e zhdukjes së diamantit, kur kishte hyrë në ora tetë te zonjusha Reçell me gotën e çajit.

Pas kësaj inspektori shprehu dëshirën për të folur me zonjushën Reçell.

— Nuk kam asgjë c'ti them inspektorit; nuk dëshiroj të shoh kërkënd, — ishte përgjigja e saj.

Pas kësaj zbritëm poshtë dhe, duke kaluar nëpër dhomën e ndënjos, pamë zotin Godfri dhe zotin Frenklin.

Inspektori i pyeti që të dy në mund të sillnin ndonjë të dhënë për të ndihmuar në sqarimin e çështjes. Që të dy pohuan se s'kishin ç'të thoshin. A kishin dëgjuar zhurmë të dyshimitë natën? Ata asgjë s'kishin dëgjuar përveç fëshfërimës së shiut. Po unë, që kisha rënë më pas të tjerëve, a kisha dëgjuar gjë? Asgjë. Kur këto pyetje kishin marrë fund, zoti Frenklin më pëshpëriti:

— Ky njeri s'ka pér tē arritur gjë. Inspektori Sigrev éshëtë gomar.

Nga ana e vet zoti Godfri më pëshpëriti:

— Duket që éshëtë mjeshtër. Beterexh, shpresoj që ky do ia dalë mbanë. Mendje-mendje kjo dynja, mendja-mendjes nuk i ngja!

U kthyem përsëri në dhomën e pritjes së zonjushës Reçell. Kur ishim duke kërkuar poshtë orendive, u hap befas dera e dhomës së gjumit tē zonjushës Reçell dhe kjo iu drejtua Penelopës me këtë pyetje:

— Zoti Frenklin Blek qe ai që ju dërgoi tek unë sot në mëngjes?

— Po, zonjushë.

— Ku ndodhet tani?

Më erdhën në vesh zérat e tē dy zotërinjve që ishin duke shëtitur në tarracë. Duke iu përgjigjur në këmbë tē sime bije, i thashë:

— Zoti Frenklin éshëtë në tarracë, zonjushë.

Pa thënë më as edhe një fjalë, pa i kushtuar as vëmen-djen më tē vogël inspektorit që u orvat tē hynte me tē në bisedë, e verdhë dyll, me një pamje tejet tē menduar dhe tē merakosur; ajo doli nga dhoma dhe zbriti në tarracë te kushurirat.

E di që i shkela me tē dyja këmbët rregullat e mirësjell-jes dhe tē respektit, por ja që s'u përmbajta dot që tē mos shihja nga dritarja si u takua zonjusha Reçell me zotin Frenklin, pa e çarë kokën fare pér praninë e zotit Godfri, që bëri mënjanë pér t'i lënë ata tē dy vetëm. Dukej që po i fliste tërë nervozizëm. Biseda e tyre nuk zgjati shumë, por, po tē gjykoje nga fytyra e tij, dukej që mbeti tej mase i habitur. Ndërkaq erdhi zonja. Zonjusha Reçell këtë e pikasi, dic i foli shpejteshpejt zotit Frenklin dhe sakaq i ktheu krahët dhe u largua, para se e éma t'u afrohej. Zonja vetë e çuditur, duke parë edhe habinë e zotit Frenklin, hyri me tē në bisedë. Atyre iu afrua edhe zoti Godfri, natyrisht, që tē bisedonte edhe ai. Zoti Frenklin eci bashkë me ta nëpér tarracë, me sa dukej, duke u treguar pér ç'i ndodhi; pas disa hapash befas ndalën tē tre si tē shtangur, tē pushtuar nga një habi e madhe. Mezi arrita ta vë ré këtë, kur dera e dhomës së pritjes u hap vrulltas. Zonjusha Reçell hyri në dho-

mën e saj të gjumit, e nervozuar dhe e inatosur, me sy që i shkrepëtin nga tērbimi dhe me faqet prush të kuqe. Inspektor bëri përsëri ta ndalonte. Ajo i ktheu krahët dhe hyri në dhomën e gjumit.

— Nuk ju çova lajm të vinit! — i foli zemërake. — Mua ju nuk më nevojiteni. Diamanti im u zhduk. As ju e askush tjetër në botë nuk ka për ta gjetur!

Nga tērë këto mund të nxirrej përfundimi se zonjusha Reçell ndihej e fyter pér vdekje ngaqë u thirr policia dhe se habia e zotit Frenklin në tarraqë shpjegohej me atë që ajo i kishte folur ashpér pse e kishte thirrur. Në ishte kështu, pse qe kundër njerëzve që do ta ndihmonin të gjente diamantin? E nga ta dinte vallë që Guri i Hënës s'kishte për t'u gjetur kurrë?

Inspektori Sigrev m'u drejtua me pyetjen, në dinin gjë shërbëtorët ku qe vënë diamanti atë natë.

— E dija unë dhe një shërbëtor tjetër që u ndodhëm aty atë natë në sallë kur u fol për këtë. E ka ditur edhe ime bijë. Ajo dhe shërbëtori mund t'u kenë treguar edhe të tjerëve, dhe u kthyen për të fjetur, ndokush mund ta kishte dëgjuar pas derës. Sipas meje, shumëkush mund të ketë qënë në dijeni të vendit ku u ruajt diamanti.

Atëherë më kërkoi t'i flisja për shërbëtorët. Më shkoi mendja në çast te Rozana Spirmani, por t'i drejtoja shpjegimet tek ajo m'u duk e pandershme: kjo vajzë e gjorë i kishte kaluar tanimë të gjitha provat.

— Shërbëtorët tanë janë në çdo drejtim njëri më i mirë se tjetri, — iu përgjigja. — E kanë merituar që të gjithë besimin e zonjës.

I mori vetë në pyetje njerin pas tjetrit, asgjë nuk doli nga kjo. Duke iu përbajtur mendimit që diamanti ndodhej brenda shtëpisë, inspektori i kërkoi leje zonjës të kontrollonte placat personale të shërbëtorëve. Zonja ime e mirë nuk pranoi që me to të silleshin si me hajdutët.

Inspektori iu përkul dhe më drejtoi një shikim si të thoshte: «E pse më paskeni thirrur, në m'i lidhni kësisoj duar e këmbë?»

Si kryeshërbëtor e ndieva se nuk kishim të drejtë të keqpërdornim zemërgjerësinë e zonjës sonë.

— Ju falënderojmë nga shpirti, lartmadhëri — i thashë, — por kërkojmë të na lejohet të bëjmë ashtu si të jetë më mirë pér çështjen, ne vetë ua japim çelësat. Kur e jep këtë shembull **Gabriel Beterexhi**, të tjerët s'kanë pér të ngurruar, ju si-guroj pér këtë. Ja ku i kini çelësat e mi!

Zonja më zuri nga duart dhe më falënderoi me lotë në sy. O Zot, e c'nuq do të jepja atë çast pér ta patur të drejtën që ta zhđepja pak këtë inspektor të policisë.

Ashët si thashë, shërbëtorët ndoqën shembullin tim, kuptohet jo me ëndje, por sidoqoftë ia dorëzuan. T'i shihje gratë e gjora q'vuajtje provonin kur policët ua kthenin rrobat përmbyss.

Kontrolli mbaroi, kurse diamanti, kuptohet, që nuk u gjet. Inspektori Sigrev u mbyll në dhomën time që të mendonte; kurse mua më çuan lajm nga zoti Frenklin t'i shkoja në bibliotekë. S'arrita ta kap dorezën e derës, kur ajo u hap nga brenda dhe që andej doli Rozana Spirman. Ajo s'kishte punë aty, ndaj dhe s'e lashë pa i têrhequr vëmendjen.

— Zoti Frenklin Blek kishte humbur unazën, unë e gjeta dhe ia dhashë, — më tha Rozana.

Faqet i digjeshin flakë.

Kur hyra në bibliotekë, zoti Frenklin ishte duke shkruar. Me të më parë, më porositi t'i bëja gati kuajt pér të shkuar deri në stacion. Dukej tejet i vendosur.

— Po niseni pér në Londër, zotëri? — e pyeta.

— Po shkoj të telefonoj në Londër, — m'u përgjigj zoti Frenklin. — Arrita ta bind teton t'i drejtohemë pér ndihmë një njeriu më të zgjuar se inspektori Sigrev. Do i telegrafoj tim eti. Ai njihet me shefin e policisë. Ky mund të gjejë ndonjë dekativ të zotin pér ta zbiruar këtë fshehtësi. Meqë ra fjala pér punë fshehtësie, dua t'u them, ja se çfarë: ose kjo Rozana Spirman s'është në rregull nga trutë e kokës, ose di pér **Gurin e Hënës** më shumë sa i takon të dijë. Erdhi këtu me unazën që më kishte rënë në dhomën e gjumit, — vazhdoi zoti Frenklin. — E falënderova dhe zura të presë që ajo të largohet, kurse kjo qëndroi përkundruall tryezës dhe po më shihte në mënyrë të çuditshme: gjysmë e trembur dhe gjysmë me familjaritet, nuk arrita dot ta marrë vesh. «Është diçka e çuditshme ajo zhdukja e diamantit, zotëri», — më tha papritur e pa kujtar. I thashë

«po» dhe prita ç'do më thoshtë tjetër. Ju betohem, Beterexh, ajo vajzë më duket e ndërlipur! Më tha: «Se ai diamanti nuk ka për t'u gjetur, apo jo? Edhe atë që e ka marrë, s'kanë për ta gjetur, për këtë unë përgjigjim me kokë!» Më pa ngultas dhe tundi kryet tërë familjaritet duke më buzëqeshur. Para se të bëja për ta pyetur se ç'donte të thoshtë me këtë, prapa derës u dëgjuan hapat tuaj. Me siguri u tremb që e gjetët këtu. Sidoqoftë ndryshoi krejt në fytyrë dhe doli nga dhoma. Ç'kuptim të ketë e gjithë kjo?

As edhe këtë herë nuk guxova t'i rrëfej historinë e asaj vajze. Se kjo donte të thoshtë thjesht ta akuzoje për vjedhje. Pastaj, edhe po t'ia kisha treguar fill e për pe atë histori, duke supozuar që është ajo që e ka vjedhur diamantin, pyetja përsë Rozana kishte zgjedhur pikërisht atë, zotin Frenklin, për t'ia zbuluar të fshehtën, prap se prapë do të mbetej e paqartë.

I thashë vetëm se do ia bëja të ditur zonjës mendimin e zotit Frenklin.

Kur po shkoja në stallë për të bërë gati pajtonin për zotin Frenklin, u ktheva në mencë ku hanin shërbëtorët. Rozana Spirmani nuk ishte aty. Kur pyeta se ku gjendej, më thanë se nuk e ndiente veten mirë dhe kishte shkuar të shtrihej ca në dhomën e saj.

— Çudi! M'u duk fare mirë me shëndet, kur e takova atypari, — nuk lashë pa vënë në dukje.

Penelopa doli fill pas meje dhe më tha:

— Baba, mos flisni kështu, kësoso ju vetëm edhe më i acharoni shërbëtorët kundër Rozanës. Ajo mjerane ka rënë keq në dashuri me zotin Frenklin Blek.

Ja dhe një tjetër shpjegim i çudanërive të Rozanës. Domethënë se ajo ishte gati t'i hapej për gjithë sa dinte zotit Frenklin, mjaftonte që ky t'i conte fjalë.

Para se zoti Frenklin të merrte frerët ndër duar, më hoqi mënjanë dhe më foli me zë të ulët që askush të mos e dëgjonte.

— Hapini sytë e bëjini katër, zoti Beterexh. Përpinquni të nxirri ndonjë gjë nga Rozana Spirmani. Nuk ju kërkoj ndonjë veprim poshtërues apo të pashpirt në lidhje me atë vajzë, vetëm ju lutem të vini në veprim tërë aftësitet tuaja vrojtuese e depërtuese. Tetos për këtë do t'i flasim si për një gjepur, kur-

se çështja në vetvete është ku e ku më serioze.

— Është fjala për njëzetëmijë stërlinat, zotëri, — ia kujtova, duke pasur parasysh qëmin e diamantit.

— Është fjala për paqtimin e Reçellit. — m'u përgjigj seriozisht zoti Frenklin. — Jam shumë i shqetësuar për të.

U largua shpejteshpejt për t'i dhënë fund bisedës. E kuptova përsë: kishte frikë se mos më zbulonte fshehtësinë e atyre fjalëve që i kishte thënë zonjusha Reçell.

Dhe në këtë e sipër u nis për në Frizingol.

9.

Nata e të enjtes kaloi pa ndonjë ngjarje. Mëngjesi i së premtes solli dy lajme: qiraku i simitexhiut e kishte takuar Rozana Spirmanin në të ngrysur duke shkuar për në Frizingol nëpër një rruginë që çante mespërmes kënetës, e mbuluar me një vel të errët. Çudi që dikë e morën për Rozanën, sepse kjo mjerane, siç dihet, tërë ditën e dites të enjten kishte ndenjur shtrirë e sëmurë lart në dhomën e saj. Lajmin e dytë e solli postjeri. I nderuari zoti Kandi, duke dalë në shiun rrebesch, kishte shqiptuar një nga ato batutat e tij mendjeholla e kishte thënë se lëkura e mjekëve është impermeabël. Ishte ftohur keqas atë natë dhe kishte zënë shtratin. Fliste përcart e dërdëlliste pa pushim për gjithfarë mbresash që kishte pas pasur.

Pas mëngjesit erdhë përgjigja e zotit Blek nga Londra. Aty njoftohej se kishte mundur të porosiste për ndjekje dedektivin Kaf; ky pritej të vinte me trenin e mëngjesit.

Kur e lexoit këtë emër, zoti Frenklin u drodh. E ç'nuk kishte dëgjuar të flitej për të.

— Kam arsyë të shpresoj që së shpejti do u vijë fundi shqetësimeve tonë, — tha. — Edhe gjysma e atyre, që kam dëgjuar të flitet, në është e vërtetë, në Angli s'gjen dot të dytë që të krahasohet me dedektivin Kaf.

Të gjithë qemë me mendje të ngritur dhe mezi prisnim ta shihnim. Kur e mori vesh këtë inspektori Sigrev, u mbyll në dhomën time, pasi u pajis me bojë, penë e letër, për të shkruar

raportin që do i kërkonin. Ma kishte ënda ta takoja dedektivin Kaf në stacion. Por s'kisha me se, ngaqë zoti Godfri, duke i shprehur zonjës keqardhjen e tij të thellë që po e linte vetëm në një kohë me aq shumë shqetësimë, kishte bërë mendje të ikte. Me shpirtmadhësi vetëm mundi të bënte që ta shtynte nisjen deri me trenin e fundit, për të mësuar mendimet e dedektivit të shquar londinez. I duhej të ishte domosdo në Londër në një mbledhje të rëndësishme të komitetit femëror që kryeson te. Mbledhja kushtuar disa vështirësive eventuale të veprimtarisë së kësaj shoqërie, ishte lënë për të shtunën në mëngjes.

Po afronte koha e mbërritjes së dedektivit dhe dola ta prisja të porta. Nga karroca zbriti një burrë i moshuar, i thinjur, aq i dëbët sa që dukej kockë e lëkurë. Ishte veshur krejt me të zëza, vetëm papionin e kishte të bardhë. Fytyrën e kishte me cepa të mprehtë si spatë, kurse lëkurën aq të verdhë, të thatë, të regjur si gjethë vjeshtake. Në sytë e celur gri rrezëllinte një shprehje aspak qetësuese, dukej sikur priste nga ti më shumë se ç'dije. Ekte me hap të shtruar, fliste paksa zvargur, përtueshëm; gishtat e gjatë si shkopinj të thatë, i kishte tërë gjelmekë, si çaponj. Ngjante me pastorët, me nëpunësit e zyrave të varrimit, me këdo, veçse jo me atë që ishte në të vërtetë.

— Shtëpia e zonjës Verinder? — më pyeti.

— Po, zotëri.

— Jam dedektivi Kaf.

— Urdhéroni brenda.

Duke ecur, i tregova emrin dhe detyrën që kryeja për t'i dhënë mundësi të fliste për çështjen që kishte ardhur. Por ai nuk e zuri ngoje fare. Habitesha vetë me veten: si të kishte arritur vallë ky njeri të bëhej aq i famshëm. Shtëpisë iu afroam si dy qenë të lidhur me zinxhir që i vënë pranë njeri-tjetrit për herë të parë.

Çova të thërrisin zonjën. Dedektivi Kaf vuri rë që nga parmakët serrën me trëndafila dhe u nis drejt e për atje, duke shfaqur kështu për herë të parë interes për dicë. Për habi të kopshtarit dhe indinjatën time ky polic famëmadh doli që ishte pus i thellë në çështjen e kultivimit të trëndafilëve.

E ç'të prisje nga ky njeri që duhej të gjente diamantin e zonjushës Reçell!

— S'para kam kohë për t'u dhënë me shpirt pas ndonjë gjëje, — m'u përgjigj. — Por kur kam kohë të lirë, atë ia kushtoj trëndafilave, zoti Beterexh. E kam nisur jetën mes tyre, në serrën e tim eti, dhe do ta përfundoj po mes tyre, në m'u dhëntë mundësia. Po. Do vijë një ditë, me ndihmën e të madhit Zot, që s'do të merrem më me kapjen e hajdutëve dhe do merrem me kultivimën e trëndafilave. Veç ato rrugëzat mes posomeve s'do t'i kem të shtruara me çakell e rërë, zoti kopshtar, do t'i kem të mbuluara me bar!

Duket që mbeti i çuditur, nga rrugëzat tonë.

— Shije e çuditshme kjo, zotëri, për një njeri të profesionit tuaj, — mora guximin të vë në dukje.

— Po të shihnit mirë rretheqark, gjë që e bëjnë ca të pakët, — tha dedektivi Kaf, — do të vinit re që shija e njeriut në pjesën e saj më të madhe nuk harmonizon me profesionin. Më thoni dy gjëra më të përkundërta se hajduti dhe trëndafili dhe unë në vend kam për ta ndërruar shijen time, në rast se nuk është ende vonë në këtë moshë që jam... Po nejse, ja ku po vjen zonja. Është zonja Verinder, apo jo?

E pa përparrë meje dhe kopshtarit edhe pse ne e dinim në ç'drejtë pritej të vinte zonja, kurse ai jo. S'kisha si të mos e konsideroja shumë më të vëmendshëm sesa m'u duk në fillim.

Pamja e jashtme apo çështja pse kishte ardhur, dhe, më mirë të themi, që të dyja bashkë, e turbulluan paksa zonjën. Ishte hera e parë që e shihja të mos dinte çfarë t'i thoshte një të huaji. Dedektivi Kaf e nxori në çast nga gjendja e vështirë. E pyeti në ishte ngarkuar kush me ndjekjen e çështjes para se ta thërrisnin atë, dhe i kërkoi leje të bisedonte me të. Zonja u fut në shtëp. Para se t'i shkonte pas, Kafi edhe njëherë i përfoli ato rruginat e shtruara me çakell e rërë.

Përse inspektori Sigrev u tut dhe dukej më i vogël sec ishte kur ia paraqitën dedektivin Kaf, këtë nuk marr dot përsipër ta shpjegoj. Vetëm e kujtoj si fakt. U veçuan në dhomë dhe qëndruan aty për një kohë të gjatë. Kur dolën, inspektori ishte i tronditur, kurse dedektivi gogësinte.

— Zoti Kaf dëshiron të shohë dhomën e pritjes të zonju shës Verinder! — tha Sigrevi, duke m'u drejtuar me një solemnitet të jashtëzakonshëm dhe shumë i frymëzuar. — Mos ka nevojë të bëjë edhe disa pyetje. Ju lutem, çojeni atje.

Kafi famëmadh e pa inspektorin fare i qetë, duke pritur që ta shqëronim. E kqyri me shumë kujdes dollapin indian, i kaloi rrrethereth, duke bërë edhe pyetje, në të rrallë inspektorit e më shpesh mua, kuptimi i të cilave ishte njëlloj i paqartë pér të dy ne. Iu afrua, më në fund, derës dhe e vuri re që ishte e bojatisur taze. Preku me gisht njollëzën që ishte nën çelësin; atë e kishte diktuar edhe inspektori Sigrev, kur u kishte hequr vërejtjen shërbëtoreve të mbledhura aty pér t'i shprehur pakënaqësinë e kontrollit që do u bënte.

— Po kjo këtu, q'të jetë vallë? — pyeti.

Pjetjen ma drejtoi mua. I thashë se kishin qënë shërbëtoret dhe ato do ta kënë fshirë me fundet.

— Po a e vutë re se cili nga fundet ta ketë fshirë? — vazhdoi pyetjet dedektivi Kaf.

— Jo, zotëri.

Sakaq u kthye nga inspektori Sigrev dhe e pyeti.

— Edhe ju, besoj, e patët vënë re këtë?

— E pata vënë re po s'ka ndonjë rëndësi kushëdi se çfarë.

Dedektivi Kaf e pa njëlloj siç pa edhe ato rruginat e serrës të shtruara me çakëll e rërë dhe me atë melankolinë e tij të zakonshme pér herë të parë na dha të kuptionim se kush ishte.

— Para se të bënët qoftë edhe një hap më tej në hetimin e kësaj çështjeje, duhej sqaruar cili fund e kishte fshirë këtu derën dhe të dinit saktë kur mund të ishte tharë boja e derës.

Inspektori e dëgjoi i myrrëtar këtë vërejtje dhe nga ana e tij e pyeti, a duhej t'i mblidhte gratë. Dedektivi Kaf mendoi një hop, tundi kryet dhe pshërëtit.

— Jo, ne më parë do merremi me bojën. Sqarohet kollaj kjo punë, kurse sqarimi i fundit kërkon kohë. Në ç'orë të kenë qënë shërbëtorët në këtë dhomë dje në mëngjes? Në ora një mbëdhjetë? A mund të na e thotë kush, që tharë në këtë orë boja e derës?

— Nipi i zonjës, zoti Franklin Blek këtë e di, — i thashë.

— Këtu është?

Zoti Franklin mezi po priste rastin që t'i paraqitej famëmadhit Kaf. S'kaloi minuta dhe u gjend në dhomë. Ai tha:

— Derën e leu zonjusha Verinder nën mbikqyrjen time me një tretësirë të shpikur nga unë. Thahet plot pas dymbëdhjetë orësh, pavarësisht nga ngjyrat e përdorura.

— A ju kujtohet, zotëri, në ç'orë ka qënë e përfunduar ajo pjesë e derës ku është njolla? — e pyeti dedektivi.

— Fort mirë bile, — iu përgjigj zoti Frenklin. — Ajo pjesë është iyer e fundit, ditën e mërkurë, rrëth orës tre është përfunduar.

— Sot është e premte, — tha Kafi, duke iu drejtuar inspektorit Sigrev. — Pra, ditën e mërkurë në ora tre ka qënë e lyer, tretësira thahet për dymbëdhjetë orë, ditën e enjte në ora tre të mëngjesit ka qënë e tharë. Hetimet në këtë vend i keni kryer në ora njëmbëdhjetë të mëngjesit. Del që boja ka qënë 11 — 3 = 8. Tetë orë më pas ajo ka qënë e thatë, fundet e grave s'mund të shkaktonin këtë fshirje.

Ishte nokdauni i parë për inspektorin Sigrev!

Dedektivi Kaf tani po i drejtohej zotit Frenklin si më shpresëdhënësi në punën e hetimeve.

— Ka shumë të ngjarë që të jeni ju ai që na dhatë kyçin për zbulimin e të fshehtës, — i tha.

Këto fjalë ende nuk ishin shkëputur nga buzët e tij, kur u hap vrulltas dera e dhomës së gjumit dhe pa pritur e pa kujtuar u duk zonjusha Recëll. Zuri të flasë me dedektivin pa e zënë fare meraku që ky ishte për të një i panjohur.

— Jú thatë, — foli duke treguar me dorë nga zoti Frenklin. — që ky ju dha kyçin për zbulimin e të fshehtës?

— Është zonjusha Verinder, — i pëshpërita dedektivit.

— Po, ashtu thashë.

U kthye vetëtimthi dhe u orvat të shihte drejt në sy zotin Frenklin. Thashë « u orvat », sepse ajo në çast i ktheu shpinën, para se sytë e tyre të shkëmbenin shikimin. Dukej sheshit që mendimet i kishte quditërisht të turbulluara prej diçkaje. U skuq dhe pastaj menjëherë u zbeh. Bashkë me fshehtësinë fytyra i mori një të tillë shprehje që më kalli datën.

— Pasi iu përgjigja pyetjes suaj, më lejoni zonjushë t'ju drejtoj edhe unë një pyetje. Këtu në këtë derën tuaj ka një njollë. A e dini kur mund të jetë bërë dhe kush mund ta ketë bërë?

Në vend që t'i përgjigjej pyetjes, zonjusha Reçell vazhdoi të sajën, sikur ky të mos e kishte pyetur fare.

— Jeni nga ata të policisë ju, zotëri?

— Jam dedektivi Kaf, zonjushë, i ndjekjes së krimeve.

— Pse si thoni ju, a i duhet vënë veshi këshillave të një çupërlime?

— Do të jem shumë i gjuar t'ju dëgjoj, zonjushë?

— Atëherë vëriti vetë shpatullat detyrës dhe mos e lejoni zotin Frenklin Blek t'ju ndihmojë!

I tha këto me keqdashje e zemërim, me një mlfet aq të pa-përmbytjatur kundër zotit Frenklin, shoqëruar me zërin inatçor dhe shprehjen zemërake të fytyrës, saqë edhe pse e njihja që foshnjë, edhe pse e doja dhe e respektoja më shumë në atë shtëpi, pas zonjës, për herë të parë në jetën time ndjeva të më skuqeja faqja nga sjellja e zonjushës Reçell.

Dedektivi Kaf s'ia shqiti për asnjë çast shikimin e palëvizshëm hetues.

— Ju faleminderit, zonjushë, — tha. — Mos dini të më thoni diçka për këtë njollë? Mos ndoshta ju vetë pa dashje e keni fshirë bojën në atë vend?

— Unë asgjë nuk di për atë njollë.

E tha këtë dhe u myll përsëri në atë dhomën e saj. Dëgjova dënesje dhe ofshama. S'guxova t'ia hidhja shikimin dedektivit, pasqë nga zoti Frenklin që më ishë dhe më pranë. Dukej dhe më i leqendisur se unë nga gjithë cka ndodhi.

— Ju thashë që jam në alarm të plotë për gjendjen e saj, — më pëshpëriti. — E kuptuat tani arsyen?

— Më duket se është tejet e merakosur për zhdukjen e diamantit, — vuri në dukje dedektivi. — S'i thonë shaka, është diçka me vlerë... Domosdo...

Një drithmë e akullt ma përshkoi trupin, përsë vallë, atëherë nuk e dija; mendoj se në atë kohë më vezulloi dhe dyshimi i parë (dyshim i tmerrshëm) që i gëloj në mendje edhe dedektivist Kaf mbi bazën e asaj që pa në qëndrimin e zonjushës Reçell dhe dëgjoi nga goja e saj në këtë takim.

— Gjuha e vashave gëzon ca privilegje, zotëri, — vazhdoi dedektivi, duke iu drejtuar zotit Frenklin. — Ia lëmë harresës gjithë sa ndodhi dhe i vihemë punës. Është-merita juaj që na e sqaruat kur është tharë boja. Na mbetet të mësojmë, kur e

kanë parë për herë të fundit derën pa njollë. Se, me ç'shoh, ju qenkeni njeri me mendje dhe po më kuptoni ku dua të dalë.

Zoti Frenklin bëri të pamundurën për ta mbledhur vreten dhe me vështirësi arriti ta heqë mendjen nga zonjusha Reçell.

— Më duket se po. Sa më saktë arrijmë ta përcaktojmë kohën, aq më shumë e ngushtojmë sferën e kërkimeve tona.

— Saktë e thatë, zotëri, — e miratoi dedektivi. — A e kini parë derën ditën e mërkurë, pasi e mbaruat së lyeri?

Zoti Frenklin tundi kryet dhe iu përgjigj:

— S'më kujtohet.

— Po ju? — m'u drejtua mua dedektivi Kaf.

— As unë s'mund të them gjë, zotëri.

— Kush ka qënë i fundit në këtë dhomë të mërkurën në darkë?

— Them se ka qënë zonjusha Reçell, zotëri.

— Mos ndoshta ka qënë vajza juaj, Beterexh, — ndërhyri zoti Frenklin. U kthyte nga zoti Kaf dhe i shpjegoi se ime bijë është shërbëtorja e zonjushës Verinder.

— Zoti Beterexh, thirreni vajzën tuaj të vijë pak këtu... Pa prisni njëherë; — më mori mënjanë te dritarja për të mos na dëgjuar kush dhe më tha me pëshpërimë: — Inspektori Sivrev më raportoi për punën e bërë. Siç e tha vetë, i paska zemëruar ca shërbëtorët, për mua ka shumë rëndësi që t'i qetësojë. Çojini përhëndetjet e mia vajzës suaj dhe gjithë të tjetërëve dhe u thoni se, së pari, s'ka asgjë që të dëshmojë që diamantin e kanë vjedhur, dihet vetëm që ai ka humbur, së dyti, shërbëtcrëve do u drejtohem vetëm për ndihmë.

— Po a mund t'u them grave edhe diçka të tretë? — iu drejtova me pyetje zotit Kaf. — Se lirisht mund të ngjitin dhe të zgresin shkallët, të shkojnë tek shoshoqja, të bëjnë ç'tu teket?

— Mund t'u thoni.

— Kjo do t'i qetësonte menjëherë, zotëri.

— Bëjeni këtë sa më shpejt, zoti Beterexh.

S'kaloi as pesë minuta dhe të gjithë ishin vënë në dijeni. Veç u gjeta para një vështirësie: si t'i përmaja gratë të sulëshin gjithë sa ishin për të bërë dëshmitë e nevojshme para zotit Kaf?

U duk që Penelopa i pëlqeu dedektivit. Në fytyrë iu shfaq po ajo shprehje që ia pashtë, kur sytë i shkuan tek ai trëndafili i bardhë muskat te sera. I tha se kishte ndihmuar në lyerjen e derës, se vendi nën kyç i kujtohej, atë e kishin lyer të fundit, e kishte parë edhe pas disa orësh pa atë njollën, e kishte lënë në ora dymbëdhjetë të natës pa njollë. Kur doli, e kishte kapur me kujdes dorezën sepse e dinte që boja nuk ishte tharë, ndoshta fustani mund ta kishte prekur gjékundi derën, për këtë nuk hante inat, fustanin që kishte veshur e dinte, ishte dhurata e fundit e zonjushës Reçell, ajo mund ta sillte fustanin që tanë. Fustanin palashumë e kontrolluan me imtësi, në të s'u gjend asnëjë njollë boje.

Më pyeti në kishim ndonjë qen të madh që mund ta kishte gjerricur. Kur dëgjoi përgjigjen negative, zuri ta kqyrë njo llën me lente: aty s'kishte gjurmë të gishtave të njeriut, ajo ishte fshirë nga ndonjë rroba ndërmjet orës dymbëdhjetë të ditës së mërkurë dhe orës tre duke gdhirë e enjte. Pra duhej sqaruar, si mund të gjendej rroba që e kishte shkaktuar, kujt i përkiste dhe pse zoti i saj kishte qënë në atë orë në dhomën e fjetjes së zonjushës Reçell. Nëse shpjegimet do të ishin të pakënaqshme, s'kishte pse e kërkoje gjetiu dorën që e kishte grabitur diamantin. «Këtë, në më lejohet, dëshiroj ta bëj vetë, përtë mos ju shkëputur edhe ju nga punët e tjera», — i tha inspektorit Sigrev. Ky sidoqoftë ia shprehu mendimin që kishte para se të largohej.

— Duke e lënë hetimin e kësaj çështjeje në duart tuaja, s'mund të mos ju them që miza fare kollaj mund të bëhet buall. Lamtumirë!

— Por ca njerëz që e vrasin lart, fare lehtë mund të mos e vënë re atë mizën, — iu përgjigj zoti Kaf. Pastaj i ktheu krahët dhe pa nga dritarja. Unë dhe zoti Frenklin qëndruam në pritje të veprimeve të mëtejshme. Pasi ndenji aty si ndonja dy minuta, dedektivi Kaf bëri disa hapa drejt mesit të dhomës dhe ndali i zhytur në mendime me shikimin nga dhoma e gjumit e zonjushës Reçell. «Kështu do jetë më mirë!» — mërmëriti. Më shprehu dëshirën të bisedonte si ndonja dhjetë minuta me zonjën e shtëpisë, kur të ishte e mundur.

Kur po dilja, dëgjova që zoti Frenklin iu drejtua me një pyetje. Ndala te pragu për të dëgjuar përgjigjen.

— Ende s'i kini rënë në të se kush e ka vjedhur diamantin? — e pyeti zoti Frenklin.

— Diamantin kërkush nuk e kâ vjedhur, — iu përgjigj zoti Kaf.

Një këndshikim i tillë i çështjes na la të habitur dhe domosdø që i kërkuam sqarime bindëse se ç'donte të thoshte me këtë.

— Kini pak durim, — na e ktheu dedektivi. — Ende s'janë bashkërenduar që të gjitha hallkat e zinxhirit.

10.

Zonjën e gjeta në kabinetin e saj. U drodh, kur më pa, dhe fytyra i shprehu pakënaqësi, kur i njoftova dëshirën e zotit Kaf për ta takuar.

— Mos vallë jam e detyruar ta pres? A nuk më zëvendësoni dot ju Gabriel?

M'u duk e pakuptimitë kjo dhe desha s'desha e shpreva në fytyrë. Zonja pati nderin të shpjegohej:

— Druhem se i kam ca të acaruara nervat, — më tha, — kurse ky dedektiv seç më ysh një si neveri, as vetë s'e di përshtëpi ai. Kjo është djëka absurdë dhe e panatyrrshme, por them se kështu ka pér të qënë.

S'dija ç'përgjigje t'i jepja. Sa më shumë që i vëreja vepri met e dedektivist Kaf, aq më shumë po më hynte në zemër. Pas kësaj që tha, zonja aty pér aty e mblodhi veten; kam thënë unë, është grua më një okë mend ajo, është njeri pér të qënë.

— Po në qënka i domosdoshëm ai takimi me të, s'ke ç'bën, — tha. — Veç jo kokë më kokë, rrini edhe ju.

U ktheva në dhomën e pritjes. Zoti Frenklin kishte dalë të përcillte zotin Godfri Ebluajt, po afronte koha e nisjes së tij. Unë me dedektivin Kaf shkuam drejt e në dhomën e zonjës.

Zonia vetëm se u zbeh pak, kur e pa, po me asgjë tjetër nuk e dha veten; e pyeti dedektivin në ishte kundër qëndrimit tim aty. Ky tërë mirësjellje i tha se praninë time e konside-

ronte si ndilmë, sepse do t'i duhej diç të fliste edhe për shërbëtorët; përvoja ime do t'i qe tepër e dobishme.

Zonja na bëri më shenjë të zinim vend dhe filluam nga puna.

— Tanimë e kam një mendim për këtë çështje, — zuri të thotë dedektivi Kaf. — Ju kërkoj ndjesë, zonjë, por do të desha ta ruaja në veten time. Dua t'u tregoj se ç'farë gjeta në dhomën e pritjes së zonjushës Verinder dhe se nga mendoj ta filloj punën.

I kallëzoi për njollën në derë, për përfundimet që dëlnin nga kjo.

— Një gjë është e qartë, — tha në myllje. — Diamanti është zhdukur nga dollapi. Edhe diçka tjetër është po ashtu e qartë: gjurmët e bojës së derës duhet të gjenden në rrobet e dikujt në këtë shtëpi. Këto rrobe duhen gjetur, para se të ndërmarim hapa të tjerë në hetimet tonë.

— Kjo, me ç'duket, do të na çojë në gjetjen e hajdutit? — e pyeti zonja.

— Më falni, zonjë, nuk po them që diamantin e kanë vjedhur. Po ju them vetëm se diamanti është zhdukur. Në u gjettë rrëba e lyer me bojë, kjo do na çonte në gjetjen e diamantit.

Zonja pa nga unë.

— A kuptoni gjë ju nga kjo? — më pyeti.

— Dedektivi Kaf kupton, zonjë, — iu përgjigja.

— Po si mendoni ta gjeni atë rroben e zhyer? — e pyeti zonja dedektivin. — Turp të thuhet, por dhomat dhe sunduqet e shërbëtorëve të mi të mirë tanimë u kontrolluan nga inspektorë para jush. Nuk mundem dhe nuk dua t'i fyej për herë të dytë!

— Për këtë dhe do të desha të flasë me lartmadhërinë ujaj, — ia ktheu dedektivi. — Jam plotësisht i njëmendje me ju, zonjë, që ndjenjat e tyre duhen mëshiruar, por jam po aq i bindur edhe se garderobi i tyre duhet kontrolluar.

U ndodhëm në qorrkokak. Zonja këtë e shprehu me ca fjalë tepër të zgjedhura.

— Kam në mendje një plan, që do të na nxirre nga kjo gjendje e vështirë, — tha dedektivi Kaf. — Po të jeni dakord, zonjë, kam dëshirë që vetë unë t'ua bëj të qartë shërbëtorëve si qëndron puna...

— Gratë përsëri do pandehin se për to po dyshohet, — e ndërpreva sakaq.

— S'kanë për të pandehur, zoti Beterexh, — m'u përgjigji dedektivi, — nëse ju them se do të kontrollohet garderoba e gjithë atyre që kanë kaluar natën e të mërkurës duke gdhirë e enjtja në këtë shtëpi, duke filluar nga zonja. S'ka për të qënë veçse një formalitet, — shtoi duke parë tinës nga zonja. — Dhe shërbëtorët kësisoj kanë për t'u vënë në pozitë të barabartë me zotérinjtë; në vend që t'i pengojnë hetimet, kanë për t'i ndihmuar.

S'kisha si të mos e pranoja që kishte të drejtë. Zonja pas habisë së parë, gjithashtu që e njëmendjeje.

— Po fare i domosdoshëm është ky kontroll? — e pyeti.

— Është rruga më e shkurtër që të çon tek qëllimi, zonjë. Zonja u ngrit që të thërrisin shërbëtorët.

— Do t'u flisni shërbëtorëve, duke mbajtur ndër duar çelësat e garderobës sime.

Dedektivi Kaf e ndali me një pyetje të papritur: — A nuk do të ishte më mirë të bindeshim më parë pér dakortësinë e zonjave dhe zotérinjve të tjerë që ndodhen në këtë shtëpi?

— Zonja e vetme në këtë shtëpi është zonjusha Verinder, zotérinjtë janë vetëm nipërit e mi, zoti Blek dhe zoti Ebluajt. Nga ata s'keni për të patur kundërshtim.

Ia ndërmenda zonjës që zoti Godfri Ebluajt është duke u nisur. S'e pata mbaruar këto fjalë, kur u dëgjuat një e trokitur në derë dhe zoti Godfri hyri që t'i uronte lamtumirën, pas tij hyri edhe zoti Frenklin, që do ta shoqëronte deri në stacion. Zonja ia shpjegoi në ç'vështirësi ndodheshin. Zoti Godfri e zgjiddhi në vend çështjen: i bëri zë nga dritarja shërbëtorit që të sillte lart në dhomë valixhen, vetë ai ia dha në dorë çelësin dedektivit Kaf.

— Plaçkat m'i dërgoni në Londër, kur të përfundoni hetimet, — i tha.

Dedektivi ia mori çelësat, duke i kërkuar ndjesë përulësisht.

Zoti Godfri u nda me mall me zonjën, iu lut t'i transmetonte nderimet e tij zenjushës Reçell, duke lënë të kuptohet se në një kohë jo të largët do të kthehej përsëri për t'i kërkuar dorën. Zoti Frenklin, para se të dilte, i tha dedektivit se çdo

gjë e ka të hapur, se nuk e ka zakon të përdorë çelësa. Zoti Kaf e falenderoi për këtë. Tërë puna ishte te zonjusha, para se të thirreshin shërbëtorët.

— Veç më parë, — i tha zoti Kaf zonjës, — do të desha t'i hedh një sy regjistrat me hyrjet dhe daljet për në lavanteri të ndërresave. Rroba e zhyer me bojë mund të jetë futur në ndërrresat. Pastaj do të shohim gjithë çka ndodhet në shtëpi dhe gjithë sa është cuar në lavanteri, nëse ndonjë ndërresë munagon, mund të supozohet pikërisht se aty dhe janë gjurmët e bojës, pra enkas e kanë fshehur mbrëmë apo sot.

Zonja më urdhëroi të çoja për të sjellë regjistrin e ndërresave dhe e mbajti në dhomën e saj. Atë e solli Rozana Spiran. Në kohën kur u shtrua mëngjesi, ajo ishte dyll e verdhë dhe e shqetësuar, por sidoqoftë jo dhe aq keq pas asaj sëmundjes së djeshme. Dedektivi Kaf e pa me shumë vëmendje: si fytyrën kur hyri dhe supin e deformuar kur doli.

— A keni ndonjë gjë tjetër për të më thënë? — iu drejtua zonja, duke dashur të çlirohej një orë e më përpara nga shoqëria e dedektivit.

Kafi nammadh e hapi regjistrin, pa ç'i duhej, dhe pastaj e mbylli.

— Do ju shqetësoja me një pyetje, — i tha. — Vajza që hyri ka kohë që shërben këtu tek ju?

— E pse pyesni për këtë?

— Sepse s'ka shumë kohë që e kam takuar në burg, ku e kishin futur për vjedhje.

S'kishe nga lëvizje, i duhej thënë e vërteta. Zonja bëri çmos që ta lavdëronte qëndrimin dhe karakterin e Rozanës, i kujtoi se edhe drejtoresha e shtëpisë së edukimit kishte pasur mendim shumë të mirë për të.

— Besoj që nuk dyshoni gjë për të? — i tha më në fund me seriozitetin më të madh.

— Jua thashë një herë zonjë se deri më tani kërkënd nuk dyshoj për vjedhje në këtë shtëpi.

Zonja u cua për t'u ngjitur lart që të merrte kyçet e zonjushës Reçëll. Zoti Kaf, më parë se ta bëja unë, u sul që t'i hapte zonjës derën, duke e shoqëruar këtë me një përkulje të thelli. Zonja u drodh, duke kaluar para tij.

Pritëm gjatë, por kyçet nuk po vinin. Dedektivi nuk këmbeu me mua qoftë edhe një fjalë. Rrinte me fytyrë nga dritarja, tepër mëlankolik, me duart në xhepa dhe fëshkëllente një melodi.

Erdhi një shërbëtor, veç jo me çelësat, por me një pusullë përmua. Me ngut vura syzet, duke e ndier mbi vete shikimin pikëllimtar të dedektivit. Në pusullë me dorën e vetë zonjës qenë shkruar vetëm tri rrështa me laps. Më bënte të ditur se zonjusha Reçell në mënyrë të prerë nuk pranon të kontrollohej garderoba e saj. E kuptova mungesën e dëshirës së zonjës përtu takuar me dedektivin Kaf, pas një të tillë mospranimi të së bijës.

— Ju shkruan gjë përmë çelësat e dhomës së zonjushës? — më pyeti.

— Zonjusha nuk pranon t'i bëjnë kontroll garderobit të saj.

— A!

Zëri nuk iu nënshtrua dot asaj disiplinës së përsosur të fytërs. Kur shqiptoi atë «A!» u duk që nuk e kishte pritur këtë përgjigje. Edhe më zemëroi, edhe më trembi në të njëjtën kohë; s'di ta them përsë por kështu ishte.

— Do të hiqni dorë nga kontrolli? — e pyeta.

— Po, — m'u përgjigj Kafi. — Nga kontrolli do më duhet të heq dorë, ngaqë zonjusha s'pranoi t'i nënshtrohej baraz me të tjerët. Ose do të kontrollohen që të gjitha rrobat që janë në shtëpi, ose asnje. Niseni valixhen e zotit Ebluajt për në Londër me trenin e parë, kurse regjistrin e ndërrresave kthejani bashkë me përshëndetjet e mia gruas që e solli.

Regjistrin e vuri mbi tryezë dhe, pasi nxorri briskun, zuri të pastrojë thonjtë.

— Nuk më duket se u leqendisët shumë nga kjo që ndodhi? — e pyeta.

— Po, — ma ktheu dedektivi Kaf. — Jo dhe aq shumë. U orvata ta bëja që të shpjegohej.

— Përse t'u ketë penguar vallë zonjusha Reçell? — e pyeta. — Më duket se është në interesat e saj që t'ju ndihmonte.

— Prisni pak, zoti Beterexh, s'keni pse nguteni.

Ca koka më të mengura se kjo imja kushedi do e kapnin domethënien e fjalëve të tij. Edhe ndonjë më pak i dhënë pas

zonjushës Reçëll mund ta vinte re se ku donte të dilte. Neve-
ria që provonte zonja për të mund të donte të thoshte, — siç
e kuptova këtë më pas, — se ky e kuptonte ku duhej të dilte.

— Po tani ç'do bëjmë. — e pyeta.

Dedektivi Kaf përfundoi së pastruari thonjtë, i pa i për-
qëndruar si ndonjë minutë me një interes melankoliku dhe e
futi në xhep briskun.

— Dalim në oborr, — tha. — Shkojmë të shohim trëndafilat.

11.

— S'kemi përse të vrasim mendjen për qëndrimin e zo-
njushës, — vazhdoi dedektivi. — Na duhet të sqarojmë të fshe-
htën e njollës që është dhe e fshehta e diamantit. Do bisedoj
më shërbëtorët në vend që t'u kontrolloj veshjen. Por desha
më parë t'u drejtohem me këtë pyetje: a nuk ju ka rënë në sy
ndonjë veprim a sjellje e çuditshme e ndonjërit nga shërbëto-
rët, kuptohet, përveç tronditjes së natyrshme nga humbja e di-
amantit?

M'u kujtua sëmundja e beftë e Rozana Spirmanit dje para
drekës, por nuk arrita t'ia them, ngaqë dedektivi ia nguli shi-
kimin një kaçubeje dhe mërmëriti:

— Aha!

— C'ka ndodhur? — e pyeta.

— S'më lë rehat kjo e shkretë reumatizmë. Do prishet mo-
ti, me sa duket, — m'u përgjigj dedektivi.

Bëmë disa hapa, ku pa pritur e pakujtar zoti Kaf thotë:

— Me atë paraqitjen që ka, Rozana Spirmanit zor se i var-
diset kush, por do të desha ta pyes Rozanën, mos ia ka vënë
kujt syrin, siç bëjnë të gjithë?

C'kuptim të kishte kjo pyetje në këto rrethana?

Në vend që t'i përgjigjesha, zgurdullova sytë.

— Se ajo mjerane që fshehur pas asaj kaçubes, kur kalu-
am para pak kohe ne, — tha dedektivi.

— Kur nxorrët atë «Aha!»?

— Po, atëherë. Nëse dashuron dikë, këtu s'ka asgjë për t'u
habitur. Nëse jo, në këto rrethanat tonë kjo sjellje të bënë të

dyshosh dhe dua s'dua jam i detyruar tē marrë masat e ne-dyshosh dhe dua s'dua jam i detyruar tē marrë masat e ne-vojshme.

E dija që, duke u khyer nga stacioni, zoti Frenklin do tē kalonte nëpér kopsht, se ai ishte vendi i tij i preferuar; Pénélopa më pat folur jo një herë pér orvatjet e Rozanës, që tē tèr-hiqte vëmendjen e zotit Frenklin. Kjo kushedi atë dhe priste aty. Me këtë që po bënte, Rozana mund ta pësonë nga dyshimi i dedektivit. I nisur nga dhembshuria pér vajzën dhe vetëm nga kjo, ia bëra tē ditur dedektivit ndjenjat marroke tē saj pér zotin Frenklin.

Dedektivi Kaf nuk qeshte kurrë. Në ato tē pakta raste vëtëm ngrinte paksa çipin e buzëve dhe ato shtrembëroheshin. Kështu bëri edhe këtë herë.

— Ndiej një lehtësim në shpirt kur sqarohet ndonjë enigmë. Veç meje këtë s'ka pér ta ditur kush. Kopshtin e keni tē mrekullueshm! Sa bukur që e mbakeni lëndinën! Shikoni sa bukur që duken lulet tē rrëthuara nga bari e jo nga rrëra e çakëlli... Jo, ju faleminderit, nuk do ta këpus atë gonxhe. Më pikon mu në zemër kur i këpusin nga mëma...

U kthyem në shtëpi. Zoti Kaf kérkoi t'i caktonin një dhomë dhe t'i sillnin shërbëtorët njeri-pas tjetrit pa përjashtim. Shkoi edhe Rozana Spirman. Qëndroi aty më gjatë se tē tjerat. As edhe një fjalë nuk nxori, kur doli: heshtje e plotë dhe buzët e mavjosura, tē zbehta.

I fundit hyra unë pér tē mësuar në kishte ndonjë porosi dhe e pyeta:

— Morët vesh ndonjë gjë tē re?

— Në rast se Rozana Spirman kérkon leje që tē dalë nga shtëpia, mos ia kundërshton, veç më parë më vini në dijeni.

— Shpresoj se nuk mendoni që Rozana tē ketë gisht në humbjen e diamantit? — guxova ta pyes.

Asnjë përgjigje.

Atë qast u dégjua një e trokitur në derë. Hyri kuzhinierja dhe tha se Rozana Spirman kérkonte leje tē dilte se i dhimbte koka dhe donte tē shëtiste në ajër tē pastër.

— Le tē dalë.

— Nga ç'derë dalin shërbëtorët? — më pyeti menjëherë dedektivi.

Ia trëgova.

— Mbylleni këtë derën këtu dhe në ju pyestë njeri përmua, i thoni që jam kyçur brenda përtë menduar...

Doli nga shtëpia. Mbrëmja verore ishte mrekullisht e mirë. Më dhimbsej me gjithë shpirt e gjora vajzë, qesh i alarmuar nga rruga që morën hetimet. Kur po i afrohesha trëndafilave, takova zotin Frenklin që po shëtiste mes postateve të dashura. Kishte kohë që ishte kthyer nga stacioni dhe kishte biseduar edhe me zonjën. I kishte rrëfyer edhe për mospranimin e guditshëm të zonjushës. Reçell përtë parë garderobin e saj. Kjo e kishte pikëlluar pa masë.

Ecëm të heshtur ndonja dy minuta, pastaj më pyeti përdedektivin Kaf. Nuk guxova ta gënjeja. Ia tregova gjithë sadija përsjelljen e Rozana Spirmanit.

— Më keni treguar përatë dyqanxhiun që e kishte parë në qytet. Sémundja s'paska qënë veçse shkak. Ka pasur disa arsyet fortë ajo vajzë që shkoi me fshehtësi në qytet. Rroba e zhyster me bojën i përket asaj, me sa duket, është duke marrë masat përtë ta zhdukur, pa zgjuar dyshimin e të tjerëve. Është Rozana Spirman ajo që e ka vjedhur diamantin. Po shkoj t'ia bëjt tē ditur tetos këto.

— Jo, prisni pak, zotëri, — u dëgjua që prapa nesh një zë pikëllimtar.

U kthiyem shpejt dhe u gjendëm ballëpërballë me dedektivin Kaf.

— E pse? — e pyeti zoti Frenklin.

— Sepse po t'ia thoni zonjës, ajo ka përtë t'ia thënë zonjushës Verinder.

— Qoftë edhe kështu e çfarë pastaj?

Këto fjalë zotí Frenklin i tha me një vrull e ndjenjë aq të fuqishme, sikur dedektivi ta kishte fyjet atë vetë.

— E si mendoni jū, zotëri, — i tha qetë-qetë dedektivi Kaf, — a është e arsyeshme të më bëhen ca pyetje si kjo në këto çaste.

Heshtën. Zoti Frenklin iu afrua dedektivit. U panë të vrenjtur sy ndër sy. I pari foli zoti Frenklin, fare me zë të ulët:

— Them se jeni plotësisht i vetëdijshëm, zoti Kaf, që po rrëmoni një çështje tepër delikate.

— S'e kam përtë herë të parë këtë. — ia ktheu ky me atë qetësinë e tij të zakonshme

— Doni të thoni se ma ndaloni t'i flas tetos për gjithë sa ka ndodhur?

— Ju them, zotëri, se do e braktisja ndjekjen e mëtejshme të çështjes, nëse ia njoftoni zonjës Verinder, apo kujtdoqoftë tjetër gjithë sa ka ndodhur, pa marrë më parë pëlqimin tim.

Këto fjalë i vunë kapak bisedës. Zoti Frenklin u kthyesh rrëmbimthi dhe u largua.

— Zoti Beterexh, — m'u drejtua pas kësaj dedektivi. — Bëtë një gabim të pafalshëm që me iniciativën tuaj ndërmorët ca veprime në mungesën time. Në të ardhmen ndoshta do të jeni i detyruar të hidheni në veprim, veç së bashku me mua.

Më kapi për krahu dhe më shqëroi nëpër po atë rrugë që kisha ardhur. Veç, edhe pse e kisha hak qortimin, as që më pat shkuar në mendje t'i ndihja të ngrinte kurthe për Rozana Spirmanin. Ajo vajzë më dhimbsej.

— C'dëshironi nga unë? — e pyetë, duke e çliruar krahun nga dora e tij.

— Vetëm ndoca njoftime për vendet përreth, — m'u përgjigj dedektivi.

S'kisha si të mos pranoja t'ia bëja këto njoftime.

— A ka në këto anë ndonjë rrugë që të con te bregu i detit për në shtëpi? — më pyeti zoti Kaf.

Më kallzoi me dorë pyllin e bredhave, prapa të cilit ndodhej «Rëra e Tallazitur».

— Po, — i thashë. — Ka një rrugë.

— Ma tregoni.

Ashtu bashkë, unë dhe dedektivi, atë mbrëmje verore morëm rrugën që të shpinte te «Rëra e Tallazitur».

12.

Kafi heshtte i zhytur në mendime derisa dolëm nga pylli i bredhave. Pas pak më tha:

— Zoti Beterexh, e shoh që jeni i vendosur të mos më tregoni asgjë të tillë që mund të dëmtonte Rozana Spirmanin, nga që ju dhimbset. Ky motiv humanitar ju bën nder, por në rastin e dhënë është fare pa dobi. Rozana Spirmanit nuk i kanoset

ndonjë rrezik, edhe në u akuzoftë si bashkëfajtore për humbjen e diamantit. E për këtë kam goxha të dhëna.

— Doni të thoni që zonja nuk ka për ta paditur? — e pyeta.

— Dua të them që zonja nuk mundet ta padisë, — maktheu dedektivi. — Rozana Spirmani s'është veçse vegël në duart e një personi tjetër dhe për hir të tij atë kanë për ta falur.

Ishte duke folur seriozisht, por s'di përsë në mendje më lëvrinëtë një fije dyshimi.

— A mund t'ia thoni emrin atij personit tjetër? — e pyeta.

— Po ju, a nuk mund t'ia thoni, zoti Beterëxh?

— Jo.

Dedektivi Kaf ndali dhe më pa me keqardhje të pikëllimitë.

— Ndiej kurdoherë kënaqësi kur mëshiroj dobësinë e dikujt, — më tha. — Këtë çast e kam një dëshirë të madhe t'ju mëshiroj ju, zoti Beterexh. Edhe ju për këtë shkak keni dëshirë të madhe të mëshironi Rozana Spirmanin, kështu apo jo? Pa më thoni, mos ka qepur gjë ndërrresa të reja ajo këto ditë?

I tregova se vajza kish ardhur me pak rrobe dhe para do kohe zonja i kish dhuruar ca ndërrresa.

— Sikur të mos kishte qënë kjo dhuratë, ne fare lehtë do veçonim një fustan të ri apo triko në plaçkat e Rozanës dhe do ta kishim zënë me presh në dorë. Pas gjithë atyre pyetjeve dhe hetimeve, ka të dhëna të mendohet që Rozana Spirmani të ketë qenë ajo që e ka shkaktuar atë njollë poshtë kyçit. Me ta kuptuar që kjo njollë ra rië sy, shtiret si e sëmure dhe shkon në qytet për të blerë një copë të re për fustan apo triko, ta qepë vetë në dhomën e saj; e fsheh atë të zhyerën për ta zhdukur diku jashtë; jo për ta djegur, se do të ndihej era. Dhe përkëtë qëllim zgjodhi këtë vend të vetmuar që shtrihet, ja, para nesh. E pashë sot në darkë si shkoi në një kasolle peshkatari, ku edhe ne, ndoshta, s'bëjmë këq të kthejmë. Qëndroi disa kohë, siç m'u duk, kishte diçka të fshehur nën pardesy. Se paradesyja e gruas, kjo emblemë përdëllimi, mbulon sa e sa gjynahë. E pashë kur shkonte drejt veriut, përgjatë bregut, pasi doli nga kasolla... Po pse aq piktoresk u mbajtkë ky bregdeti këtu, zoti Beterexh?

Iu përgjigja «po», sa munda më prerë.

— Epo punë shijesh, de, — tha dedektivi Kaf. — Mua s'më duket i tillë. Se s'ka edhe asnjë vend ku mund të fshihesh dhe qetësish ta ndjekësh një njeri. Se u vura para dilemës: o ta arrestoja këtë Rozanën, o ta ndiqja hap mbas hapi, duke mënjanuar kësodore dyshimet e mundshme që do të binin mbi atë personin që ne nuk po ia zëmë ngoje emrin. Vëç kemi ndihmesë rërën. Të më falni nëse do të më duhet të shkoj përra, kurse ju të më ndiqni pas.

Po fillonte batica dhe ajo dridhja e lemerishme e «Rërës e Tallazitur». Kjo ishte e vetmjë lëvizje në tërë këtë hapësirë të llahtarshme.

Vura re si u drodh dedektivi, kur i shkuat sytë tek ajo rëra. Ia nguli shikimin për ndonja një minutë, pastaj m'u afroa.

— Vend i pabesë ky, zotë Beterekh, — më tha. — As edhe një gjurmë të Rozana Spirmanit nuk na zuri syri gjatë tërë bregdetit. Po ajo kasollja e peshkatarit në ç'drejtum bie.

— Ja këtej nga jugu, — i thashë.

— Unë e pashë vajzën duke ecur nga veriu gjatë bregut, — tha dedektivi. — Pra del që qe drejtar për këtu. Duhet gjetur vendi ku ka zbritur poshtë bregut.

Bëmë si ndonja dyqind hapa në drejtum të fshatit peshkatar të Kobs-Hollit, kur dedektivi Kaf u lëshua më gjunjë, si të kishte ndier në çast një dëshirë të papërmabjatur për t'u falur.

— Ja shenjat e këmbëve të gruas! — tha. — Do i quajmë gjurmë të Rozanës, për sa kohë që nuk do të kemi argumente që nuk janë të saj. Gjurmët janë të fshira, shihini vetë. E gjora! I di jo më keq se unë ato vëgoritë prej tradhëtarë të rërës. Por sa nguturazi e paska bërë këtë punë. Ja, ca gjurmë vijnë nga Kobs-Holli, këto të tjerat shkojnë në të kundërtën. Ja, drejtimi të çon në ujë. Diç ka dashur të fshehë me dinakëri. Për të mos lënë gjurmë, ka ecur nëpër ujë për të dali tek ai shkëmbi atje, pastaj po me atë rrugë është kthyer. Por kjo është vetëm hamendje dhe shkon për bukuri me atë hamerdjen tjetër që nën pardesy diç mbante të shtrënguar, kur po dilte nga kasollja e peshkatarit. Dhe e ka bërë tërë këtë përtat fshehur atë plaçkën diku këtu e jo për ta zhdukur. Ndoshta,

kur të shkojmë tek ajo kasollja, e marrim vesh se ç'ishte ajo plaçkë.

— Po unë ç'duhem në këtë mes? — e pyeta.

— Po të shkoj vetëm, të zotët e shtëpisë zor se do më përgjigjen, kur t'i pyes. Me ju biseda do të jetë fare e çlirtë, bisedë mes komshinjsh.

U nisëm pér te kasollja e peshkatarit Jolland, që rronte me të shoqen dhe me dy fëmijë të rritur, vajzë e djalë. Me të bijën, Lusí Çalamenan, Rozana kishte miqësi.

Jollandi me të birin kishin dalë pér peshk. Ishte e shoqja me të bijën çyryke që lodhej shpejt, ndej dhe po pushonin në dhomën e saj. Bisedën e hapi dedektivi Kaf, që theksoi sidomos këtë anë i të çështjes: duke u marrë me gjetjen e diamantit të shquar, interesohet, kuptohet, pér t'ia kthyer atë të zotërve, por edhe pér të hequr nga Rozana Spirmani dyshimet e armiqve të saj në shtëpinë e zonjës Verinder. Pas një cerek ore bisede e shcqja e peshkatarit u bind që ishte duke folur me dashamirin më të madh të Rozanës. Kur po bënim të dilnim, dedektivi hodhi mbi tryezë kartën e fundit.

— Ju uroj natën e mirë, zonjë, — shqiptoi, — dhe ja ku po ju them para se të largohem: po e bëj tërë këtë në të mirë të Rozanës dhe e këshilloj të mos qëndrojë më gjatë në këtë vend!

— Zot i madh, po ajo dhe vetë do që të largohet! — thirri zonja Jolland.

Rozana Spirmani po largohej nga ne! I bëra veshët bigë. M'u duk e çudtshme, pa thënë diçka më tepër, që po e bënte këtë pa vënë në dijeni as zonjën e as mua. Më lindi një dyshim, mos i ka rënë pikës ky dedektivi Kaf?

— Po ku ka ndërmend të vejë?... Se, e gjora, s'ka ku e pérplas kokën, veçse te ju dhe tek unë.

— Ka ku vete, — e kundërshtoi zonja Jolland. — Erdhi mbrëmë, siç ju thashë, ndenji pak e bisedoi me time bijë Lusinë, pastaj kërkoi leje që të rrinte pér një kohë vetëm, lart në dhomën e Lusisë. Është e vetmja dhomë në këtë shtëpi ku ka bojë, penë e letër. «Më duhet t'i shkruaj letër një mikut tim, — tha. — Atje në shtëpi s'e bëj dot se më ndjekin ato shërbëtoret dhe më spiunojnë». Se kujt ia shkroi, s'mund ta them, veç ishte letër e gjatë e ndenji shumë atje lart që e shkroi. I dhashë pu-

Më që ta niste, por letrën s'ia pashë ndër duar dhe pullen nuk e mori. Se ajo mjerane është ca e fshehur, s'tregon se ç'farë bën. Ka një mik ajo, vë bast pér këtë, dhe them se tek ai ka pér të shkuar.

— Tani shpejt do niset? — e pyeti dedektivi.

— Sa më shpejt që të jetë e mundur, — iu përgjigj zonja Jolland.

— Ju, me siguri që gaboheni, — i thashë. — Po të donte ta linte vendin e punës, pikësëpari do të ma kishte bërë këtë të ditur mua.

— Gabohem? — thirri zonja Jolland. — S'ka një orë që i bleu tek unë ca rrrobe që i duhen pér rrugë! Po, sa pér ato paratë... — e ndërpree rrjedhën e mendimeve të veta zonja Jolland. — I kam ca borxh... Në e takoni, ia jepni kur të ktheheni në shtëpi.

— Me kënaqësinë më të madhe e çoj në vend këtë porosinë tuaj, — iu përgjigj dedektivi Kaf, para se të thosha unë ndonjë fjalë.

Zonja i numëroi me shumë kujdes të hollat, edhe pse fytyra i shprehte një mungesë dëshire pér t'u ndarë prej tyre.

— Mezi i ka mbledhur, e gjora, s'kam pse ia marr këto para pér ato plaçkat që i dhashë. I thoni që ia kam dhuruar me gjithë shpirt. Dhe mos i lini ashtu mbi tryezë se jemi nevojtarë e kushedi më kthehet mendja dhe i fus përsëri në xhep.

— Shkojmë! — i thirra Kafit. — S'mund të rrimë as edhe një minutë.

— Ja, tani, — m'u përgjigj ky.

— S'është e lehtë t'ia kthesht të hollat tjetrit, zonjë. Se ju dhe kështu do ia keni shitur pér një copë bukë.

— Po vërtet, fare lirë ia shita, — tha gruaja.

Mori qiririn dhe e çoi dëdektivin në qoshe të kuzhinës ku kishte gjithfarë hekurinash të mbledhura, me sa dukej, nga peskatari, mbeturina të anijeve të mbytura, që ende nuk kishte arritur t'i shiste. S'durova dot dhe u afrova dhe unë. Zonja Jolland futi dorën në ato hekurishte dhe nxori që andej një kuti të vjetër hekuri me kapak dhe me një unazë pér ta varur, të lyer me katran të zi, nga ato që përdoren nëpër anije pér të vënë hartat gjeografike dhe detare, në to janë të mbrojtura nga lagështia.

— Ja, — tha. — Kur erdhi këtu, mori një kuti kësisoj. «Ja kjo kutia më duhet, — tha, — pér të vënë manshatat dhe jakat që të mos zhuraviten në valixhe». Një shilingë dhe nëntë pensë, zoti Kaf. As edhe një kacidhe më tepër s'i mora!

— Lirë fare! — tha dedektivi me psherëtimë.

— Epo mjaft tani, — thashë përsëri. — U bë vonë, duhet të ikim.

Pa i kushtuar as pikën e vëmendjes këtyre fjalëve të mia, zonja Jolland përsëri futi dorën në hekurishte dhe nxori që andej një zinxhir si ata, me të cilët lidhin qentë.

— Pa peshojini në dorë, zotëri, — iu drejtua dedektivit. — Kemi patur tre të tillë, Rozana mori dy. «E ç'ju duhen, moj shpirte, këta zinxhirë?» — e pyes. «Do t'i bashkoj të dy e do të lidh valixhen», — më thotë. «Litari bën më lirë», — i them. «Po zinxhiri është më i fortë», — ma kthen. «Po pse lidhet valixhja me zinxhirë?» — e pyes. «Zonja Jolland, — më thotë, — mos kundërshto, m'i jep edhe këta zinxhirë!» Vajzë e çuditshme, zoti Kaf! E ka flori shpirtin; time bijë, Lusinë, e ka së motër e shkuar motrës, por që kurdoherë e çuditshme ka qënë ajo. Kuptohet, ia dhashë zinxhirët. Pér tre stërlina dhe gjashtë pensë ia dhashë! As edhe një santim më shumë, zoti Kaf.

— Pér secilën? — pyeti dedektivi.

— Pér të dyja bashkë, — iu përgjigj zonja Jolland. — Badihava, thuaj.

— Ashtu vërtet, zonjë, — tundi kryet dedektivi. — Badihava!

— Ja dhe paratë, — tha zonja Jolland. — Bëjini të falura nga urë dhe i thoni se s'më bën zemra t'ia marrë këto para që me aq mundim i ka kursyer.

Dolëm me ngut nga kasollja.

— Ja pra, zoti Beterexh, — m'u drejtua kur po ecnim drejt shtëpisë. — Veprimet e vajzës janë fare të qarta: të dy zinxhirët i ka mbërthyer në të dyja anët e kutisë metalike, këtë kuti e ka futur në ujë ose në rërë, fundin tjetër të zinxhirit e ka mbërthyer në ndonjë shkëmb që vetëm ajo e di. Do ta lërë aty aq kohë sa të marrin fund hetimet. Por mbetet e paqartë ç'të ketë fshehur në atë kuti?

Me vete mendova: «Gurin e Hënës», kurse me zë të lartë thashë: — Pse mos éshëtë aq e vështirë përgjigja?

— Diamantin jo njéherë, — m'u përgjigj dedektivi. — As edhe një grosh nuk do të viente tërë kjo pérvojë imja, nëqof-tëse éshië Rozana Spirmani ajo që e ka marrë diamantin.

— Atéherë rrobën e zhyer me bojë!

Dedektivi Kaf ndali në vend në errësirë dhe vuri dorën e tij mbi timen.

— Kur kanë flakur diçka në atë «Rérën e Tallazitur», a e ka nxjerrë mbanë dallga? — më pyeti.

— Kurrë, — iu përgjigja. — Si sendet e rënda, si sendet e lehta «Réra e Tallazitur» i thith në gjeratoren e saj njéherë e përgjithmonë.

— Rozana Spirmani e di këtë?

— Po aq mirë sa edhe unë.

— Domethënë se mjafkonte që të mbështillte me rrobën e zhyer një gur të rëndë dhe ta vërviste në «Rérën e Tallazitur» dhe puna mbyllej me kaq, — tha dedektivi. — S'kishte përsë tē kujdesej aq shumë që ta fshihte. Kurse ajo domosdo që e ka fshehur. Lind pyetja: a éshëtë ajo rrobe diçka e tillë që duhej ruajtur se s'bën. Në s'më pengoftë gjë, do të më duhet nesër të bëj një rrugë deri në Frizingol pér tē marrë vesh, ç'ka blerë aty. Me këtë riscoj, por ama edhe të vazhdoj tē veproj këshfu qorrazi, s'riskoj më pak. Të më falni pér këtë humor tē pri-shur; e humba respektin ndaj vetes derisa i lejova Rozana Spirmanit tē më fus në qorrsokak.

Pyetja e parë që bëri dedektivi Kaf kur u kthyem ishte: a qe kthyer Rozana Spirman?

I thanë se kishte ndonjë orë. Ishte ngjitur lart pér tē zhveshur pardesynë dhe kapelen dhe ishte shtruar me tē gjithë pér tē ngrënë darkë.

Pa thënë më as edhe një fjalë, dedektivi Kaf doli në oborr. Ia qepi shikimin dritaresh së dhomës tē zonjushës Reçell ku drita lëvizte sa në një anë në tjetrën, si tē ndodhët aty diçka e pazakontë.

— Éshtë dhoma e gjumit e zonjushës Verinder? — më pyeti dedektivi Kaf.

I thashë «po» dhe e ftova tē shkonim tek unë pér tē ngrënë darkë

Dedektivi nuk luajti vendit, vetëm belbëzoi se i pëlqente mbrëmjeve të thithte ca ajër të pastër. Mora vesh që dedektivi Kaf kishte bërë një zbulim të ri dhe për këtë e kishte ndihmuar dritarja e zonjushës!

— Vë bast, zoti Beterexh, — më tha, kur u ktheva në oborr tek ai pas pak, — se zonjusha ka vendosur të ikë që këtej dhe mendimi për të ikur s'ka veç një orë që i ka shkrepur në mendje.

Qesh tejet i tronditur dhe, duke harruar edhe mirësjelljen elementare, hyra në derë para se të kalonte zoti Kaf.

Na doli përparrë një shërbëtor dhe, papritur që unë t'i bëja ndonjë pyetje, tha:

— Zonja po ju pret ju dhe zotin Kaf.

— Ka kohë që është duke na pritur? — e pyeti dedektivi.

— Si ndonjë orë, zotëri.

Dhe ja! Rozana qe kthyer një orë më parë, zonjusha Reçell e kishte marrë këtë vendim të beftë dhe ishte duke pritur dedektivin si ndonja një orë më parë! Ishte tejet e pakëndshme që njerëz dhe sende aq të ndryshëm të ishin kësisoj aq të kokolepsur me njeri-tjetrin. U ngjita lart pa ia hedhur sytë dedektivist dhe pa i thënë as edhe një fjalë. Dora po më dridhej si purtekë, kur e ngritura për të trokitur në derën e zonjës.

— S'do më habis aspak ndonjë skandal që kishte për ta pataksur keq tërë shtëpinë sonte, — më pëshpëriti që prapa shpinës dedektivi. — Veç mos u qederosni, në praktikën time më është dashur të kapërcej vështirësi ku e ku më të mëdha se këto.

Dedektivi Kaf s'arriti dot ta mbaronte këtë pëshpërimë, kur që nga dhoma tjetër u dëgjua zëri i zonjës që na urdhëronte të hynim.

13.

Në dhomën e zonjës ishte ndezur vetëm llambushka e vogël që e mbante kur lexonte. Abazhuri ishte ulur aq shumë, saqë edhe fytyra i që kredhur në errësirë. Në vend që të na shihe drejt e në sy, siç e kishte zakon, ajo rrinte pa ia shqitur systë faqeve të librit.

— Zoti Kaf, — tha. — Mos ju hyn në punë ky njoftim pér ato hetimet. Zonjusha Verinder ka ndérmend tē niset nesër në mëngjes pér në Frizingol tek teto Ebluajti.

Dedektivi Kaf më pa drejt në sy. Bëra tē çapëloj pérpara pér tē folur me zonjën, por, t'u them tē drejtën, më mungoi guximi, qëndrova aty ku isha pa thënë as edhe një fjalë.

— Mund t'ju pyes, madhëri, kur i lindi ky mendim zonjushës Verinder? — u intresua dedektivi.

— Ndonja një orë më parë, — iu përgjigj zonja.

Dedektivi Kaf përsëri pa nga unë. Thonë se zemra e pleqve nuk rreh dot vrullshëm. Zor tē këtë pas rrahu ndonjëherë kjo timja më vrullshëm se tani.

— Nuk kam asnëj tē drejtë, — tha dedektivi, — tē mbikqyr veprimet e zonjushës Verinder. Vetëm se ju lutem pérulësish tē shtyhet ky largim, po qe e mundur. E ndiej tē nevojshme tē nisem vetë pér në Frizingol nesër në mëngjes, do ktheshem rrëth orës dy, ndoshta dhe më parë. Sikur tē mundte tē qëndronte zonjusha Verinder deri në kthimin tim, kisha dëshirë t'i thosha nja dy fjalë para se tē nisej.

Zonja më porositi ta urdhëroja karrocierin e zonjushës Recëll tē mos nisej para orës dy.

— Ndonjë gjë a keni ç'të më thoni? — e pyeti pastaj dekativin.

— Po, madhëri. Në rast se zonjusha Verinder do tē shprehë habinë e saj pér këtë ndalesë, mos i thoni që shkaktar kam qénë unë.

Zonja e ngriti vrulltas kokën nga libri, si tē deshte diç tē thoshte, e përbajti me një sforcim tē mundimshëm veten dhe përsëri i uli sytë në faqet e librit, me një lëvizje tē dorës më bëri shënje tē dilnim.

— Grua e çuditshme! — tha dedektivi Kaf, kur dolëm në korridor. — Të mos ishte ajo vetëpërbajtja e saj, e fshehta, që aq shumë ju ka vënë në merak ju, zoti Beterexh, do tē qe zbuluar sot.

— Dreqi ju marrtë, — iu vërsula me britma. — Zonjusha Recëll s'i ka mirë punët dhe ju këtë ma paskeni fshehur tërë kohës!

I zënë ngushtë dedektivi vetëm më shihte pa u orvatur as-

pak tē kundërshtonte dhe madje pa e ndryshuar aspak shprehjen pikëllimitare tē fytyrës.

— Ehë, i ratë pikës, më në fund! — thirri.

Hymë në një dhomë dhe e mbylla derën me çelës.

— Ma thoni troç, zoti Kaf, — i thashë. — Cilat janë dyshimet tuaja? Do tē tregoheshit i pashpirt në do vazhdonit ta fshihnit këtë nga unë.

— Unë nuk dyshoj, — m'u përgjigj dedektivi Kaf. — Unë jam i sigurt.

Fërsëri më hipi gjaku në kokë.

— Me ç'po shoh, doni tē më mbushni mendjen që zonjusha Recëll e paska vjedhur diamantin e saj.

— Po, — ma preu dedektivi. — Këtë desha tē bëj. Zonjusha Verinder e ka fshehur ajo vetë «Gurin e Hënës» dhe këtë fshehtë ia ka besuar Rozana Spirmananit, duke qënë e sigurtë që do tē dyshonim te kjo. Ja si qëndron puna!

O Zot, ki mëshirë për mua! S'dija ku tē futesha.

— Këtë ju duhet ta vërtetoni.

— Nesër do t'i keni që tē gjitha tē dhënrat, — m'u përgjigj dedektivi. — Në rast se zonjusha Verinder nuk do tē pranojë ta shtyjë nisjen, — dhe kini për ta parë që nuk ka për ta pranuar. — do tē jem i detyruar që nesër t'i shtjelloj zonjës tërë çështjen. Por meqë s'mund t'i parashikoj dot rrjedhojat, ju lutem tē ndodheni si dëshmitar. Dhe tanj e lëmë me kaq. S'keni për tē dëgjuar më as edhe një fjalë për diamantin, zoti Beterexh. Më duket se po na pret darka. Është një nga dobësitë e njeriut, tē cilën kurdoherë e respektoj. Sa t'u bëni zë shërbëtorëve, po them pak lutjen.

Në korridor takova Penelopën. Më tha se zonjusha Recëll po nisej për në Frizingol ngaqë shtëpi^{ja} këtu i ishte bërë skëterrë, s'mundëj më tē duronte praninë ogurzezë tē këtij dedektivit. Kur mësoi se ia kishin shtyrë nisjen; qe zemëruar keq. Zonja që ia kishin bërë tē ditur, i kishte têrhequr vrejtjen dhe meqë desh tē fliste kokë më kokë me të, i kishte thënë Penelopës t'i linte vetëm. Vajza qe shumë e pezmatuar nga tërë këto ndryshime që kishin ndodhur në shtëpinë tonë.

— S'është si më parë, baba. E ndiej se po na kanosin e mënxyra.

Edhe unë ndieja të njëjtën gjë, por në sy të Penelopës nuk e dhashë veten. Ndërkaq u dëgjua zilja e zonjushës Reçell. Penelopa vrapoi sipër për të mbledhur plaçkat. Eca më tej nëpër korridor. Befas u pérplas një derë dhe që nga një dhomë doli me vrap Rozana Spirman, me një shprehje dhimbjeje të tmerrshme në fytirë, duke shtrënguar fort me dorë zemrën.

— Ç'ke kështu, moj vajzë? — e pyeta pasi e ndala. — Mos je gjë e sëmurë?

— Emri Zotit, më lini të shkoj, — m'u përgjigj dhe u shkëput vrulltas nga duart e mia. Çova dy shërbëtorë ta ndiqnin pas. Ndërkaq nga dhoma ime doli zoti Kaf, dhe më pyeti ç'kishte ndodhur. I thashë se s'kishte ndodhur gjë. Zoti Frenklin dhe ai doli nga dhoma e tij dhe më pyeti në e kisha parë Rozana Spirmanin?

— Sapo doli me vrap që këtej, zotëri, dukej tepër e alarmuar dh u soll në një mënyrë të çuditshme.

— Druhem mos, pa dashjen time, jam unë ai që ia shkaktova këtë shqetësim, Beterexh.

— Ju, zotëri?

— S'jam në gjendje që ta shpjegoj, por nëse kjo vajzë ka gisht në zhdukjen e diamantit, them se nja dy minuta më parë po bëhej gati të më hapej, dhe, s'di përsë, pikërisht mua.

Kur mbaroi së foluri, pashë rastësisht nga dera që të nxirrte jashtë shtëpisë dhe m'u duk se ajo u hap paksa nga brenda.

Mos vallë po na përgjonin? Pastaj dera përsëri u puthit, kur iu afrova, e hapa me të shpejtë. Sytë më zunë redingotën e zezë të zotit Kaf, që sakaq u zhduk pas qoshes së murit. Ky tanimë e dintë fort mirë, si dhe unë, që s'kishte si i varte më shpresat mbi mua në ato hetimet e mëtejshme të çështjes. Në këto rrëthana prej atij njeriu mund të pritej që vetë ta ndihmonte veten, madje edhe me kësi mënyra.

S'desha ta tërhiqja vëmendjen e zotit Frenklin nga biseda e nisur, ndaj iu luta të vazhdonte tregimin.

— Isha duke lozur bilardo, — tha ky, duke treguar nga tryeza e bilardos, — doja ta largoja për ca kohë nga mendja këtë të shkretë çështje të diamantit. Ngre rastësisht kryet, para meje qëndronte aq heshturazi sa që nuk e kisha ndier tek hynte. Duke e parë ashtu të trondititur, i thashë, mos donte të

më bënte të ditur ndonjë gjë? M'u përgjigj: «Po, në guxofsha!» Duke e ditur q'dyshime binin mbi të, atyre fjalëve u dhashë vetëm një kuptim: donte të më hapej. «Me se mund t'u shërbej» — e pyeta. I fola butë, Beterexh, më besoni, se ajo fatkeqe nuk është aspak fajtore që është aq e shëmtuar. Për ta fshehur turbullimin që ndieja, vazhdoja të godisja me stekë guriët e bilardos. Por me këtë vetëm se e keqësova gjendjen. M'u duk se e fyeva pa e patur as në mendje e as në fiqir një gjë të tillë. Befas m'i ktheu krahët dhe unë dëgjova të thotë duke dalë: «Tërë vëmendjen e ka të përqëndruar te bilardoja. Ndjen më shumë kënaqësi kur sheh guriët e bilardos sesa mua!» Nuk arrita as të orvatem ta ndalë, kur iku me vrapi. Seç kam një merak në shpirt, Beterexh... Mos merrni përsipër t'i thoni Rozanës se nuk desha të jem i pavëmendshëm ndaj saj? Ndoshita vetë me vete e kam gjykuar ashpër atë vajzë, thuajse qesh i mendimit se fajtore për zhdukjen e diamantit ishte ajo. Dhe kam menduar kështu jo me keqdashje, por...

Heshti dhe ju kthyti përsëri lojës së bilardos.

Pas gjithë c'kishte ndodhur ndërmjet meje dhe dedektivit e dija çfarë që ajo që nuk e shprehu zoti Frenklin dhe madje më mirë se ai vetë.

Vetëm bindja e plotë që diamantin e kishte vjedhur Rozana Spirman e shpërqëndronte vëmendjen e dedektivist Kaf nga zonjusha Reçell. I fola për këtë zotit Frenklin.

— Po, po, — m'u përgjigj. — Por ka edhe një shpresë, si-gurisht të pakët, që sjellja e Rozanës të ketë edhe një shpjegim tjetër që ende s'e shohim. S'më pëlqen t'i fyey gratë, Beterexh. Thuajini të gjorës vajzë, ç'ju thashë. Në dëshiron të bisedojë me mua, — pavarësisht se çfarë e keq mund të më gjejë, — i thoni se e pres në bibliotekë.

Me këto fjalë dashamire e la në vend stekën dhe u largua.

Mora vesh që Rozana qe kthyer në dhomën e saj dhe kish-te kërkuar vetëm një gjë: ta linin të qetë. Ia thashë këtë zotit Frenklin që pas kësaj doli nga biblioteka për të rënë në gjumë.

Njëri nga shërbëtorët më njofftoi se qe zhdukur zoti Kaf. Zura ta kërkoi nëpër shtëpi. E gjeta shtrirë mbi tre karrige para derës së zonjushës Reçell. U zgjua me t'iu afruar.

— Natën e mirë, zoti Beterexh, — më tha.

— Ç'bëni këtu? — e pyeta. — Pse s'jeni shtritur në shtrat?

— Nuk jam në shtrat, — ma ktheu, — sepse i përkas asaj kategorie njerëzish që s'i fitojnë dot paratë lehtësish dhe ndershëmërisht. Një rrëthanë e çuditshme: kthimi i Rozanës Spirman nga «Rëra e Tallazitur» u përputh me vendimin që mori zonjusha Verinder për ta braktisur shtëpinë, kërkon shpjegim. Çdo gjë që të ketë fshehur Rozana, është e qartë që zonjusha s'kishte si largohet pa e marrë vesh që ajo gjë është fshehur. Kështu duhet të ketë rënë dakord. Nëse do të vendosin të flasin përsëri, kur në shtëpi të ketë mbretëuar qetësia, dua që kjo të mos ndodhë. E pra fajin që nuk rashë të filia në atë shtratin që me aq pekul porositët ta shtronin përmua, s'e kam unë por diamanti.

— Do të kisha dashur që ky i shkretë diamant të mos që dukur kurrë në këtë shtëpinë tonë! — thashë me gjithë shpirt.

Zoti Kaf pa me një shprehje ankintari të trija karriget që kishte përgatitur si shtrat për atë natë dhe ma mbështeti seriozisht këtë mendim:

— Edhe unë po ashtu.

14.

Natën asgjë nuk ndodhi, asnë shënjë dëshire për t'u takuar s'u vu re as te zonjusha Reçell e as te Rozana.

Pandehja që dedektivi Kaf do nisej qysh herët në mëngjes për në Frizingol, por s'ndodhi kështu: ky u vonua si të donte të bënte më parë ca punë të tjera. Dola për ta takuar zotin Frenklin që ishte duke shëtitur në atë rruginë e preferuar te trëndafilat. S'arritëm të këmbejmë as edhe dy fjalë, kur pa pritur na u afrua dedektivi. Duhet thënë që zoti Frenklin e priti ftohtë.

— Mos doni të më thoni diçka? — e pyeti.

— Po, — iu përgjigj dedektivi, — lidhur me hetimet që jam duke bërë. Në rrëthanat e krijuara a s'më thoni, si qyte-

tar dashamirë, vallë e ndieni veten të detyruar të më ndihmoni me njoftime që ju mund t'i dispononi?

— Nuk disponoj njoftime të vëçanta, — ia ktheu zoti Frenklin.

Zoti Kaf nuk ia vuri veshin kësaj përgjigjeje, sikur zoti Frenklin të mos ia kishte dhënë fare.

— Ju mund të më lehtësoni e të mos më detyroni të humbas kohë, duke i grumbulluar njoftimet me rrugë të tjera.

— Nuk po arrij dot t'ju kuptoj, — i tha zoti Frenklin. — S'kam asnjë njoftim pér t'ju bërë.

— Njëra nga shërbëtoret, s'dua t'ia përmend emrin, foli me ju kokë më kokë dje.

Përsëri zoti Frenklin i tha se s'kishte asnjë njoftim pér t'i bërë.

Sakaq në fund të rrujinës u duk Rozana Spirman. Pas i shkonte Penelopa që jepte e merrte pér ta detyruar të kthehej në shtëpi. Kur e pa që zoti Frenklin nuk ishte vetëm, Rozana ndali pa ditur q'të bënte më tej. Penelopa e priste aty pranë. Zoti Frenklin i vuri re vajzat në të njëjtën kohë me mua. Dedektivi me një pamje tinzari bënte sikur s'kishte parë gjë. Tërrë kjo ndodhi brenda një sekonde. Para se zoti Frenklin të thoshte qoftë edhe një fjalë, dedektivi Kaf, si pa gjë të keq, gjoja, duke vazhduar bisedën e nisur, tha me zë të lartë që edhe Rozana të mund ta dëgjonte:

— Ju s'keni pérse druheni mos dëmtoni kënd, zotëri! Përkundrazi, në ju dhimbstë Rozana Spirmani, ju lutem të më nderoni duke më besuar.

Zoti Frenklin atë çast u shtir sikur s'e vuri re vajzën. Iu përgjigj i zymtë:

— Unë s'kam pérse të kem dhimbsuri pér Rozana Spirmanin.

Pashë në drejtim të vajzave dhe vura re që Rozana u kthyte rrëmbimthi, me të dëgjuar këto fjalë. E la Penelopën ta kapte pér krahу dhe të ktheheshin pér në shtëpi.

U dëgjua zilja pér të ngrënë mëngjesin. Kafi më tha fare i qetë:

— Po nisem pér në Frizingol dhe do kthëhem para orës dy.

Mbetëm të dy me zotin Frenklin.

— Ju duhet t'ia shpjegoni të gjitha kësaj Rozanës, — më tha zoti Frenklin. — Në ato rrethana, për të mos i dhënë mundësi vajzës të llapte diçka që s'duhet ta dijë dedektivi, fola ashtu si më dëgjuat.

I dhashë fjalën se do t'ia bëja të qartë këtë Rozanës në rastin më të parë që ta takoja.

— Po për mbrëmjen e kaluar nuk i keni thënë gjë? — më pyeti zoti Frenklin.

— Nuk i kam thënë, zotëri.

— Mirë, mos i thoni. Është më mirë të mos e nisim me biseda në një kohë që dedektivi mezi pret të na shohë të dy bashkë. Kjo sjellja imë s'para është konsekvente, Beterexh. kështu apo jo? Po të mos i gjindet diamanti Rozanës, nuk shoh asnjë zgjidhje tjetër të çështjes. E kjo të kall tmerrin. Dhe ndërkojë as nuk mundem dhe as nuk dua t'i ndih dedektivit Kaf ta akuzojë këtë vajzë.

Mendime aspak të llogjikshme. Por edhe vetë unë ca mendime si këto bluaja në kokën time. Pra e kuptoja fort mirë. Dhe secili nga ju, lexues, si i vdekshëm që është, s'ka sesi të mos e kuptoj këtë.

U ndava me zotin Frenklin pér ca punë të mijat. Në dhomë gjeta Penelopën që më priti me këto fjalë:

— Baba, ju lutem, shkon i bisedoni pak me Rozanën. Jam shumë e shqetësuar pér fatin e saj. Druhem që zoti Frenklin, pa dashje, e fyeu keqas.

— Po q'deshte ajo në atë rruginë?

— Ashtu i kishte shkrepur në kokë, — m'u përgjigj Penelope. — Ndryshe s'ke si e quan. Donte të fliste me zotin Frenklin, domosdo. U përpinqa ta ndalja po s'munda. Sa mirë do të kishte qenë sikur ta kisha kthyer para se t'i dëgjonte ato fjalë të tmerrshme!

— Mirë, de, mirë, mos e bëj mizën buall. S'ndodhi ndonjë kushedi se c'farë që ta dëshpëronte deri në atë farë feje.

— Po zoti Frenklin tha se s'do as të japë e as të marrë me të, me një ton aq të pashpirt!

— Po e tha pér t'i zënë gojën dedektivit, de!

— Ia thashë edhe këtë, por ai ka kohë që e poshtëron dhe e fyen. Kjo e fundit i vuri kapak të gjithave! Ta shihje si u tërbua kur i dëgjoi ato fjalë! Shtangu në vend! Pastaj e push-

toi një qetësi e çuditshme dhe tani vazhdon ta bëjë qdo gjë si në jerm.

E ndjeva që punët ishin pisk. Vendosat taçoja sa më shpejt në vend fjalën që i pata dhënë zotit Frenklin.

Rozana veshur me një fustan të rëndomtë basmaje ishte duke larë korridorin. Ashtu e zbehtë dhe e qetë, si ngahera e katandepsur. Vetëm sytë i kishte si të hirnosur, të çuditshëm: jo se kishte dënesur, por sesi shihnin aq të përqendruar. Ndoshta i qenë mjegulluar nga mendimet e shumta.

— Pa çojeni pak kokën, Rozana! — i thashë. — Mos e torturoni kësisoj vetën me gjithfarë fantazirash. Kam ardhur diç t'ju them me porosi të zotit Frenklin.

Ia tregova si qëndronte puna, duke zgjedhur shprehjet më qetësuese e dashamirëse.

— Zoti Frenklin është i mirë dhe i vëmëndshëm. Ju lutem, ta falënderoni nga ana ime.

Kaq më tha. Ime bijë e vuri re që Rozana iu kthye punëve si në ëndërr; shtoj që edhe kur dëgjoi, edhe kur foli, ajo i bëri këto si në ëndërr. Dyshoj në e kuptoi gjithë sa i thashë.

— Mjaft me këto, — iu drejtova me zë lutës. — Më duket se nuk jeni në të fare. Diç ju vlon përbrenda. Unë jam miku juaj i vjetër dhe do të mbetem i tillë edhe në paçi ndonjë cen. Jini e ciltër me mua, Rozana, ma hapni zemrën!

Një herë e një kohë kur i flisja kështu, ajo përlotej. Tani nuk vura re ndonjë ndryshim tek ajo.

— Po, — më foli fare mekanikisht. — Kam përfia rrëfyer qđo gjë me zemër në dorë..

— Zonjës?

— Jo.

— Zotit Frenklin?

— Po, zotit Frenklin.

S'dija c'përgjigje t'i jepja pas kësaj. Ishte në një të tillë gjendje që s'murd ta kuptonte paralajmërimin përf të mos bisuduar kokë më kokë me zotin Frenklin. Kjo ishte porosia që pata marrë nga zoti Frenklin. Mendova vetëm t'i bëj të ditur që zoti Frenklin ka dalë shëtitje.

— Kjo as që më intereson, — m'u përgjigj. — S'kam përf ta shqetësuar aspak sonte zotin Frenklin.

— E pse të mos bisedoni me zonjën? — e pyeta. — Do ju

lirohej shpirti nga ajo bisedë me zonjën përdëllimtare që është aq e përzemërt me ju.

Më pa e përqëndruar dhe serioze, si të donte t'i ngulte fort ato fjalë në kujtesë. Pastaj iu kthyte punës për pastrimin e korridorit.

— Jo, — tha duke vazhduar larjen. — Di një mënyrë më të mirë për të lehtësuar shpirtin.

— Ç'mënyrë na qënka kjo?

— Ju lutem, më lini të vazhdoj punën!

Penelopa iu qas dhe i ofroi ndihmën e saj. Kjo iu përgjigj:

— Jo. Dua ta mbaroj vetë punën që kam ndër duar. Ju faleminderit, Penelopë.

Pa edhe nga unë.

— Ju faleminderit edhe juve, zoti Beterexh.

S'dije ç'qëndrim të mbaje ndaj saj. I bëra shenjë Penelopës të largohej bashkë me mua. E lamë ashtu si e kishim gjetur, duke larë me shtupë korridorin si të ishte në ëndërr.

— I duhet folur mjekut, — i thashë. — Ne jemi të pafuqishëm të bëjmë diçka.

Vajza ma kujtoi që doktor Kandi ishte sëmurë qysh prej asaj natës me shi pas darkës së ditëlindjes së zonjushës Vérinder. Ishte në dispozicionin tonë ndihmësi i tij, zoti Ezra Xhenningsi. Veçse në anët tona atë rrallë kush e njihte.

Vendosa të këshillohesha me zonjën. Por kjo qe në dhomë me zonjushën Reçell.

E prita gjatë, derisa ra ora dy pa një çerek. Pas pesë minutash më thirrën nga rruga para shtëpisë. Ishte zëri i dedektivit Kaf që apo ishte kthyer prej Frizingolit.

15.

E hasa dedektivin në shkallët e hyrjes kryesore. S'ma kishte ënda të interesohesha për rezultatet e udhëtimit, ama tundimi qe aq i fortë sa që nuk durova dot.

— Ç'të re na sollët nga Frizingoli? — e pyeta.

— Pashë indianët, — m'u përgjigj dedektivi Kaf. — Mora vesh se çtarë kishte bërë Rozana fshehtas në qytet të enjten e shkuar. Sa për indianët mund t'ju them që në goftë se ne nuk do ta gjejmë dot diamantin, ata kanë për ta gjetur. Kurse ajo puna e Rozanës mbetet edhe më e errët se më parë. Te shitësi i manifakturave Moltbi ajo kishte blerë vetëm një cohë dhe ishte interesuar për cilësinë e saj. Kishte blerë aq sa duhet për të qepur një këmishë nate.

— Këmishë nate?

— Për vete, kuptohet. Me sa duket, ndërmjet orës dymbëdhjetë dhe tre të natës ajo ka shkuar te zonjusha Reçell për ta pyetur se çdo të bënин me diamantin. Kur ka qënë duke dalë nga dhoma, ka fshikur me këmishën e natës derën ende të pa-tharë. S'ka patur si ta lante njollën, s'guxoi ta zhdukë këmi-shën pa e zëvendësuar me tjetër njëlloj si ajo që kishte, në mënyrë që rrobat të qenë të gjitha në vendin e duhur.

— Po si mund ta vërtetoni që kjo ka qënë këmisha e natës e Rozanës?

— Nga coha që bleu, — m'u përgjigj dedektivi. — Po të kishte qënë këmisha e natës e zonjushës Verinder, do t'i duhej të blinte edhe dantella, kordonë e sa e sa gjëra të tjera dhe s'do të kishte arritur ta qepte brenda natës. Pra cohën e ka blerë sa për një këmishë të thjeshtë shërbëtoreje. Jo, jo, zoti Beterexh, gjithçka është e qartë. Vështirësi paraqet pyetja tjetër: përsë, pasi ka qepur këmishën e re, e ka fshehur atë të zhyrën, në vend që ta kishte zhdukur? Nëse vajza s'pranon të shpjegohet, mbetet vetëm një rrugë për zbulimin e fshehtësisë: të kontrollojmë «Rërën e Tallazit». Aty dhe sqarohet kjo punë.

— Po si do ta gjeni vendin ku mund ta ketë fshehur? — u interesova të di.

— Më vjen keq që s'mundem ta kënaq këtë kërshëri tua-jën, — tha dedektivi. — Është një sekret që mendoj ta ruaj për vete.

Në Frizingol ai ishte pajisur me leje për të bërë kontroll. Përvoja e kishte cuar në përfundimin se Rozana, me siguri, mban me vete një shënim për vendin ku e ka fshehur sendin, për ta patur në rast se ndryshoinë rrethanat dhe kalon një ko-hë e gjatë. Po ta shtinte në dorë atë shënim, kishte gjithë sa i duhej për përfundimin e hetimeve.

Ishte plot ora dy. Të hyrja kryesore u afrua pajtoni për zonjushën Reçell. Dëdektivi Kaf i bëri me shenjë karrocierit dhe, pasi e hoqi mënjanë, i pëshpëriti:

— Një njeriu im, që është fshehur pas pemëve, pa dalë nga porta e çifligut do kërcej prapa pajtonit pa u vënë re. As mos shih e as mos dëgjo gjë, ndryshe do e kish pisk punën.

Me të dalë nga kjo shtëpi, zonjusha do të mbikqyrej! Spinuni do t'i qepej nga pas pullë! Tmerr e shkuar tmerrit.

Zonja qe e para që zbriti shkallët. Qëndroi pak larg, në shkallën e fundit, nga ku mund ta shihte gjithë ç'ndodhë. Nuk na tha as edhe një fjalë: as mua e as dedektivit. Me buzë të shtrënguara, me duart në xhepat e pardesysë, qëndronte si statujë në pritje të së bijës.

Pas ndonjë minute doli Reçelli, e veshur me shumë hijeshi, me një kostum ngjyrë mjalti të ëmbël, që aq shumë i shkonte fytyrës brune. Xhaketa i qe puthitur bukur pas belit. Në kokë mbante një kapele elegante kashte më vel të bardhë, në duar kishte doreza bojë zambaku. Buklet e mrekullueshme skrom të zeza dukeshin që poshtë kapeles të shtruara si atlass. Veshët e veckël të ndërmendnin dy guacka deti rozë në fundin e së cilave varej nga një xhevahir. Na u afrua shpejt e shpejt me trupin gargi dhe të epshëm pas çdo lëvizjeje si një mackë. Vura re se në fytyrë, përvëç sýve dhe buzëve, asgjë nuk i kishte ndryshuar. Sytë i rrezëllinin më tepër se zakonisht; dhe qenë më zemërakë se herët e tjera, kurse buzët e kishin humbur aq shumë njomështinë, ngjyrën dhe ngazëllimin, saqë nuk i njoha dot. E puthi nguturazi të ëmën në faqe dhe i tha: «Më falni për gjithçka, mama!» Pastaj e uli vrulltas velin saqë e shqeu pakëz. Pas një minute u fsheh në pajton si të dëshironte që të mos e shihnin.

Dëdektivi Kaf sakaq s'mbeti pa e demonstruar shkathësinë e tij: e shtyti shërbëtorin, dhe, duke u mbajtur nga doreza e derës së pajtonit, i qëndroi përpëra pikërisht në atë çast kur ajo zuri vend.

— Ç'dëshironi? — e pyeti zonjusha Reçell pa e ngritur velin.

— T'ju them vetëm një fjalë, zonjushë, para se të niseni, — iu përgjigj dedektivi. — Nuk e marr dot guximin t'ua ndaloj të shkonit te tetova, marr guximin vetëm t'ju them se ky lar-

gimi juaj, në këto rrethana, mund të bëhet pengesë për gjetjen e diamantit. Vendosni vetë, në duhet të niseni apo të qëndroni këtu.

Zonjusha Reçell as që iu përgjigj.

— Niseni pajtonin, Xhemis! — i thirri karrocierit.

Pa i thënë as edhe një fjalë tjetër, dedektivi e mbylli derën e pajtonit. Atë çast qe duke zbritur shkallët zoti Frenklin.

— Lamtumirë, Reçell! — i tha, duke i tundur dorën.

— Nisemi! — bërtiti Reçelli edhe më fort se herën e parë, pa i kushtuar vëmendjen më të vogël zotit Frenklin, ashtu si nuk ia kishte kushtuar pak më parë as dedektivit Kaf.

Zoti Frenklin u zmbraps i mahnitur. Karrocieri që s'po dinte ç'të bënte, pa nga zonja që vazhdonte të qëndronte pa lëvizur në këmbëzën e shkallëve. Në fytyrën e saj qe trazuar zemërimi me hidhërimin dhe me turpin. I bëri shenjë karrocierit të nisej dhe me hap të shpejtë zuri të ngjiste shkallët për në shtëpi. Zoti Frenklin, që e mblođhi veten pas atij shokimi, i bërtiti zonjës, kur pajtoni qe nisur:

— Teto, ju kishit plotësisht të drejtë! Pranoni falënderimin tim për mirësinë që treguat dhe më lejoni të nisem.

Zonja u kthye që t'i jepte përgjigje, por ashtu e pavendorës së që, i tundi dorën me përkëdheli dhe i tha me zë të dridhur:

— Ktheni pak nga unë para se të niseni, Frenklin.

— Më bëni këtë ndër të fundit, Beterexh, — m'u drejtua mua zoti Frenklin me lot ndër sy. — Më çoni në stacion sa më shpejt që të jetë e mundur.

Edhe ai hyri në shtëpi. Kjo sjellje e zonjushës Reçell e kishte tronditur shumë. Sa shumë që e donte atë vajzë!

Dedektivi Kaf dhe unë mbetëm të vetëm te shkallët. Dedektivi qëndronte me fytyrën kthyer nga drurët ku dukej edhe bërryli i rrugës. Atë çast atje u duk pajtoni që po ecte me shpejtësi drejt daljes nga çifligu. Mbrapa saj qëndronte në këmbë një njeri.

— Çdo gjë në rregull, — belbëzoi me vete zoti Kaf. U kthye nga unë. — U duhet përveshur punëve, zoti Beterexh, pa kursyer kërkënd. Do ia nisim me Rozana Spirmanin. Ku të jetë vallë?

Thirrëm Xhojsin që dedektivi Kaf e kishte porositur ta mbikqyrté.

— S'di ç'të them, zotéri... — filloi Xhojsi. — Më vjen shumë keq por s'di se si...

— Para se të nisesha në Frizingol, — e ndërpren rreptë dedektivi, — ju urdhërova të mos ia ndanit sytë Rozana Spiranit pa u vënë re prej saj. Mos doni të më thoni se ia keni lejuar vetes që t'ju rrëshqiste pa u vënë re?

— Kam frikë, zotéri, — mërmëriti Xhojsi me drithmë në zë, — se mos e teprava me atë kujdesin për të mos u vënë re prej saj. Në këtë shtëpi ka aq shumë korridore...

— Ke kohë që s'e ke parë?

— Rreth një orë, zotéri.

— Kthehuni andej nga erdhët, — i tha dedektivi fare i qetë me atë melankolinë e tij të zakonshme. — Mund t'ju them se s'paskeni haber nga kjo punë, zoti Xhojs. Lamitumirë.

E kam të vështirë t'ua pëershkruar se ç'tronditje ndjeva, kur dëgjova ato fjalë. Mendimet me shpejtësi rrufeje këmbe-nin njeri-tjetrin. Ia qepa sytë zotit Kaf.

— Jo, zoti Beterexh, — më tha dedektivi. — Ajo mikesha juaj Rozana s'ka për të më rrëshqitur kag kollaj nga duart. Perderisa jam në dijeni të plotë të vendndodhjes së zonjushës Verinder, kam ndër duar edhe mjetin për të rënë në gjurmë të bashhkëpunëtores së saj. Nuk i lashë të takoheshin mbrëmë natën. Do të takohen në Frizingol. Atje dhe do i vazhdojmë hetimet, ndonëse pak më herët seç e parashikova. Druhem se do më duhet t'i drejtohem përsëri për ndihmë shërbëtorëve.

Nga pyetjet që bëmë doli se e fundit Rozanën e pati takuar piatalarsja Narsi. E kishte parë të dilte me një letër ndër duar dhe kishte ndalur çirakun e kasapit, i kishte dhënë letrën t'ia hidhte në postë, kur të kthehej në Frizingol. Ky e kishte lexuar adresën dhe i kishte thënë se i dukej e çuditshme ta hidhe letrën në postën e Frizingolit, kur adresa ishte Kobs-Holl. Rozana kishte ngulur këmbë dhe ky i kishte dhënë fjalën se do ia conte në vend porosinë. Nansinë e kishin thirrur në kuzhinë. Pas kësaj Rozana Spiranin s'e kishin parë më.

— Po tani? — e pyeta dedektivin kur mbetëm vetëm.

— Tani më duhet të nisem për në Frizingol.

— Për punën e asaj letrës, zotéri?

— Po. Ai shënim i përvendndodhjen e asaj gjësë gjendet në atë letër. Duhet të marrë vesh se kujt i adresohet. Nëse është adresa që dyshoj, do t'i bëj të njojurës suaj, zonjës Jolland, një tjetër vizitë ditën e hënë.

Shkova të porosis kaloshinën për dedektivin. Në stallë mësova ca lajme të reja përvajzën që ishte zhdukur.

16.

Djaloshi me emrin Defi e kishte parë Rozanën kur kishte kaluar me vrap nëpër rruginën e kopshtit drejt bregut të detit.

— A e njeh mirë djali bregdetin e këtushëm? — më pyeti dedektivi.

— Ka lindur dhe është rritur në këto anë, — i thashë.

— Defi, — iu drejtua dedektivi. — A do të fitosh një stërlinë? Eja të më shoqërosh... Kaloshina le të presë e gatshme, zoti Beterexh.

Morën rrugën për nga «Rëra e Tallazitur» me një të tillë shpejtësie, saqë s'kaloi shumë dhe m'u fshehën nga sytë. Ndjeja një frikë të çuditshme, ca parandjenja ogurzeza më kishin pushtuar të terin. S'mund ta them sa kohë kishte kaluar nga dikja e tyre, kur vjen me vrap djali Defi me një pusullë nga dedektivi Kaf.

«Më dërgoni sa më shpejt këpucën e Rozana Spirmanit», — lexova aty. E nisa djalin, duke i thënë se këpucën do e bija vëtë. Desha të ndiqja rrjedhën e mendimeve dhe të veprimeve të dedektivistit.

Kur mbërrita te bregu, zuri një rrebesch me erë. Këmbë njeriu s'kishte përreth, përvèç figurës së zezë të dedektivistit Kaf. Më tregoi me dorë nga veriu dhe më tha:

— Ejani nga kjo anë!

Mezi mbushesha me frymë, zemra më rrihte si çekan. Nuk isha në gjendje të flisja. Fytyra e tij më trëmbi: shprehte tmerr. Rrëmbeu këpucën dhe e puthiti me gjurmën në rërë. Ajo të conte drejt thepit të mollokut që quhet Shkëmbi Jugor.

Gjurma ende nuk qe shpëlarë nga shiu, tabani i këpucës së vajzës u puthit me të. Eci në drejtim të gjurmëve deri te vendi ku bashkohet shkëmbi me rërën. Kishte filluar ta përmbytte batica, uji e kishte mbuluar sipërfaqen e «Rërës së Tallazitur». Të gjitha gjurmët të çonin në një drejtim. Sadoqë kërkonte, dedektivi Kaf nuk kishte mundur të gjente gjurmë të tjera që të vinin s'andejmi. Më në fund ndali. Pa nga unë, pastaj ujin që sa vinte e ngrihej mbi «Rërën e Tallazitur». Pashë andej nga shihte dedektivi dhe e kuptova se ç'mendime e preokupo-nin. Më shkuan të dridhura nëpër trup. Rashë në gjunjë mbi rërë.

— Ka ardhur këtu te ky vend i fshehtë, — dëgjova zërin e dedektivit, — dhe në këta shkëmbinjë një rastësi fatale...

Nga ç'dija për Rozanën, desha t'i them: «Ka vdekur ashtu siç ka dashur...» Por jo, s'm'i nxinte goja ato fjalë.

Dedektivi më ngriti dhe më largoi nga vendi ku i kishte dhënë fund jetës vajza. Ktheva kryet pas dhe pashë të vraponin drejt nesh shërbëtorët dhe peshkatari Jolland; na pyetën të alarmuar në u gjend vajza.

Dedektivi u tha ç'tregonin gjurmët dhe se do t'i kishte ndodhur ndonjë fatkeqësi. Pastaj pa nga deti dhe iu drejtua peshkatarit me këtë pyetje:

— A s'më thoni, a mundet të afrohet një barkë tek ai mollok aty për ta marrë?

— As edhe një barkë nuk do të shpëtonte pa u shkatërruar, — iu përgjigj ky.

— Rozanës nuk i ka ndodhur fatkeqësi! — thirra i ngjirur. — Ajo ka ardhur këtu e lodhur ngajeta për t'i dhënë fund asaj.

Dedektivit Kaf iu morën këmbët.

— Nga e dini ju këtë? — më pyeti.

Më rrëthuan nga të katër anët. Dedektivi u përmend pas asaj habije të shprehur dhe i largoi njerëzit nga unë. U tha se e pata thënë nga tronditja.

— Lëreni plakoshin të qetë! — përfundoi dhe iu drejtua Jollandit me pyetjen: — A mund t'ia gjejmë kufomën kur të fillojë zbatica?

Ky iu përgjigj:

— Kurrën e kurrës. Ç'bie në atë rërë, mbetet aty përgjithmonë.

Peshkatari bëri një hap drejt meje dhe vazhdoi:

— Zoti Beterexh, dua t'ju them diçka lidhur më vdekjen e kësaj vajze. Përgjatë kësaj ane të mollokut mbi rërë në thellësinë tre këmbë kalon një brez i gjerë shkëmbor. Ju pyes: përsë nuk eci nëpër atë brez? Po të rrëshqiste rastësish, do të ishte rrëzuar aty dhe do të ishte ngritur përsëri në këmbë në një të tillë thellësie që s'do i vinte ujë më lart mezit. Ajo me vetëdije i është shmangur këtij brezi shkëmbor apo e ka kapërcyer atë dhe është hedhur mu në gjeratoren e «Rërës së Tallazitur», ndryshe s'kishte si t'i jepte fund vetes. S'kemi ndonjë rast fatkeq në këtë mes, zotëri! «Rëra e Tallazitur» e ka përfshirë në gjirin e saj dhe kjo ka ndodhur ngaqë ka qënë dëshira e saj.

Pas kësaj dëshmie të njeriut që kuptonte nga këto punë, dedektivi s'foli. Edhe në ndoqëm shëmbullin e tij. U kthyem dhe morëm përpjetë bregut.

Në dunat na doli përpara ndihmësi i stallierit me një pusllë në dorë që ia kishte dhënë Penelopa. Ma dha me një shprehje pikëllimi të thellë në ftyrë.

— Ma dha Penelopa, zoti Beterexh. E gjeti në dhomën e Rozanës.

Ishin fjalët e lamtumirës së asaj mjeraneje.

«Shumë gjëra m'i keni falur ju, Zoti Beterexh. Kur të shihni «Rërën e Tallazitur», mundchuni të më falni edhe një herë. E gjeta varrin tim atje, ku më priste. Kam rrojtur dhe po vdes, zotëri, me mirën johjen e thellë për mirësinë e saj».

Kjo qe e gjitha. S'e mbajta dot veten. Lotët më shkonin curg. Se ata lotët i derdhim kollaj, kur jemi të rinj dhe nisim jetën në këtë botë, por i derdhim lehtë edhe kur jemi pleq dhe po bëhemë gati ta braktisim këtë jetë.

Dedektivi Kaf bëri një hap drejt meje, me dashamirësi, s'e vë në dyshim këtë, por si i xhindosur u zmbrapsa.

— Mos më prekni! — thashë. — Ju i kallët datën asaj mjeraneje dhe e çuat në këtë derexhe!

— S'keni fare të drejtë, zoti Beterexh, — m'u përgjigj i qetë. — Do të kemi kohë të flasim për këtë, kur të kthehemë në shtëpi.

Shkova bashkë me të tjerët, duke u mbështetur në krahun e ndihmësit të stallierit. U kthyem nën rrebesch që të bë-heshim dëshmitarë të tmerrit dhe të kujës që na priste në shtëpi.

17.

Ata që kishin ardhur para nesh, u kishin dhënë mandatën njerëzve të shtëpisë të pushtuar tanimë nga një panik e angushti e tmerrshme. Kur kaluam para dhomës së zonjës, u hapnë brenda dera dhe doli zonja e shtëpisë, prapa së cilës qëndronte zoti Frenklin që më kot orvatej ta qetësonte, krejt e pataksur nga ndodhia tragjike.

— Ju e keni fajin pér të gjitha! — i bërtiti dedektivit, duke e kërcënuar edhe me grushta. — Gabriel, paguajini hakun këtij zotërie dhe të mos ma zënë më sytë këtu!

Vec dedektivi ishte ndër ne i vetmi që mund ta qetësonte gjendjen, ngaqë ai e kishte ruajtur gjakftohtësinë.

— Jam po aq pak fajtor në gjithë sa ndodhi, zonjë, sa edhe ju, — i tha. — Nëse edhe pas një gjysmë ore do të ngulni këmbë që ta lë shtëpinë tuaj, unë këtë do ta pranoj, vec jo të hollat tuaja.

Foli me shumë mirësjellje dhe ndikoi po aq fort mbi zonjën ashtu si edhe mbi mua. Kjo e la zotin Frenklin ta conte në dhomën e saj. Kur dera prapa tyre u myll, dedektivi pa rga shërbëtoret dhe vuri re se, ndërsa të gjitha ishin thjesht të trembara. Penelopa qe larë në lotë.

— Kur ati juaj të jetë ndërruar, — i tha, — ejani te ne në dhomën e tij.

S'kaloi as një gjysmë ore që isha ndërruar, kur erdhi Penelopa e na pyeti përsë na duhej. Ato çaste e ndjeva sidomos thellë se c'vajzë zemiërmirë dhe të dëgjuar që kisha. E mora në prehër dhe iu luta zotit të ma falte. Ma mbështeti kokën në kraharor dhe më pushtoi pér qafe. Pér disa kohë qëndruam kështu të heshtur. Që të dyve mendja na rrinte te qyqarja vajzë. Dedektivi shkoi te dritarja dhe heshturazi shihte andej. E falënderova pér këtë pjesëmarrje në dhimbjen tonë.

Ishim gati t'i përgjigjeshim, atë e bijë, sapo dedektivi ta niste bisedën. Kur e pyeti vajzën, q'e detyroi Rozanën të ndërmerrte këtë hap të tmerrshëm, kjo iu përgjigj (siç dhe e parashikoni edhe ju) se e bëri nga dashuria për zotin Frenklin Blek. Kur dedektivi e pyeti në ia ka thënë ndonjërit këtë, Penelopa iu përgjigj:

— Nuk ia kam thënë nga që më vinte keq për Rozanën.

E ndjeva të nevojshme të shtoja edhe unë disa fjalë:

— Edhe për zotin Frenklin, shpirte. Nëse Rozana të ketë vdekur nga dashuria për të, kjo ndodhi pa dijeninë e tij dhe aspak jo për faj të tij. Pra le të niset sonte i qetë për rrugë, s'kemi pse ta leqendisim, duke i zbuluar këtë të vërtetë.

Dedektivi Kaf vuri në dukje: «Shumë e drejtë» dhe përsëri heshti, duke i vënë në peshore fjalët e Penelopës dhe mendimin vetjak që parapëlqeu të mos e shfaqte.

Pas një gjysëm ore ra zilja e zonjës. Në rrugën për tek ajo takova zotin Frenklin që sapo kishte dalë nga dhoma e zonjës. Më tha se zonja Verinder qe gati ta takonte dedektivin Kaf, në praninë time, si dhe më parë, dhe veç kësaj ai vetë dëshironë t'i thoshte disa fjalë dedektivit. Kur u kthyesh bashkë me mua në dhomën time, pa orarin e trenave që ishte varur aty.

— Domethënë se po na lini, zotëri? — e pyeta. — Zonjusha Reçell ka për të ndërruar mendje, në rast se i jepni kohë të reflektojë.

— Ka për të ndërruar mendje, — m'u përgjigj zoti Frenklin, — kur ta marrë vesh që kam ikur dhe s'ka për të më parë më kurrë.

Thashë me vete se e kishte nga gjaknxehtësia, por nuk qe ashtu. Zonja kishte vënë re se nga çasti që në shtëpi kishte shkelur këmba e policisë, vetëm përmendja e emrit të zotit Frenklin e bënte të tërbohej zonjushën Reçell. Ky e donte shumë zonjushën Reçell dhe s'donte t'ia thoshte këtë vetes, por e vërteta doli në shesh, kur zonjusha Reçell u nis për tek tetova. E ndieu këtë në çaste shumë të rënda dhe e preu mendjen: të largohej një orë e më parë nga shtëpia jonë.

Me dedektivin ai bisedoi në praninë time. I tha që zonja është gati ta pranojë se qe shprehur ashtu në gjaknxehtësi e sipër. E pyeti në pranonte dedektivi, në rrethanat e krijuara,

të merrte shpërblimin dhe ta linte ndjekjen e mëtejshme të çështjes së diamantit. Dedektivi kundërshtoi.

— Shpërblimi, zotëri, më jepet për kryerjen e detyrës. Unë nuk e pranoj po nuk e kreva detyrën.

— Nuk po ju kuptoj, — shqiptoi zoti Frenklin.

— Po jua shpjegoj, zotëri, — iu përgjigj dedektivi. — Erdhë për të shkokolepsur çështjen e errët të zhdukjes së diamantit. Tani për këtë jam gati dhe vetëm pres të më jepet mundësia për ta çuar në vend detyrimin që mora përsipër. Pasi t'ia kem parashtuar zonjës Verinder gjendjen në të cilën ndodhet tani çështja dhe pasi t'ia them qartë se ç'duhet ndërmarrë përgjetjen e diamantit, përgjegjësia ime bie. Le të vendosë vetë zonja në duhen çuar më tej hetimet apo jo. Në rast se përgjegjja do të jetë pozitive, do ta çoj deri në fund punën që mora përsipër dhe do të pranoj edhe shpërblimin.

Zoti Kaf na e kujtoi kësisoj se edhe dedektivi ka dinjitetin e vet që s'dëshiron t'ia nepërķëmbin. Dhe ky qëndrim i tij ishte kaq i denjë, saqë s'kishe si ia kundërshtoje. Kur e çova për ta shoqëruar në dhomën e zonjës; ky iu drejtua zotit Frenklin, në dëshironte të ishte i pranishëm në bisedën me zonjën. Zoti Frenklin iu përgjigji:

— Jo, po qe se zonja Verinder këtë nuk e dëshiron.

Më pëshpëriti, kur po dilja me dedektivin:

— E di që ky njeri ka pér t'i folur për Reçëllin, kurse unë ushqej ndjenja të forta për të, që të mund ta dëgjoj i përbajtur. Më mirë po qëndroj këtu.

E lashë tepër të pikëlluar; mbështeti bërrylat në parvazin e drirates dhe mbuloi fytyrën me të dyja duart; Penelopa futi kokën në derë me dëshirën e madhe për ta ngushëlluar.

Ndërkaq dedektivi Kaf dhe unë shkuam për në dhomën e zonjës.

18.

E para foli zonja:

— Zoti Kaf, ju, me siguri, që gjeni disa rrethana detyruese për ato fjalë që ju thashë gjysmë ore më parë. Veç nuk dua

t'i shfrytëzoj ato. Me sinqeritet të plotë ju kërkoj ndjesë në ju fyeva.

Zemërgiltërsia që e shoqëroi këtë ndjesë bëri pijnën e vet. Dedektivi Kaf kërkoi leje të përligjte mënyrat se si kishte vepruar dhe e bëri këtë në shenjë respekti për zonjën. Tha se nuk ishte aspak shkaktar i asaj fatkeqësie që e tronditi aq shumë shtëpinë, për arsyen e thjeshtë që suksesi i veprimeve përcaktohej nga qëndrimi i kujdeshëm ndaj Rozana Spirmananit, të cilën në asnjë mënyrë nuk duhej as ta trëmbje as ta emocionoje. Kërkoi lidhur me këtë edhe dëshminë time. Pandeha se me kaq shpjegimi do merrte fund, por nuk ndodhi kështu. U hodh menjëherë në çështjen më delikate dhe të vështirë.

— Kam dëgjuar ta shpjegojnë këtë vetëvrasje të vajzës me një arsy, — tha dedektivi Kaf. — Ajo ndoshta dhe qëndron, por me çështjen për të cilën kam ardhur, nuk ka lidhje. Dua t'ju them se unë shoh në këtë mes një tjetër arsy. Për mendimin tim, një shqetësim i pashpjegueshëm e pat pushtuar atë vajzë pas zhdukjes së diamantit, shqetësim që e çoi deri në vetëvrasje. S'di si ta shpjegoj arsyen e shqetësimit të çuditshëm, por, zonjë, mund t'u përmendja emrin e njeriut që e përcakton saktë sa të drejtë kam apo nuk kam.

— Dhe ai gjendet këtu në shtëpi? — e pyeti zonja pas një heshtje të shkurtër.

— Është larguar që këtej, zonjë.

Aludimi qe fare i qartë, fjala ishte për zonjushën Reçell. Ra heshtja që m'u duk se s'do të kishte të sosur.

— Shpjegohuni më qartë, ju lutem, — shqiptoi më në fund zonja. — Keni parasysh time bijë?

— Po, kam parasysh zonjushën Reçell, — iu përgjigj dedektivi Kaf pa më të voglin ngurrim.

Kur hymë në dhomë, mbi tryezën e zonjës ishte blloku i çeqeve, s'ka dyshim, për të larë hesapet me dedektivin. Tani ajo e mori dhe e futi në sirtar. Më theri mu në zemër kur e pashtë si i dridheshin gishtat.

— Kam shkuar me shpresën, — vazhdoi zonja ngadalë dhe qetë, — se do ju shpërbleja e do ndaheshim pa zënë në gojë emrin e zonjushës Verinder... Me këtë që bëtë, ju shkuat shumë larg dhe kthim mbrapa s'mund të ketë. Për hir të vetes si-

me dhe për hir të sime bije më duhet të ngulë këmbë që të na i shkoqisni mirë punën.

Dedektivi pa orën.

— Sikur të kisha kohë, do të parapëlqeja ta bëja këtë raportim me shkrim. Se s'do ta kemi të lehtë si unë që do të flas, ashtu edhe ju që do dëgjoni...

Zonja e ndali përsëri.

— Ndoshta do të jetë më e lehtë për të gjithë ne që rrëfimin ta nis unë vetë. Ju dyshoni që zonjusha Verinder po na mashtron të gjithëve, duke e fshehur diamantin për qëllimet e saj? Kështu apo jo?

— Kështu, zonjë.

— Ja ku po jua them, si nënë që jam, nuk është e zonja ta bëjë këtë. Jam e sigurt që, pavarësisht nga përvoja e gjerë që keni, rrethanat ju bënë të mashtroheni. E njoh mirë time bijë.

Fytyra e dedektivit Kaf u zbut për një minutë, por bindja e tij nuk u lëkund as edhe një fije.

— Do ju lutesha, zonjë, ta shihni çështjen nga pozita imë. Ja mendimi im: nga përvoja mund t'ju them se janë të shumta vashat e sojit që bëjnë borxhe të mëdha, për të cilat s'kanë dijeni as prindërit, as të afërmit. Shkaktarë mund të jenë rroba-qepësit dhe kuinxhinjtë por edhe ca të tjerë, që në rastin e dhënë nuk i dyshoj dhe s'dua t'i kujtoj që të mos ju fyej. E nisa ndjekjen e çështjes pasi dëgjova raportin e inspektorit Sigrev. M'u ngul në mendje një frazë e tij që zonjusha Verinder s'pranoi t'i përgjigjej pyetjeve me një ton të ashpër. U diktua ajo njolla në derë që është një hallkë në zinxhirin që të çon te zhdukja e diamantit. Kur zonjusha Verinder hapi derën dhe më foli, vura re tre rrethana që më vunë në dyshime: vazhdonte të ishte tejet e emocionuar edhe pse nga koha e zhdukjes së diamantit kishin kaluar tri ditë, me mua u soll po aq keq si dhe me inspektorin Sigrev; që tmerrësisht shumë e zemëruar me zotin Frenklin Blek. Mrekullia vetë, thashë. Kjo zonjushe gjaknxehtë dhe e papërbajtur s'na sheh dot me sy pikërisht ne që po bëjmë çmos për ta ndihmuar të gjejë diamantin e saj. Që nga ky çast e vura në përdorim atë përvojën time. E radhita përbri atyre zonjave që kám pasur rastin t'i njoh e për të cilat ju folia. «A nuk po shkon, — thashë me vete, — ky diamant i zhdu-

kur në shlyerjen e atyre borxheve të padeklaruar?» Ju ç'men-dim keni pér këtë përfundim timin, zonjë?

— Se rr Ethanat ju kanë mashtruar, — iu përgjigj zonja. Dedektivi Kaf vazhdoi raportimin.

— Ju kërkova të kontrolloheshin rrobat e tërë banorëve të shtëpisë. Vetëm zonjusha nuk pranoi. Thashë me vete se përfundimi që kisha bërë qe i drejtë. Me zë të lartë sy të gjithëve iu luta zonjës Verinder të mos nisej pér te tetova, se kjo mund të më pengonte të gjeja diamantin. S'pranoi, madje në prani të të gjithëve e fyeu zotin Frenklin Blek. Ç'do të thotë gjithë kjo?

Ishte e lemerishme që ai mbarështronte njërin pas tjetrit faktet kurdër zonjushës Reçell, kurse ti, duke u djegur nga dëshira pér ta kundërshtuar, s'ke se si e bën këtë. Por përvèç argumenteve logjike ka edhe disa të tjerë që qëndrojnë mbi ta. Drejtëshuni atyre, lexues, nën shembullin tim dhe keni pér ta parë se sa të vështirë do ta kenë të tjerët t'u privojnë nga mu-nësia pér të ruajtur qetësinë shpirtërore. Është në të mirën tuaj! Kur e pa që si unë, si zonja, heshtëm, dedektivi Kaf vazhdoi (Ah, ç'maraz që ndjeva kur e pashtë që atë s'e turbulloi fare kjo heshtja jonë).

— Tani lidhur me rastin e Rozana Spirmanit. Dua t'ju them se, meqë çështja lidhej me zonjushën Verinder, vendosa të mos e nxjerr këtë të fshehtë jashtë rrëthit tuaj familjar. Mu duk më e volitshme të mbështetësha në ndihmën dhe përkra-hjen e kryesherbëtorit tuaj besnik zotit Beterexh.

E ndjeva se karriera ime varej nga mos heshtja ime.

— Më lejoni t'u bëj të ditur, zonjë, se kurrë nuk i kam shtyrë përpara në mënyrë të vetëdijshme këto hetime dhe i bëj thirrje zotit Kaf që t'm'i kundërshtojë këto fjalë në s'i mungon guximi.

U ndjeva fort i lehtësuar pas këtij vërvshimi të vrullshëm ndjenjash. Zonja më bëri nder të madh, duke më rënë lehtë pas shpatullave.

— Pra, e kishim fjalën te Rozana Spirmani. U binda që Rozana kishte gisht në zhdukjen e diamantit, kuptohet, përmes pronares së tij. Zura të hetoj në do të mjaftohej zonjusha Verinder me variantin që diamanti qe zhdukur apo do të shkon-te më tej dhe do orvatej t'i bindëte të tjerët që atë e kishin vjedhur. Rozana Spirmani do ta ndihmonte zonjushën Reçell të

shtinte në dorë fshehur paratë për diamantin. Se vetë ajo kurë nuk do të shkonte në një rrisk të tillë. Se e di saktë, zonjë, që Rozana Spirmani ka patur marrje e dhënë me një fajdexhi londinez që do t'i ofronte para të madhe për t'u bërë pronar i një diçkaje me aq vlerë siç ishte **Guri i Hënës** pa i bërë pyetje që do ta vinin në vështirësi vajzën.

Pas kësaj ia bëri të qartë zonjës si në pëllëmbë të dorës tërë sjelljen e çuditshme të Rozana Spirmanit, për çka, i nderuar lexues, ju jeni në dijeni.

— Pas gjithë sa u tregova, zonjë, — vazhdoi dedektivi Kaf, — mendoj se ka dy mënyra për të vazhduar më tej hetimet: njérën e quaj më shpresëdhënëse, tjetrën e pranoj thjesht si një pravë të guximshme. Jeni ju, zonjë, ajo që do të zgjidhni në çrrugë duhet ecur.

Zonja i tha se e lë në dorë të tij të zgjedhë cilën të dojë.

— Ju faleminderit, — iu përgjigj dedektivi. — Po e filloj nga mënyra më shpresëdhënëse. Në do të qendrojë zonjusha Verinder në Frizingol, apo do të kthehet këtu, them të mbikqyr që të gjitha veprimet e saj. Do ju propozoa të pranonit në vend të Rozana Spirmanit një grua të stërvitur për mbikqyrje veprimesh, tepër modeste e fjalëpak. Për këtë bëhem unë garant. Mandej them të ngarkoj një njeriuun tim në Londër që të ndjekë veprimet e atij fajdexhiut, për të cilin ju fola. Se emri i këtij njeriu dhe adresa i janë bërë të ditura zonjushës Verinder nga Rozana Spirmani, për këtë ju siguroj. E di që tërë kjo është e kushtueshme dhe kërkon kohë, por arritjet janë të padiskutueshme. Do të bëjmë një unazë rrëth diamantit dhe do të vijmë duke e ngushtuar deri sa ky të gjendet në duart e zonjushës Verinder, kuptohet, nëse e ka bërë top mendjen ta ruaj ajo vetë. Në rast se borxhet s'durojnë të shtyhen dhe vendos ta shesë, do të kemi atë njeriuun në Londër që do ta zbulojë sakaq.

Kësisoj hamendësimesh për të bijën qenë aq të padurueshme, saqë zonjës Verinder s'iu durua të thotë:

— Quajeni këtë propozim krejt të kundërshtuar dhe na bëni të ditur atë mënyrën tjetër për t'i çuar deri në fund hetimet.

— Mendoj të kryej një sprovë të guximshme. Për mendimin tim, zonjusha Verinder mund t'i drejtohet gjenjeshtës së çar-

tur. Por ajo është gjaknxehtë dhe e pamësuar në kësi punësh, s'di të shtiret dhe të fshihet. Tërë këto kohë ajo u dha liri ndjehave, në një kohë kur në interesat e saj ishte që ato t'i fshihet. Kam ndërmënd të veproj, duke patur parasysh këto tipare të karakterit të saj. Do t'i kallzoj në mënyrë të beftë për vdekjen e Rozanës me shpresë që ndjenjat më të mira që ka ta detyrojnë të pranojë çdo gjë sinqerisht. Zonjë, a e miratoni këtë mënyrë?

Zonja më habiti sa më s'bëhet. Ju përgjigj në çast se pranonte.

— Poshtë më pret kaloshina. Më lejen tuaj mund të nisem?

Zonja ngriti dorën dhe e ndali pa dalë nga dera.

— Më thatë se doni të vini në provë ndjenjat më të mira të sime bije, — mërmëriti. — Si nënë që jam, kërkoj të drejtën që këtë provë ta bëj unë vetë.

Për herë të parë në jetën e tij Kafi famëmadh shtangu i mahnitur si të vdekshmit e rëndomtë.

Zonja urdhëroi, t'i sillnin mushamanë, shiu binte si me shtëmba, kurse pajtoni që kishte çuar zonjushën Reçell në Frizingol ende nuk ishte kthyer. Bëra q'munda për ta përbajturi, por më kot! I kërkova ta shoqëroja që t'i mbaja çadrën. As që donte të dëgjonte për këtë. Kaloshina do nisej vetëm me karrocierin.

— Të jeni i sigurt. — i tha dedektivi, — se këtë provë me zonjushën Verinder kam për ta bërë po aq guximshëm sa ç'kisht për ta bërë ju vetë. Do ju njoftoj për rezultatin, me gojë apo me shkrim, më përpara se treni i fundit të niset sot për në Londër.

Në këtë e sipër zuri vend në kaloshinën që mori rrugën për në Frizingol.

19.

Kisha kohë që rrija me dedektivin Kaf. E gjeta ulur në një qoshe të rehatshme në sallën e katit të parë. Po shfletonte bllokun e shënimave, çipin e buzëve e kishte tejet të kithët.

— Po mendoni pér çështjen? — e pyeta.

— Jo, — m'u përgjigj dedektivi. — Po merrem me pér-
caktimin e çështjes me të cilën duhet të merrem pas kësaj.
— O-o! — thirra. — Domethënë se këtë të tanishmen e
quani të mbyllur?

— Them, — m'u përgjigj dedektivi, — se zonja Verinder
është nga gratë më të zgjaura të Anglisë. Them po ashtu se të
sodisësh trëndafilët është ku e ku më e këndshme se sa të sho-
hësh diamantët.

S'kishte perëndi ta bënte pas kësaj të shqiptonte qoftë
edhe një fjalë më pér «Guri i Hënës».

Sa pér zotin Frenklin, me të dëgjuar njoftimin tim pér bi-
sedën në dhomën e zonjës, e anulloi nisjen dhe vendosi të pri-
ste lajmet nga Frizingoli.

Kaloshina erdhi një gjysmë ore më parë nga ç'e prisja. Zon-
ja kishte vendosur të gostiste tek e motra. Me karrocierin dërgoi
dy letra: njerën pér zotin Frenklin, tjetrën pér mua. Shko-
va ta lexoj në dhomën time. Çeku që ra kur hapa letrën, më
foli para se ta lexoja atë se hetimet që lidheshin me çështjen
«Guri i Hënës» ndërpriteshin.

Cova të thërrisin zotin Kaf dhe i lexova letrën: «I nde-
ruar Gabriel, bëjani të ditur dedektivit. Kaf se premtimin e
dhënë e cova në vend dhe ja rezultati: Zonjusha Verinder më
siguroi solemnisht se s'ka këmbyer as edhe një fjalë me Rozanën
kokë më kokë qysh kur këmba e saj shkeli tek ne në shtëpi.
As dhe rastësishët nuk është takuar me të atë natë dhe as
edhe ndonjë marrëdhënie që nga mëngjesi i të enjtes e këtej
me të nuk ka patur. I fola pér atë largim të beftë, me të cilin
tërhiqte mbi vete dyshime, dhe i thashë se këto dyshime janë
tani një realitet. M'u betua se nuk ka borxhe dhe se diamanti
nuk ndodhet dhe nuk ndodhej në duart e saj që nga ajo minuti
kur e vuri të mërkurën në sirtarin e dollapit indian. S'pronon
në asnje mënyrë të shprehë ndonjë mendim lidhur me
zhdukjen e diamantit. Me lot në sy kundërshton të flasë kur i
kërkoi të jetë e sinqertë. «Do vijë një ditë dhe do ta merrni
vesh përsë s'më bëhet vonë që pér mua dyshojnë dhe përsë që-
ndroj e heshtur madje para jush», — më tha.

Lexojani zotit Kaf kësë letër dhe i jepni çekun që gjendet
brenda në këtë letër. Duke hequr dorë nga shërbimi i tij i më-

tejshëm, s'kam si mos vë në dukje ndershëmërënë, skrupulozitetin dhe mendjen e tij, veç jam e bindur edhe më fort se më parë që në rastin e dhënë rrëthanat në mënyrë fatale e mashtruan.»

Ia zgjata çekun përmes tryezës. Kur e pa, foli:

— Është një çmim aq i lartë i kohës sime, saqë më detyron të gjej rrugët për ta shpërblyer atë zonjë. Do ta fiksoj në kokë shumën që përmban çeku dhe do të di q'duhet bërë kur të vijë koha.

— Ç'doni të thoni me këtë? — e pyeta.

— Zonja Verinder me shumë marifet e fashiti çështjen, — tha dedektivi. — Veç ky skandal familjar është nga ata që befas përsëri marrin flakë dhe atëhere kur më pak se kurrë pritet. S'kanë për të kaluar as disa muaj dhe neve përsëri do të na duhet të merremi me **Gurin e Hënës**.

— Zoti Kaf, — ia ktheva. — Kjo që sapo thatë s'është vëçse fyterje për zonjën dhe të bijën e saj.

— Zoti Beterexh, — më tha. — Ruajeni mire në kujtesë këtë paralajmërim timin dhe keni për të qënë më afër qëllimit. Tani le të bashkohemi me atë mendimin e zonjës: rrëthanat në mënyrë fatale më mashtruan.

— Për sa më takon mua, — vijova, — letra më bindi plotësisht, por ju vazhdoni të arsyetonit njëloj sikur të donit të më bindnit. Ju mendoni që fjalëve të zonjushës nuk i duhet zënë besë dhe se ne do t'ia dëgjojmë kakërrimën atij diamantit? Pa na e vërtettoni këtë! Hë, vërtetojeni!

Në vend që të fyhej, dedektivi më kapi fort nga dora dhe më tha:

— Bukur fort. Po ju zë nga tri ngjarje të cilat, siç mendoj unë, do jua tërheqin vëmendjen pavarësisht në e dëshironi ju apo jo. Së pari, të hënën keni për të marrë vesh diçka nga Jollandët, kur postjeri t'ju ketë dorëzuar letren e Rozanës. Së dyti, përsëri do të dëgjoni të flitet për ata të tre indianët dhe keni për t'i takuar në këto anë, në rast se zonjusha Reçell do të kthehet këtu, ose në Londër, në rast se zonjusha Reçell do të niset për në Londër. Së treti, shpejt a vonë diç keni për të dëgjuar për atë fajdexhiun londinez, për të cilin ju kam folur. Ma jepni këtu atë bllokun tuaj të shënimëve t'ua shkruaj adresën që ta keni për çdo rast.

Fluturimthi shkroi në një faqe të re të bllokut «Zoti Septimus Luker, Sheshi Midseks, Lambet, Londër». — Në mos u takofishim para se të dalë në lirim, shkoj me shpresën që t'u pres si mikun tim në shtëpinë pranë Londrës, që po bëhem gati ta ble, dhe ju jap fjalën, zoti Beterexh, se në kopshtin tim rruginat do t'i kem të shtruara me bar.

20.

E bëra gati kaloshinën për çdo rast, nëse zoti Frenklin do të dëshironte të nisej domosdo me trenin e mbrëmjes. Kur pas hë te shkallët valixhet dhe pas tyre edhe vetë zotin Frenklin, m'u bë e qartë që ky për herë të parë në jetën e tij po i përmblahej pa u lëkundur vendimit të marrë.

— Përse të mos prisnit edhe ndonja dy ditë për t'i dhënë kohë zonjushës Reçell të mendohej? — i thashë zotit Frenklin.

Në vend të përgjigjes më zgjati letrën që i kishte dërguar zonja. Më shumë se gjysma qe me ato njoftime që më kishte bërë edhe mua në letër, në fund kishte edhe diçka që lidhej me zonjushën Reçell.

«I dashur Frenklin, ju duhet të tregoheni i duruar dhe të prisni, ashtu si do pres edhe unë, një kohë më të mirë. Ndihma shumë e tmuar pér mbarëvajtjen e hetimeve, s'di përse Reçellit i dëket një fyerje e pafalshme. S'kam për t'ia falur atë keqdashje me të cilën ju akuzon përrnjedhojat e hidhura që as ju e as unë nuk mund t'i parashihnim. Reçellin s'ke si e bind, përtë vetëm duhet të të vijë keq. Me hidhërim duhet t'ju them se tani pér tani është më mirë të mos e takoni. Këshilla e vetme që mund t'iu jap është t'i lini kohë të mendohet për gjithçka».

Ia ktheva letrën, duke ndier një keqardhje të sinqertë për zotin Frenklin, ngaqë e dija sa shumë e donte zonjushën dhe e pashë që fjalët e së jëmës i ranë plumb në zemër.

— E dini atë thënien, zotëri: kur ka zënë për të dalë, hapi derën!

— Por ama edhe kur të zërë për të hyrë do i hapësh derën. Do vijë ajo ditë, zoti Frenklin, që do zërë për të hyrë.

Zoti Frenklin futi në xhep letrën e tetos jo shumë i ngushëlluar nga fjalët e mijë.

— Zor të gjeje në Angli familje më të lumtur se kjo, kur erdha këtu nga Londra me atë diamantin e tmerrshëm. Pa shihni si u katandis! E copëtar, e shpërndarë, madje dhe ajri sesi u helmatis nga fshehtësia dhe dyshimet. Ju ndërmendet ajo biseda atë mëngjes te «Rëra e Tallazitur», kur biseduam për xhaxha Hernkastlin dhe dhuratën e tij për ditëlindjen? «Guri i Hënës» më së miri e kreu atë misionin e hakmarrjes që i kishte ngarkuar xhaxhai, Beterexh, dhe aq mirë sa dhe vetë koloneli as që e ka pas pandehur, — më tha zoti Frenklin.

Më shtrëngoi dorën dhe bëri për te kaloshina.

U ndamë me lot ndër sy. Kur po nisej, iu luta zotit Frenklin të ncs na harronte, të na bënte një gisht letër. M'u duk se s'para i kushtoi vëmendje këtyre fjalëve të mia; shihte rrëth e rrotull, ia ngulte sytë herë një sendi dhe herë një tjetëri, si të deshte t'i linte lamtumirën shtëpisë së vjetër dhe kopshtit.

— A s'më thoni, për ku po e mbani rrugën, zotëri? — e pyeta me synimin për të mësuar diçka mbi planet e tij.

Zoti Frenklin rrasi kapelen deri te vetullat.

— Për ku? Për te dreqi!

Kali u drodh nga tendosja e frerit si të provonte një neveri prej të krishteri.

— Zoti qoftë me ju, zotëri, kudo vafshi! — ja ç'farë munda t'i them para se të fshihej nga shikimi im.

C'djalosh i këndshëm! Edhe pse jo pa dobësi e të meta, djallë i lezetshëm! Na la pas vetes një zbrazëti të trishtë, kur u largua.

Të nesërmen (ditën e diel) pajtoni, që çoi zonjushën Reçëll te Ebluajtët, u kthye bosh. Karrocieri më solli një pusullë nga zonja ku thuhej se kishte vendosur ta çonte Reçëllin në Londër ditën e hënë drejt e nga Frizingoli.

Më të gdhirë e hënë, na ra si bombë lajmi, për të cilin më pat paralajmëruar dedektivi Kaf, nga shtëpia e peshkatarit Jolland.

Pasi kisha nisur për në Londër te zonja Penelopën dhe shërbëtoren e zonjës, isha duke shëtitur në kopsht. Befas më zuri veshi emrin tim. Kur u ktheva, u gjenda ballépërballë me të bijën e peshkatarit, çalashen Lusí. Përveç që çalonte dhe ish-

te fare hollake (kjo e fundit, pér mendimin tim, éshtë një e mëtë e tmerrshme e gruas), kjo vajzë kishte një varg epërsish në sytë e burrave. Fytyra e zeshkët, zëri i këndshëm kumbimtar, flokët e mrekullueshëm gështenjë e bënин mjaft térheqëse. Paterica dëshmonte pér fatkeqësinë, kurse gjaknxehtësia renditej pérbri të metave që sapo përmendëm.

— Hë moj vajzë, me se mund t'ju shërbej? — e pyeta.

— Ku éshtë ai burri me emrin Frenklin Blek? — tha vajza, duke u mbështetur mbi patericën e duke ma ngulur shikimin e egër.

— S'éshtë e hijshme të flasësh kësisoj pér zotérinjtë, — i hcqa vërejtjen. — Në éshtë fjala pér nipin e zonjës, a nuk do të ishte më mirë ta quaje zoti Frenklin Blek?

Bëri një hap përpëra dhe më pa më një të tillë hakërrime, sikur donte të më hante të gjallë.

— Ta quaj zoti Frenklin Blek, ë! — përsëriti pas meje. — Më e saktë do ishte ta quaja vrasësi Frenklin Blek!

Mënyra e sjelljes me të ndjerën zonjën Beterexh më dha dorë të dilja nga situata edhe në këtë rast. Kur gruaja orvatet të të nxjerrë nga binarët, bën çmos nga ana juaj, ta nxirrni vetë atë nga binarët. Se gratë janë të parapërgatitura pér gjithfarë kundërshtimi pér vetëmbrojtje, përvëç këtij që sapo thashë. Me një fjalë të vetme mund të arrish më tepër se me një lumë fjalësh dhe ia arrita me sukses qëllimit në rastin e calashes Lusí. E pashë tërë mirësjellje drejt në sy dhe i thashë:

— Fu!

Vajza u bë lulekuq në fytyrë, u mbështet mirazi mbi këmbën e shëndoshë dhe dy a tri herë trokiti patericën pas tokës.

— Ai éshtë vrasës! Ai éshtë vrasës! Ai éshtë vrasës! Ai éshtë shkaktari i vdekjes së Rozana Spirmanit!

Zëri iu corr. Dy punëtorë që kujdeseshin pér kopshtin ngritën sytë, e panë që ishte çalashja Lusí dhe, duke e ditur ç'mund të vinte prej saj, s'bëzajtën por shikuani punën.

— Ai qënka shkaku i vdekjes së Rozana Spirmanit? — e pyeta. — E si e vërtetoni këtë, Lusí?

— Po ju ç'u duhet? E ç'punë kanë burat në këtë mesele? Ah, të kishte patur edhe ajo këtë mendje që kam unë pér burrat, do të ishte edhe tani si kokrra e mollës.

— Po me zotin Frenklin Blek mos keni ndonjë punë? — e pyeta.

— Po, — m'u përgjigj. — Kam një letër për të.

— Nga Rozana Spirmani?

— Po.

— E ka futur në letrën që ju dërgonte juve?

— Po.

Mos vallë filloi të davaritej terri? Mos vallë ajo që aq shumë dëshiroja të mësoja po më bëhej e ditur vetveti? Heshta për një hop. Dëdiktivi Kaf qe larguar por pati lënë pas vetes infekzionin e hetimit. E ndjeva ndikimin e tij.

— Zotin Frenklin nuk keni si e takoni, — i thashë.

— Do ta takoj se s'bën, — ma preu.

— Dje u nis për në Londër.

Çalashja Lusí më pa ngultas dhe u bind që thosha të vërtetën. Pa thënë më as edhe një fjalë, u kthye dhe mori rrugën për në Kobs-Holl.

— Pa prisni, — i thirra. — Nesër do të kem lajm nga zoti Frenklin Blek. Ma lini mua t'ia nis me postë.

— S'ka mundësi, duhet t'ia jap dorazi.

— A t'i shkruaj gjë për këtë?

— I shkruani që e urrej dhe kini për t'i thënë të vërtetën.

— Mirë, de, mirë, po puna e asaj letrës, si?...

— Nëse ka dëshirë ta marrë, duhet të vijë tek unë.

Foli kështu dhe vazhdoi rrugën për në Kobs-Holl.

Jua lë juve ta mendoni se me çfarë padurimi e prisja postierin të martën në mëngjes. Më solli dy letra: një nga Penelopa, ku thuhej që zonja dhe zonjusha kishin mbërritur shëndo-shë e mirë në Londër, dhe tjetra nga zoti Xhefko, kryeshërbëtori i të atit të zotit Frenklin Blek, ku thuhej se i biri të zotit të tij ishte larguar nga Anglia.

S'kaloi shumë dhe mora një tjetër letër nga Penelopa ku thuhej se zonjushën Reçell e kishte vizituar një doktor i shquar, i cili vetëm e pati porositur të argëtohej: ekspozitat e luleve, operat, ballot. I kishte bërë një vizitë edhe zoti Godfri Eblluatj, si dhe më parë, dukej i dashuruar pas zonjushës, pavarësisht nga pritja e ftohtë që i kishin bërë në atë ditëlindjen. Për fat të keq, shkruante Penelopa, këtë herë e kishin pritur me

dashamirësi Ky madje e paska regjistruar zonjushën Reçell edhe anëtare të Komitetit bamirës të grave.

S'kaloi shumë dhe mora një letër, shkrimi i adresës të së cilës më bëri të mendohem. E krahasova me atë që kisha në bllokun e shënimëve dhe u binda që ishte shkrimi i dedektivit Kaf. Brenda në zart gjeta një gazetë, kur e shpalosa, vura re një shkrim të titulluar: «Nga salla e gjuqit», ishte nënvijëzuar me bojë të zezë. Lexojeni dhe ju, lexues, siç e lexova unë dhe do të bindeni sa dashamirës dhe i vëmendshëm u tregua dedektivi që na e bëri të ditur këtë të re të fundit.

«Lambet. Para se të mbyllte punimet seanca gjuqësore, zoti Septimus Lukeri, tregëtar i njohur arturinash dhe gurësh të çmuar, iu drejtua trupit gjykues me një kërkësë për ndihmë. U bëri të ditur që gjatë tërë këtyre ditëve kishte qënë tejet i shqetësuar nga prania e pashqitshme e ca endacakëve indianë, që sorollateshin para shtëpisë së tij. Edhe pse i kishte zbuar policia, kishin ardhur përsëri dhe qenë orvatur disa herë të futeshin në shtëpi gjoja për të lypur diçka. Kur i kishin zbuar nga porta kryesore, qenë përpjekur të futeshin nga dera tjetër. Zoti Luker tërroq i vëmendjen e trupit gjykues, mos kur-disej kësisoj ndonjë kusari. Në kasafortat e tij ruhen jo pak gjera me vlerë: edhe antike, edhe orientale. Para do kohe qe i detyruar të mos e merrte në punë një gdhëndës me emër (indian, siç e nënkuptuam ne), ngaqë dyshonte se kishte synime grabitjeje dhe nuk kishte as më të voglën siguri se ky gdhëndës dhe ata fallxhorët indianë të mos bashkëpunonin. Ndoshta kishin për qëllim të mblidhnin turmën, të bënin gjullurdi dhe në këtë e sipër t'i hynin në shtëpi. Pyetjes së një gjyqtari në kishte dëshmi për këtë, Lukeri i qe përgjigjur në mënyrë negative. Ai qahet nga që ata indianët po e bezdisin shumë dhe e pengojnë të ndihet i qetë. Gjuqtari i tha se né rast përsëritjeje, zoti Luker kishte të drejtë t'i padiste në gjyq indianët dhe këta do dënohoeshin sipas ligjit. Sa për gjeralat me vlerë, zoti Luker vetë duhet të marrë masat për t'i ruajtur. Ndoshta do të ishte më mirë të vihej në dijeni policia lidhur më këtë. Ata dhe mund t'i jepnin këshilla e porosi si duhet mbrojtur. Kërkuesi e falenderoi gjyqtarin dhe u largua».

Thonë se një mendimtar i lashtë i këshillonte të afërmit «të kqyrnin mirë fundin». Duke parë fundin e këtyre shkrime-

ve të mia dhe duke ndërmendur sa shumë shqetësohesha disa kohë më parë në do ia dilja mbanë apo jo këtij rrëfimi, them se gjithë sa kam mbarështruar është bërë jo keq. U hodhëm në punën e atij **Gurit të Hënës**, nga një ndodhi në tjetrën, dhe përfunduam në atë çudinë e çudive: përmbushjen e tre parashiki-meve të dedektitivit Kaf brenda më pak se një javë nga dita që ai i pat parashtruar. Të hënën morëm lajmin nga Jolandët për letrën e Rozana Spirmanit, tani sa po mësuam pér indianët, dhe, mos harroni, zonjusha Recëll ndodhet në Londër. Morëm vesh edhe lajmin pér shqetësimet e zotit Septimus Luker lidhur me ruajtjen e gjerave me vlerë tek ai dhe ngacmimet që kishte patur nga indianët.

PJESA E DYTË

ZBULIMI I SË VËRTETËS

TREGIME NJERËZISH TË NDRYSHËM

1848-1849.

Tregimi i parë,
i shkruar nga zonjusha Klak, mbesa e të ndjerit
Khon Verinder.

1.

Për arsyе ekonomike jam e detyruar të banoj në një qytet
të vogël breton, mes ca miqsh të nderuar anglezë, që shquhet
për dy epërsi jo të vogla: ka një pastor protestan dhe mallra
me çmime të lira.

Në këtë poshe të vetmuar më vjen befas një letër nga An-
gлиа. S'di përsë, për këtë qënien time mosmëkeq u kujtua zoti
Frenklin Blek. Ky gjiri pasunar (për të cilin shumë me këna-

qësi shtoj se edhe shpirtin e ka xhevahir) më shkruan se pas ka nevojë për mua: i paska shkrepur t'i kthehet përsëri asaj historisë zhurmëmadhe të Gurit të Hënës, më lutet ta ndihmoj, duke shkruar një tregim për gjithë sa kam qënë dëshmitare në shtëpinë londinezë të tetos Verinder. Ma thotë copë se këtë do e bëj kundrejt pagesës; si gjithë të pasurit edhe ky vuan nga mungesa e delikatesës. Do më duhet përsëri të gërvisht ato plagët, që koha mezi i ka mbyllur me një cipë të hollë, do më duhet të rikujtojë ngjarje dhe bëma torturuese, duke e ndier në çdo hap edhe atë poshtërimin e çekut të zotit Frenklin. Po fukarallëku është maskarallëk! Iu drejtova përdëllimit të krishter dhe e mposhta krenarinë mëkatare, e hëngra me bukë atë turpin dhe bëra q'bëra e pranova atë çek.

Kurdoherë mbaj ditar; këtë e bëj e nisur nga respekti i shenjtë për të vërtetën, ky respekt qëndron për mua më lart se respekti për njerëzit.

Ditari më bën të ditur se ditën e hënë, datë 3 korrik 1848, duke kaluar fare rastësisht nëpër parkun Montegy, ngrita sytë nga dritat e shtëpisë së tetos Verinder dhe pashë grilat e hapura dhe perden e ngritur. S'do mend, mirësjellja e kërkonte të ktheja dhe të pyesja për shëndetin e zonjave të shtëpisë. Shërbëtorja më tha se tetoja me të bijën paskan ardhur nga çifligu para një jave dhe paskan bërë mendje të rrinë në Londër për një farë kohe. E porosita se nuk doja t'i bezdisja, por vëtëm desha të dija në mund t'u shërbeja me ndonjë gjë. Shërbëtorja më dëgjoi heshturazi dhe më la të prisja në korrider.

— Zonja ju falenderon për vëmendjen dhe ju pret të urdhëroni për një çaj nesër paradite, — më tha.

Mora rrugën për në Komitetin e Bamirësisë, anëtarë e të cilit jam, që të takoja zotin Godfri Ebluajt dhe t'i jepja lajmin e ardhjes këtu në Londër të tetos së dashur Verinder. Më erdhë plasje që s'e gjeta. Të habitura nga ky qëndrim imi, morrat e Komitetit më pyetën: si ishte e mundur që nuk paskam dëgjuar për gjithë që paska ndodhur? U fola sinqerisht që s'dija gjëprejgjëje dhe ato më treguan sa më poshtë: të premten e shkuar dy zotërinj me pozitë shoqërore të ndryshme paskan qenë njëlloj viktime e një komploti të çuditshëm. Njëri zotëri

qënka Septimus Luker, me banim në Lambet, tjetri ishte zoti Godfri Ebluajt.

Po të ndjekim radhën kronologjike të ngjarjeve, për sak-tësinë e të cilave unë vë dorën në zjarr. Ja se çfarë kishte ndodhur:

E premte, 13 korrik 1848.

Herët në mëngjes zoti Godfri shkoi për të thyer një çek në një bankë në rrugën «Lombardi». Kur po dilte te dera, u gjend ballpërballë me një të panjohur. Këmbyen disa fjalë mirësjelljeje, duke e lënë shoshoqin të dilte i pari. Iu përkulën njeri-tjetrit dhe u larguan secili në punë të vet.

Ju bëjmë të ditur paraprakisht se zotëria i mirësjellshëm kishte qënë zoti Luker nga Lambeti; të ndjekim pas tani zotin Godfri që kthehej në shtëpinë e tij në Kilbern. Në korridor po e priste një djali i veshur keq, por i sjellshëm dhe i pashëm. Ky i dha një letër, duke i thënë vetëm se ia dërgonte një zonjë e moshuar. E la të lirë djalin dhe u mor me leximin e letrës. Shkrimi ishte i panjohur. E ftonin të vinte në një shtëpi në rrugën «Nortumberland», ku s'kishte shkelur ndonjëherë. Zonja plakë i premtonte ndihma bujare bamirësie nëse ky iu përgjigjej kënaqshëm disa pyetjeve të saj. Ia thoshte emrin dhe shtonte me keqardhje se qëndrimi i pakët këtu në Londër nuk i dha mundësinë të takohej e të bisedonte me filantropin e shquar, të cilit ka nderin t'i drejtoshet me këtë letër.

Zoti Godfri, si i krishter i vërtetë, u nis menjëherë për në rrugën «Nortumberland». Një person me pamje njeriu të respektueshëm i hapi derën dhe, me të dëgjuar emrin e zotit Godfri Ebluajt, e shoqëroi për në katin e parë. Dy gjëra të jash-tëzakonshme ia tërhoqën vëmiendjen: era e indërshasë e përzier me atë të kamforës si dhe një libér i madh mbi tryezë i mbushur me vizatime e skica indiane. Po e shfletonte me shpinët të kthyer nga dera kur befas, pa zhurmën më të vogël, e mbërthyen që prapa prej gryke. Vuri re vetëm se krahu i keqbërësit ishte i zeshkët, pastaj në çast i lidhën sytë, i shtupuan gojën dhe e përplasën në dysheme. Një tjetër i kontrolloi xhepat dhe gjithkund nga koka deri te këmbët. Tërë kjo dhunë u krye në heshtje të plotë. Pastaj e ulën në karrige dhe ia lidhën fort duar e këmbë. U bind që e kishin lënë vetëm në dhomë. Kaloi njëfarë kohe dhe zotit Godfri i zuri veshi një si fëshfë-

rimë fustani, pastaj një britmë gruaje. Ca këmbë burrash u ndi-
en nëpër shkallë dhe pas pak ky ndjeu që gishtat e dikujt po e
zgjidhnin. Edhe shtupën ia hoqën nga goja. U habit shumë, kur
pa një çift bashkëshortësh të mbajtur për bukurin dhe thirri:

— C'do të thotë kjo?

Bashkëshortët panë përreth dhe iu përgjigjën:

— Ishte pikërisht kjo pyetje ajo që po gatiteshim t'uua bë-
nim juve, zotëri.

Të zotët e shtëpisë i bënë të ditur zotit Godfri se katin e
parë dhe të dytë dje ua kishte zënë me qira një zotëri me pa-
mje njeriu të respektueshëm, pikërisht ai që i kishte hapur derën.
Kishte thënë se i zinte për disa fisnikë indianë, miq të tij,
që vinin për herë të parë në Angli. Para pak kohe të tre këta
të huaj, të shoqëruar nga miku i tyre anglez, kishin pritur një
zotëri të panjohur në katin e parë dhe, meqë vetë këta sapo kishin
dalë nga shtëpia, bashkëshortëve u qe dukur e çuditshme
që atë të panjohurin e kishin lënë vetëm brenda. Pasi qenë kë-
hilluar me njeri-tjetrin, kishin vendosur të shihnin, mos kishte
ndodhur gjë. C'kishte ndodhur, lexuesi tanimë e di.

Asgjë nga sendet e zotit Godfri: as ora, as qosteku, as qe-
seja me para e as gelësat, nuk ishin prekur. Letrat që kish-
te pasur me vete dhe blloknoti ishin kontrolluar me kujdes, por
qenë lënë të pacënuara. Edhe orënditë e shtëpisë nuk qenë
prekur. Kishin marrë me vete vetëm librin e madh me ilustri-
me indiane dhe asgjë më tepër.

Ç'donte të thoshte tërë kjo?

Por lypset lënë për një hop zoti Godfri në rrugën «Nortum-
berland» për të parë q'i ndodh në një tjetër shtëpi zotit
Luker.

Kur doli nga banka, zoti Luker shkoi për të kryer ca punë
të vetat në anë të ndryshme të Londrës. Në shtëpi gjeti një pu-
sullë që i thanë se para pak kohe ia kishte lënë një djalë. Shkri-
mi edhe këtu ishte i panjohur, por përmendej emri i një klien-
ti të zotit Luker nga një qytet tjetër. Ky i bënte të ditur se e
kishin thirrur pa pritur e pa kujtuar të ishte në Londër, se ki-
shte zënë dhomë në sheshin «Alfred», Totenhem-Kurt-rod dhe
dëshironte ta takonte sa më shpejtë që të ishte e mundur zotin
Luker për punën e një blerjeje që kishte ndër mend të bënte.
Ky zotëri merrej me koleksionimin e antikave të Lindjes dhe

vite me radhë kishte qënë klient bujar i zotit Luker në Lambet. Zoti Luker pa e zgjatur i hipi karrocës dhe u nis. Po ajo që i ndodhi zotit Godfri në «Nortumberland», u përsërit me zotin Luker në sheshin «Alfred». Me një ndryshim të vetëm: sendet e nxjerra nga xhepat e zotit Luker dhe të hedhur andej-këndeje qenë aty, përveç një shkrese që ishte zhdukur. Ishte fatura e një diçkaje shumë të çmuar, që zoti Luker ia kishte dhënë pér ta ruajtur bankierëve të vetë. Pér kusarët ajo ishte e pavlefshme, sepse sendi i çmuar duhej t'i jepej domosdo në dorë të zotit. Sapo e mori pak veten, zoti Luker nxitoi pér në bankë se mos vjedhësit, duke mos e ditur atë kusht, paraqiteshin aty me faturën. Por në bankë s'i kishte parë njeri, as atë ditë e as më pas. Miku anglez merrte vesh nga faturat dhe, me sa dukej, i pati paralajmëruar pér gjithçka.

Që të dy viktimat qenë paraqitur në polici, qenë bërë he-time të kujdeshme, të menjëherëshme. Qe bërë përfundimi se keqberësit kishin patur si synim grabitjen e sendeve me vlerë, por të dhënat, siç duket, qenë të cunguara. Shihej qart se nuk kishin qënë në dijeni nëse zoti Luker e kishte dorëzuar sendin e çmuar vetë apo jo vetë, sa pér të varfrin e të mirësjellshmin zotin Godfri, ky e kishte pësuar vetëm ngaqë fare rastësisht kishte shkëmbyer me të ato fjalë pér mirësjellje te dera e banës.

Shkova te tetova Verinder në shtëpinë e parkut «Montegy» të martën para dite. Më priti me atë përzemërsinë e saj karakteristike, por menjëherë më ra në sy që në atë shtëpi nuk ishte gjithçka në rregull. Tetova rrinte-rrinte dhe hidhete ca shikime të shqetësuara nga e bija. Kjo seç kishte një si tronditje dhe nervozizëm që e bënin të dukej si në ethe.

Pas çajit tetova i tha:

— Mos harro, Reçell, mjeku të ka lënë porosi që pas buke tē léxosh e qetë diçka shtritur.

— Po shkoj në bibliotekë, mama, — iu përgjigj kjo. — Po tē vijë zoti Godfri, më thërrisni. Dua tē di gjithçka pér ç'i ndodhi në rrugën «Nortumberland».

E puthi të émën në ball dhe pa nga unë.

— Lamtumirë, Klak! — shqiptoi pa sajdi. (Kur mbetëm vetëm, tetova më tregoi historinë e tmerrshme të diamantit indian. Më tha se do i pëlqente që tërë ç'ngjau të ruhej në fshe-

htësi. Por kjo s'u arrit dhe s'mund të arrihej).

Në këtë e sipër shërbëtori hapi derën dhe bëri të ditur se kishte ardhur zoti Godfri Ebluajt.

2.

Kishte ardhur në kohën e duhur. Hyri jo shumë vrulltas që të mos na trembëte, por jo dhe shumë ngadalë që të na detyronte të prisnim.

— Thirreni të vijë zonjushën Verinder, — i tha zonja shërbëtorit. — I thoni që zoti Ebluajt është këtu.

S'vonoi dhe në dhomë hyri zonjusha Verinder. Vrapoi drejt zotit Godfri me fjalët:

— Gëzohem shumë që ju shoh, Godfri! Sa keq që nuk paskeni marrë me vete edhe zotin Luker! Ju dhe ai sot për sot jeni njerëzit më interesantë në Londër. Sidoqoftë, na e tregoni me të tëra hollësitë atë historinë në rrugën «Nortumberland». E di, ca gjëra gazetat nuk i përmendën.

— E shtrenjta Reçell, — i foli i përgjëruar zoti Godfri. — Gazetat e kanë treguar gjithçka dhe ku e ku më mirë se mund të ta bëja unë.

— Godfri thotë se sikur po i japim ca si shumë rëndësi kësaj çështjeje ne, — vuri në dukje tetova. — Madje sapo na tha se as që donte të fliste për të.

— E pse?

Reçelli e bëri këtë pyetje me sy të zgurdulluar, të ngulur në fytyrën e zotit Godfri.

— Ju, në atë mënyrën tuaj s'jeni djalë i keq, Godfri, — vazhdoi kjo. — Por jam e bindur që në personin tuaj nuk ka aspak madhështi; s'besoj që jeni trim, dhe kam bindjen se nuk doni të flisni për atë ngjarjen në rrugën «Nortumberland» i nisur nga shkaqe vetjake. Dua t'i di këto shkaqe.

— Shkaku është fare i thjeshtë dhe thuhet lehtë, — iu përgjegj ky me një zemërgjerësi bujari. — Më ka ardhur në majë të hundës e gjithë kjo.

— Në majë të hundës? I dashur Godfri, do ju bëj një vërejtje.

— Ç'vërejtje?

— Ju qëllon të qëndroni gjatë në shoqërinë e grave. Keni bërë zakon, lidhur me këtë, të llomotisni gjepura dhe të gënjeni vetëm i nisur nga kënaqësia për të gënjenyer. Açıq ju atje s'keni si i thoni gjërat. Dua t'ju detyroj të jeni transparent me mua. Pa uluni këtu. Mezi ju prisja që t'ju bombardoj me pyetje, të cilave shpresoj, se do i përgjigjeni pa dredhuar.

Thuajse e hoqi hosh nëpër tërë dhomén për te dritarja që drita t'u binte në ftyrë. Pashë nga tetova. Kjo qëndronte si e ngrirë, me sa dukej, as që kishte ndër mend të ndërhynte. S'e kisha parë kurrë në këtë gjendje të topitur. Ndërkaq Reçelli po e bombardonte me atë breshërinë e pyetjeve, pa u drojtur fare nga prania e së jëmës dhe imja.

— Policia s'ka arritur dot të zbulojë gjë Godfri?

— Jo.

— Them se ata të tre që ju ngritën grackë janë po ata që ia punuan të njëjtën gjë edhe atij Lukerit?

— Nuk ka as dyshimin më të vogël se kështu është, e dashur Reçell.

— Ühe asnje gjurmë e tyre nuk është gjetur?

— As edhe një.

— Mendohet të jenë pikërisht ata indianët që erdhën edhe atje në çiflig?

— Ka nga ata që këtë kështu e mendojnë.

— Po ju si e mendoni?

— E dashur, më lidhën sytë para se të arrija t'u shihja ftyrat. E ç'mund të them pas kësaj?

Pa e prishur terezinë zonjusha Verinder vazhdoi breshëri-në e pyetjeve:

— Dua të di diçka për atë zotin Luker, Godfri.

— Ja edhe këtë kërkesë tuajën s'kam si e plotësoj; s'di as gjë për atë njeri.

— E keni pas njohur para atij takimit në bankë?

— Jo.

— Po më pas?

— Po, kur na morën të dy në pyetje në polici, në fillim vëç e vëç, pastaj bashkë.

— Zotit Luker, me sa di, i vodhën faturën që kishte marrë nga bankieri i tij.

— C'faturë ishte?

— Fatura e një sendi të çmuar që e kishte lënë për ta ruajtur në bankë.

— Kështu shkruan edhe gazetat, por në rast se kjo është e mjaftueshme për gjithfarë lexuesish, për mua jo. Në atë dëftesë me siguri ka qënë e shkruar se për g'send të çmuar ishte fjala.

— Kam dëgjuar Reçell, se aty asgjë nuk ka qënë shkruar. Di vetëm që ai send i çmuar i përkiste zotit Luker, mbante vuilen e tij dhe u dha për t'u ruajtur me kusht që t'i kthehej atij në dorë, ja kjo është e gjitha sa di për këtë çështje.

Reçelli heshti për një hop, pa nga e ëma dhe pshëretiu. Pastaj pa përsëri nga zoti Godfri dhe vazhdoi:

— Se më duket që ca çështje tonat private u përfolën në përgazeta?

— Më pikëllim duhet ta pranoj që kjo është e vërtetë.

— Dhe ca njerëz fyckë, krejt të huaj për ne, përpiken të hedhin ca ura ndërmjet asaj që ndodhi në shtëpinë tonë në Jorkshir dhe gjithë sa ndodhi pas asaj këtu në Londër.

— Druaj se këershëria e hallkut këtu dhe është përqëndruar.

— Ata që thonë se tre të panjohurit që ju kontrolluan ju dhe zotin Luker janë po ata indianë, që ishin atë natë në cilë, thonë se edhe ai sendi me vlerë...

Reçellit i ngeci fjala në grykë. I ra një çehre e verdhë. Flokët korbi të zinx e bënë këtë zbehti aq të tmerrshme saqë pandehëm mos i binte të fikët, kur i ngeci ashtu fjala. Zoti Godfri bëri të ngrihej. Tetoja e lutti të bijën t'i jepte fund kësaj bisede.

— Godfri, mos luani nga vendi... Mama, s'keni përse trembeni për mua...

Iu drejtua përsëri zotit Godfri. Me një këmbëngulje të çuditshme iu kthyte frazës së papërfunduar dhë shqiptoi:

— Ma thoni troç, Godfri: a flitet që ai sendi i çmuar i zotit Luker është **Guri i Hënës**?

Sapo u përmend diamanti, zoti Godfri u pre: fytyra iu nxi, tërë qenia e tij u egërsua. Përgjigja që i dha s'qe tjetër veçse indinjatë e zemërim.

— Flitet pos! — thirri. — Ka nga ata që e akuzojnë zotin

Luker pér mashtirim nisur nga interesa vetjake. Veç ai éshtë betuar dhe vazhdon tē betohet se kurrën e kurrës s'ia kanë zënë sytë e as veshët atë **Gurin e Hënës**. Kurse këta tē poshtër, pa kurrfarë faktesh, i thonë se ka arsyen ta fshehë këtë. «S'duam as tē dëgjojmë pér atë betimin e tij!» — thonë. Turp e marre!

Gjatë kohës që ky fliste, Reçëlli e shihte në ményrë tē çuditshme, vështirë tē thuhet sa tē çuditshme. Kur ky mbaroi, ajo i tha:

— Po tē mbajmë parasysh që ju zotin Luker fare pak e njihni, tē habit pasioni me tē cilin e mbroni, Godfri.

Ky iu përgjigj:

— Më duket, Reçëll, se unë kurdoherë me pasion i mbroj ata që tē tjerët i nepërkëmbin.

Zonjusha Reçëll nxorri ca tinguj shpërfillës dhe i qeshi mu në fytyrë.

— Ruajini këto fraza fisnike pér atë Komitetin e grave bamirëse, Godfri. Jam e bindur që skandali rrëth emrit tē Luke-rit nuk ju la pa ju fshikulluar edhe ju.

— Reçëll, moj bijë, — ndërhyri e pikëlluar tetova. — Ti nuk ke asnje tē drejtë tē flasësh kështu!

— Po nuk éshtë se kam parasysh ndonjë gjë tē keqë, moj mama. Këtë e thashë nga dashmirësia. Duroni edhe një minutë e keni pér ta parë.

Ia nguli përsëri shikimin zotit Godfri, por kësaj here me një shprehje kaqardhjeje tē thellë në fytyrë madje e mori edhe nga dora.

— Jam e sigurt se e di arsyen e mos dëshirës suaj pér tē folur në këtë temë me mamanë dhe me mua. Një rastësi fatkeqe e vuri emrin tuaj përbri emrit tē zotit Luker në sy tē njerezve. Sapo zutë ngoje ato thashethemet skandalozë rrëth personit tē tij. A s'më thoni, po pér ju ç'thashetheme skandalozë qarkullojnë?

— Mos ma bëni këtë pyetje, Reçëll! — i tha. — E mira e tē mirave éshtë ta harrojmë këtë... vërtet, kjo do ishte gjëja më e mirë!

— Këtë unë **dëshiroj** ta di! — thirri ajo me tërbim.

— Përgjigjiu asaj pyetjeje, Godfri, — u përzie në bisedë tetova. — S'ka gjë më dëmprurëse pér tē tani se sa heshtja juaj.

Zoti Godfri u përlot. Me përdëllim e lutje, ia drejtoi pastaj sytë zonjushës Reçell dhe shqiptoi më në fund ato fjalët fatale.

— Në ngulni aq shumë këmbë që ta dini, Reçell, qarkullojnë fjalë që **Guri i Hënës** është dhënë në bankë për ruajtje nga zoti Luker, kurse unë jam ai që ia paskam dhënë të ma ruaj.

Brofi me një rënkim të thellë. Ajo e shihte me një pamje të tillë, sa që s'munda të mos them me vete: mos u çmend kjo vajzë?

— As edhe një fjalë më shumë! Mos guxoni të më prekni! — bërtiti duke u çapluar pas si ndonjë egërsirë kafazi! — Tërë kjo përfajin tim! Unë jam ajo që duhet ta vë në vend çdo gjë! Se që vetë unë e sakrifikova veten, kjo është e drejta ime. Por ta shoh me sytë e mi si po merret më qafë një i pafajshëm dhe ta ruaj këtë fshehtësi duke ia shkatërruar atij jetën? O Zot! Kjo është e tmerrshme. Ja, kjo s'mund të durohet.

Tetoja u çua paksa nga karrigia dhe përsëri u ul. Më thirri me zë të shuar duke më treguar ilaçin me pikë që gjendej në një kanistër mbi tryezë.

— Shpejt! — më pëshpëriti. — Gjashtë pika në një gotë ujë. Reçelli s'duhet ta shohë!

Në ca rrethana të tjera do të më habiste një porosi e tillë, por tanë s'kishte kohë përfunduar, duhej bërë si më thanë. Zoti Godfri më ndihmoi ta bëja këtë fshehtas Reçellit, duke i folur në qoshen tjetër të dhomës fjalë ngushëllimi:

— Epo, epo, sikur jemi duke e zmadhuar ca... — dëgjova t'i thoshte. — Emri im aspak s'është përlyer, s'mund ta përlyente një shpifje aq kalimtare. Pas një jave tërë kjo do harrorhet. E lëmë më mirë këtë bisedë.

Zonjusha Reçell edhe pas këtij gjesti shpirtmadhësie vazhdonte të ngulte këmbë në të sajën.

— Më duhet domosdo t'ia pres rrugën kësaj shpifjeje, — tha. — Mama, zonjusha Klak, më dëgjoni se ç'do ju them! Unë e di kush e mori **Gurin e Hënës**. E di... — I shqiptoi me një theksim të fortë këto fjalë dhe përplasi duart më zemërim. — E di që **Godfri Ebluajt** është i pafajshëm! Më çoni në gjyq, Godfri! Më çoni, jam gati të betohem për këtë.

Tetoja më kapi nga duart dhe më pëshpëriti:

— Bëni që të mos më shohin si ndonja dy minuta. Mos e lini Reçëllin të më shohë.

Më kalli datën mavijosja e fytyrës së saj. E vuri re që u tremba

— Pas dy minutash çdo gjë ka për të qënë në rregull. — me bëlbëzoi përsëri dhe zuri të presë me sy të mbyllur përmirësimin.

Ndërkokë dëgjoja si i fliste zoti Godfri zonjushës Reçëll:

— Emri juaj nuk duhet të përzihet më në këtë çështje. Reputacioni juaj, e shtrenjtë Reçëll, është tepër i shenjtë dhe duhet të ruhet i papërlyer. Kjo është kryesore.

— Reputacioni im, — qeshi tërë nervozizëm. — Po mua, Godfri, më akuzojnë po ashtu si dhe ju. Dedektivi më i mirë i Anglisë është i bindur që e kam vjedhur unë diamantin tim. Pyeteni po të doni dhe do ju thotë që e kam lënë peng për të larë ca borxhe të fshehta që paskam!

Heshti pak, vrapi përmes dhomës dhe u lëshua në gjunjë para së jëmës:

— O mama! Mama! Unë me siguri që jam çmendur! Se ja, as tani s'po e zbuloj të vërtetët!

Ishte kaq e tronditür saqë s'e vuri re as gjendjen e së jëmës. Brofi përsëri në këmbë dhe u gjend sërisht pranë zotit Godfri.

— S'kam për ta lejuar që ju..., që një njeri të pafajshëm ta akuzojnë e ta çnderojnë për fajin tim! Nëse nuk dëshironi të më shpini te gjqtari, atëherë uluni e shkruajeni që tani deklaratën për pafajsinë tuaj dhe unë kam për ta firmosur në vend. Bëni kështu si po ju them, ndryshe do e jap të botohet në gazeta, do të dalë e do thërras në rrugë.

Dukej që s'ishte fare në vete. Godfri zemërgjerë zuri ta qëtësonë dhe, pasi mori një fije letër, u vu të shkruante deklaratën. Ajo e nënshkroi me një ngut të ethshëm.

— Tregojeni gjithkund dhe mos mendoni fare për mua, — i tha duke i zgjatur letrën. — Druhem, Godfri, se në mendimet për ju s'kam qënë e drejtë. Ju nuk jeni aq egoist, saç pata menduar, jeni ku e ku më i mirë. Ejani sa herë që të mundeni; do të bëj çmos që ta shlyej padrejtësinë ndaj jush.

Ajo i zgjati dorën. Zoti Godfri ia puthi dhe iu përgjigj me zë të ëmbël por të dridhur:

— Do të vij, e shtrenjtë, vetëm me një kusht që kështu e tutje kurrë të mos flasim për këtë send të urryer.

Para se ndonjëri prej nesh të thoshte diçka, u dëgjuat një e trokitur e fortë në ërrë. Pashë në dritare një pajton me tre zonja të veshura me aq guxim, saqë kurrë në jetën time s'më ka rastisur të shihjë gjë tjetër të ngjashme.

Reçëlli u rrënqeth dhe erdhi në vete. Iu afroa së jëmës dhe i tha:

— Kanë ardhur të më marrin për të parë ekspozitën e luleve. Një fjalë, mama, para se të shkoj: mos të hidhërova gjë?

Pikat e kishin bërë punën e tyre. Të gjorës teto i që kthyer ngjyra e mëparshme e fytyrës.

— Jo, aspak, moj shpirt, — i tha. — Sh'ko me ato shoqet dhe argëtohu.

Vajza iu përkul dhe e puthi.

Qëndrova te dera derisa Reçëlli doli nga dhoma. Sytë i qenë mbushur me lotë. Vura re se zoti Godfri diçka kërkonte nëpër dhomë. S'arrita t'i ofroja ndihmën time, kur e gjeti ç'kërkonte. Iu afroa tetos me deklaratën në njëren dorë dhe me kutinë e shkrepseve në dorën tjetër.

— E shtrenjta teto, një kompllot i vogël, — tha. — E shtrenjta zonjusha Klak, një gjenjeshtër e shenjtë e pranueshme madje edhe nga rigoroziteti juaj moral! Ju lutem, të mos ia davaritni Reçëllit atë bindjen që e mirëprita therorinë zemërgjerrë, me të cilën ajo nënshkroi këtë letër. Ju lutem të jini dëshmitare të asgjësimit në praninë tuaj të kësaj deklarate, para se të dal nga kjo shtëpi!

Ndezi një fije shkrepse dhe e dogji letrën mbi taketuken përsipër tryezës.

— Bezdia e vockël që m'u shkaktua s'është veçse gjepur, kryesore — të ruhet i papërlyer emri i saj nga fëlliqësitetë e turmës. Ja! Kjo tokicë e pa'ajshme hiri dhe, Reçëlli e dashur aq e ndjeshme, kërkush nuk ka për ta ditur këtë që bëmë. Ç'ndjenja vallë provoni? Miq të shtrenjtë, ç'ndjenja provoni, de? Sa për mua, e ndiej veten aq të f'tilluar, si një djalkë miturak.

Njëren dorë ia zgjati tetos, tjetren mua. Shkëlgente nga hareja. Sakaq doli.

Kur mbeta vetëm me zonjën Verinder, kuptohet që ia hapa llafin për sikletin, i thashë se më habiti që e mbante të fshehur nga e bija gjendjen shëndetësore.

— Zonjusha Klak, ju prekët kësisoj, pa ndonjë paramendim, kuptohet, një gjë tepër të rëndë.

U ngrita dhe bëra të dalë. Zonja Verinder më mbajti dhe këmbënguli që të ulesha.

— Rastësishtr zbuluat një të fshehtë që ia kam besuar vetëm motrës sime, zonjës Ebluajt, dhe juristik tim, zotit Bref, askujt tjetër. Them se s'kanë për të qënë kundër pranisë suaj, kur t'u bëj të ditur si qëndron puna. A jeni e lirë sot, zonjusha Klak? Atëherë, a pranoni të qëndroni këtu me mua edhe ndonjë orë? Do të mësoni diçka që do t'ju hidhërojë. Mandej do t'ju kërkoj një shërbim, në rast se nuk jeni kundër.

Doemos që i shpreha tërë gadishmérinë time.

— Të presim, zoti Bref do jetë këtu në ora pesë. Ju mund të jeni njëra nga dëshmitaret e nënshkrimit të testamentit tim.

Testamenti i saj! M'u kujtuan ato pikat e ilaçit, m'u kujtua ajo çehreja e mavjosur. Mendja më shkoi për të keq. E fshehta e tetos pushoi së qëni për mua e fshehtë.

3.

— Kam kohë që ndihem fare keq, Klak, — më tha, — dhe, cudi ta them, por kam pandehur se do më kalonte. E dini, besoj, që Recëllin e solla në Londër për t'u këshilluar me mjekët. E vizitova te dy doktorë të njohur. Njërin e kemi patur mjekun e familjes që në të gjallë të tim shoqi. Mbasi mbaroi së shkruari recetën për Recëllin, më tha se dëshironte të fliste vetëm për vetëm me mua. Pandeva se do të më jepte ndonjë porosi të veçantë për time bijë, kur me një pikëllim të pafshehur në ftyrë, më tha: «Ju shoh, zonja Verinder, jo thjesht me syrin e mikut por edhe të mjekut. Them se konsulta mjeksore është ku e ku më e domosdoshme për ju sesa për vajzën tuaj.» Më bëri një vizitë tjetër në shtëpi, bashkë me atë shokun e tij, kur nuk ishte Recëlli. Përfundimin në të cilin kishin arritur, ma bënë

të ditur pa më alarmuar. Thanë se sëmundja e pakonstatuar më parë, ka marrë përmasa kërcënuese dhe tani u ka dalë nga kontrolli. Paskam më shumë se dy vjet që qënkam me zemër, por që simptoma kërcënuese nuk më janë shfaqur. Kjo ma paskej shka ërruar shëndetin. Mund të zgjas edhe disa muaj, por mund të vdes edhe sot, asgjë të saktë për këtë mjekët nuk mundën të më thoshin. Kuptohet që u trondita shumë, por tanimë i jam nënshtruar satit, po bëj çmos për të lënë në rregull punët. Dua vetëm një gjë: Reçelli të mos e marrë vesh këtë. Ajo do bëjë fajtor shqetësimin nga humbja e diamantit dhe do ta rëndoje veten. Mirëpo mjekët qenë të një mendjeje se sëmundja më paska filluar dy a tre vjet më parë. Them se do ta ruani në fishehtësi gjithë sa ju thashë. E shoh që u pikëlluat dhe jeni duke marrë pjesë në këtë fatkeqësi timen.

S'kaloi shumë dhe erdhi zoti Bref, juristi i zonjës Verinder.

— Edhe ju qënkeni këtu? — më pyeti.
— Tetoja më tha se do nënshkruaj testamentin, — iu përgjigja, — dhe qe kaq e mirë saqë m'u lut të isha edhe unë e pranishme si dëshmitare.
— Ashtu, ë? Epo, zonjusha Klak, moshën e keni goxha, s'jeni miturake, de, dhe ndonjë interes vetë ju për këtë testament nuk keni. Si ju shkojnë punët me atë Komitetin e Bamirësisë? Si e ndjen veten miku juaj, zoti Godfri Ebluajt pas atij dushit të ftohtë që i dhanë ata banditët në rrugën «Nortumberland»? Boll hyqajete kallzojnë për atë zotëri, shef të bamirësisë këtu tek ne!

— Edhe unë diç kam dëgjuar, zotëri, veç mund të them se gënjeshtër më të ndyrë se tërë ato thashetheme s'ka parë bota, — i fola e indinjuar nga mënyra si më foli për moshën dhe interesin tim lidhur me testamentin, por sidomos për zotin Godfri.

— Sigurisht ju i besoni mikut tuaj, por të bindet bota s'është gjë e lehtë. Se ai ka qënë në atë shtëpi natën kur humbi diamanti dhe qe i pari që u largua nga ajo shtëpi për në Londër. Po ata indianët c'bëjnë, thoni ju, kur i liruan nga burgu i Frizingolit? Shkojnë drejt e në Londër dhe ndjekin hap pas hapi zotin Luker. Ky nga frika depoziton sendin e çmuar

në bankë, e depoziton në fshehtësi, por indianët dhelpërakë e morën vesh. E zënë dhe e kontrolojnë, veç jo vetëm atë, edhe zotin Godfri Ebluajt. E përse? Ky thotë se dyshuan pas asaj bisedës së mirësjelljes te dera e bankës me zotin Luker. Çfarë absurditeti! Ka vetëm një përgjigje për arsyen që indianët vendosën të kontrollojnë edhe atë: ky ka lidhje se sendin e çmuar njëlloj si edhe zoti Luker. Duke mos e ditur saktë se të cili nga të dy mund të gjendej, indianët e kontrolluan, si njërin edhe tjetrin.

— S'kam si debatoj me një jurist të sprovuar si ju, zoti Bref, — i thashë. — Por si mund të lihet jashtë vemendjes mendimi i një dedektivi aq famëmadh siç është zoti Kaf, i cili dyshon për një person, për zonjushën Verinder.

— Për mua dedektivi Kaf s'ka fare të drejtë. Sikur ta nijhte zonjushën Reçell ashtu si e njoh unë, ky duhej të dyshonte te të gjithë në atë shtëpi përvèç asaj natyrisht. E di që s'është pa të meta ajo vajzë: është e myllur, kokëngjeshur, aspak nuk ngjan me moshataret, veç është në të njëjtën kohë shpirt-qelibar, zemërbardhë, fisnike, madje jashtë mase e tillë. Në thënçin faktet një gjë, kurse zonjusha Reçell një tjetër, unë i besoj asaj që thotë kjo vajzë, zonjusha Klak!

— Atëherë, më lejoni t'ju bëj të ditur, zoti Bref, se zoti Godfri Ebluajt ishte në këtë shtëpi para dy orësh dhe pafajsia e tij e plotë lidhur me zhdukjen e Gurit të Hënës u pranua nga vetë zonjusha Verinder me fjalë nga më të fuqishmet që kam dëgjuar ndonjëherë nga goja e ndonjë vajze të re.

Zoti Bref u çua vrulltas dhe shqeu sytë. Qëndrova fare e qetë aty ku isha dhe i kallzova gjithë sa kishte ndodhur në këtë shtëpi para pak kohe.

— Në qoftë kështu, pafajsia e zotit Godfri Ebluajt për mua është e padiskutueshme. Na paskan mashtruar ca dukuri të jashtme. Do ta hedh poshtë çështjen kundër atij njeriu publikisht në ndonjë gazetë.

Më ktheu krahët dhe nisi ecejaket nëpër dhomë.

— Veç më lejoni të bëj një supozim lidhur me atë mendimin e shprehur nga ju për njerëzit që qenë atë natë në atë shtëpi, zoti Bref. Më lejoni tju kujtoj se aty ka qënë edhe zoti Frenklin Blek.

Zoti Bref u largua nga dritarja, u ul në karrige përkarshi meje dhe ma qepi shikimin të shoqëruar nga një buzëqeshje hidhnake.

— S'bëkeni për gjyqtare, zonjusha Klak, — vuri në dukje mendueshëm. — Ju nuk ditkeni ta përmbari vrullin.

— Druhem se s'po arrij dot ta kuptoq ç'doni të thoni me këtë, zoti Bref, — iu përgjigja me përlüesi.

— Po ju, zonjushë, e dini që zoti Frenklin Blek është kanakari im. Veç kjo asgjë s'do të thotë. Po mundohem ta shoh çështjen me syrin tuaj. Është e vërtetë që zotin Ebluajt e rrethova me qarkun e dyshimit nisur nga po ato argumente që mund të përdoren edhe për të dyshuar zotin Blek. Atëherë mirë; ta vëmë në dyshim edhe atë. Po përsë vallë duhej ta vidhite atë diamantin?

— Borxhet që ka zoti Frenklin Blek i dinë të gjithë, — i thashë.

— Kurse borxhet e zotit Godfri Ebluajt ende s'u janë bërë të ditura njerëzve. Drejt po flisni. Por si i ngarkuar me drejtimin e punëve të zotit Frenklin Blek, më lejoni t'ju them se shumica e kreditorëve të tij, duke e ditur të çfarë pasurie ka i jati, janë të kënaqur me marrjen e përqindjes dhe të qetë presin t'u kthehen borxhet. Dhe ajo që është më kryesore, nga goja e zonjës Verinder kam dëgjuar se e bija po bëhej gati të fejohej me zotin Frenklin Blek tamam kur ai diamant ogurzi u zhduk nga shtëpia e tyre. E përsë i duhej ky **Guri i Hënës**?

— Shpirti i njeriut është pus i thellë, — i thashë. — Kush ia gjen fundin?

— Ta zëmë se e bëri këtë ngaqë është njeri i shprishur... Pra e vodhi, po pse atëherë të tregohej aq i zellshëm që diamanti të gjendej? Mund të thoni se ka qënë dinakéri nga ana e tij, e ka bërë për të larguar dyshimin. Kurse unë them që atë kërkush nuk e dyshonte. Aq më tepër që nga ky shkak të prishet me vajzen që po bëhej gati ta merrte për grua. Absurditet e shkuar absurditetit. Mund të thuhet, zonjusha Klak, se cështia e atij diamantit sotpërsot ka ngecur në qorrskak. Se pafajisia e Reçëllit as që vihet në dyshim, pafajisia e zotit Ebluajt është e padiskutueshme, kurse pafajisia e Frenklin Blekut, siç e thamë, është krejt evidente. Por ama jemi të bindur se dikush e ka sjellë **Gurin e Hënës** këtu në Londër dhe ai gjë-

ndet i fshehur nga zoti Luker apo bankieri i tij. Asnjë përvojë në një rast si ky s'të hynë në punë. I ka çoroditur që të gjithë...

Por jo, jo të gjithë. Dedektivi Kaf nuk ishte i çorodiur... Desha ta zë ngoje me shumë kujdes këtë fakt, duke protestuar energjikisht kundër mendimit se dëshiroja të hidhja baltë mbi emrin e zonjushës Reçell, por hyri shërbëtori dhe tha se mjekët kishin ikur dhe tetoja po na priste.

Debati ynë këtu u mbyll. Morëm ç'kishim dhe shkuam në dhomën e zonjës Verinder.

4.

Ceremonia e nënshkrimit të testamentit zgjati shumë më pak nga ç'e prisja. U bë çdo gjë me një shpejtësi aspak të hijshme. Thirrën një shërbëtor si dëshmitar të dytë, dhe në çast i dhanë penën tetos. Pas dy minutash gjithçka kish marrë fund.

— Edhe ju do të keni pjesën që ju takon, — më tha tetoja kur mbetëm vetëm.

— Më lejoni tani të largohem, e dashur teto, — i thashë, — që të mund të pushoni ca.

Të nesërmen, kur po afronte koha e ngrënies së mëngjesit, vura kapelen dhe mora rrugën për në parkun «Montegy», në shtëpinë e tetos Verinder.

Kur po kaloja para dhomës së bibliotekës, më zunë veshët bisëdën e një djali me një vajzë: ishte Godfri Ebluat me Reçellin.

— A jeni i sigurt, Godfri, që më dashuroni aq shumë siç po thoni?

— A jam i sigurt! Më lejoni, Reçell, t'ju them disa fjalë për gjendjen time të tanishme: e kam humbur interesin për gjithçka në botë përvëç jush. Më ka ndodhur një i tillë transformimi, që as vetë s'jam në gjendje ta shpjegoj. Tërë ato punë bamirësie më kanë ardhur në majë të hundës.

— Ju sapo u rrëfyet para meje, — i tha ajo. — Më lejoni tani mua t'ju bëj të njëjtën gjë që të mund ta gjykoni gjithçka si duhet.

Godfri u rrënqeth. U rrënqetha edhe unë. Me q'dukej që tē dy pandehëm se tani do hapej sekreti i **Gurit të Hënës**.

— A më besoni po t'ju them se para jush qëndron vajza më fatkeqe në botë? Kjo është më se e vërtetë, Godfri. A mund tē ketë pér njeriun gjë më fatkeqe se vetëdija e humbjes së respektit ndaj së vërtetës? Ja se në q'gjendje që jam tani!

— Po a keni vallë arsyé pér këtë?

— E ku e dini ju që nuk kam?

— E di ngaqë ju njoh. Heshtja që keni ruajtur, e dashura Reçell, nuk ju ka ulur aspak në sytë e miqve tuaj tē vërfetë. Zhdukja e asaj dhurate tē shtrenjtë pér ditëlindje mbeti një enigmë e çuditshme; lidhja juaj e pakuptueshme me këtë ngjarje mund tē duket edhe më e çuditshme...

— E keni fjalën pér **Gurin e Hënës**, Godfri? M'u duk se ju atë keni parasysh kur jeni duke folur kështu. Pér zhdukjen e atij diamanti mund tē dëgjoj pifte pa m'u cënuar aspak dinjiteti vetjak. Nëse zhdukja e diamantit do tē zbulohet ndonjë herë, ka pér t'u bërë e qartë se mora mbi vete një përgjegjësi tē tmerrshme, se mora përsipër ruajtjen e sekretit tē kësaj çështjeje, por ka pér t'u dukur qart dhe që vëtë unë nuk kam fare faj! Ju nuk më kuptuat se q'desha tē them, Godfri. Duhej tē isha shprehur më shkoqur. Po mundohem ta bëj këtë me çdo kusht. Ta zëmë se ju keni rënë në dashuri me ndonjë grua tjetër...

— Po?

— Ta zëmë se u bindët që ajo grua këtë asfare nuk e meriton. Ta zëmë se u bindët plotësisht që pér ju është thjesht poshtërim çdo mendim pér tē. Ta zëmë se vetëm nga mendimi pér atë martesën me një tē tillë gruaje s'do gjenit dot vend ku tē futeshit...

— Po?

— Dhe ta zëmë se pavarësisht nga tē gjitha këto ju s'gjenni dot forca pér ta shkulur nga zemra juaj... Atëherë si? Por jo! Tërë këtë që ju thashë ai kurrë s'ka pér ta marrë vesh. Unë atë kurrë nuk do ta shoh më! Ndaj më mirë e mbyllim këtë bisëdë. A kuptoni ndopak nga mjeksia, Godfri, që tē më shpjegoni pérse kam një si ndjenjë angushtie, mezi mbushem me frymë? A ekziston ndonjë lloj histerie që shfaqet jo përmes vë-

shimit të lotëve por përmes vërshimit të fjalëve? Me siguri që ekziston.

U kthyë vrulltas dhe goditi me grushta shpinën e divanit. Koka iu zhyt pastaj në jastëkë dhe ia plasi të qarit. Zoti Godfri sakaq u lëshua para saj në gjunjë, e përqafoi dhe i pëshpëriti: «Ç'qënie fsniqe që jeni!» Asgjë më tepër nuk tha por këto fjalë i nënvizoi me një të tillë pâtosi që i shkonte përshtat namit të përhapur për të si për një orator të rrallë. Pas një pauze zo-ti Godfri vazhdoi.

— Po, — i tha ai. — Ju jeni vërtet qënie fisniqe! Një grua që e shpalos të vërtetët vetëm për hir të së vërtetës, një grua që vetësakrifikohet për të mos cënuar nderin e tjetrit është thesari më i çmuar i të gjithë thesareve. Në rast se një grua e tillë pranon të martohet me dikë, duke ushqyer ndaj bashkëshortit vetëm ndjenja respekti, ajo ka për ta lumturuar atë jo pak dhe në jetë të jetëve. Sa për mua, e dashur, më lejoni kështu më gjunjë tu lutem të më lejoni të bëj ç'është e mundur për ta shëruar atë zemrën e lënduar me anë të përkujdesit për ju! Reçell, a ma bën atë nder, a më lejon të gëzoj lumturinë më të madhe, duke pranuar të bëheni gruaja ime?

— Godfri! — i tha. — Mos keni luajtur mendsh?

— Kurre në jetën time nuk kam folur me aq llogjikë, e dashur, kur ëshë fjala për dobinë tuaj dhe timen. Rrethojeni veten me interesa që janë ku e ku më të larta se këto argëtime mjerane mondanë. Zemra që ju do dhe ju respekton, vatra familjare, detyrimet e qeta dhe lumturuese që do ju vijnë njera pas tjetrës dhe do ju thithin të tërën, mos i flakni tej këto virtute, Reçell! Nuk ju kërkoj të më doni, do të më mjaftonte vëtëm miqësia dhe respekti juaj.

Tërë këto lutje dhe përgjerime zunë ta lëkundin.

— Mos më shty në ngasje kësisoj, Godfri! — i tha. — Edhe pa këtë jam tejet e nervozuar dhe fatkeqe. Mos mi shton i edhe më vuajtjet.

— Vetëm një pyetje, Reçell. Mos ndjeni gjë neveri për mua?

— Neveri? Ah, jo! Ju kurdoherë më keni pëlqyer! Pas gjithë sa më thatë, do të isha fare dru që të mos ndjeja entuziazëm.

— Po a janë të shumta gratë, e dashura Reçëll, që i respektojnë dhe entuziazmohen nga burrat e tyre? E pra, s'rrojnë keq.

— Po më joshni me atë shpresën e re, në një kohë kur të gjitha shpresat më janë shëmbur. Ndihem aq po aq fatkeqe dhe më ka pushtuar një i tillë makthi, saqë po të më thoni qoftë edhe një fjalë, kushedi edhe pranoj të bëhem gruaja juaj, brenda kushteve që ju përmendët. Më mirë dëgjojeni këtë paralajmërim dhe largohuni!

— S'kam për të dalë që këtej pa më thonë «po»!

— Në ju thënca «po», keni për t'u penduar, edhe unë do të pendohem, por ka për të qënë vonë.

— Të dy bashkë do e bekojmë ditën kur unë këmbëngula, kurse ju lëshuat pe!

— Jeni krejt i sigurt për këtë?

— Ju jap fjalën e nderit se po.

— Atëherë edhe unë pranoj.

Një shkulm i ri mallëngjimi të patreguar por kësaj here të përzier me entuziazëm e vërshoi të tërin zotin Godfri. E afroi avash-avash tek vetja derisa fytyra e saj ciku të tijën dhe ata u përqafuan. Zoti Godfri edhe ai u ul në divan pranë saj dhe i tha:

— A mund t'ia bëj të ditur mamasë suaj të dashur këtë? Apo mos dëshironi t'ia thoni vetë?

Ajo nuk ra njëmendje as me mendimin e parë e as me të dytin.

— Mamaja është më mirë të mos dijë asgjë për këtë deri sa ta ndiej veten më mirë. Dua të mbetet vetëm ndërmjet nesh, Godfri. Tani ikni dhe ejani në darkë. Edhe kështu ndenjëm ca si shumë bashkë këtu.

Këtë cast u dëgjuan të thirrura në korridor. Ishte zë njeriu tepër të trondititur dhe të trëmbur.

— Zonjusha Reçëll! — thërriste. — Ku jeni, zonjusha Reçëll?

Ajo u turr me vrapi për të dera. Atë çast ia befi shërbëtori i verdhë si meit. I tha:

— Ejani poshtë. Zonjës i ra të fikët, s'po e sjellim dot në vete.

Zoti Godfri u nis me vrap për të marrë doktorin.

E gjeta Reçellin më gjunjë te divani. Koka e së jëmës prehej në gjoksin e saj. Kur e pashë, s'e pata aspak të vështirë ta kuptoja të vërtetën e tmerrshme, por heshta deri sa të vinte mjeku. Ky para së gjithash urdhëroi ta nxirrnin nga dhoma Reçellin dhe pastaj tha se zonja Verinder kishte vdekur...

Kaloi më se një muaj nga vdekja e tetos para se të takohesh përsëri me Reçell Verinderin. Ndenja disa ditë nën një çati me të. Gjatë kësaj kohe ndodhi diçka shumë e rëndësishme që kishte të bënte me fejesën e saj me zotin Godfri Ebluajt

Në shtëpinë e re në Brajton erdhi pas disa ditësh zoti Godfri Ebluajt. Isha duke dalë për t'u bërë një vizitë dy miqve të këtushëm, kur te shkallët u gjenda ballpërballë me zotin Godfri. M'u afrua nguturazi:

— E shtrenjtë zonjusha Klak, — më tha. — Desha t'ju takoj! Fare rastësish u çlirova më parë se e parashikoja nga ato punët e Londrés dhe erdha me një frymë këtu.

— U takuat me Reçellin? — e pyeta.

Psherëtiu thellë dhe më kapi nga kruhu.

— E takova Reçellin, — më foli krejt i qetë. — Ju e dini, mik i shtrenjtë, që kemi qënë fejuar, por befas ajo vendosi ta prishë këtë fejesë. Pasi qenka menduar gjatë, paska ardhur në përfundimin se do të ishte në të mirën tonë të përbashkët që të prishej kjo fejesë me ngut dhe aspak e menduar. E quan më me vend të më lerë të lirë për të bërë ndonjë zgjedhje tjetër që vërtet do të më lumturonte. Vetëm këtë shkak më nxorri dhe po ashtu një përgjigje përsëriti.

— Po ju, nga ana juaj, çfarë i thatë? C'mendoni ju të bëni. Mos do i nënshtroheni fatit? — e pyeta.

— Po, — m'u përgjigj me një qetësi të çuditshme. — Ju nënshtrova fatit.

Shtanga nga habija. Të shohësh dikë me sy të zgurdulluar nuk është e hijshme aq më tepër kur para teje qëndron një zotëri. Shqiptova si në jerm:

— Ç'do të thotë kjo?

— Më lejoni t'ua kallzoj si qëndron puna. Ulemi në këtë dhomë.

Më coi te një kolltuk.

— Humba nusen hamgjítëse, pozitën e mrekullueshme shoqérore dhe një prikë tē majme, — zuri tē thotë zoti Godfri, — dhe iu neshtrova fatit pa kundërshtuar. Cila vallë tē jetë arsyëja? Ja ku po jua them, e shtrenjtë, që asnë lloj arsyë nuk ekziston.

— Nuk ekzistoka? — e pyeta.

— Se, ju pyes juve, përsë tē sakrifikoja atë lumturi tē vërtetë që ndiej, duke u marrë me punë bamirësie, nga ca gra tē adhurueshme? E ç'më duhet pozita e mrekullueshme shoqérore, kur edhe kjo e tanishmja s'është më pak e tillë? E ç'më hyjnë në punë tē ardhurat nga kjo martesë, kur sa pér tē blerë bukën, pér tē paguar apartamentin dhe mirëmbajtur veten kam aq tē holla? Në atë gjendje pikëllimtare në tē cilën ajo ndodhet vërtet që u ndjeva i lehtësuar kur më tha se e têrhiqtë fjalën e dhënë.

S'e zgjati më tej bisedën, ngaqë punë tē ngutshme e prisin në Londër dhe i duhej tē nisej pa vonesë. Mbeta e vetme në dhomë.

Tregimi i dytë,

i shkruar nga Matje Brefi, jurist i familjes Verinder.

1.

Rrëfimtarja rigorozë, zonjusha Klak, e la penën, vendosat marrë unë pér dy arsyë.

Së pari, sepse mund tē hedh dritë në disa gjëra që deri më tani kanë mbetur në errësirë. Zonjusha Verinder kishte ca arsyë tē vetat, tē fshehta që u prish me tē fejuarin dhe unë qesh ai që u bëra shkak. Zoti Godfri Ebluajt kishte ca arsyë tē vetat që pranoi sakaq prishjen e fejesës me kushurirën hamgjítëse dhe qeshë unë ai që i zbulova.

Së dyti, nuk e di, për të mirë apo për të keq, por në atë ndërkojë, për të cilën po bëjmë fjalë, vetë s'di sesi qeshë tra-zuar në atë çështjen e diamantit indian. Pata nderin të prisja në zyrën time një të huaj me maniera sjelljeje tejet elegante, i cili, sigurisht, që nuk ishte tjetër veçse kokësi i tre indianëve. Shtoni që të nesërmen mora një takim me udhëtarin e famshëm zotin Mertuet dhe pata me të një bisedë rrith Gurit të Hënës; gjithë sa më thanë ndihmuani së tepërmët në sqarimin e çështjeve të mbeturë pezull.

Prishja e fejesës së zonjushës Verinder me zotin Godfri Ebluajt duhet të zërë vendin e parë në këtë tregimin tonë.

Testamenti i nënshkruar në dhomën e zonjës Verinder në prani edhe të zonjushës Klak, për çka u fol më sipër, përbante një kusht të rëndësishëm: Reçell Verinder nuk kishte të drejtë të qeveriste pasurinë, asaj i siguroheshin vetëm të ardhurat nga kjo pasuri gjatë tërë jetës së saj. Kjo masë e ruante zonjushën Reçell nga laktmia e ndonjë të babëzituri dhe bataku. As ajo vëtë, as bashkëshorti i saj (në rast se martohej) nuk kishin të drejtë të qeverisnin as tokën, as kapitalin. U ishin lënë vetëm shtëpitë në Londër dhe në Jorkshir dhe u qenë siguruar të ardhura të bollshme nga fitimet.

Pas vdekjes së zonjës Verinder, ia dhashë testamentin noterit që ishte dhe miku im që ta regjistronte konform rregulla.

Pas tri javësh më erdhën në vesh ca lajme të pazakontë: dikush, karshi pagesës, kishte qënë i interesuar të njihet me tekstin e testamentit. Pa ndonjë vështirësi të veçantë mora vesh se kishte qënë zoti Godfri Ebluajt.

U gjenda ngushtë. S'kishte më shumë se një javë që kisha dëgjuar për fejesën e zonjës Verinder. E doja me shpirt atë vajzë, e adhuroja dhe u trishtova pa masë kur mësova për këtë ngutje të saj. Zotin Godfri Ebluajt e pata konsideruar kurdo-herë njeri gënjeshtar të paskrupullt, që di të maskohet dhe të shtiret me një hipokrizi të rrallë. Ishte e qartë se kish vendosur të fejohej me zonjushën Reçell përfitim vetjak. «E çë pastaj? — mund të më pyesni. — Këtë e gjen në çdo hap». Ashtu është, i nderuar zotëri, po a do t'ju vinte mirë vallë ta dëgjonit këtë për motrën tuaj?

Thashë me vete: zoti Godfri Ebluajt ndoshta heq dorë nga kjo fejesë pas asaj që mori vesh nga testamenti. Kjo varej nga gjendja e tij financiare, për të cilën nuk kisha fare dijeni. Slikur të ishte mirë nga gjendja, të ardhurat nga pronat e zonjushës Reçëll nuk do të qenë të vogla. Por në i duheshin me ngul paratë, atëherë testamenti i zonjës Verinder ia kishte arritur qëlliimit: nuk e linte batakçinë t'i afrohej së bijës.

Isha në mëdyshje të madhe në qe apo jo e udhës që ta shqetësoja zonjushën Reçëll me njoftime të këtij lloji pas pikëllimit të thellë që provonte nga humbja e së jëmës. Vendosa që po. U nisa për në Brajton ku kishte qëndruar pas vdekjes së zonjës mëmë. Ia tregova si qëndronte puna, por jo drejtpërdrejt. E kuptoi me atë depërtueshmërinë që e karakterizonte, m'i nguli sytë zhbirues dhe më tha:

— Zoti Bref, ju diç doni të më bëni të ditur lidhur me Godfri Ebluajtin. Ma thoni troç.

E njihja aq zonjushën Reçëll saqë, pa u lëkundur gjatë, t'ia tregoj që të gjitha.

Më mori përkrahu dhe eci me hap të ngadaltë. Ndjeva sesi krahu i saj ma shtrëngonte gjithë më tepër krahun, ndërkohë që fytyra sa vinte e i bëhej më e zbehtë. Kur mbarova, s'foli as edhe një fjalë. Me kokën ulur, ecte përbri meje, pa e vënë re fare praninë time, e zhytur e téra në mendime. E lashë të mendonte. E njihja mirë dhe e dija që i duhej lënë kohë të mbildhë veten.

Kishim bërë kështu si ndonjë milje, kur Reçëlli u përmend nga ajo gjendje përgjumjeje. Më pa me atë buzagazin përshkënditës, më të këndshmin që më ka rastisur të shohë në fytyrën e ndonjë gruaje.

— I detyrohem shumë zemërgjerësisë suaj, — më tha. — Pas kësaj që bëtë për mua ky detyrim bëhet edhe më i madh. Nëse ju flet kush në Londër për fejesën time, përgënjeshtrojeni në emrin tim.

— Vendosët të prisheni me të fejuarin? — e pyeta.

— A mund të vihet në dyshim kjo, — më foli plot krenari, — pas gjithë asaj që më treguat?

— E shtrenjta zonjusha Reçëll, ju jeni shumë e re dhe ndoshta do ta keni të vështirë të dilni nga kjo gjendje. Mos ke-

n' ndonjë, kam parasysh grua, me të cilën mund të këshillohshit?

— Jo.

U hidhërova shumë, kur e dëgjova. Aq e re dhe me aq qetësi i kalon që të gjitha!

Sa për bisedën e shpjegimit me të fejuarin zotin Godfri Ebluajt, për mënyrën si e priti ky lajmin për prishjen e fejesës dhe për mendimet e tij lidhur me atë nënshtrimin ndaj fatit është treguar nga zonjusha Klak. Më mbetet vetëm të shtoj se zonjusha Verinder gjeti prehje dhe qetësi për të cilat ajo fatkeqe kishte aq shumë nevojë, në shtëpinë time në Hempsted. Ku erdhi fill pas bisedës me zotin Godfri Ebluajt dhe të jatin e tij. Na nderoi kësisoj me qëndrimin e saj për një kohë të gjatë. Ime shoqe dhe vajzat linin kokën për të.

2.

Tani e ka radhën tregimi për të dhënët plotësuese rrëth Gurit të Hënës, më saktë do të ishte të thoja, për planin e indianëve që ta rrëmbenin me çdo kusht.

Ndonja dhjetë ditë pas vdekjes së zonjës Verinder vjen tek unë në zyrë njeri nga nëpunësit me një kartëvizitë ndër duar dhe më thotë se më priste poshtë një zotëri që dëshironte të fliste me mua.

I hodha një sy kartvizitës: qe shkruar një emër të huaji që s'po e ndërmendja dot. Nën emrin qenë shkruar anglisht këto fjalë: «Me rekomandim të zotit Septimus Luker».

Paturpësia e këtij zotit Luker për t'i rekomanduar dikujt të më drejtohej mua më habitit aq shumë saqë ndonjë minutë shtanga në vend, duke mos u besuar syve. Nëpunësi këtë e vu ri re dhe e quajti të udhës të ndante me mua përfundimet, në të cilat ai vetë pat arritur, pasi e kishte vrojtuar mirë e mirë atë të huaj.

— Është një burrë i pashëm, zotëri, aq i zeshkët, saqë e merr fare lehtë për indian.

E kuptova se kishte lidhje me Gurin e Hënës. Për habi të nëpunësit pranova ta presë menjëherë atë zotëri.

Kur u fut, u binda përfundimisht se para meje qëndronte njëri nga ata të tre indianët e mirënjohnur, me sa dukej, kokësi i tyre. Ishte veshur me rrobe evropiane. E ftova të ulej dhe e pyeta c'ë kishte sjellë.

Pikësëpari më kërkoi ndjesë pér shqetësimin, pastaj nxori një pako të mbështjellë me një cohë të endur me fije ari. Zuri ta shpalosë, pastaj edhe cohën e dytë prej mëndafshi. Qetë-qetë vuri mbi tryezë një kutizë të vogël ebaniti të zbukuruar mrekullishët me gurë të çmuar.

— Kam ardhur, zotëri, t'ju lutem të më jepni hua ca të holla. Këtë po jua ië peng, — më tha.

I tregova në drejtëm të kartvizitës.

— Keni ardhur me rekomandim të zotit Luker? — e pyeta.

Indian i m'u përkul.

— A mund t'ju pyes, përsë nuk ju dha të holla vetë zoti Luker?

— Zoti Luker, zotëri, më tha se nuk i gjendeshin para të lira.

— Dhe ju rekomandoi të më drejtoheshit mua?

Indian i nga ana e vet, më tregoi kartvizitën.

— Kështu është shkruar.

Përgjigje e shkurtër dhe e saktë! Sikur të gjendej **Guri i Hënës** tek unë, s'ka më të voglin dyshim që ky aristokrat oriental do të më kishte vrarë pa iu dridhur dora fare. Por ama si klient s'e kishte shokun: u tregua shumë i kujdeshshëm në repektimin e kohës së tjetrit.

— Më vjen keq që u munduat deri tek unë. Zoti Luker gabohet që ju ka dërguar. Se vërtet që u rekomandojnë njerëzve të vijnë tek unë pér të marrë para hua, por e kam pér zakon të mos u jap kurrë të panjohurve goftë edhe me kësisoj pengu si ky juaji.

Pa bërë as orvatjen më të vogël pér të më bindur siç do të bënte gjithësecili, indian i m'u përkul përsëri dhe pa më thënë as edhe nië fjalë, e mbështolli kutinë me të dy cohat. U quan dhe u bë gati të dilte, por më parë më tha:

— A do t'i bëni aq lëshim një të huaji para se të largohet?

Iu përkula me mirësjelljeje. Vetëm një lëshim, kurse zakonisht të kërkojnë dhjetra.

— Desha t'ju pyes, po tē më jepnit para hua, me ç'farë afati do tē m'i jepnit?

— Me tē zakonshmin e vendit tim: pér një vit, ditë më ditë.

Indian i më bëri tamina më tē fortë se tē parat dhe pa u ndier doli.

Ishite punë sekondash, ecja e tij e butë si e maces, tē them tē drejtén, më vuri në merak. S'kisha as dyshimin më tē vogël se ky njeri kishte ardhur vetém pér tē më pyetur lidhur me afatin që huamarrësi është i detyruar t'ia kthejë huan huadhë-nësit. Edhe kutia, edhe kërkesa e huas s'qenë veçse sebep pér tē mësuar afatin e huas.

Vendosa tē bëj ca më pérpara dhe tē pyes veten pér arsyen e ardhjes tek unë tē indianit. Atë çast më sollën një letër nga Septimus Lukeri dora vetë. Më kërkonte pérulësish tē falur dhe shprehte dëshirën tē më takonte pér tē më bërë shpjegimet e duhura. Vendosa tē sakrifikoj pak kohë, i nisur nga kërshëria, dhe i lashë takim në zyrën time ditën tjetër.

Në tē gjitha drejtimet ky zoti Luker u tregua ku e ku më pak dinjitoz se indiani: ishte fare banal, njeri i pafytyrë, servil; as që ia vlen tē ndalemi gjatë këtu. Ja thelbi i asaj që më tha.

Një ditë më parë aristokrati indian kishte qënë pér vizitë tek ai. Zoti Luker e kishte njojur menjëherë: ishte njëri nga tē tre indianët, që ia kishin pas sjellë në majë tē hundës me ato ecejaket e tyre para shtëpisë së tij, derisa qe ankuar në polici. Pas kësaj, fare natyrshëm, ky kishte thënë me vete se indiani ishte njëri nga ata që i kishin lidhur sytë dhe e kishin kontrolluar, duke i marrë faturën e bankierit. Pra kishte shtangur nga 'merri dhe i kishte dhënë karar punës se pat ardhur qasti tē nxjerrë atë kutizën me gurë tē çmuar dhe i qe drejtuar po me atë kërkесë që m'u drejtua edhe mua. Duke dashur ta heqë qafe, i kishte thënë se nuk i gjendeshin para tē lira. Indian i qe lutur t'i rekomandonte një person ku mund tē merrte para hua. Zoti Luker i kishte thënë se pér këtë i duhet drejtuar një personi me reputacion tē mirë dhe i kishte zënë ngoje emrin tim. Ngaqë i kishte hyrë frika në palcë, i kishte përmendur emrin e tē parit njeri që i kishte ardhur në mendje.

— Më shkonin djersët çurg nga sikleti, zotëri, — e përfundoi fatkeqi. — As vetë s'ë dija se ç'flisja. Besoj se s'më bëni me faj, zotëri, isha tmerrësish i trembur.

I thashë se e kuptoj gjendjen e tij. Ishte mënyra e vëtmë për ta bërë të ngrihej. Para se të dilte i bëra edhe një pyetje: mos tha indiani ndonjë gjë me interes për t'u ditur para se të largohej?

Po! Indiani e kishte pyetur zotin Luker për po atë gjë, për të cilën më kishte pyetur edhe mua dhe kishte marrë të njëjtën përgjigje.

C'donte të thoshte e gjithë kjo?

Atë mbrëmje më kishin thirrur për darkë, ndaj shkova lart për t'u veshur, ndonëse isha në humor të keq. As që më shkonte në mendje se rruga për atje lart në rastin e dhënë ishtë rruga drejt zbulimit.

3.

I ftuar nderi në atë darkë kishte qënë zoti Mertuet. S'qenë të paktë personat e interesuar që të dinin për ato udhëtimet e tij plot me aventura dhe rreziqe. Kishte shpallur se do të kthehet përsëri në atë arenën e veprimeve të rrezikshme.

Kur burrat mbetën vetëm në sallën e ngrënies, u gjenda pranë zotit Mertuet. Biseda për politikën që mori zjarr me të dalë gratë, as mua e as atë nuk e interesonte. Pashë si po e kapëlcnte një dremitje kapitëse. Më shkrepi mendimi t'ia davarisja atë dremitje duke i hapur bisedën për **Gurin e Hënës** dhe, në më paraqitej mundësia, të vilja mendimin që kishte për planet e indianëve në të ardhmen.

— Në nuk gabohem, zoti Mertuet, — fillova t'i them, — keni qenë njohur me zonjën Verinder dhe keni pas treguar interes për ato ngjarjet që u përmbyllën me zhdukjen e **Gurit të Hënës**.

Udhëtarë i famshëm më bëri nder, pasi e flaku tej dremitjen, dhe më pyeti kush isha. I fola për lidhjet që kisha me familjen Hernkastl pa lënë pa theksuar gjithë sa më ziente përbrenda lidhur me kolonelin dhe diamantin.

Zoti Mertuet u kthyé në karrige në mënyrë që të kishte pas shpine të pranishmit e tjerë dhe e përqëndroi tërë vëmendjen te zoti Bref, te ky jurist i rëndomtë.

— A flitet gjë pér ata indianët? — më pyeti.

— Kam të dhëna bindëse të mendoj që njëri prej tyre më erdhi dje në zyrë, — iu përgjigja.

Zoti Mertuet nuk ishte nga ata që habitej kollaj, por kjo përgjigje imja e habit. I tregova q'i kishte ndodhur zotit Luka ahe mua.

— S'do mend që ajo pyetja e lamtumirës e indianit ndjek qëllime të caktuara, — i thashë. — E përsë i lypsej të dinte afatin e kthimit të borxhit.

— Si eshtë e mundur që ju këtë të mos e kuptioni, zoti Bref?

— Turp të them, por nuk arrij dot ta kuptioni, zoti Mertuet.

— Atëherë më lejoni t'ju bëj këtë pyetje, — më tha. — C'kanë ndër mend të bëjnë indianët në kushtet e krijuara pér të rrëmbyer Gurin e Hënës?

— S'di q'përgjigje t'ju jap, pér mua ky eshtë një mister!

Lexuesit tanimë i eshtë bërë e ditur se mundësia e parë pér t'u bërë përsëri zotër të diamantit indianëve u rrëshqiti nga dora atëherë kur i futën në burg në Frizingol. Këtu dhe ju luta zotit Mertuet ta niste tregimin pér veprimet e mëtejshme të indianëve.

Para se të vazhdonte, zoti Mertuet nxori bllokun e shëni meve dhe zuri ta shfletojë.

— Ato ditë isha pér gasti te disa miq të mi në Frizingol. Dy ditë para se t'i lironin nga burgu indianët (më duket se ishte e hënë), gardiani erdhi tek unë.

Një zonjë e quajtur Makan, ku ata kishin zënë me qira një apartament, kishte çuar në burg një letër pér njërin nga indianët, zonjës Makan postierë ia kishte dorëzuar atë letër në mëngjes. Ata të drejtorisë së burgut kishin vënë re vulën e Lambetit dhe se adresat, edhe pse e shkruar në një anglishtë të rregullt, nuk qe formuluar ashtu siç bëjnë tek ne zakonisht. Kur e hapën, e panë se qe shkruar në gjuhë të huaj, në njëren nga gjuhët e Indisë. Kështu menduan ata. Gardiani erdhi tek unë

me lutjen që t'ia përktheja. E kopjova në bllokun e shënimeve edhe origjinalin, edhe përkthimin që bëra. Ja ku i keni.

Më zgjati bllokun e tekstet. Adresa qe kopjuar krejt e ngjitur, pa shenja pikësimi: «Tre indianëve që banojnë te zonja Makan në Frizingol në Jorkshir». Mandej vinte teksti në origjinal dhe më poshtë përkthimi në anglisht. Ja ai:

«Në emër të qeveritarit të Natës që mbretëron në Sajge, krahët e të cilit pushtojnë të katër anët e tokës!

Vellezër, kthejeni fytyrën nga jugu, ejani me mua në rrugën e shumëzhurmshme që zbret poshtë për te uji i ndotur!

Shkaku është po ai:

Sytë e mi atë e panë!»

Kaq! As datë, as nënshkrim nuk kishte. Ia ktheva zotit Mertuet dhe s'durova pa shtuar se kishim të bënim me një she mbull kërvshërendjellës të letërkëmbimit indian, por që mua më futi në qorrakak.

— Mund t'ua shpjegoj frazën e parë, — më tha. — Të tjerat ua bënë të qartë sjellja e indianëve. Zoti i hënës së mitologjisë indiane përfytyrohet katërkrahësh, që rri ulur në një antilopë, njëri nga titujt e tij është qeveritar i Natës. Kemi të bëjmë me një nëntekst që ta çon mendjen te **Guri i Hënës**. Të shohim tanë sjelljen e indianëve pas kësaj letre. Sapo i liruan nga burgu, këta morën rrugën për nga stacioni hekurudhor dhe hipën në të parin tren që shkonte në Londër. Në Frizingol ne të gjithë shprehëm keqardhje që indianët nuk u gjurmuan në fshehtësi. Por, pasi zonja Verinder, i bëri pagesën dedektivit dhe e ndërpren hetimin e çështjes së diamantit kërkush nuk u interesua më për indianët. Fare të qetë këta mbërritën në Londër. E kur dëgjuam përsëri për ta, zoti Bref?

— Kur zunë ta mërzisnin me praninë e tyre zotin Luker, — iu përgjigja.

— A keni lexuar që zoti Luker iu drejtua gjyqit?

— Po.

— Në ju ndërmendet, ai përmendëte aty një të huaj që kishte shërbyer tek ai, të cilin apo e kishte pushuar sepse e kishte dyshuar për vjedhje; kishte pandehur gjithashu se ky i huaj bashkëpunonte me indianët që ia kishin sjellë në majë të hundës. Përfundimi, zoti Bref, del vetvetiu: edhe lidhur me atë që u kishte dërguar indianëve letrën, që juve ju futi në

qorrskak, edhe lidhur me vjedhjen që ky nëpunës kishte ten-
tuar të bënte të zoti Luker.

Asnjë nere nuk kam pasë dyshuar se diamanti kishte rënë
në dorë të zotit Luker. Pikërisht në ndërkokë për të cilën më
ton zoti Mertuet. Më çudiste fakti, nga e morën vesh këta in-
dianët. Tani edhe kjo enigmë u sqarua.

— Ka edhe një pyetje që kërkon përgjigje, — më tha zoti
Mertuet. — Dikush e çoi Gurin e Hënës nga Jorkshiri në Lon-
dër dhe e la aty peng, ndryshtë s'kishte si të gjendej në duart e
zotit Luker. A dihet personi që e bëri këtë?

— Me sa di unë, nuk dihet.

— Kanë pas qarkulluar zëra se e ka bërë zoti Godfri Eb-
luajt, kështu apo jo? Më kanë folur për të si për një filantrop
të dëgjuar, kjo që flitet s'i bën nder.

Qesnë sinqerisht i njëmendjeje me zotin Mertuet. E ndje-
va për detyrë t'i bëj të ditur (kuptohet pa zënë ngoje emrin e
zonjushës Verinder), që zoti Godfri Ebluajt qe i çliruar nga çdo
iloj dyshimi fal dëshmisë së një të tillë personi, vërtetësisë së
të cilës unë i dilja për zot.

— Shumë mirë, — tha i qetë Mertueti. — La lemë kohës
të na e kthjellojë këtë çështje. Le t'i kthehem, zoti Bref, indi-
anëve. Udhëtimi i Londrës për ta nuk qe i suksesshëm. Nuk u
ra në dorë diamanti, shkaku i dinakërisë dhe finokërisë së zo-
tit Luker, të këtij fajdexhiu të regjur. Duke pushuar menjëhe-
re nga puna bakhëpunëtorin e tyre, ua preu indianëve dorën e
djathtë. Se ai ishte i vetmi njeri që mund t'i fuste në atë shtë-
pi. Duke e çuar nguturazi diamantin te bankieri, i vuri india-
nët para detyrave të reja. E dimë, që ia morën faturën e dorëzi-
mit zotit Luker. U bindën që Guri i Hënës përsëri u rrëshqiti
nga dora. Ç'mundësi tjetër dhe kur do u krijohet kjo mundë-
si indianëve?

Sakaq m'u bë e qartë edhe përse më erdhi dje ai indianë.

— E kuptoj! — thirra. — Indianët janë të sigurt, ashtu si
edhe ne, që Guri i Hënës është lënë peng dhe u duhej afati më
i afërt kur mund të shlyhej pengu; sepse atëherë do të mund
të merret edhe diamanti nga bankieri!

— Jua thashë që vetë ju, zoti Bref, keni për t'i rënë në të,
pasi t'u kisha sqaruar diçka. Pas një viti indianët do të qën-
drojnë sogjetarë në kërkim të ndonjë mundësie të re për ta

grabitur. Zoti Luker ua bëri të ditur afatin, ju me autoritetin tuaj ia përforcuat drejtësinë e fjalëve të zotit Luker. Sipas jush, kur i ëshë dorëzuar diamanti si peng bankierit?

— Në fund të qershorit, — iu përgjigja.

— Jemi në vitin 1848. Njeriu që e ka lënë peng mund ta kthejë atë në fund të qershorit. Atë kohë do të gjendem larg Anglisë dhe të rejave të këtij vendi. Ju do të bënit mirë ta mbanit shënim këtë datë dhe të bëni çmos të jeni në Londër në këtë kohë.

— Mendoni se ka për të ndodhur ndonjë gjë serioze? — e pyeta.

— Them se ke për të qënë më larg rrezikut po të ndodheshë në fiset e egra dhe fanatike të Azisë Qendrore se sa të kalloje pragun e bankës me **Gurin e Hënës**. Indianët kanë pasur disa disfata, zoti Bref. Jam i sigurt që s'kanë për të duruar më ndonjë disfatë tjetër.

Këto qenë fjalët e fundit që më tha. Na sollën kafenë, my-safirët u çuan dhe u shpërndanë, kurse ne u ngjitëm lart te zonjat.

E mbajta shënim datën dhe s'do të ishte keq t'i përfundoja këto shënime me këto fjalë:

Qershor i vitiit 1849. Të pres njoftim për indianët në fund të këtij muaji.

Tregimi i tretë,

i shkruar nga Frenklin Bleku

1.

Pas një udhëtimi të gjatë në vendet e Lindjes, verën e vitiit 1849 vendosa të kthehesha në Londër. Në njérën nga letrat zoti Bref më bënte të ditur vdekjen e tim eti dhe që isha bërë trashëgimtar i një pasurie të madhe.

Zoti Beterexh ka shprehur tē värtetēn e shenjtē, kur ka shkruar se qeshë thellësisht i prekur nga sjellja e zonjushës Reçell dhe e braktisa Anglinë nē shkulmin e vuajtjes që provoja nga zhgënji i hidhur.

U largova jashtë shtetit me shpresën që ndërrimi i vendqendrimit dhe mungesa e gjatë do tē më ndihmonin ta harroja. Por s'më ndodhi kështu. Sa më shumë i afrohesha vendlindjes, sime dhe tē saj, sa më e afërt bëhej mundësia pér ta parë, aq më i fuqishém bëhej ai pushteti i dikurshém i saj mbi mua. Sapo u takova me zotin Bref, pyetjet e para ia bëra pör tē. Më tha, ndër tē tjera, se zonjusha Verinder banonte te motra e zotit Xhon Verinder, zonja Meridju, që ishte edhe tutore e saj.

U nisa pér nē rrugën «Portlend». Shërbëtori që më hapi derën nuk qe i sigurt nē ishte aty zonjusha Verinder. E dërgova lart me kartëvizitën time. U kthyte me një fytyrë tē padepërtueshme dhe më njoftoi se zonjusha Verindër nuk ishte nē shtëpi.

Pér këdo mund tē dyshoja se mund tē mos pranonte tē takohëj me paramendim me mua, por kurrë jo pér zonjushën Reçell. I thashë se do kthehesha aty përsëri nē ora gjashtë. Kur erdha, më thanë përsëri se nuk gjendej nē shtëpi. Vallë zonjusha Verinder nuk e mori kartvizitën time? Jo, zonjusha Verinder e mori.

E qartë: Reçelli nuk donte tē më takonte.

S'kisha si ia lejoja vetes tē trajtohesha kësisoj. Ia dërgova kartëvizitën zonjës Meridju, kjo pranoi menjëherë por as gjë s'mundi tē më shpjegojë.

Bëra edhe një provë tē fundit: i shkrova një letër. Përgjigja qe e prerë: «Zonjusha Verinder s'pranon tē ketë letërkëmbim me zotin Frenklin Blek».

Sado që e doja me shpirt, fyerja s'kishte sesi tē mos më indinjonte.

Thirra shërbëtorin dhe e urdhërova tē merrte vesh orarin e trenave dhe tē mblidhët plaçkat. Zoti Bref më pyeti i habitur, se ç'kisha ndërmend tē bëja.

— Po nisem pér nē Jorkshir, — i thashë. — Me trenin më tē afërm.

— A mund t'ju pyes pérse?

— Zoti Bref, ndihma, që në mënyrën më të pafajshme dhe të sinqertë pata dhënë për gjetjen e diamantit, doli që e paska fyer në mënyrë të tmerrshme Reçëllin vitin e shkuar dhe kjo fyerje vazhdon të ruhet. Nuk dua të pajtohem me këtë. Dua medoemos ta sqaroj, përsë nuk iu hap së jëmës, si shpjegohet ky qëndrim i saj ndaj meje. Në rast se koha, mundi dhe të hollat mund të bëjnë diçka, do e gjej hajdutin e **Gurit të Hënës!** Do nis ta ndjek çështjen aty ku është lënë, se në zinxhirin e të dhënavë mungojnë disa hallka, them se mund ta plotësojë Gabriel Beterexhi. Tek ai dhe po shkoj.

Atë mbërëmje, në perëndim të diellit, u gjenda përsëri në tarracën e njohur aq mirë të asaj shtëpie të vjetër çifligu. S'voноi dhe aty erdhi miku im i vjetër e besnik Gabriel Beterexhi.

2.

— Beterexh! — thirra. — A të shkonte në mendje vallë se son te mund të shiheshe me Frenklin Blekun?

— Për perëndi, zoti Frenklin, gjë më të bukur se ky takim nuk gjeni.

U përqafuam me mall. Prisja të më lëshonte një breshëri pyetjesh, fare të natyrshme në këto rrethana. Por jo, ndjenja e mikpritjes i ngushtoi që të gjitha në shpirtin e shërbëtorit të vjetër.

— Urdhéroni, zoti Frenklin, — më tha, duke më hapur derën *shoqëruar* nga ajo përulja *përdëllimtare* si qëmoti. — Kam kohë t'ju pyes se ç'ju solli, në fillim uluni, qetohuni, shplodhuni se vini nga rruga. Nga koha e largimit tuaj kanë ndodhur aq shumë ndryshime trishtimndjellëse. Shtëpia rri mbyllur, shërbëtorët janë shpërndarë. Po nejse! Darkën do ua përgatis unë vëtë. e shoqja e kopshtarit do t'ju shtrojë shtratin, kurse në bodrum do të na gjendet ndonjë shishe me verë të mirë. Urdhéroni, zotëri, mirë se erdhët!

M'u dhimbë që do më duhej ta zhgënjeja. Se kjo shtëpi i përkiste Reçëllit. A mundesa vallë të haja e të pija aty pas gjithë asaj që më ndodhi në Londër? Ndjenja më e thjeshtë e

respektit ndaj vetes ma ndalonte të bëja qoftë edhe një hap drejt kësaj shtëpie.

E mora Beterexhin nga krahu dhe e çova në kopsht. S'ki-sha si ia bëja, duhet t'ia zbulloja të vërietën. Na donte shumë, si mua ashtu edhe Reçëllin, dhe ishte hidhëruar singerisht nga kjo perrupi e punëve.

— Zonjusna heqell nuk është pa të meta, e kam thënë edhe më parë këtë, — filloi. — Hera-herës ngul këmbë më shumë se ç'duhet në të sajën. Kështu po bën edhe për këtë punën tuaj. Pse ende s'i paskeni njohur gratë, zoti Frenklin? Sidoqoftë ur-dhëroni brenda!

— Mbrëmja është e një bukurie të rrallë, — i thashë — kështu që avash-avash po shkoj deri në Frizingol, do zë aty hotel dhe nesër në mëngjes jeni i ftuar të hani bashkë me mua. Dua tju them diçka.

— Më vjen shumë keq për të gjitha këto, por s'keni pse shkoni aq larg, dy hapa që këtu ndodhet ferma e Hoterstonë-ve, aty dhe mund të rregulloheni fare mirë.

— Ka dhoma të lira?

— Vetë zonja Hoterston më ka porositur t'i gjej myshterinj.

— Mirë atëherë, Beterexh, aty po vendosem.

Beterexhi mori një hu, e kaloi në dorezën e valixhes dhe e hodhi në sup. Shihte i habitur dhe i hutuar nga shtëpia, pastaj nga unë.

— S'ma ka marrë mendja se do të vinte një ditë, zoti Frenklin, që kjo alamet shtëpie të jetë këtu pranë, kurse zoti Frenklin t'i kthejë shpinën dhe të zërë dhoma me qira!

Kur po i afroheshim shtëpisë së Hoterstonëve, Beterexhi ndaloi dhe më tha:

— Aty pari apo thatë se keni diçka për të më thënë. Në nuk është sekret, zotëri, s'më durohet ta di që tani, ç'ju solli vallë këtu aq pa pritur e pa kujtuar?

— Ajo që më solli edhe herën e shkuar, — i thashë.

— Guri i Hënës, zoti Frenklin?

— Po, Beterexh.

Plaku shtangu dhe po më shihte si të mos u zinte besë veshëve.

— Nëse jeni duke bërë shaka, zotëri, druhem se qënkam

matufepsur nga pleqëria. S'po arrij dot t'ju kuptoj.

— Nuk po bëj shaka, — iu përgjigja. — Erdha pér të vijuar hetimet e ndërprera, kur ika nga Anglia. Erdha të bëj atë që deri më sot s'e ka bërë dot njeri: të zbuloj kush e vodhi diamantin.

— Do të bënët mirë ta harronit atë diamant, zoti Frenklin! Më dëgjoni mua! Kush bëri të merret me atë diamant të mallkuar, ngeli me gisht në gojë. Mos i harxhon i kot së koti, as paratë e as forcat, zotëri. E si mund të keni ndonjë shpresë, kur vetë dedektivi Kaf ngeci dhe u ngatërrua mosmëkeq? Dedektivi Kaf! — përsëriti Beterexhi, duke tundur gishtin tregues. — Dedektivi më i famshëm në tërë Anglinë.

— Vendimi që kam marrë është i formës së prerë, or mik. As dedektivi Kaf s'më bën dot të heq dorë. Por, me që ra fjala, do vijë një ditë që do të më nevojitet këshillimi me të. Dini gjë ku ndodhet?

— Kaf s'ka pér t'ju ndihmuar, zoti Frenklin.

— E pse?

— Kafi i famshëm, pas atij largimit tuaj, kërkoi të dilte në lirim. Ka zënë një vilë në Darking dhe ditë e natë merret me kultivimin e trëndafilave. Më ka shkruar vetë pér këtë.

— Po mirë atëhere, — iu përgjigja. — Do bëj si do bëj edhe pa ndihmën e dedektivist Kaf. Si fillim do më duhet t'ua besoj juve punët e mia.

Ndoshta këto fjalë i fola si pa sajdi. Sidoqoftë diç nuk i pëlqeu Beterexhit në ato që thashë dhe si i thashë.

— Juve mund t'ju duhet t'ua besoni ato edhe ndokujt tjetër, zoti Frenklin, — mërmëriti qejfprishur.

Mënyra si e tha këtë dhe pasiguria që iu ndie në zë, më lanë të mendoj se dispononte ca lajme që s'po vendoste të m'i bënte të ditura.

— Ju mand të më ndihmoni të bije në gjurmë të të dhënavë që kanë rrëshqitur nga fusha e shikimit të dedektivist Kaf. Jam i bindur që ju këtë jeni në gjendje ta bëni.

Beterexhi s'po vendoste. Mendova t'i drejtohem ndikimit përmes ndjenjës së madhe që ushqente pér zonjushén Reçell dhe pér mua.

— Beterexh, a do të gëzoheshiit po të na shihnit në marrëdhëni e miqve të mirë mua dhe Reçellin?

— Në rast se ruani qoftë edhe dyshimin më të vogël, zotëri, atëherë unë i paskam shërbyer keq familjes suaj tërë këtë vite.

— A ju kujtohet qëndrimi që mbajti ndaj meje Reçelli para se të largohesha nga Anglia?

— Aq shkoqur, si të kishte ndodhur dje. Dhe as zonja Verinder e as unë nuk arritëm dot ta kuptionim arsyen.

— Ashtu është, Beterexh. Edhe tani që u ktheva, e gjeta Reçellin po aq të fyer si dhe më parë. E kam ditur qysh vitin e shkuar se shkaktar u bë diamanti, e di këtë edhe tani. Provova të bisedoj, s'më pranoi. Provova t'i shkruej, s'më ktheu përgjigje. A s'më thoni, emri i Zotit, si ta kuptoj tërë këtë? Ka vetëm një rrugë: të mësoj të vërtetën për zhdukjen e Gurit të Hënës.

Këto fjalë, me sa duket, e detyruan të shohë tërë çështjen me një sy tjetër. M'u drejtua me një pyetje që tregoi se, fundja më në fund, e kisha bërë të tundej nga vendi.

— Nuk është se keni ndonjë paramendim të keq për të, zoti Frenklin?

— Qesh i zemëruar kur ika nga Londra, por tani më kaloi, — iu përgjigja. — Dua të paktën ta detyroj Reçellin që të shpjegoj.

— Po ta zëmë se diç do zbuloni, zotëri; a nuk druheni se pas këtij zbulimi mundet diç të mësoni për zonjushën Reçell?

E kuptova se i tha këto nga besimi i pakufishëm që kishte te zonjusha e tij.

— I bsoj asaj po aq sa dhe juve, — iu përgjigja. — Edhe zbulimi i plotë i të fshehtës s'ka për të ndikuar asfare në atë respektin tuaj dhe timin për të.

Pavendosmëria e Beterexhit pas këtyre fjalëve u zhduk si vesa para diellit mëngjesor.

— Atëherë po përpinqem t'ju tregoj rrugën drejt këhjelli-mit të çështjes dhe, sa për të ecur në të, ecni vetëm me këmbët tuaja. A ju kujtchet ajo mjerania, shërbëtorja jonë Rozana Spirmani?

— Sigurisht.

— Ju kurdoherë patët dyshuar se diç kërkonte t'ju njoftonte për Gurin e Hënës.

— Ndryshe s'kisha si e shpjegoja atë sjelljen e saj të çuditshme.

— Po të dëshironi, zoti Frenklin, mund t'i davarisni dyshimet tuaja.

E pashë i hutuar. Bëra t'ia shihja shprehjen e fytyrës në atë gjysmerrësirë. I habitur sa më s'bëhet, e pyeta me padurim, ç'donte të thoshte me këtë.

— Rozana Spirmani, zotëri, ju ka lënë një letër.

— Ku gjendet?

— Te shoqja e saj në Kobs-Holl, te çalashja Lusí.

— E bija e peshkatarit?

— Po, ajo, zoti Frenklin.

— E përse nuk e morët?

— S'pranoi, zotëri. Do t'ua japë vetëm dorazi. Ju ikët shpejt dhe nuk arrita t'ju shkruaj.

— Shkojmë qysh tanë ta marrim, Beterexh!

— U bë vonë, zotëri. Peshkatarët kursejnë qirinjtë dhe bien herët.

— Shkojmë, pas një gjysmë ore do jemi në vend.

— Ka rrezik të gjejmë derën të mbyllur me lloz, zotëri. Ja ku mbërritëm në fermë. Kaloni mirë e bukur natën këtu dhe nesër me ditë vemi.

— Edhe ju do të vini me mua? Herët në mëngjes.

— Domosdo, zotëri

3.

Edhe pse ora e mbërritjes ishte e hershme, e shoqja e peshkatarit po vinte vërdallë nëpër kuzhinë. Kur më prezantoi Beterexhi, zonja Jolland m'u përkul tërë respekt që ia bënte vetëm miqve më të nderuar. Vuri mbi tryezë një shishe xhin hollandez, dy çibukë dhe e hapi bisedën kështu:

— Ç'të reja kemi nga Londra, zotëri?

S'arrita dot as ta nisja tregimin për t'iu përgjigjur një pyetjeje aq të gjerë, kur në qoshen gjysmë të errët të kuzhinës lëvriu një vajzë kockë e lëkurë me ca flokë jashtëzakonisht të bukur që, duke u mbështetur mbi një patericë, zuri të afrohej te tryeza ku isha ulur dhe më shigjetoi me një shikim tmerrësisht zemërak; dukej që s'po e honepte dot praninë time aty,

por edhe nuk m'i shqiste dot sytë si e magjepsur.

— Zoti Beterexh, — tha, duke vazhduar tē më shohë, — ju lutem, përsëriteni edhe një herë emrin e këtij njeriu.

— Këtë zotëri, — i foli Beterexhi, duke e vënë mirë theksin në fjalën «zotëri», — e quajnë Frenklin Blek.

Vajza më ktheu shpinën dhe doli nga dhoma. Zonja Jolland, si shpirtmirë që ishte, zu tē kërkojë falje për sjelljen e së bijës. Veç këtë po e them me hamendje se me tërë qënien time po përpinqesha ta kuptoja ç'donte tē bënte çalamania. U kthye sakaq por me një letër ndër duar. Seç më bënte ca shenja. U ngrita dhe dola pas saj. Më çoi te ca barka peshkimi, ku tē mos na shihte kush, tē mos na dëgjonte kush. Aty më ndali e më pa drejt në sy.

— Po e shoh që keni për mua një letër? — e pyeta.

— Pa përsëriteni edhe një herë atë që më thatë, — më ktheu aty për aty.

Si ai fëmija i dëgjueshmë ia përsërita.

— Jo, — tha vajza si duke folur vetë me veten, por pa më shqitur atë shikimin drejt në sy. — As që mund ta kuptoj ç'gjeti te ky tē veçantë, ç'zëra i folën me atë zërin e këtij?...

Më ktheu vrulltas shpinën dhe pështeti kryet mbi patricë.

— Mjeraneja, — tha pastaj me mallëngjim. — Shkoi e vate kot së kot! E ç'gjeti vallë tē pazakontë te ky njeri!

Ngriti përsëri kryet dhe më pa e egërsuar.

— A ju bën zemra tē hani e tē pini? — më pyeti.

Bëra ç'ishte e mundur për tē ruajtur seriozitetin dhe iu përgjigja.

— Po.

— A ju zë gjumi natën?

— Po.

— Kur shihni ndonjë shërbëtore tē varfër, a nuk provoni vrasje ndërgjegjeje?

Befas më vërviti letrën në fytyrë.

— Merreni! — bërtiti frenetike. — Është hera e parë që ju shoh. Mos e dhëntë Zoti t'u shohë herë tjetër!

Ashtu çalë-çalë u largua aq shpejt sa më s'bëhet. Vetë me vete thashë atë që do tē thoshte kushdo, në këmbën time: qënka e çmendur.

«Zotit Frenklin Blek. T'i jepet në dorë (të mos i besohet kërkujt) nga Lusi Jolland».

E hapa zariin dhe lexova në fillim një pusullë, pastaj tërë letrën. Ja ç'shkruhej në pusullë:

«Zotëri, në jeni kurreshtar të dini ç'kuptim kishte ajo sjeillja ime gjatë kohës që ju ishit mysafir në shtëpinë e zonjës time Verinder, bëni ashtu si do mësoni nga letra dhe bëjeni këtë pa praninë e dikujt tjetër. Shërbëtorja që ju përulet me adhurim.

Rozana Spirman.»

Ja dhe letra:

«Të shkonit te «Rëra e Tallazitur» para se të fillojë batica. T'i afroheni Mollokut Jugor deri sa flamuri në qëndrën doganore dhe fanari i Mollokut Jugor të formojnë një vijë të drejtë. Të vini një shkop mbi shkëmb që të shënoni vijën që bashkon fanarin dhe flamurin e doganës. Kjo duhet bërë në mënyrë që fundi i shkopit të ndodhet në atë anë të shkëmbit që sheh në drejtim të «Rërës së Tallazitur», të rrëmohen me dorë leshterikët përgjatë shkopit, për të gjetur zinxhirin. Me ta gjetur, të kalchet mbi zinxhir dora te vendi ku ai varet në buzë të shkëmbit, poshtë «Rërës së Tallazitur» pastaj të tèrhiqet zinxhiri».

S'arrita ta lexoja deri këtu, kur dëgjova të më thërriste Beterexhi, që s'po e mbante vendi gjatë tërë kësaj kohe. Iu afrova dhe i zgjata në fillim pusullën. E lexoi pa shfaqur ndonjë interes të veçantë. Sapo i dhash letrën, u zhyt në të dhe e lexoi me një frymë.

— Këtë edhe dedektivi e pat thënë, — thirri Beterexhi. — Tamam kështu e pat parashikuar. Aty dhe fshihet misteri që na bëri të gabohemi që të gjithë, madje edhe famëmadhin Kaf! Ja ku po ju pret ta zbuloni, zotëri! Tani është kohë zbatice, zotëri. Edhe sa duhet të fillojë batica?

Ngriti kokën dhe pa jo larg nesh një peshkatar të ri që po qepte rrjetat.

— Tomi Brejt! — i thirri me sa i hante zéri.

— Urdhëroni! — ia ktheu ky.

— Kur fillon batica?

— Pas një ore.

Pamë që të dy orën.

— I bjemë më mirë rrretherreh bregut për të arritur te «Rëra e Tallazitur», zoti Frenklin, — tha Beterexhi. — Kemi kohë. Si thoni, zotëri?

— Shkojmë.

E gjetëm atë vendin ku shihej në një vijë të drejtë fanari me flamurin e doganës. Bëmë siç udhëzonte letra për punën e shkopit dhe të drejtimit dhe pritëm sa të vinte koha. Duheshin edhe njëzetë minuta. I thashë të uleshim diku në bregun e thatë e të prisnim kohën. Kur dolëm, Beterexhi, për habinë time të madhe, më ktheu krahët dhe vazhdoi të ecte sa më larg meje.

— Ku po shkoni? — e pyeta.

— Pa lexojeni mirë atë letrën, aty thuhet që këtë zbulim ju duhet ta bëni duke qënë vetëm. S'e kam të lehtë ta bëj këtë, por ajo mjerane pati një vdekje të lemerishme dhe e ndiej veten të detyruar, zoti Frenklin, t'ia çoj në vend kërkesën e fundit. Shkoni vetëm. Ama në letër s'thuhet as edhe një fjalë që ju ta mbani të fshehtë zbulimin që po bëni. Po ju pres, ja atje, tek ai pylli me bredha. Ejani sa më shpejt, zotëri. Mezi që ju pres.

Me këtë porosi që më la u nda nga unë.

Sado e shkurtër koha e pritjes, në kësi rastesh të duket e pafund. Ishte një nga ata rastet, kur zakoni që nuk ka të çmuar i duhanit të duket veçanërisht i shtrenjtë dhe ngushëllues. Ndoza një cigare dhe u ula në bregun e pjerrët.

Dielli i jepte një bukur të veçantë mjedisit. Ajri ishte aq i freskët, saqë të rrije e të dihasje ishte në vetvete një kënaqësi e madhe. Madje edhe ai gjii aq shumë vetmitar dhe i vogël e pëershëndeste gazplot mëngjesin dhe sipërfaqja e lagësht e «Rërrës së Tallazitur», duke vezulluar si e praruar, fshihte tërë tmerrin brenda vetes përmes kësaj buzëqeshjeje kalimtare. Ishte dita më e bukur nga koha që qesh kthyer në Angli.

Batica filloj para se të mbaroja cigaren. Pashë si zuri të ngrihej rëra, pastaj si u lëkund dhe u dallgëzua në mënyrë të

tmerrshme sipërfaqja, si të ishte shkiftuar ai shpirti i keq i fshehur aty brenda, në atë thellësi të pafund. E flaka cigaren dhe iu afrova shkëmbinje.

Letra më udhëzonte të prekja nën leshterikët përgjatë bastunit, duke filluar nga ana që ishte më afër fenerit. Bëra kështu deri te gjysma e bastunit, por nuk gjeta kurrgjë përveç formacioneve shkëmbore. Rrëmova më tej, dhe durimi mori shpérblimin e merituar: në një të çarë të ngushtë të shkëmbit, pikërisht aty ku arrinte gishti tregues, preka zinxhirin. Kur u përpoqa ta ndjek me dorë, u ngatërrova me një kokolepsje leshterikësh që ishin depozituar, sigurisht, pasi aty e kishte fshehur Rozana atë kutinë metalike.

Ishte e pamundur t'i shkulje apo të fusje përmes tyre dorën. Fytirën e kisha në nivelin e «Rërës së Tallazitur» që vazhdonte të dallgëzohej e të gulçonte. Një mendim i llahtarshëm që e vdekura mund të fanitej në vendin e vetvrasjes për të më ndihmuar ta gjeja kutinë, një tmerr i pashlyeshëm që nga casti në çast ajo mund të ngríhej mbi rërën e dallgëzuar dhe të më tregonte vendndodhjen, më pushtoi të tèrin dhe më kalli datën: zura të dridhem, ndonëse rrezet e diellit nxehnin për bukuri. Nisa të kérkoj vazhdimin e zinxhirit, duke futur bastunin në leshterik. Më ndihu fati, fundi i bastunit ndeshi shpejt me zinxhirin.

E nxora atë pa më të voglën vështirësi. Fundi i tij qe mbërthyer në kutinë metalike. Çdo gjë e kishte mbuluar ndryshku. E vura kutinë midis gjunjëve dhe ia shpértheva kapakun. Gjeta brenda diçka të bardhë, e preka me dorë, ishte cohë e bardhë. Duke provuar ta nxjerrë, doli edhe një letër e zhobravit. E pashë adresën, më drejtohej mua. Ruhej për bukuri. E vura cohën mbi rërën e thatë, e shpalosa dhe e shtrova me dorë. Ishte këmishë nate burrash. Kur e ktheva në anën e prapme, pashë në të njollën e bojës, me të cilën qe lyer déra e dhomës së gjumit të Reçëllit!

Ia ngula sytë kësaj njolle, kurse mendimet sakaq më fluturuat në të kaluarën. M'u kujtuan qartë ato fjalët e dedektivit Kaf: «Gieni në këtë shtëpi rröben e zhyer me të tillë boje. Mësoni e kujt eshtë. Pyeten si e shpjegon hyrjen në atë dhomë, pas dërës të së cilës qe zhyer, ndërmjet orës dy mëdha jetë dhe orës tre të natës. Nëse s'ka për të dhënë shpjegime të kë-

naqshme, s'duhet shkuar larg për të gjetur dorën që e ka vjetdhur diamantin».

U përmenda nga kjo gjendje shoku, që m'u duk se zgjati disa orë, kur nuk kishin kaluar veçse disa minuta, kur dëgjova të më thërriste zëri i Beterexhit, që s'po e mbante më vendi. Po vinte drejt meje.

Pamja e plakut më solli në vete: e kisha gjetur njollën në këmishënaten, po e kujt ishte ajo? Thashë me vete se në të është ruajtur, me siguri, emri i të zotë. E ngrita dhe zura ta kërkoj. E gjeta dhe lexova... emrin tim!

Po, kjo këmishënatë është imja. I shkëputa në çast sytë dhe ia ktheva diellit, ia ktheva ujrave përshkënditës të gjirit, ia ktheva plakut Beterexh, që sa vinte e po më afrohej...

Pashë përsëri emrin e shkruar në atë këmishë. S'kishte asnjë dyshim, ishte emri im!

«Në rast se koha, mundi dhe paratë janë të zonjat ta bëjnë, kam për ta zbuluar vjedhësin e «**Gurit të Hënës**», — me këto fjalë në gojë qeshë larguar nga Londra. Kisha depërtuar në atë fshehtësi që «Rëra e Tallazitur» e kishte fshehur nga të gjithë të vdekshmit. Dhe dëshmja e pakundërshtueshme — njolla e bojës në këmishën e natës — më çoi në përfundimin se vjetdhësi isha unë, dora vetë!

4.

E çmund të them për ndijimet që provaja. Goditja që aq e fuqishme sa më paralizoi të tèrin. Kuuptohet që e kisha humbur vetëdijen sepse, sipas fjalëve të Beterexhit, qesh duke u zgërdhirë, kur më qe afruar dhe më kishte pyetur, si qëndronte puna; pasi i kisha rrasur në duar këmishën e natës, i kisha thënë që ai vetë ta zbulonte të vërtetën.

As që e kam idenë e bisedës që kemi bërë në bregun e detit. Më ndërmendet vetëm rrugina përmes postateve të trëndafilave. Ishim duke u kthyer për në shtëpi dhe Beterexhi më tha se, pas një gote të mirë konjaku, edhe unë edhe ai do të jemi në gjendje t'i shohim gjérat esëll.

E mora nëpër këmbë atë vendimin për të mos shkelur në shtëpinë e Reçellit. Pas gotës me konjak, nervat sikur na erdhën në vete: zumë i shohim gjérat ashtu siç ishin.

Druhem se ky rërshkim i gjendjes sime ka për t'iu dukur lexuesit disi i çuditshëm, për të mos thënë diçka më tepër. Pse a mund të priteshin ca veprime si këto nga një njeri si unë të gjendur në një situatë aq të tmerrshme?

Mund të them vetëm se pamja e plakoshit Beterexh ishte për mua një ngushëllim që s'kishte çmim dhe konjaku që më dha më ndihmoi aq shumë saqë asgjë tjetër s'do më ndihte të dilja nga kjo shtangje trompoze dhe shpirtërore. Vetëm këtë mund të them për të përligjur veprimet e mia.

— Tani një gjë e dimë saktë, zoti Frenklin, — më tha Beterexhi, duke vërvitur këmishën e natës mbi tryezë dhe duke ma freguar sic tregojmë një qenie të gjallë që këtë e dëgjoi: — Dimë që kjo këmishë gënjen.

Ky këndshikim qetësues i çështjes mua aspak nuk më qetësoi.

— Unë s'jam fajtor në vjedhjen e diamantit po aq sa s'jeni dhe ju, — i thashë. — Por kjo këmishë është dëshmi kundër meje! Edhe njolla, edhe emri im në këtë këmishë përbëjnë faktë.

Beterexhi e mori gotën nga tryeza dhe ma futi në dorë.

— Përbëkan fakte? — përsëriti. — Pa kthejeni edhe një zoti Frenklin, dhe keni për ta kapërcyer atë dobësinë, që ju detyron t'i besoni faktave. S'është e pastër kjo punë, zotëri, — vazhdoi me zë të ulët. — Ja si e shoh unë këtë: s'është e pastër kjo punë dhe të dy duhet ta hetojmë. Në atë kutinë metatile nuk kishte ndonjë gjë tjetër?

Pyetja më bëri të kujtoj zarin që e kisha në xhep. E nxora, e hapa. Kishte vetëm disa faqe letre të shkruara me gërmë të vockëla. Pashë shpejt e shpejt nënshkrimin: «Rozana Spiman».

Atë çast m'u kujtua që Rozana Spimanishte pajtuar te tetova që nga shtëpia e edukimit, se më parë kishte qënë hajdute. Ia thashë këtë Beterexhit.

— Ato që thatë janë të vërteta. po ku doni të dilni, zoti Frenklin?

— Si kështu «ku dua të dalë»? Ku i dihet, ajo dhe mund ta ketë vjedhur diamantin? Ajo me paramendim mund ta ketë zhyer me bojë këmishën time të natës?

Beterexhi më vuri dorën mbi timen dhe s'më la të vazhdoja.

— Ju siguroj, zoti Frenklin, që do ta gjeni mënyrën si ta vërtetoni pafajsinë tuaj, veç jo në këtë rrugë. Pa të shohim çështë shkruar në atë letër. Le t'u bëjmë nderimet e nevojshtme të vdekurve.

Serioziteti, me të cilin u thanë këto fjalë, ushtroi mbi mua efektin e qortimit.

— Po e lexoj me zë të lartë që edhe ju të gjykon pér gjithë sa shkruhet, — i thashë.

Lexova sa më poshtë:

«Zotëri, më duhet t'u rrëfehem; ndonjëherë rrëfimi zeher i hidhur mund të bëhet edhe me pak fjalë. Rrëfimi im përbëhet nga tri fjalët: ju dashuroj...»

Letra më shkau nga duart. Pashë Beterexhin. E vura re që s'ia kishte ëndë të më përgjigjej.

— Do të ishte më mirë të vazhdonit leximin e letrës, zotëri. Pa të dëgjojmë çdo të na thotë ajo vetë pér veten e saj, zotëri.

Iu ktheva përsëri letrës:

«Të isha gjallë, s'do të guxojë t'ua thosha, por s'do të jem më, kur t'ju bjerë në dorë kjo letër. Ndaj dhe kuturisa.

Do të gjeni në kutinë metalike këmishënatën tuaj të zhyer me bojë, do të keni dëshirë të mësoni si e fsheha dhe përsë nuk ju thashë as edhe një fjalë. Çdo gjë e bëra ngaqë ju dashuroj.

Historia e jetës sime ngjan shumë me ato që tregohen rëndom nëpër gazeta. Mund të shkruaja faqe të tëra pér ndjenjat e embla që provova kur ju pashë, pér xhelozinë përvëluese ndaj zonjushës Verinder, pér drithërimat dhe lotët që më shkoni curg sa herë që ju shihja.

Po të hidhemi te çështja që ju intereson aq shumë, te zhdukja e diamantit.

Zoti Sigrev, kur na mblođhi në dhomën e zonjushës Reçell, na e bëri të ditur vendin ku qe fshirë boja nën çelësin e derës. Na qortoi se e kishim fshirë bojën me fundet tona. E

pashë edhe unë fustanin mos më qe bërë me bojë, më pa edhe Penelopa Beterexhi, e vëtmja nga shërbëtoret me të cilën mba-ja marrëdhënie miqësore.

— S'ke pse merakose, Rozana, — më tha, — boja ka disa orë që është tharë.

— E nga e dini ju këtë ? — e pyeta.

— Dje tërë mëngjesin kam qënë me zotin Frenklin dhe më zonjushën Reçell, kam trazuar bojën. E dëgjova me veshët e mi zotin Frenklin, kur tha se do të jetë e thatë jo më parë se pas dympëdhjetë orëve. Pra aty nga ora tre e mëngjesit dera ka qënë e thatë.

— Po mos e kanë fshirë zonjat që mund të kenë qënë përvizitë te zonjusha Reçell? — e pyeta.

— S'ka sesi, — m'u përgjigj Penelopa. — Kur dola në ora dympëdhjetë nga dhoma e zonjushës Reçell; pasi qe rehatuar në shtrat, e pashë atë derën dhe në të nuk kishte njollë.

Me këto fjalë dhe u ndamë!

Detyra ime, zotëri, ishte t'ju shtroja shtratin dhe t'ju pastroja dhomën. Kjo ishte ora ime më e lumtur e ditës. Përqafoja dhe puthja jastëkun ku qe prehur koka juaj, ledhatoja plaçkat e garderobit tuaj... Por të vazhdojmë atje ku e lamë.

Zura të vë rregull në dhomën tuaj, ngrita dhe këmishnatën tuaj, të hedhur pa kujdes mbi krevat, kur syri më shkoi te njolla e bojës në të, pikërisht e asaj bojës me të cilën ishte lyer dera e zonjushës Reçell!

U tremba sa më s'bëhet, e rrëmbeva dhe vrapova për në dhomën time, e mylla derën me çelës, që ta kqyrja më nge. M'u kujtua biseda me Penelopën, thashë me vete: «Ja dëshmia që ai ka qënë në dhomën e zonjushës Reçell ndërmjet orës dympëdhjetë dhe orës tre!»

Kuptohet se për ku më shkoi mendja, por shpejt u qetësova: po të ishit treguar aq kokëkrisur e t'i kishit shkuar natën në dhomë zonjushës Reçell, vetë ajo do ju kishte paralajmëruar të kishit kujdes derën që të mos binte në sy vajtja tek ajo natën. Vendosa ta mbaja në dhomën time këmishnënatën tuaj dhe të prisja zhvillimin e mëtejshëm të ngjarjeve. Sakaq ju si-guroj se as në mendje nuk më shkonte që të ishit ju ai që e vodhi diamantin...»

E ndërpresa përsëri leximin e letrës.

Kur shkruante pér ndjenjat që kishte pér mua më dhimb-sej sinqerisht ajo vajzë, ndjeja keqardhje që kisha hedhur hije dyshimi mbi emrin e saj. Por kur lexova ato fjalët me dyshimin pér mua si vjedhës, me zor po e pérmbaja inatin dhe zemërimin kundër Rozana Spirmanit.

— Lexojeni ju vetë pjesën tjetër, — i thashë Beterexhit, duke ia zgjatur letrën. — Po të ketë ndonjë gjë që më duhet ta di, ma thoni vetë.

— Ju kuptoj, zoti Frenklin, — m'u përgjigj.

Po e kopoj nga origjinali vazhdimin e asaj letre:

«Duhej menduar që ta fshihja sa më mirë atë këmishë. Kishte vetëm një rrugëdalje; të qepja një të re tamam si ajo, para ditës së shtunë, kur vinte rrobalarsja dhe mblidhë ndërresat, pasi i kishte regjistruar në regjistër. Kisha frikë ta lija punën pér të premten; kushedi c'mund tē ndodhë, dhe vendosa ta kem gati këmishën e re që atë ditë. Por duhej kthyer njéherë në dhomën tuaj tē gjumit jo aq pér të përfunduar pastrimin (atë mund ta bënte edhe Penelopa, po t'i lutesha) po pér të parë mos kishit bërë me bojë diku çarçafët apo orenditë. Pashë me kujdes dhe gjeta ca gjurmë boje në pizhamat tuaja. Meqë keni mbërdhihur, keni veshur edhe pixhamet. I fshiva me kujdes. Pra e vettja gjë që fliste kundër jush mbeti këmishë-nata që e kisha kyçur në komo. Pas zemërimit të Penelopës që ishte indinjuar nga dyshimi i inspektorit Sigrev pér vjedhjen e diamantit, vetëm nga shkaku që paska dalë e fundit nga dhma e Recëllit, më shkoi mendja te ju që kishit qënë pas Penelopës në atë dhomë. U trondita tmerrësisët shumë se e kuptova që ajo këmisha e zhyer mund tē kishte domethënënie krejt tjetër.

Thashë me vete se, duke patur në dorë shpëtimin tuaj nga turpi i pashmangshëm, do të gézoja edhe dashamirësinë tuaj. Pas dreke u shtira si e sëmurë dhe dola pér të blerë cohën si ajo e këmishënatës suaj, e qepa pér tërë natën, dhe ditën e grumbullimit tē ndërresave çdo gjë ishte në rregull. Tani s'kisha më asnjë frikë edhe sikur t'i kontrollonin ndërresat në shtëpi...».

Këtu Beterexhi ngriti sytë nga letra.

— Asgjë shpresëdhënëse nuk po shoh pér punën e zhdukjes së diamantiit, zotin Frenklin, — tha.

— Vazhdoni tē lexoni letrën, zoti Beterexh, kushedi nga

fundi mund tē ketē ndonjē tē dhënë shpresëndjellëse. Atéherë do ju shpreh edhe mendimin tim.

— Shumë mirë, zotëri. T'i lëmë një grimë sytë tē pushojnë. S'dua t'ju ngut, zoti Frenklin, por qoftë edhe me disa fjalë; a s'më thoni, ç'rrugëdalje keni gjetur tek kjo kashelashë?

— Do nisem pér në Londër, — i thashë, — do këshillohem me zotin Bref. Në qoftë se s'më ndihmon dot, dhe dedektivi Kaf s'pranon ta braktisë vetminë e tij në Dorking... atéherë, Beterexh, me sa shoh deri më tanë, mundësitë janë fare tē shteruara.

Ndërkohë u dëgjuan tē trokitura në derë. Fytyra e Beterexhit shprehu edhe habi, edhe pakënaqësi që po na pengonin.

— Hyni, — thirri disi i nxehur. — Hyni!

Dera u hap dhe qetë-qetë hyri një njeri me një pamje disi tē veçantë, tē rrallë. Nga lëvizjet dhe paraqitja dukej që ishte në moshë tē re. Ish zijosh si cigan, faqet e fishkura i kishte tē rëna, mollëzat dhe nofullat i kishte tē dala. Hundën e kishte tē drejtë, tē bukur, siç haset réndomë në banorët e Lindjes. Ballin e kishte tē lartë plot me zhubra që zbrisnin edhe poshtë nëpér fytyrë. Në këtë fytyrë tē çuditshme edhe më tē çuditshëm ishin sytë gështenjë tē kadifenjtë, pikëllimtarë dhe tē mendueshëm, tē futur thellë në zgavra. Kur tē shihnin, tē detyronin t'i përkushtoje vëmendje (të paktën kjo kështu ndodhi me mua). Shtoni këtu edhe kreshtën e flokëve tē dendur, tē qethur kare, tē një ngjyre tē çuditshme, thuajse tē papërcaktueshme. Vetëm në çakë kishin ruajtur ngjyrën e tyre tē dikurshme korb tē zezë. Në tëmtha ata qenë fare tē bardhë, duke formuar kësijoj një kontrast tē pazakontë. Ia ngula shikimin kurreshtar këtij njeriu, më vjen turp ta them, por s'po gjeja forma që ta përbaja veteñ. Sytë e tij bojë kafe tē butë më shihnin me ëmbëlsi, shikimit tim tē ngulur dhe tē habitur iu përgjigj duke më kërkuar ndjesë, tē cilën, isha i bindur pér këtë, aspak nuk e meritoja.

— Më falni, — tha. — S'e dija që zoti Beterexh qënka i zënë. Lista pér javën e ardhshme, — shqiptoi.

Më pa përsëri dhe doli nga dhoma po aq heshturazi siç hyri.

— Kush është ky, — e pyeta.

— Ndihmësi i zotit Kandi, — m'u përgjigj Beterexhi. — Do ju pikëlloja po t'ju njoftoja, zoti Frenklin, që doktori shtatvogël nuk e ka marrë veten pas asaj sëmundjes që mori kur po kthehej pas darkës me rastin e ditëlindjes së zonjushës Reçell. Veten s'e ndien dhe aq keq, por ka humbur kujtesën pas etheve të forta që kaloi. Punët e shërbimit mjekësor i ka marrë mbi vete ndihmësi. Pacientët u larguan, kanë mbetur ca të vobek-të; se ata s'kanë ç'të bëjnë, janë të detyruar të pranojnë shërbimet e këtij balashi.

— Me ç po shoh, s'e honepskeni atë, Beterexh?

— Askush s'e do atë, zotëri.

— E pse vallë?

— Po ja edhe pamja flet kundër tij. Qarkullojnë dhe zëra që Kandi e paska pranuar në klinikën e vet edhe pse nuk paska nam të mirë. Askush nuk e di se nga éshtë. S'ka as edhe një mik në këto anë. E si të flitet mirë pas tërë kësaj?

— Epo, domosdo. Po a mund të ma thoni pse erdhi t'ju takonte. Ç'është ajo letër që ju dha?

— Më solli listën e të sëmurëve që kanë nevojë për verë, zotëri. Se zonja gjithmonë u ka dhënë falas verë të sëmurëve të vobektë, edhe zonjusha Reçell ka dëshirë ta vazhdojë këtë traditë. Po kanë ndryshuar kohët! Më kujtohet si zoti Kandi me dorën e tij ia jepet vetë listën zonjës. Kurse tani ndihmësi i zotit Kadi ma dorëzon mua. Po, në më lejoni zotëri, ta vazhdoj leximin e asaj letrës, — tha Beterexhi dhe mori përsëri letrën e Rozana Spirmanit. — S'është ndonjë qejf, por sidoqoftë s'më le të pikëllohem, duke e çuar mendjen tek e kaluara.

Vuri syzet dhe tundi i dëshpëruar kryet.

Ndihmësi i zotit Kandi më pataksi. Para se Beterexhi t'i kthehej asaj letrës, e pyeta.

— Po si e ka emrin ky ndihmësi?

— Ka një emër shëmtirë, — m'u përgjigj zymtak Beterexhi. — Ezra Xhenings.

5.

Ndërkohë që Beterexhi u mor me leximin e letrës së Rozana Spirmanit, përpunova me mendjen time planin e vepri-meve në të ardhmen: të kthehesha në Londër, të takoja Brefin,

dhe, kryesorja, të arrija të bisedoja kokë më kokë me Reçëllin. Kishite mbetur vetëm një orë nga nisja e trenit të Londrës, shkoja me shpresë që Beterexhi të gjente në atë letër diçka që do më qe e dobishme para se të largohesha nga shtëpia ku ishte zhdukur diamanti. Ndaj dhe vendosa të prisja që të mbarohej së lexuari letra. Ja ç'skruhej në myllje të saj.

«Mos m'u zemëroni, zoti Frenklin, që ngadhnjeva ndopak, kur mësova se e ardhmja juaj gjendej në dorën time. Kjo s'më zgjati shumë: meraku dhe frika për ju m'u kthyen shpejt. Duke e ditur që dedektivi Kaf mund të ndërmerrete kontrollin e ndërresave, do të kontrollonte edhe tuajat. Në tërë shtëpinë, për mendimin tim, s'gjendej dot ndonjë vend jashtë rrezikut. E ç'bëra unë thoni ju? E vesha vetë këmishënatën tuaj. Atë e kishit mbajtur ju, tani e vesha unë, ç'kënaqësi e padëgjuar!

Lajmi i posamarrë më bindi që kisha vepruar drejt: dedektivi Kaf kish shprehur dëshirën të kontrollonte regjistrin ku shkruhej hyrja dhe dalja e ndërresave për larje. E çova regjistrin në dhomën e zonjës. E dija që do më njihte se ishim takuar jo një herë më parë. Mendova se duhej ngutur për t'u takuar dhe biseduar me ju. Ishte koha kur sapo ishit kthyer nga stacioni hekurudhor ku kishit përcjellë zotin Godfri Ebluajt. Shkova te rrugina juaj e dashur mes postateve me trëndafila, për t'ju takuar. Ju aty nuk kaluat, por më e keqja qe që zoti Beterexh dhe dedektivi Kaf kaluan pranë vendit ku qesh fshehur unë; dedektivi më pikasi. S'më mbeti tjetër vecse të kthehesha në punët e mia. Atë çast ia behët ju. Me të më parë, përkëtë jam e sigurt, zotëri, më kthyet shpinën, si para një lebrozeje, dhe hytë në shtëpi.

U ngjita lart nëpër shkallët e tjera. Në atë kohë lavanteria ishte bosh, qëndrova aty vetëm. Thashë me vete: ç'gjë do të jetë më e vështirë, të duroj këtë mospërfillje të zotit Frenklin Blek apo të mytem në «Rërën e Tallazitur» e kësisoj të marrë fund gjithçka.

As që mund të më kërkohet shpjegim për sjelljen në ato çaste. Sado që përpiqem, s'po arrij dot as vetë ta kuptoj.

E përsë nuk ju thirra, kur në atë mënyrë të pashpirtë më kthyet krahët? T'ju thosha: «Zoti Frenklin, më duhet diç t'ju them, më dëgjoni?» Se ju kisha në dorë të tèrin, de... Dija jo pak gjëra (nëse do më duhej t'u detyroja të më besonit) që

mund t'u isha e dobishme më pas. Kuptohet, as që më besohej që një njeri fisnik si ju ta kishte vjedhur diamantin thjesht nga kënaqësia për ta vjedhur. Jo. Penelopa kishte dëgjuar zonjushën Reçell dhe unë zotin Beterexh të thoshin se jeni dorëlëshuar dhe deri në fyt me borxhe. S'kisha as dyshimin më të vogël që e kishit marrë diamantin për ta shitur apo për ta lënë peng. Po unë mund t'ju rekmandoja një njeri në Londër që t'u jepte borxh një shumë të mirë po t'i linit peng këtë diamant, pa ju bërë as edhe një pyetje që do ju vinte në pozitë të vështirë.

E pse nuk ju thirra! Pse s'u bëra zë! Në lavanteri erdhi Penelopa që e dinte prej kohësh të fshehtën time dhe bënte çmos që të më bindte t'i thërrisja mendjes.

«E di pse rrini këtu si qyqare! — më tha. — Për ju, Rozana, do të ishte më mirë që zoti Frenklin të largohej që këtej... Më duket se ka për ta bërë së shpejti këtë...»

S'më pati shkuar kurrë në mendje që ju mund të largoheshit. S'gjeta dot forca që t'i përgjigjesha. Vetëm e pashë si e fandaksur.

«Tani po vij nga zonjusha Reçell, — vazhdoi Penelopa, — unë e di ç'po heq nga kapriçot e saj. Thotë se është i padurueshëm qëndrimi në këtë shtëpi bashkë me atë policin; ka vendosur që të bisedojë që sot me zonjën dhe nesër do shkojë te tetoja Ebluajt. Në e bëftë këtë, edhe zoti Frenklin s'ka për të qëndruar gjatë, ta them unë këtë!»

Këto fjalë më kthyen aftësinë e të folurit.

«Domethënë, sipas jush, zoti Frenklin do të iki bashkë me të?» — e pyeta.

«Do ta kishte bërë me gjithë qejf, po ta kishte pranuar ajo një gjë të tillë. E ka pësuar dhe jo pak edhe ai nga kapriçot e saj, se edhe atë s'e sheh dot me sy ajo. E cilin pa, atë që u bë copë për ta ndihmuar! Se ku do vejë, s'ta them dot, por këtu s'ka për të qëndruar më, Rozana.»

Shënim i Frenklin Blekut. E gjora, është gabuar rëndë. Unë atë nuk e vura re. Kur bëra të shëtis nëpër rruginë e dashur, m'u kujtua se ndoshta tetoja kishte dëshirë të më takonte pas kthimit nga stacioni hekurudhor, ndaj dhe bëra atë kthesë të beftë dhe hyra në shtëpi.

Arrita ta ndrydh angushtinë që më pushtoi. T'ju them të vërtetën, gjeta ca fije shprese pér veten time në këtë ftohjen tuaj.

«Po a e dini pérse janë prishur? — e pyeta».

«Pér fajin e zonjushës Reçell, — më tha Penelopa. — Veç mos pandehni, Rozana, se kjo prishje është përgjithmonë. E do shumë zonjushën Reçell ai!»

Sakaq hyri zoti Beterexh. Shërbëtorët duhej të mblidheshin në sallën e katit të parë. Që andej një nga një duhej të shkonin në dhomën e zotit Beterexh, ku do na merrte në pyetje dedektivi Kaf.

Para meje qenë marrë në pyetje dy shërbëtore, armike të mijat pér vdekje. Edhe pse tepër të maskuara, pyetjet e dedektivit Kaf më lanë të kuptoja që ato gra më kishin përgjuar prapa derës. Ky e dinte që kisha qepur në fshehtësi një këmishë-nate, por gabimisht mendonte se ishte imja. Kuptohet që e hante dyshimi që kisha gisht në atë çështjen e zhdukjes së diamantit, por, në të njëjtën kohë, më la të kuptoja se nuk më quante fajtoren kryesore të zhdukjes së diamantit. Me sa dukej, pandehte që të kem vepruar me urdhër të dikujt tjetër. Kush ishte ky tjetër, s'arrita ta marrë vesh as atëherë, as tani.

Ishte e qartë që dedektivi Kaf nuk po i binte fare në të. Ju ishit jashtë çdo rreziku, pérderisa nuk kishte si të gjendej këmisha juaj e natës. Vendosa ta fshehë dhe zgjodha pér këtë vendin që e njihja më mirë nga të tjerët: «Rërën e Tallazitur».

Me të përfunduar marrja në pyetje, mora leje pér të thi-thur pak ajër të pastër dhe u nisa drejt e në Kobs-Holl. I kisha miq të zotët e shtëpisë, veç mos kujtoni se ua besova të fshehtë-tuaj. Desha vetëm të shkruaj këtë letër drejuar juve dhe të fshihja këmishën tuaj.

Po i jap fund kësaj letre në dhomën e gjumit të Lusí Jollandit. Do të zbres poshtë, do të gjej ndonjë kuti hekuri që të fsheh këmishën, do shkoj te «Réra e Tallazitur» — mos kini frikë, gjurmët do t'i fshij, që të mos më tradhëtojnë — dhe do e fsheh në rërë këmishën, as edhe një qenie e gjallë s'ka pér ta gjetur dot.

Po kur ta kem bërë tërë këtë, çë pastaj?

Pastaj, zoti Frenklin, do të kem dy herë të drejtë t'ua them ato fjalë që deri më tani s'kam patur mundësi. Së pari, më

duhet të flasë me ju, para se të niseni që këtej, ndryshe s'do më paraqitet më ndonjë rast tjetër. Së dyti, më bën të ndihem e qetë vetëdija se edhe në ju zemërofshin ato fjalët e mia, këmishënata do të jetë zbutëse. Nëse të dyja këto rrëthana s'do të më bëjnë të ndihem aq e fortë sa të përballoj atë ftohtësinë tuaj, që aq shumë më pikëllon, atëherë s'do të jetë e largët di ta, kur tërë sforcimet e mia të marrin fund. Do t'i lë lamtumi rën kësaj bote që më privoi nga lumturia, ndërkohë që i gostit me bujari të tjerët. Do të ndahem nga bota që, përveç asaj mi resisë suaj, asgjë tjetër s'mund ta bëjë për mua të këndshme. Mos e qortoni veten, zotëri, nëse kjo punë kësisoj ka për të përfunduar. Veç përpinquni t'ju vij qoftë edhe pak keq për mua! Do kujdesem që ju t'i mësoni gjithë sa kam bërë për ju, atëherë kur nuk do të jem në gjendje t'ua trëgoj këtë vetë. A do të thoni, vallë, atëherë për mua ndonjë fjalë ledhatuese me atë zë të dridhur siç i thoni zonjushës Reçell? Në e bëfshi dhe në ekzistofshin shpirtërat, jam e sigurt që shpirti im ka për ta dëgjuar dhe ka për të gëzuar. Për të qënë sa më e sigurt që kjo letër t'u bjerë në dorë, do ta vë bashkë me këmishënatën në kuti. S'e pata aspak të lehtë shkrimin e kësaj letre për ju.

Mbetem kurdoherë besnikë, kurdoherë e dashruar, shërbëtorja juaj kokulur, Rozana Spiran».

Beterexhi e përfundoi heshturazi letrën, e palosi me kujdes, e futi në zarf dhe ra në mendime me kokën varur dhe me shikimin në tokë.

— Beterexh, — i thashë. — Mos ka në atë letër ndonjë gjë që mund të na ndihë në këtë çështjen tonë?

Ky ngriti sytë ngadalë dhe pshëretiu thellë.

— Asgjë të tillë që t'u ndihmonte nuk gjeta këtu, zoti Frenklin. Dëgjojeni këshillën time, mos e nxirri letrën nga zarfi, pa marrë fund tërë shqetësimi dhe preokupimi që keni. Ka për t'ju hidhëruar shumë. Më dëgjoni mua, mos e lexoni tanë.

6.

U nisa për në stacion në këmbë. Kuptohet që s'më la vetëm Gabriel Beterexhi. Letrën e kisha në xhep, kurse këmishë-

nata gjendej në valixhe pér t'ia treguar si njerën, ashtu dhe tjetrën zotit Bref, me të mbërritur në Londër.

Dolëm të heshtur nga shtëpia. Ishte hera e parë që plakoshi Beterexh s'dinte pérse të fjalosej me mua. Por meqë kisha unë pér t'i thënë, e nisa bisedën me të dalë nga porta e parkut.

— Dua t'u bëj dy pyetje që kanë lidhje me mua dhe them se do ju çudisin disi.

— Nëse ma shkulim nga mendja lëtrën e asaj vajze, zoti Frenklin, le të më çudisin sa të duan.

— Pyetja e parë, Beterexh, është kjo: mos kam qënë gjë i dehur atë mbrëmje kur kishte ditëlindjen Reçëlli?

— I dehur? Ju? — thirri plakoshi. — Përkundrazi, kjo është një e metë e madhe tuaja, zoti Frenklin, që pini vetëm kur hani drekë, më pas nuk pranoni të vini në gojë as edhe një pikë!

— Po ditëlindja është diçka e shënuar, mund të bëja edhe ndonjë përjashtim.

Beterexhi u mendua një hop.

— Mund t'ju them, zotëri, vetëm këtë: atë mbrëmje kisht pamjen e një njeriu fare të sëmurë, dhe ne ju lutëm të pinit pak konjak të holluar me ujë të akullt, në mënyrë që të gjallëroheshit ca.

— S'e kam zakon të pi konjak të holluar në ujë. Ndoshita...

— Po ja, zoti Frenklin, e kam ditur që s'ishit mësuar ndaj dhe ndonja gjysmë gote konjak të vjetër e hollova me një gotë ujë. As edhe fëmija s'kishte pér ta ndjerë, e jo pastaj i rrituri!

E kuptova që pyetja e parë e kishte marrë përgjigjen. I bëra pyetjen e dytë.

— Para se të shkoja jashtë shtetit, Beterexh, më keni parë jo një herë fëmijë. Ma thoni troç: mos më ka pas ndodhur diçka e çuditshme pasi më ka pas zënë gjumi? Mos më ka pas ndodhur të ecë në gjumë?

Beterexhi ndali pér një çast, më pa ngultas dhe, pasi tun-di kryet, çapiti më tej.

— E kuptova ku doni të dëlni ju, zoti Frenklin, — më tha.

— Ju po orvateni të shpjegoni si u gjend ajo njolla në këmi-shënatën tuaj pa ditur ju vetë asgjë pér këtë. Por jemi një

shekull larg së vërtetës. Të çoheni e të vërdalloseni në gjumë? Kurrë s'e keni bërë këtë ndonjëherë!

Edhe këtë herë u binda që Beterexhi kishte të drejtë. Po të kisha qënë somnambul, do të kishin qënë me qindra ata që do ta kishin vënë re këtë, do ma kishin bërë të ditur që të merrja masa pér shërimin e saj. Por i thashë tërë këto në pamundësi pér të kërkuar ndonjë shpjegim tjetër.

Beterexhi ma përforcoi edhe më pamundësinë e këtyre hamendjeve, kur më tha:

— Ta zëmë se paskeni qënë ose i dehur, ose somnambul, po ju jo vetëm duhej të kishit zhyer këmishënatën, ju duhet të kishit marrë edhe diamantin. Atëherë si u gjend ky në Londër, i lënë peng te zoti Luker? Mos vallë edhe këtë ta keni bërë pa qënë i vetëdijshëm? Pse mos paskeni qënë i dehur, kur ju përcolla të shtunën më darkë në kaloshinë? Pse në gjumë të keni qënë, kur keni shkuar te zoti Luker? Më falni që po ju them, zoti Frenklin, se kjo çështje ju ka trullosur aq keq, sa që po humbisni fare logjikën. Sa më shpejt që të këshilloheni me zotin Bref, aq më herët keni pér t'u shqitur nga kjo gjendje pa rrugëdalje ku tani ndodheni.

Mbërritëm në stacion nja dy minuta para nisjes së trenit. I dhashë me ngut Beterexhit adresën time të Londrés që të më shkruante po ta ndiente të nevojshme dhe i dhashë fjalën që edhe unë do ia njoftoja të rejas që mund të kisha. Kur po ndahesha me të, fare rastësish më shkuau sytë te tezga me libra dhe gazeta, ku qe duke biseduar me të zotin e tezgës ndihmësi i çuditshëm i zotit Kandi. Sakaq shikimet tona u kryqëzuan. Ezra Xheningsi hoqi kapelen. Ia ktheva përhëndetjen me një përkulje të lehtë të trupit dhe hyra në wagon, kur treni u nis. Edhe vetë u çudita kur më rastisi ta shoh brenda ditës dy herë atë njeri të çuditshëm!

Në Londër kisha ardhur në një të tillë ore, që s'kisha as edhe një fije shprese ta gjeja zotin Bref në zyrë. Ndaj dhe u nisa nga stacioni i trenit drejt tek ai në shtëpi, duke e bezdisur atë burrë plak që ishte duke dremitur në kuzhinë me kisen e dashur në prehër dhe me një shishe verë përpara.

Se ç'përshtypje i bëri tregimi im zotit Bref, po mundohem t'ua bëj të qartë, duke përshkruar veprimet që ai ndërmori. Pasi më dëgjoi, urdhëroi të ndiznin zjarrin në oxhak, të na

sillnin çaj tē nxehëtë nē dhomën e tij tē punës dhe t'u thoshin grave qē nē asnje mënyrë tē mos na shqetësonin. Pastaj pa vëmendshëm këmishënatën dhe lezoi letrën e Rozana Spirmanit.

Vetëm pas kësaj më foli:

— Frenklin Blek, kemi përpëra një çështje tepër serioze nē tē gjitha drejtimet. Ka tē bëjë me Reçëllin po aq sa dhe me ju. Ajo sjellja e saj e çuditshme tanimë gjen shpjegimin e vet: ajo është fare e sigurt që diamantin e vodhët ju.

Më vinte tē pëlcisja nga një përfundim i tillë, por doja s'doja ai ishte krejt i pranishëm.

— Gjëja e parë që duhet tē bëjmë është t'i drejtohem Reçëllit, — tha zoti Bref. — Deri më tanë ajo ka heshtur për arsyen fare tē qarta, po tē kemi parasysh karakterin e saj; tanë, pas gjithë ç'ka ndodhur, kjo heshtje e saj s'durohet më. Ajo duhet bindur apo edhe detyruar tē na thotë, përsë mendon që jeni pikërisht ju ai që e keni marrë **Gurin e Hënës**. Kushedi, kjo çështje që ne na duket aq serioze, del një bllof, nëse Reçëlli pranon tē na e zbulojë gjithçka.

— Është një mendim që më bën ta ndjej veten tē qetë, — i thashë. — Të them tē drejtën, do tē doja tē dija...

— Se si e argumentoj unë këtë? — ma ndërpree fjalën zoti Bref. — Mund t'ua shpjegoj fare lehtë. Pikësëpari këtë çështje e gjykoj nga pikëpamja juridike. Për mendimin tim, tërë çështja fshihet nē tē dhënat që kemi ndër duar. Ato nuk qëndrojnë.

— Si kështu?

— Tani do ta merrni vesh. Është e vërtetë që njolla nē këmishënatën tuaj tregon se ajo është juaja. Është e vërtetë se kjo njollë tregon që kjo këmishënatë është zhyer me bojën e derës së Reçëllit. Po kush e vërteton që këtë këmishënatë e kenë pas veshur ju?

Ky argument m'u duk aq më tepër bindës e serioz, ngaqë edhe vetë mua më pat ardhur nē mendje.

— Sa për këtë, — vazhdoi zoti Bref, duke marrë ndër duar letrën e Rozana Spirmanit, — kuptohet, është për ju diçka e pakëndshme. Veç t'i gjykojmë punët me syrin e juristit: pa zë-në ngoje faktin që ka qënë hajdute, po them vetëm se nga letra e saj del se paska qënë një mashtruese e sprovuar; kam

plotësish tē drejtë tē dyshoj se nuk ua ka thënë deri në fund tē vërtetë. Mund tē them vetëm këtë; nëse Reçelli dyshon tek ju nisur nga njolla e këmishënati, me siguri që këtë këmishë ia ka treguar Rozana Spirman. Se ajo e pranon me gojën e saj që ka vuajtur nga xhelozia ndaj Reçellit. Mund tē them, pra, se zhdukja e diamantit do t'i krijonte kësaj hajduteje, tē dashruar çmendurisht, një rrethanë tē favorshme pér t'u bërë tē grindeni e tē prisheni përfundimisht mes jush. Se ajo, në kësi rrethana, s'kishte pse vendoste t'i jepte fund jetës, kështu shkruan në letër! Them se, nisur nga karakteri, aftësia dhe e kaluara e saj kjo ishte e aftë pér tē shfrytëzuar rastin e ta vidente diamantin. Ju ç'mendim keni lidhur me këtë?

— Afërsisht këtë që keni ju, — iu përgjigja. — Po sikur këtë këmishënati ta kem pas veshur unë, atëherë si i bëhet?

— Këtë s'e vërteton dot kush, — tha zoti Bref. — Tani kryesore mbetet nëse dyshimi i Reçellit mbështetet vetëm në punën e këmishës apo gjetiu.

O Zot! Me çfarë gjakftothësie që e thoni këtë! — fola i nxehur. — A ka vallë tē drejtë ajo tē më dyshojë pér vjedhje, pavarësisht nga tē dhënati që mund tē ketë?

— Keni plotësish tē drejtë tē shpreheni kështu, zotëri. Por ajo që s'po arrini dot tē kuptoni ju vetë, nuk po arrij as unë. Duam s'duam, hapi tjetër në rrugën e hetimeve do na ço-jë te Reçelli. Dhe vështirësia kryesore është ta detyrojmë tē zërthehet. Ju keni ndonjë mendim lidhur me këtë?

— Kam vendosur, zoti Bref, tē flas vetë me Reçellin.

— Ju?!

Më pa siç shohim një tē lojtur.

— Po a mundeni ta bëni vallë?

Tundi fort kryet dhe filloj ecejaket nëpér dhomë.

— Epo, po nuk riskove, nuk fiton. Kam mendimin se Reçelli ende vazhdon tē ketë një farë dobësie pér ju. Duhet ta shfrytëzoni këtë dhe, tē jeni i sigurt, keni pér tē dëgjuar një rrëfim tē vërtetë, kuptohet sa mund ta bëjë këtë një grua. Tërë puna është si ta takoni.

— Ka qënë mysafire tek ju, — iu përgjigja. — A mund t'u lutem ta ftoni këtu, pa i thënë se do më takojë mua?

— Si tepër e guximshme kjo! — tha zoti Bref.

Përsëri nisi ato ecejaket nëpër dhomë.

— Po të shpreheshim më saktë duhej të thoshim që shtëpia ime duhet të shndrrohet në grackë për Reçellin. Po të mos quheshit Frenklin Blek dhe po të mos që e rëndësisë jetike kjo çështje, do të kisha kundërshtuar kategorikisht, por gjendemi në të tilla rrethana, që jam më se i sigurt; më pas vetë Reçelli do na falenderojë për këtë që po bëjmë. Më konsideroni pra pjesëmarrës në këtë komplot tuajin. Do ta ftojmë Reçellin të kalojë një ditë me ne dhe do ju vëmë në kohën e duhur në dijeni për këtë.

— Po kur, nesër?

— Nesër nuk arrijmë dot të marrim prej saj përgjigje. Më mirë pasnesër.

— E si do më vini në dijeni?

— Mos dilni tërë mëngjesin nga shtëpia se do vij vetë t'ua njoftoj.

E falënderova për ndihmën e çmuar dhe u ktheva në apartamentin tim të Londrës.

Për ditën e nesërme mund të them vetëm se ka qënë dita më e gjatë e jetës sime. Edhe pse e dija që isha i pafajshëm, edhe pse qeshë i sigurt qëakuza e tmerrshme s'do të vononte të sqarohej, prapë se prapë sesi ndihesha i poshtëruar. S'ma kishte fare ënda të takohesha me miqtë.

Ditën tjetër, kur isha duke ngrënë mëngjes, ia behu pa pritur e pa kujtar zoti Bref. Më futi në dorë kyçin e derës dhe më tha se ishte hera e parë në jetë që i vinte turp nga vetja.

— Do vijë?

— Do vijë që në mëngjes dhe do rrijë tërë ditën me gruan dhe me vajzat.

— Zonja Bref dhe vajzat janë në dijeni të së fshehtës sonë?

— Ndryshe s'kishte si bëhej. Por gratë, siç mund ta keni vënë re edhe ju vetë, s'para janë aq strikte në respektimin e rregullave. Veç njerëzit e familjes sime nuk provojnë asnjë vrasi ndërgjegjeje se synimi i vetëm yni është t'u pajtojnë ju më Reçellin.

— Ju jam shumë po shumë i detyruar. Po ky kyçi që më dhatë, c'është?

— Është i deriqkës së kopshtit. Jini aty në ora tre, pastaj

që andej përmes serrës hyni në shtëpi. Do të kaloni nëpër dhomën e vogël të pritjes e do hapni derën përballë që të çon në dhomën e muzikës. Aty do të gjeni Reçëllin, ka për të qënë vetëm.

— S'di si t'ju falenderoj.

— Jua them unë si: mos të më bëni fajtor për asgjë, pavarësisht nga drejtimi që do të marrin punët!

Në këtë e sipër doli

M'u desh të prisja shumë. Për të kaluar kohën, zura të shoh postën. Gjeta një letër nga Beterexhi. E hapa me ngut, por niste e bitiste me fjalët për ndjesë që s'mund të më njoftonte asgjë të re. Veç nëpër të përmendej emri i Ezra Xheningtonit që e kishte pyetur Beterexhin se kush isha. I kishte thënë se më paska parë zotëria e tij doktor Kandi. I kishte thënë se ka një arsyesh të veçantë, do të dëshironte të më takonte dhe e kishte porositur t'i conte lajm kur të kthehesha në atë vend. E futa letrën në xhep dhe pas një minute harrova për ekzisten cën e saj, i përqëndruar i téri në atë takimin e pritshëm me Reçëllin.

Plot në ora tre futa çelësin e zotit Bref në bravën e deriqës së kopshtit. Kur e mbylla derën përsëri me kyç nga benda, më pushtoi tmerri nga mendimi ç'mund të më ndodhë. Pas shë përreth me frikë mos kishte të fshehur ndonjë njeri në kopsht. Rruginat qenë të zbrazëta, dëshmitarë të vetëm të qënies sime aty ishin zogjtë dhe bletët.

Kalova përmes kopshtit, u futa në serrë, pastaj hyra në dhomën e pritjes ku më zunë veshët disa akorde të mëkët pianoje. Reçëllit i pëlgente ja, kështu, e shpërqendruar të merrte ca akorde në piano, kur kisha qënë tek ajo mysafir. U detyrova të qëndroja aty disa caste, që të mbushesha me frymë. E kaluara dhe e tashmja më shkuan shpejt para syve dhe kontrasti ndërmjet tyre më la të habitur.

Pas pak sekondash mora guximin dhe hapa derën.

7.

Kur më pa te dera, Reçëlli u ngrit nga fortepianoja. E mbylla derën. Pamë heshturazi njeri-tjetrin. Na ndante gjatësia e dhomës. Tërë forcat shpirtërore dukej që i kishte përqe-

ndruar në atë shikimin që më kishte drejtuar. Ishte si shumë e beftë për të kjo paraqitja ime aty. Bëra disa hapa drejt saj dhe i fola më zë të ndrydhur:

— Reçell.

Tingëllimi i zërit tim e ktheu në jetë, u skuq në fytyrë. Pa nxjerrë as edhe një fjalë u prir drejt meje, pastaj si t'i bindej një force të padukshme, zuri të më afrohej. I digjeshin faqet, i rrezëllinin sytë. E harrova fare atë për çka kisha ardhur, e harrova atë dyshimin famëkeq, që hidhët hije mbi emrin tim të mirë, gjithçka sikur më fluturoi nga mendja: e tanishmja e ardhshmja, të cilat isha i detyruar të mos i harroja. Shihja vëtëm si gruaja që aq shumë e doja po më afrohej gjithë më te për.. Ajo u rrënqeth dhe ndali e pavendosur. S'u përbajti dot më, e pushtova fort dhe ia mbulova fytyrën me të puthura.

Ishte një çast, kur pandeva se po i përgjigjej puthjeve të mia, thashë me vete se edhe ajo e kishte harruar çdo gjë të kësaj bote. Por s'vonoit dhe e kuptova që ajo çdo gjë e mbante mend. Atë çast lëshoi një britmë që ngjante me rënkim tmerri, e cila më tronditi aq shumë, saqë s'kishin për të më mbajtur këmbët po të tentonte për të më shtyrë. Në sy iu duk një zemërim i pamëshirshëm, buzët iu shtrembëruan në një grimasë përbuzjeje. M'i nguli sytë inatçorë të njeriut që ndihej e fyer.

— Frikacak! — më tha. — Frikacak i poshtër, i nëmur, i pashpirt!

Këto qenë fjalët e para me të cilat m'u drejtua.

— Më duket, Reçell, se ka qenë njéherë një kohë që më me dinjitet mund të më thoshit që ju kam fyer. Ju lutem të më falni.

Ndoshta tërë ai hidhërim që provoja nxori krye përmes zërit. Kur i dëgjoi këto fjalë, përtueshëm i ktheu sytë nga unë dhe m'u përgjigj me zë të ulët, me një zymti të papërbajtur që s'e kisha vënë re tek ajo kurrë më parë.

— Më duket se e kam hak këtë falje, — më tha. — Pas gjithë asaj që bëtë, s'ke si e cilëson ndryshe veçse si të poshtër këtë veprim tuajin për të më takuar kësisoj. Më duket se s'është tjetër veçse spekullim kjo sjellja juaj për të shfrytëzuar kësisoj dobësinë time. Më duket diçka e ulët që të shfrytëzoni befasi-

në për të më shkëputur një të puthur. Por këto nuk janë veçse mendime gruaje. Do të kisha bërë më mirë po të mos ju kisha folur as edhe një fjalë.

Ky kërkim ndjese qe më i keq se çdo lloj fyterje. Edhe ndonjë leckë njeri kishte pér ta ndjerë veten të poshtëuar.

— Po të mos gjendej nderi im në duart tuaja, — i thashë, — do ju kisha lënë që në këtë minutë dhe s'do të doja t'u shihja kurrë. Por ju përmendët se diç paskam bërë. Ç'qënka kjo vallë?

— C'qënka? Edhe ju pyetkeni?

— Po.

— E kam ruajtur në fshehtësi të plotë atë ndyrësirë që bëtë, — m'u përgjigj. — Dhe e kam paguar shtrenjtë atë hesh-tje. Vallë nuk paskam të drejtë që të mos ma dëgjojnë veshët tje. Vallë nuk ju paska mbetur as edhe një grimë falënderimi në zemër? Dikur keni qënë zotni burrë. Keni qënë i shtrenjtë pér mamanë, edhe më i shtrenjtë pér mua...

Zéri iu drodh. U lëshua në karrige, më ktheu krahët dhe e mbuloi fytyrën me duar.

Prita pak sa arrita të mbledh forcat pér të folur.

— Nëse s'do më tregoni ju si qëndron puna, atëherë do jem i detyruar ta bëj unë. Erdha pér të biseduar pér diçka shumë të rëndësishme. A do pranoni të më dëgjoni?

As lëvizi e as foli. Nuk iu drejtova më me pyetje, nuk bëra as një hap drejt saj. I tregova shkurt pér gjithë ç'kisha zbuluar në «Rërën e Tallazit». Kaloi goxha kohë, por s'bëri as lëvizjen më të vogël pér t'u kthyer nga unë, nuk nxori as edhe një fjalë.

U tregova i papërbajtur. E ardhmja ime varej në një qime. Kishte ardhur koha e verifikimit të teorisë së zotit Bref. I pushtuar nga dëshira e thekshme pér ta vënë atë në provë, eca rreth tryezës që të gjendesha përballë saj.

— Duhet t'ju bëj një pyetje, — i thashë, — edhe pse de-tyrohem të kthehem tek diçka shumë e rëndë: a ua ka treguar Rozana Spirman këmishën time? Po apo jo?

Brofi dhe m'u drejtua, thuajse u puthit pas meje. Sytë m'u ngulën në fytyrë, si të donin të lexonin atë që kurrë nuk e kishin lexuar ndonjëherë në të.

— Mos paskeni lojtur! — thirri.

Edhe pas kësaj e përbajta veten. I thashë fare i qetë:

— Reçëll, a do t'i përgjigjeni kësaj pyetjeje?

Vazhdoi pa ma varur fare.

— Mos fshihet në këtë mes ndonjë qëllim i fshehtë? Ndonjë frikë prej mizantropi për të ardhmen që më prek edhe mua? Thonë se pas vdekjes së atit tuaj ju jeni bërë i pasur. Mos kenë ardhur për të më kompensuar çmimin e diamantit? Dhe kushti u paska mbetur aq sedër që e ndjeni veten me turp? Mos vallë ky të jetë shpjegimi i asaj pafajsisë së rrëme dhe historisë së Rozana Spirmanit? Mos fshihet turpi në thellësi të kësaj gënjeshtre?

S'u përbajta dot më dhe e ndërpresa.

— Po më fyeni në mënyrën më përbindshore! — thirra. — Dyshokeni që unë e paskam vjedhur diamantin? Kam të drejtë dhe dua ta di, mbi ç'bazë?

— Dyshokam? — u habit, duke u nxehur jo më pak. — Maskara! Po unë e pashë, ja, me këta dy sy si e morët diamantin!

Ky shpjegim i tmerrshëm e bënte shkrumb e hi çdo shpresë të zotit Bref; shtanga. Edhe pse isha krejt pa faj, heshta. Në sytë e saj por edhe në sytë e kujtdo që të kishte qënë do të dukeshë i tronditur deri në lemeri nga zbulimi i krimtit. Kurse atë kjo heshtja ime e beftë sikur e trëmbi.

— Ju kam mëshiruar atëherë, — më tha, — do ju mëshirroja edhe tani, po të mos më kishit detyruar të flisja.

Bëri mënjanë, duke dashur të dilte nga dhoma, por, kur arriti te dera, qëndroi në mëdyshje.

— Jy pyes, përsë erdhët, vallë për të poshtëruar veten? Për të më poshtëruar mua?

Bëri edhe disa hapa dhe përsëri ndali.

— Po flisni, de, flisni, thoni ndonjë gjë, — thirri me zë të drithëruar. — Nëse ju ka mbetur qoftë edhe një fije keqardhje në shpirt, mos më detyroni ta poshtëroj kësosoj veten! Thoni diçka dhe më detyroni të dalë nga dhoma!

Iu afrova pa e ditur as vetë se çfarë po bëja. Ndoshta më gëlonë ndonjë mendim i turbullt që ta lusja të më bënte ndoca shpjegime më të hollësishme. Qysh kur dëgjova që dëshmia, mbi bazën e së cilës Reçëlli më akuzonte, ishte dëshmi e parë nga ajo me sytë e saj, asgjë, madje as bindja për pafajsinë e

plotë timen, e humbi atë qartësinë e kulluar në kokën time. E mora për krahun; u përpoqa t'i flas i sigurt dhe më logjikë, ndërkohë që arrita vetëm t'i bëlbëzoj.

— Reçell, ju dikur më keni dashur!

U rrënqeth e tëra dhe u kthyen mënjanë. Dora që i dridhej i mbeti në dorën time.

— Lëshomani dorën, — shqiptoi me zë të shuar.

Prekjet e mia ndikonin tek ajo ashtu si zëri kur hyra. Pasi më kishte quajtur frikacak, pas damkosjes me damkën e hajdutit, ende kisha forcë pushteti mbi të, dora e saj ishte në timen!

E çova qetësishët në mesin e dhomës. E ula pranë vetes.

— Reçell, — i thashë. — S'jam në gjendje të t'i shpjegoj kundërtitë e kësaj që do të them. Mundem vetëm t'ju them të vërtetën, ashtu siç ma thatë edhe ju. Ju vetë e kini parë si e kam marrë diamantin. Të betohem para Zotit që na dëgjon, është hera e parë që po e dëgjoj se e paskam marrë unë! Unde dyshoni për këtë?

Ose nuk i kushtoi fare vëmendje këtyre fjaleve, ose nuk i dëgjoi.

— Lëshomani dorën, — përsëriti me zë të mekur.

Kjo qe përgjigja e saj e vetme. Koka iu vajis mbi supin tim, kurse dora në mënyrë të pavetëdijshme shtrëngoi dorën time ndërkohë që më lutej t'ia lëshoja. Nuk ia përsërita më atë pyetje. Vëç këtu dhe mori fund durimi im. E kuptova që përsëri mundesha t'i shihja drejt në sy njëzit e ndershëm nëse arrija ta detyroja Reçellin të më kallzonte gjithçka që dinte. Shpresë e vetme që më kishte mbetur ishte: kushedi Reçellit i kishte shpëtar ndonjë hallkë, ndonjë detaj që, pas një shqyrtimi më të vëmendshëm, mund të shërbente si provë e pafajisë sime. Të them të drejtën, nuk ia lëshova dorën. I fola me ngrohtësinë dhe besimin e kohëve të mëparshme.

— Do t'ju lutem për diçka, — i thashë. — Të më tregoni se çfarë ndodhi që nga casti, kur i uruam njeri-tjetrit natën e mire e deri në castin kur ju e patë që unë e mora diamantin.

I ngriti kryet nga supi dhe u përpooq të çlironte dorën.

— E pse duhet t'i kthehem i asaj kohe? — tha. — Përse?

— Ja përse, Reçell. Ju dhe unë jemi viktimi e një mash-

trimi të tmerrshëm që ka mbuluar të vërtetën. Po ta shohim së basi ku gjithë ç'ka ndodhi, pas kremitimit të ditëlindjes, ne kusheci e kuptojmë njëri-tjetrin.

E lëshoi përsëri kokën mbi supin tím. Lotët i shkuan çurg.

— Oh! — psherëtiu. — Po pse unë a nuk kam shkuar me këtë shpresë? Pse a nuk kam bërë çmos që ta shoh këtë ndodhi ja kështu siç po e shihni ju tanë?

— E keni bërë vetëm, — iu përgjigja. — Ta provojmë bashkërisht.

Këto fjalë sikur ia përtërinë ato shpresa që ushqëja dhe unë kur i fola kështu. M'u përgjigj jo vetëm e përkorë, por duke u tendosur të kujtojë gjithçka; ma hapi zemrën sinqerisht.

— T'a fillojmë, — i thashë, — nga çasti kur i uruam njëri-tjetrit natën e mirë. Ju ratë të flinit apo jo?

— Rash të fle.

— A e patë sa ishte ora? Ishte vonë?

— Jo dhe shumë, ishte rreth orës dymbëuhjetë.

— Ju zuri gjumi?

— Jo nuk kisha gjumë atë natë.

— Keni patur shqetësimë?

— Më rrinte mendja te ju.

Kjo përgjigje më çarmatosi. Toni me të cilin u thanë më shitoi mu në zemër. Munda të vazhdoj vetëm pas njëfarë heshtjeje.

— Drjtën ndezur e kishit? — e pyeta.

— Jo, më pas u ngrita dhe e ndeza.

— E ndezët pasi kishit ndenjur shtritur pér njëfarë kohe?

— Më duket se pas ndonjë ore.

— A dolët nga dhoma e gjumit?

— Desha të dilja. Hodha krahëve rrobënatën dhe desha të shkoja në dhomën e pritjes pér të marrë librin.

— E hapët derën e dhomës së gjumit?

— E hapa.

— Po nuk hytë në dhomën e pritjes?

— Jo se diç më ndali...

— E çfarë qe ajo që ju ndali?

— Pashë drjtë në të çarën poshtë derës dhe dëgjova hapa.

— U trembët?

— Jo. E dija që e gjora ime ëmë vuante nga pagjumësia dhe m'u kujtua që më ishte latur t'ia jepja asaj të ma ruante diamantin. Edhe pa ndonjë arsyе ajo mund të ndihej e shqetësuar dhe thashë me vete se ishte ajo që po vinte të shihne në isha në krevat dhe të më flipte për diamantin, ose të merrte vesh që ende nuk më kishte zënë gjumi.

— E ç'farë bëtë pastaj?

— E shova dritën që ajo të mendonte se po flija. S'desha të dëgjoja njeri, diamantin desha ta mbaja vetë.

— Pasi e shuat dritën, ratë përsëri në shtrat?

— Nuk arrita. Atë çast u hap dera e dhomës së pritjes dhe pashë të hynit...

— Të hynte kush?

— Ju.

— I veshur si zakonisht?

— Jo. Me këmishënatë dhe me qiri në dorë.

— Vetëm?

— Vetëm.

— Ma shquat mirë fytyrën?

— Po. Qıriri që mbanit në dorë ua ndriçonte fare mirë.

— Sytë të hapura i kisha?

— Po.

— A vutë re ndonjë gjë të çuditshme në ta, ndonjë shprehje të huptë?

— Aspak. Sytë ju përshkënditeshin më tepër se zakonisht. Patë përreth ashtu si sheh njeriu që e di se ku duhet të ndodhet dhe sikur të trembeshit mos ju shihnin.

— A ju ra në sy diçka e pazakontë në pamjen time, kur hyra në dhomë?

— Ecnit siç ecni ngaherë. Me të arritur në mes të dhomës, ndalët dhe patë rrretherrotull.

— Po ju çfarë bëtë, kur më patë?

— S'mund të bëja asgjë. Qëndroja si e ngurosur. S'më dillnin fjalët nga goja, nuk bërtisja dot, nuk mundja madje as të lëvizja që të mbyllja derën.

— A mund t'ju shihja atje ku ndodheshit?

— Sigurisht që po. Kurse ju as edhe një herë s'mi hodhët sytë. Eshtë e kotë të bëhet kjo pyetje: jam e sigurt që nuk më shihnit.

— E pse jeni kaq e sigurt?

— Pse a do ta kishit marrë diamantin ju, po të më shihnit që isha aty? Pse a do të ishit ju tani këtu me mua, po ta dinit që unë atëherë nuk flija, por ju shihja c'po bënët? Mos më detyroni të flas për këtë! Dua që t'i përgjigjem qetësish pyetjeve që po më bëni. Më ndihmoni ta ruaj qetësinë. Vazhdojmë më mirë këto pyetje-përgjigjet.

Kishte të drejtë, në çdo drejtim që ta merrje.

— Po c'bëra pastaj, pasi qëndrova në mes të dhomës?

— U kthyet dhe iu drejtuat qoshes pranë dritares ku ishte dollapi indian.

— Qëndrova më shpinë nga ju, domethënë. E si e patë c'bëra?

— Në dhomën e pritjes janë tri pasqyra. Kur qëndronit aty, ndoqa pasqyrimin tuaj në pasqyrë.

— E çfarë patë aty?

— E vutë qiririn mbi dollap, hapët sirtarët njërin pas tjetrit deri sa arritët tek ai ku kisha vënë diamantin. Patë për disa sekonda brenda, futët dorën dhe nxorrët diamantin.

— Nga e dini që nxora diamantin?

— E pashë si e futët dorën në sirtar, pashë vezullimin e diamantit ndërmjet gishtit tuaj tregues dhe të madh, kur e nxorët nga sirtari.

— Po nuk e zgjata përsëri dorën, për shembull, për të mbyllur sirtarin?

— Jo. Diamantin e kishit në dorën e djathtë, kurse qiririn nga dollapi e morët me dorën e majtë.

— Dhe përsëri pashë rrretherrotull?

— Jo. Qëndruat fare pa lëvizur dhe, me c'mbaj mend, jo pak. Jua pashë fytyrën në pasqyrë. Dukeshit i menduar, i pakënaqur nga gjithë c'bluanit në veten tuaj.

— Po pastaj c'farë ndodhi?

— Sakaq u shkundët nga gjendja e menduar dhë dolët nga dhoma.

— Derën e mbylla pas vetes?

— Jo. Dolët shpejt në korridor dhe e latë derën të hapur.

— Po pastaj?

— Pastaj drita e qiririt tuaj u zhduk, dhe zhurma e hapse tuaja u shua; unë mbeta e vetme në dhomë.

— Dhe asgjë tjetër nuk ndodhi deri në atë kohë, kur në shtëpi u hap lajmi se diamanti që zhdukur?

— Asgjë.

— Jeni e sigurt pér këtë? Mos ju mundi gjumi pér pak kohë?

— Unë nuk mbylla sy, as që u shtriva më në shtrat. Asgjë nuk ndodhi derisa erdhi Penelopa si ngaherë, në mëngjes.

Ia lashë dorën, u çova dhe nisa nga ecejaket népér dhomë. Pyetjeve që kisha u ishte dhënë përgjigje. Deri edhe detajet, që kisha dashur t'i di, i pata mësuar. Bile përsëri më erdhi ai mendimi pér gjendjen somnambul dhe prej të dehuri, dhe përsëri pamundësia e tyre më doli edhe më e qartë se më parë; veç kësaj here nga deponimet e një dëshmitari që çdo gjë e kishte parë me sytë e veta. E ç'mund të thosha tani? Ç'duhet të bëja? Në atë terr të padepërtueshëm, ku qe zhytur gjithçka, qëndronte i patundur një fakt evident, i parë açik. As edhe një fije drite pér hetime të mëtejshme.

Këtë herë ishte ajo që e ndërpree heshqen.

— Epo, — më tha, — ju më pyetët dhe unë iu përgjigja. Më thatë se kishit shpresë se diç do të dilte? Ç'mund të më thoni tani?

Toni me të cilin e tha këtë, më bëri të ditur që i kishte ardhur fundi atij ndikimit tím mbi të.

— Se ne duhej ta riprodhonim bashkë gjithë sa ndodhi atë natë pas kremitimit të ditëlindjes sime, — vazhdoi, — dhe atëherë duhej ta kuptonim shoshoqin. A ndodhi vallë kjo?

Priste e pamëshirshme përgjigjen time. Po ta kisha bërë, do ta kishte mbytur dëshpërimi dhe angushtia.

— Po të ishit shpjeguar atëherë kur duhej, — fillova, — po të ma kishit thënë copë atëherë...

Më ndërpree me një britmë tèrbimi. Fjalët që i thashë e zemëruan pa masë.

— Të isha shpjeguar! — përsëriti. — Po a mund të gjenet një i dytë në botë kështu si unë? E mëshirova duke bërë të më coptohej zemra, e mbrojta kur vihej në pikëryetje tèrë reputacioni im, kurse ky të merr e të qorton, duke të thënë se duhej të isha shpjeguar. Pas tèrë atii besimi, pas tèrë asaj ndjenje, pas tèrë atyre mendimeve ditë e net pa mbarim, pas tèrë atyre èndrrave të llahtarshme

ky këtu të merr e të thotë pérse nuk e akuzova dhe nuk e tur-pérova me të parë! «Oh i dashuri im, ju jeni hajdut! Heroi im i adhuruar, më ke ardhur natën në dhomë dhe më ke vjedhur diamantin! Të dua e të respekoj, por kjo kështu është!» — kështu duhej të të thoshja? Ç'maskarallëk, maskarallëk i padëgjuar! Po unë do të qesh gati të sakrifikoja pesëdhjetë diamante bashkë se sa të pranoja të të shihja atë fytyrën tuaj të masheshtroste ashtu siç po mashtron tan!

Mora kapelen dhe nga mëshira pér të, — e them këtë me ndershëmërinenë më të madhe, — nga mëshira pér të ktheva shpinën pa thënë as edhe një fjalë, hapa derën, në të cilën kisha hyré.

Sakaq ajo u turr drejt derës, më futi, duke më shtyrë, benda, e përplasi fort kur e mbylli dhe më tregoi karrigen ku isha ulur.

— Jo, — më tha, — s'keni ku të shkon! Pra, qénkam e detyruar të përligj sy jush sjelljen time. Uluni, de, dhe dëgjoni. Fo që se ke kundërshtim me këtë dëshirë timen ik, kjo ka pér të qënë poshtërsia më e madhe.

E kisha të rëndë ta shihja, të dëgjoja këto fjalë. I tregova me shenjë, tjeter s'qeshë në gjendje të bëja, se i nënshtrohesha vullnetit të saj.

Të kuqtë e zemërimit herë i dukej e herë i zhdukej në fytyrë. U ula. Priti pak sa mblodhi veten. Kur zuri të flasë, nuk shfaqi pikë ndjenje. Fliste pa më parë në fytyrë. I shtrëngonte fort gjunjët me duar, sytë ia kishte ngulur dyshemesë.

— Pra duhej ta kisha vénë në vend drejtësinë dhe t'uak kisha bërë të ditur, thoni ju. Dëgjoni atëherë, a jam përpjekur të jem e drejtë apo jo. Sapo ju thashë që nuk rash të flifa pasi dolët nga dhoma. S'ka asnjë dobi t'ju llokanis kokën me tregimin pér mendimet që më roitnin në kokë, s'keni pér të më kup-tuar: ju them vetëm se çfarë bëra kur e mblodha veten pas pak kohe. Vendosa të mos ndihesha fare, të mos i kallzoja kujt rër gjithë çka ndodhi. Kurse në të mirën time ishte ta bëja këtë. Edhe pse çdo gjë e pashë me sytë e mi, ju doja aq shumë, saqë isha gati t'i zija besë gjithçkaje, por jo asaj që ju qën-keni hajdut. Mendova, mendova dhe i dhash karar t'ju shkru-a ja.

— Këtë letër unë nuk e kam marrë.

— E di që nuk e keni marrë. Pak durim dhe do ta merrni vesh përse. Ajo letër asgjë të qartë nuk do ju rrëfente. S'kishte për t'ju marrë më qafë, po të binte në dorën e ndokujt. Aty vetëm thuhej se kisha arsyë të mendoja që jeni deri në fyt me borxhe dhe se si unë, si mamaja ime e dimë që s'para jeni i kujdeshëm në mënyrën e të siguruarit të parave, kur ju nevojiten. Pastaj ju do të njiheshit me propozimin tim për t'ju ofruar një shumë të mirë të hollash borxh. Dhe do ta kisha gjetur atë! — tha Recëlli me zë të lartë. Përsëri iu ndezën faqet prush, sytë më panë ngultas. — Do të lija peng diamantin, po të mos e siguroja dot atë shumë me rrugë tjetër. Ja për këtë ju shkrova. Po mos u ngutni të flisni, bëra edhe më shumë se kaq: e porosita Penelopën t'ua japë atë letër vetëm juve në dorë. Thashë të fshiheshët në dhomën e gjumit dhe ta lëja dhomën e pritjes pa njëri tërë atë mëngjes. Shkoja me shpresën, dhe besoja me gjithë shpirt, që do ta shfrytëzonit këtë rast dhe fshehtas do ta vinit diamantin në dollap.

Bëra diç të them, po ajo më ndaloi me një lëvizje që shprehte padurim. Përsëri dukej e inatosur. U ngrit nga karria e dherës m'u afroa.

— E di ç'do më thoni, — vazhdoi. — Doni të ma kujtoni se këtë letër nuk e keni marrë. Dhe mund t'ua them unë përse: e grisa.

— E pse?

— Sepse parapëlqeva ta bëj më mirë copë-copë se sa t'ia jepja një njeriu si ju! E ç'lajme mësova atë mëngjes? Se ju — ju!!! — i pari u hodhët për të thërritur policinë. U treguat më i zellshmi se të tërë në hetimet për gjetjen e diamantit! Madje guximi juaj arriti deri në atë shkallë saqë u orvatët të flisni edhe me mua për punën e zhdukjes së diamantit që e kishit vjedhur vetë dhe që tërë kohës ishte në xhepin tuaj! Pas kësaj e bëra copë e çik letrën. Veç edhe pas gjithë këtyre një si verbëri e çuditshme më pengonte të ndërprisia çdo lloj lidhje me ju. Dikush më tha se ishit në tarracë. Erdha edhe unë aty. Mezi e detyrova veten t'ju shihja në fytyrë, të hapja muhabete. E mbaj mend mirë c'ju thashë, sepse e pata menduar mirë qysh më parë. Ju dhashë jo një mundësi për të më thënë të vërtetë. Nuk ju thashë vetëm se e dija që këtë vjedhje e keni bërë ju. Kurse ju më shihnit me një habi të shtirë, me një pafajësi

të rrëme, ja kështu siç më shihni edhe tani. U largova atë mëngjes nga ju pasi u binda përfundimisht se kush qënkeni: maskarai më i poshtër, që ka ekzistuar ndonjë herë në botë!

— Po të m'i kishit thënë atëherë që të gjitha, Recëll, do të largoreshet nga unë me vetëdijen se keni fyer rëndë një njeri të pafajshëm.

— Po ta thosha sy njerëzish, do të ishit damkosur në jetë të jetëve! Po t'ua kisha thënë juve vetëm, do të fshiheshit, ashtu siç po fshiheni edhe tani! Pse mos ju shkon në mendje se do ju besoja? E c'i kushton gënjeshtra një njeriu si ju që bëri atë që unë e pashë me sytë e mi? Po jua përsëris, më kallte tmerrin qoftë edhe mendimi se do ju dëgjoja të më mashtronit, e, kur, pas asaj që e pashë me sytë e mi. Se unë juve as tani nuk ju besoj! Nuk ju besoj që e keni gjetur atë këmishënatë; nuk ju besoj që Rozana Spirman ta ketë shkruar atë letër; nuk i besoj as edhe një fjale tuajës. Ju e vodhët diamantin, ju pashë me sytë e mi! Ju u shtirët gjoja sikur donit ta ndihmonit polici, këtë e pashë vetë! Ja keni lënë peng diamantin atij fajdexhiut londinez, jam e sigurt për këtë! Ju hodhët hije dyshimi dhe çnderimi, nga që në mënyrë të poshtër heshta unë, mbi një njeri të ndershëm! Ju ia mbathët edhe jashtë shtetit, duke e patur në xhep atë gur të çmuar! Pas gjithë këtyre fëlliqësirave mundët të bënët edhe këtë: erdhët këtu me gënjeshtën e fundit në gojë, të më thoni se ju dënokam me pa të drejtë.

Po të qëndroja edhe një minutë, mund të shpërtheja në një të tillë baterie fjalësh, që do pendohesha më pas. E lashë mëjanë Recëllin dhe bëra të hap përsëri derën. Dhe përsëri me atë mendjeshkurtësinë e gruas, që e ka humbur kontrollin mbi veten, më kapi nga krahu dhë më zuri rrugën.

— Largohuni nga dera, Recëll, kështu do të jetë më mirë për të dy ne. Hapuni, — i thashë.

Kraharori i gufonte nga zemërimi, frymëmarrja e shpesh-tuar dhë vrullshme më përplasej në fytyrë.

— Po pse erdhët këtu? — më pyeti si në makth. — Mos keni frikë se ju denoncoj? Tani jeni i pasur, njeri me peshë në shqëri, mund të martoheni me nusen më të mirë në tërë Anglinë dhe trembeni se tërë këto fjalë që ju thashë juve ia them edhe të tjerëve? Jo! S'mund t'ia them kërkujt këto fjalë. S'mundem t'ju denoncoj! Se jam më e keqe ndoshta edhe se ju...

U shkreh në dënesa edhe pse bënte aq shumë për të mos i ndodhur kjo.

— Nuk po mundem dot ta shkul nga zemra ndjenjën që kam për ju, — thirri. — As edhe tani! Mund ta shfrytëzoni fare mirë këtë dobësi timen për dobinë tuaj!

Më lëshoi, ngriti lart krahët dhe rënkoj e dëshpëruar.

— Cilado grua do ta kishte për turp t'i afrohej një të tilli! Zot i madh! E përbuz veten më shumë sa përbuz atë!

Më dolën vetvetiu lot në sy, s'kisha më forcë ta duroja këtë skenë të tmerrshme.

— Do ta merrni vesh ndonjëherë që s'keni fare të drejtë, kur silleni kështu me mua. Ndoshita edhe nuk do shihemi më!

Dola nxitimthi. Ajo brofi nga karrigia, ku u ul para një minute, dhe, o kriesë fisnike, më përçollti përmes dhomës fjinje, duke shqiptuar ndërkokë këto fjalë mëshirëplotë:

— Frenklin! Jua fal që të gjitha! Oh, Frenklin, Frenklin! Nuk kemi për t'u parë më kurrë. Ma thoni që edhe ju më falni.

U ktheva që të mund ta lexonte në fytyrën time atë që s'kisha forca t'ia thosha, pastaj tunda dorën dhe e pashë turbull, përmes lotëve që më shkuant çurg.

Gjithçka kishte marrë fund. Dola përsëri në kopsht. As shihja e as dëgjoja më.

8.

Në mbrëmje vonë erdhi pa kurrfarë njoftimi zoti Bref. Kishte ndryshuar shumë; s'e kishte atë vetëbesimin e tij të zakonshëm, dukej apatik. Ma shtrëngoi heshturazi dorën.

— Me c'po shoh, — filloj zoti Bref, — jemi të detyruar të bëjmë këto përfundime: ju s'keni as pikën e dyshimit që Reçelli ju tha të vërtetën edhe pse do ta marrim vesh që në këtë mes ka ndodhur një gabim i tmerrshëm. Reçellin s'e akuzon dot për asgjë.

— Nuk e akuzoj Reçellin, — e ndërpreva. — Unë vetëm i shpreva keqardhjen që nuk vendosi të ma kishte thënë troç që atëherë.

— Duke e njojur mirë vajzën, — ma ktheu zoti Bref, — fare lehtë mund të pohohet se ajo këtë nuk mund ta bënte. Do të bënë mirë ta harronim gjithë q'ka ndodhur vitin e kaluar në shtëpinë e zonjës Verinder, dhe të shohim q'mund të ndërmarrim në të ardhmen. Ju pyes edhe një herë zoti Frenklin, i përbaheni ende mendimit se shkaktar i tërë këtyre telashevë éshtë **Guri i Hënës**?

— Sigurisht, që ai éshtë.

— Dhe tanë ai ndodhet në një bankë të Londrës, te zoti Luker. Por dihet që s'jeni ju ai që e ka lënë peng. Po kush ésh-të? S'dihet. Veç ai njeri, po nuk qe në gjendje të shlyejë pen-gun, do detyrohet t'ia lërë diamantin zotit Luker. Duhet të vë-më njeri të gjurmojë veprimet e zotit Luker në fundin e këtij muaji.

Pranova të bëhej kjo edhe pse s'arrita dot ta shoshis mirë këtë mendim.

— Ky éshtë edhe mendimi i zotit Mertuet, — vazhdoi zoti Bref. — Sipas tij, edhe indianët do të gjurmojnë çdo veprim te banka. Ndoshta do të ndodhë diçka serioze. Çfarë pikërisht ne nuk na intereson fare, kryesore éshtë të mësojmë kush éshtë ky pengvénës misterioz. Them se pikërisht ai dhe éshtë shkak-tari i kësaj gjendjes së vështirë në të cilën u ndodhët; vetëm zbulimi i tij ia kthen respektin Recëllit.

— Smund ta mohoj, — i thashë, — që ky plan éshtë tepër i guximshëm dhe i hollë, por... do të jemi të detyruar të presim.

— Sipas përllogaritjeve të mia, rreth dy javë. Pse mos ésh-të shumë?

— Jo shumë, por një shekull éshtë, zoti Bref, — i thashë. — Jeta më éshtë bërë e padurueshme, më duhet të veproj shpejt pér të vënë në vend nderin tim.

— Ju kuuptoj, po a keni menduar ndonjë gjë konkrete?

Kisha vendosur të këshillohesha me dedektivin Kaf.

— Po mirë, — lëshoi pe zoti Bref. — Të veprojmë në të dy krahët. Dedektivit Kaf i thoni nga ana ime se zbulimi i së vërtetës gjendet i përqëndruar në personin që e ka lënë peng dia-mantin. Ma bëni të ditur mendimin e zotit Kaf.

Me këtë dhe u ndamë.

Të nesërmen në mëngjes u nisa për në qytetin e vogël Dorking, ku, sipas fjalëve të Beterexhit, jetonte i vëtmuar dektrivi Kaf. Vila ndodhej larg qytetit, e rrëthuar nga një kopsht për merak. Dericka qe mbyllur. Përmes hekurave pa shë bimët e dashura të Kafit të famshëm: ishin të një bukurie të rrallë. Gruaja e moshuar që më hapi derickën, më bëri të ditur se zoi Kaf një ditë më parë ishte nisur për në Irlandë. I dhashë kartvizitën time, pasi shkrova me kalem: «Kam njoftime për «Gurin e Hënës». Më çoni lajm me t'u kthyer». S'më mbeti tjetër, veçse të kthehesha në Londër. Me të mbërritur, i bëra një vizitë kortezie kushërit tim zotit Godfri Ebluajt, por s'gjeta njeri. Para një dite edhe ky ishte nisur për në Duvër. U nisa pa vonesë për në Frizingol, që ishte tanë pika e përqëndrimit të kërkimeve të mia. Takova Beterexhin dhe bashkë vendosëm t'i bënim një vizitë doktor Kandit. Nuk isha i përgatitur të shhja tërë ato ndryshime që kishin ndodhur: sytë i qenë shuar, flokët i qenë zbardhur, fytyra i qe rrudhosur, shpina i qe kërrusur. M'u ndërmendën ato shakatë e kripura dhe shpotitë gudu-litëse që lëshonte, por ato i kishin lënë shëndenë. S'ishte veçse një gërmadhë e së dikurshmes, po të përjashtonim veshjen lagane e spic, plot me zbukurime, që në mënyrë sarkastike theksonte ndryshimet e thella që i kishin ndodhur.

— Ju kam kujtar jo një herë, zoti Blek, — tha doktori. — Jam thellësish i gjëzuar që ju shoh. Po të mundem të bëj diçka për ju. ju lutem, jam në dispozicionin tuaj!

I tregova përsë kisha ardhur përsëri në Jorkshir: për disa të dhëna të reja lidhur me zhdukjen e atij diamantit para një viti, për preokupimin që ndjeja si antar i asaj familjeje. I thashë se doja ta pyesja për ndonjë gjë që mund të paraqiste interes lidhur me ditëlindjen e zonjushës Reçell. Kur i përmenda këtë, e kuptova nga shprehja e fytyrës së zotit Kandi që sprova s'pati sukses. Rinte si i hutuar dhe i përhumbur, më shihte si i mpirë dhe i hupët. Madje shpejt vura re se s'po më dëgjonte fare. U detyrova ta ndryshoja temën e bisedës. Kaloi fare pak kohë dhe i thashë zotit Kandi që më kishte çuar lajm, përmes Beterexhit, të viia ta takoja sepse kishte diçka për të më thënë lidhur me atë ditëlindje.

— A! Po! Darka te zonja Verinder! — thirri tërë pasion. — Duhet diç t'ju tregoj për atë darkë!

Sytë e tij përsëri më panë ngultas, në mënyrë pyetëse dhe me një shprehje të thellë keqardhjeje e pafuqie sa që më dhimbëj. Bënte sforcim të dukshëm pér të kujtar diçka, por nuk mundej ta kujtonte.

U largova nga doktor Kandi me mendimin e hidhur se dente diç të më thoshte, shumë të rëndësishme pér mua, por kujtesa e kishte lënë dhe s'arrinte dot ta ndërmendëte.

Kur zbrita shkallët dhe mora në drejtim të derës së daljes, një zë i mekur, i përkorë më foli ultas:

— E gjetët shumë të ndryshuar zotin Kandi, zotëri, apo jo?

Ndala në vend dhe u gjenda ballëpërballë me Ezra Xheningsin.

9.

Nuk kishe si e hidhje poshtë mendimin e Beterexhit se pamja e jashtme e Ezra Xheningsit nuk fliste në favor të tij. Dukej edhe i ri, edhe plak në të njëjtën kohë, veç kishte në të edhe diçka që të bënte ta simpatizoje.

Vura re që kërkonte rastin të bisedonte me mua kokë më kokë pér të zotin.

— Mos e kemi bashkë rrugën, zoti Xhenings? — e pyeta kur pasqë që mbante ndër duar kapelen — i o sëkoj pér një vizitë te tetu Ebluajt.

Ezra Xheningsi m'u përgjigj se do shkonte te një i sëmu-rë që banonte në po atë anë.

Shkoi llafi te sëmundja e zotit Kandi.

— Me ç'duket. — ia fillova unë, — sëmundja e zotit Kandi paska qënë ku e ku më e rrezikshme nga ç'paskemi pandehur.

— Është një mrekulli që mbeti gjallë, — m'u përgjigj Ezra Xheningsi.

— Po kujtesën kështu e ka vazhdimisht, apo me hope? Seç nisi të më thoshte, por s'e kujtoi që s'e kujtoi dot...

— Mos ka pas ndodhur para se të sëmurej? — më pyeti.

— Po.

— Thuajse e ka lënë fare kujtesa, — tha. — Ndonjë dëshirë e kahershme edhe i ndërmendet turbull; por se çfarë, s'e

thotë dot. Është shumë i brengosur nga humbja e kujtesës dhe bën çmos që të tjerët të mos e vënë re. Sikur pas shërimit ta kishte harruar krejt të kaluarën do të ndihej ku e ku më i lumbur. Se ne të gjithë, — shtoi me një buzëqeshje të trishtë, — do të ishim më të lumtur të mundnim ta harronim fare të kaluarën tonë.

— Çdo njeri, — e kundërshtova, — ka në jetën e tij të tilla ngjarje, me të cilat s'ia ka ëndë kurrrë të ndahet.

— Them se kjo i përket pjesës më të madhe të njerëzimit, zoti Blek. Por druhem se do të jetë e drejtë nëse e shtrijmë në tërë njerëzimin. A thua që ai njoftimi që u përpooq të ringjallte në kujtesë zoti Kandi të jetë i një rëndësie të veçantë përu?

Më zuri kësisoj ngoje pikërisht çështjen për të cilën po bë-hesha gati të këshillohesha me të. Sakaq m'u krijua bindja se kisha të bëja me një njeri fisnik. Kishte në të një si vetëpërmajtje të natyrshme që, jo vetëm në Angli, por në mbarë botën e civilizuar konsiderohet si shenja e parë e edukatës. Cili do që të ishte qëllimi i asaj pyetjeje, isha i sigurt që mund t'i përgjigjesha deri diku hapur.

— Mund t'ju them, se për mua ka shumë rëndësi, ripër-tëritja e atyre rrethanave që zoti Kandi s'është në gjendje t'i ndërmend, — i thashë. Nuk dini vallë ndonjë mënyrë që të ndihmohet kujtesa e dëmtuar?

Ezra Xheningsi më vështron te serioz me sytë gështenjë të mendueshëm ku s'kishte si të mos e vije re pjesëmarrjen.

— Kujtesa e zotit Kandi tanimë nuk mund të ndihmohet. Këtë ua them sakt.

U hidhërova kur e dëgjova dhe nuk e fsheha këtë.

— Kisha shumë shpresë tek ju. — i thashë.

— Por kushedi kjo përgjigje nuk është e formës së prerë, zoti Blek. Ndoshta do të gjenden mënyra për të ripërtërirë rrethanat që i kanë fluturuar nga kujtesa zotit Kandi, pa patur nevojë për ndihmën e tij.

— Vërtet? A s'do tregohesha i ngutur po t'ju pyesja: në c'mënyrë?

— Aspak. Vështirësia e vetme për t'iu përgjigjur pyetjes suaj është në vetë shpjegimin. A mund të shpresoj se do tre-

goheni i duruar, po t'u flas pa mundur t'i shhangim edhe ndopak hollësi të natyrës profesionale?

— Pa tjetër, mezi që pres t'i dëgjoj.

Kjo kërshëri që tregoja, dukej që e kënaqte. Ndali hapin për të këputur disa lule që ishin rritur buzë rruge.

— Sa të mira që janë, — nëpërdhëmbi, duke ma treguar tufën. — Sa të paktë janë në Angli ata që vërtet i adhurojnë ashtu si e meritojnë!

— Nuk keni banuar kurdoherë në Angli? — e pyeta.

— Jo. Kam lindur dhe kam kaluar fëmijërinë në njérën nga kolonitë. Im atë ka qënë anglez, kurse ime më... Po sikur dolëm jashtë teme, zoti Blek, dhe fajtor për këtë jam unë.

S'e pata të vështirë të konstatoja se ishte njeri që kishte hequr shumë në jetë dhe nuk ishte me gjak të pastër anglezi.

— Jeni në dijeni të shkakut të asaj sémundjes së zotit Kandi, zoti Blek? — vijoi sakaaq Ezra. — Bëra shumë për kurimin e saj të plotë, madje u detyrova të shpërfill edhe rekomandimet e dy mjekëve më të dëgjuar të qytetit. Mora përsipër një përgjegjësi të madhe: të përkujdesesha fill i vetëm për shëndetin, ndoshta dhe për jetën e zotit Kandi, gjendja erdhi dhe u keqësua, temperatura e lartë, ethet, dobësimi i përgjithshëm, i shoqëruar edhe me përcartje. S'po futem në analiza të imta të shkakpasojës së përcartjeve, por po ndalem vetëm në përshkrimin e atyre anëve të tyre që për ju paraqesin interes. Nga praktika ime mjeksore kam arritur në përfundimin se në kohë përcartjesh, humbja e aftësisë për të shqiptuar gjëra të lidhura, s'është gjë tjetër veçse rrjedhojë e humbjes së aftësisë për të menduar në mënyrë konsekiente. Edhe sémundja e zotit Kandi ma përforcoi këtë konstatim. E zoteroj mirë stenografinë dhe me lehtësi mund t'i shenoj frazat e ndërprrera që shqipton një i sëmurë me përpikmërinë më të madhe. Këtë e bëra edhe në rastin e përcartjeve së zotit Kandi. Në fillim ajo që pata mbajtur shënim m'u duk diçka kaotike, por kur zura t'i mbarështronjë pjesët e shkëputura, më doli parasysh një tablo e përfunduar krejt e qartë.

— A e përmendi ndonjëherë emrin tim në ato përcartjet, — s'mu durua ta pyes.

— Tani do i mësoni që të gjitha, zoti Blek. — vijoi Ezra. — Në ato shënimet stenografike përmendet edhe emri juaj, zoti Blek. I ruaj si shprehjet kaotike të të sëmurit gjatë përcartjeve, ashtu dhe tekstin e formuluar sipas hamendjes sime.

— Shkojmë t'i shohim ato shëname, — i fola me padurim.

— Po këtu ka një problem, zoti Blek. — më ndali Ezra Xheningsi. — A kam të drejtë, vallë, t'ia bëj të ditur një personi të tretë atë që i sëmuri e ka nxjerrë në gjendje të pavetë-dijshme?

— Tërë puna është në i bëj dëm apo jo mikut, — u përpoqa ta kundërshtoj.

— Sidoqoftë, — vazhdoi, — s'mund të bije dakord t'ua bëj të ditur pa më parashtruar më parë arsyen pse duhet ta bëj këtë.

U ndodha para mëdyshjes në duhej ta vija veten në atë gjendje poshtërimi e t'i rrëfeja fare sinqerisht, siç kish bërë ai deri tani me mua, pse qeshë aq i interesuar të dija brendinë e përcartjeve të zotit Kandi për mua. S'kisha nga ia mbaja, ia tregova me kujdes dhe takt. Më dëgjonte me shumë vëmendje por, kur mbarova, më tha:

— Më vjen keq, zoti Blek, se ju bëra t'ju lindin ndopak shpresa, të cilat janë parapërcaktuar me zhgënjim. Tërë atë kohë të lëngatës zoti Kandi as edhe një herë nuk e zuri ngoje diamantin. Emrin tuaj e përmendi në raste që s'kishin asfare të bënин me atë gur të çmuar të zonjushes Regëll.

Në këtë e sipër bashkëudhëtari im më dha të kuptojoë se i duhej të ndiqte një rrugë tjetër. Ndala në vend dhe thashë me vete: «S'kam si ia bëj ndryshe, duhet thënë e vërteta deri në fund».

— Nuk u thashë diçka të rëndësishme, zoti Xhenings, — fillova. — Interesi im për ato kujtimet e zotit Kandi darkën e ditëlindjes nuk ka të bëjë me kërkimet e diamantit. Është një çështje personale, për mua jetike ajo që më solli këtu në Jorkshir. Veç e kam shumë po shumë të vështirë të hapem.

Ezra Xheningsi më pa disi i hutuar.

— Nuk kam as të drejtë e as dëshirë, zoti Blek, të përzihem në punët tuaja private. Ju kérkoj ndjesë nëse pa dashjen time ju vura para kësisoj provash.

— Është e drejta juaj të më diktoni gjithfarë kushtesh para se të më njoftoni ndonjë gjë nga ato që keni patur rastin të dëgjoni pranë shtratit të zotit Kandi të sëmurë. E kuqtoj dhe e çmoj fisnikërinë që jua dikton këtë. Do ta merrni vesh shpejt përsë jam aq shumë i interesuar të di, çfarë ka dashur të më bëjë të ditur zoti Kandi. Në gabofsha, do ju jap fjalën e nderit që çdo gjë do të ruhet në fshehtësi të plotë, ashtu si dhe ju do më betoheni të ruani në fshehtësi ato që do dëgjoni nga unë.

— Po më parë duhet t'ju bëj të ditur diçka tjetër, zoti Blek. Do përpinqem sa më shkurt. Do ju tregoj aq sa i kam pas treguar edhe zotit Kandi. Po që se pas këtij rrëfimi nuk ndërroni mndje, do të jem në dispozicionin tuaj. Po më parë, në mos jeni kundër, ulemi në atë lëndinë të çlodhemi pak.

Kështu dhe bemë. Pas një çasti m'u drejtua me këto fjalë:

— Zoti Blek. Një akuzë e tmerrshme më është bërë kohë më parë. Emri më është damkosur keq, pa shpresë korrigjimi. S'kam si e detyroj veten që ta pranoj këtë akuzë, por s'kam as si e vërtetoj pafajësinë time: pér rrjedhojë hoqa dorë përfundimisht nga karriera mjeksore, u ndava me gruan që e desha. Mallkimi më ndoqi pas, u detyrova të këmbej disa vende pune. Edhe pse s'jam veçse dyzet vjeç, ndihem i kapitur, andrallat më kanë plakur para kohe. Fati, më në fund, më solli në këto anë: zoti Kandi kishte nevojë pér ndihmës. Rekomandimin pér zotësinë profesionale e kisha të shkëlqyer, veç damka më mbetej damkë. Ia bëra këtë të ditur zotit Kandi. «Nëse ju jeni gatë të riskoni, edhe unë jam gati të rishkoj bashkë me ju», — më tha doktor Kandi, kur e mbarova rrëfimin dhe e paralajmërova se isha i detyruar të jetojë me emër tjetër.

— Të bekoftë zoti! — më tha. — Më dha strehë, më bëri të ushtroj profesionin, m'i dhuroi qetësi shpirtit dhe jam i bindur se tanimë s'ka pér të ndodhur asgjë e tillë që do ta bënte të pendohej.

— Mos zuri karar ajo shpifja? — e pyeta.

— Jo, është më e fortë se kurrë. Por sa të vijë deri në këto anë, ka pér të qënë vonë.

— Do të largoheni kur ta shihni të nevojshme?

— Jo, zoti Blek, atëherë nuk do të jem gjallë. Kam dhjetë vjet që vuaj nga një sëmundje e pashërueshme. Do e kisha lënë prej kohësh veten që ajo sëmundje të bënte të vetën, por kam

një njeri të shtrenjtë që dua ta lë të siguruar... Dhe tanimë e kam arritur këtë... Tani ju takon juve, zotëri, të vendosni në duhet të më hapeni lidhur me atë të fshehtën tuaj munduese.

Pa u lëkundur as edhe një çast ia tregova tërë historinë e zhdukjes së diamantit. U çua i tronditur në këmbë dhe po më shihte me zemër të ngrirë dhe me frymëmarrje të ndalur.

— S'ka asnjë dyshim që kam hyrë në atë dhomë, që e kam marrë diamantin. Veç mund t'ju them me bindje të plotë që e kam bërë fare pa vetëdije.

Ezra Xheningsi më kapi prej krahut.

— Prisni! — thirri. — E kam të qartë çështjen. A s'më thoni, ju ka rastisur ndonjë herë të pini opium?

— Kurre ndonjëherë në jetën time.

— Mos keni patur shqetësimë nervore vitin e shkuar në këto kohë? Mos keni patur shqetësimë të ndonjë lloji të veçantë apo ngacmimi të fuqishme?

— Po, kam patur.

— Keni vuajur nga pagjumësia?

— Shumë. Net të tëra s'kam pas mbyllur sy fare.

— Mos ka bërë përjashtim vetëm nata e ditëlindjes së zonjushës Verinder? Përpinquni ta kujtoni, keni pas bërë gjumë të mirë atë natë.

— Më kujtohet fort mirë që fjeta për mrekulli.

Ma lëshoi krahun po aq befas siç edhe ma kapi dhe më pa siç sheh njeriu i shkarkuar nga barra e dyshimit mundues.

— Është një ditë e mrekullueshme ajo në jetën tuaj dhe timen! — tha me bindje të palëkundur. — Një gjë mund t'ua them të sigurt, zoti Blek: e di ç'ka dashur t'ju thotë zoti Kandi; gjendet e shkruar në ato shënimet e mia ajo. Po prisni, ka edhe më: jam krejt i sigurt që në mënyrë fare të pavetëdijshme keni hyrë në dhomë dhe e keni marrë diamantin. Më lejoni tani t'ju pyes hollësisht. Më duket se dëshmja e pafajësisë suaj gjetet në duart e mia!

— Si kështu! ç'doni të thoni me këtë?

Atë çast dikush e thirri nga rruga aty pranë.

— Erdha, — iu përgjigj ky. — Një minuti! Më pret në këtë fshat një i sëmurë rëndë; — më tha. — Duhej të kisha qënë tek ai një gjysmë ore më parë, më duhet të shkoj. Pas dy orësh ejani përsëri te zoti Kandi; do më keni në dispozicion.

— Po si mund të të pres! — thirra me padurim. — A nuk mund të më qetësoni me një fjalë para se të ndahemi?

— Është një çështje disi e koklavitur e nuk shpjegohet me një fjalë, zoti Blek. S'është kapriçoja ime ajo që ua diktton këtë provë durimi; përkundrazi, do t'ua bëja të padurueshme pritjen po të përpinqesha t'ua lehtësoja tani. Mirupafshim në Frizingol pas dy orësh, zotëri!

U dëgjua përsëri zëri i njeriut në rrugë dhe ai u largua, duke më lënë vetëm.

10.

Ajo torturë dyorëshe m'u shoqërua ja me çfarë: s'më rrjehë në një vend, s'më flitej me kënd. Jo vetëm hoqa dorë nga vizita te teto Ebluajti, por nuk desha as të takohesha me Gabriel Beterexhin. Dola nga qyteti dhe shëtitë jashtë tij, derisa ora më tregoi se kishte ardhur koha e shumëpritur për t'i bërë vizitën zotit Kandi.

Ezra Xheningsi po më priste. Ishte vetëm në atë dhomën e vogël, dera prej xhami e së cilës të conte në farmaci.

— Ju kërkoj ndjesë, zoti Blek, që po ju pres në këtë dhomëzë, — më tha. — Është e vjetmja në tërë godinën ku në këtë orë do jemi të sigurt që nuk do të na shqetësojë kush. Ja dhe letrat që kam përgatitur për ju; këto librat i vura këtu sepse do të na duhet t'i hapim para se të përfundojmë bisedën tonë. Afrohuni te tryeza dhe t'i shohim së bashku që të gjitha me radhë.

Afrova karrigen dhe ai zuri të më japë njërin pas tjetrit shënimet. I kishte mbajtur në dy letra të mëdha. Në njërin ishin shkruar fjalë me ndërprerje nga njëra-tjetra në tjetrën ishte shkruar teksti i lidhur nga fillimi deri në fund.

— Pa më thoni, de, para se të lexoj këto letra, ç'më pret pas këtij njoftimi?

— Me kënaqësi do ta bëja këtë, zoti Blek! A më lejoni t'ju bëjë nja dy-tri pyetje?

— Pyesni për çfarë të doni.

Më pa me një buzagaz të trishtë dhe me një shikim kuptimplotë të syve gështenjë.

— Më thatë se, me sa dini, kurrë nuk keni vënë në gojë ndonjëherë opium.

— Me sa di unë kështuështë, — i thashë.

— Nuk ju kujtohet, pra, që ndonjë herë të keni pirë opium. Ja, vitin e kaluar keni qënë me nerva të prishura, keni patur pagjumësi. Atë natën e ditëlindjes së zonjushës Verinder, thatë se keni fjetur mirë? A mund të më thoni, cili ka qënë shkaku i atyre çrregullimeve?

— Jo, s'mund ta them. Me sa di unë, plakoshi Beterexh thotë se e ka të qartë shkakun. Por kjo as që ia vlen të përmendet.

— Më falni, por që të gjitha janë të rëndësishme. E si i shpjegon këto çrregullime Beterexhi.

— Me lënien e duhanit.

— Pse e kishit pirë më parë?

— Po.

— Dhe e latë menjëherë?

— Po, menjëherë!

— Beterexhi ka të drejtë, zoti Blek. Pagjumësia, përmendimin tim, me këtë dhë shpjegohet. Pyetja tjetër ka të bëjë me zotin Kandi. Mos keni patur me të, atë darkë apo më parë, ndonjë debat lidhur me profesionin e tij?

Pyetja më solli ndër mend një kujtim të trubullt të asaj që ndodhi në darkë. E kisha atakuar mjekësinë me aq rreptësi dhe ashpërsi, sa që kisha bërë të prekej zoti Kandi. M'u kujtua gjithashtu që zonja Verinder kishte ndërhyrë përt'i dhënë fund këtij debati dhe me doktorin topolak qemë pajtuar, siç shprehen përfémijët, kishim mbetur përsëri miq, kur i shtrënguam shoshoqit dorën para se ky të largohej.

— Ka edhe një diçka tjetër që do të desha të dija, — tha Ezra Xheningsi. — Mos keni patur ndonjë ngasje shqetësuese me Gurin e Hënës në këtë vitin e kaluar?

— Kam patur dhe madje të fortë. Mora vesh se donin ta grabisin me çdo kusht dhe më patën paralajmëruar të merrja masat e duhura përt'a ruajtur zonjushën Verinder, së cilës i përkiste.

— Mos folët para se të shkonit të flinit përményrën si do të ishte më mirë përt'a ruajtjen e diamantit?

— Zonja Verinder foli për këtë me të bijën...

— Në praninë tuaj?

— Po, në praninë time.

Ezra Xheningsi mori shënimet dhe m'i zgjati.

— Zoti Blek, — më tha. — Po t'i lexoni tanë këto shënimë, pas kësaj bisedës sonë, do të arrini të bëni disa zbulime të çuditshme që lidhen me ju: se keni hyrë në dhomën e zonjushës Verinder dhe e keni marrë diamantin në gjendje të pavetëdijshme, të shkaktuar nga opiumi, dhe se atë ua ka dhënë zoti Kandi, pa dijeninë tuaj, që konkretisht, nga përvoja juaj, të bindeshit për pavërtëtesinë e atyre mendimeve që shprehët atë darkë ditëlindjeje të zonjushës Reçell, lidhur me mjekësinë.

Rrija me ato fletë ndër duar si i fandaksur.

— Faljani këtë të gjorit Kandi, — tha i përkorë Xheningsi. — Ju shkaktoi dëm të pallogaritshëm, por pa prapamendim. Ju do ta shihni në ato shënimë, se po të mos ishte sëmurur, do të vinte te zonja Verinder në mëngjes dhe do ia bënte të ditur shakanë që bëri. Kësisoj e vërteta do të qe sqaruar.

— S'kam si i zë mëri zotit Kandi, në atë gjendje në të cilën ndodhet! — thashë i pezmatuar. — Sidoqoftë shakaja që provoi të bënte ishte tejet e pabesë. Mund edhe t'ia fal, por për ta harruar — kurrrë!

— Njihuni me këto shënimë, — vazhdoi Ezra, — përpiku-ni të përsëritni në vetëdijen tuaj gjithë ç'ju ndodhi atë natë, kam ndër mend t'ju propozoj një diçka tepër të guximshme dhe të beftë për të ardhmen.

Këto fjalë më dhanë zemër. Iu vura shikimit të vëmend-shëm të fletëve. Ja se ç'lexova:

«Zoti Frenklin Blek është i zgjuar dhe i këndshëm, por duhet ta firapsë pak atë fodullëkun, kur jep mendime për mjekësinë. E pranon që vuani nga pagjumësia. I them që i ka të prishura nervat dhe ndaj duhet të kurohet. Ai më thotë se si të kurohesh, si të shkosh në qilarin e errët është e njëjta gjë. Dhe e thotë në sy të të gjithëve, gjatë darkës. I them: jeni ju ai që e kërkoni gjumin qorrazi në qilarin e errët dhe asgjë përveç ilaçeve nuk ju ndihmon dot ta gjeni. Ai ma ktheu se ka parë njëherë një të verbër që mbante përdore një të verbër tjetër dhe e di mirë se ç'do të thqtë kjo. E thënë e hollë, sigurisht, por ama unë jam aq i zotit sa ta bëj të flejë tërë natën pa u

zgjuar as edhe një herë. Të vërë mendje e të dijë ku ta vërë në përdorim atë gjuhën brisk të hollë. Se vërtet që po ngordh pér gjumë dhe farmacia e zonjës Verinder është në dispozicionin tim. T'i jap ndonja njézet e pesë gran¹⁾ laudanum para se të bjerë të flejë, pa dijeninë e tij dhe të vijë ta shoh të nesërmen në mëngjes. «Hë, si, zoti Blek, a do të pranoni të merrni ndopak ilaç sonte? Pa ndihmën e tij s'keni si e kuroni pagjumësinë». — «Gaboni, zoti Kandi, — do më thotë, — kam bërë një gjumë të shkëlqyer natën që shkoi pa ato ilaçet tuaja».

Dhe atëherë t'i bëj mat, duke ia zbuluar të vërtetën:

«Bëtë gjumë të shkëlqyer natën që shkoi ngaqë pitë laudanum, zotëri, që jua dhashë para se të flinit. Hë, po tanë, c'do të thoni pér mjekësinë?»

Mbeta i mahnitur nga aftësia depërtuese e Ezra Xheningsit që atë lesheli përcartjesh të doktor Kandit ta riprodhonte aq shtruar dhe aq lidhur. Me atë modestinë që e karakterizonte m'u drejtua me pyetjen në isha i njëmendjeje me të pér përfundimin?

— A mendoni edhe ju si mendoj unë që gjithë c'ju ndodhi atë natë në shtëpinë Verinder ka qënë ndikim i laudanumit? — më pyeti.

— Di pak pér forcën ndikuese të tij, por i besoj tërësisht bindjes që keni krijuar ju, — iu përgjigja.

— Shumë mirë. Tani i duhet dhënë përgjigje edhe një pyetjeje tjeter: ju jeni i bindur, edhe unë po ashtu, por si do të bindim pér këtë të tjerët?

I tregova fletët që rrinin mbi tryezë.

Ezra tundi kokën në shenjë mohimi: — S'na hyjnë në punë pér këtë, zoti Blek. Dhe ja përsë: janë shkruar në ca rrethana krejt të panjohura pér shumicën dërrmuesë të njerëzve, në të ka gjetur pasqyrim një pikëpamje e re në mjekësi, që ende nuk është vërtetuar në praktikë dhe, më në fund, këto shënimë janë të mijat, janë diçka personale; përveç pohimit tim, asgjë nuk e vërteton që s'janë sajime. Kujtoni c'ju tregova atje në lëndinë pér veten time: c'peshë mund

1) pikëz.

të kenë sy njerëzve fjalët e mia? Në opinionin publik këto shë-nime nuk kanë asnë vlerë, por ama na e bëjnë të qartë mënyrën si duhet ta vërtetojmë pafajsinë tuaj!

— Në ç'mënyrë? — e pyeta.

U përkul me trup drejt meje përmbi tryezë.

— A jeni gati t'i nënshtroheni një sprove të guximshme?

— Jam gati për gjithçka vetëm të më hiqet damka e dyshimit! — i thashë.

— Jeni dakord t'i nënshtroheni edhe disa parapërgatitjeve për sprovën?

— Jam dakord për gjithçka!

— A do t'i bindeni të gjitha këshillave që do ju jap? Ndonsjë i trashë do mund edhe t'ju qeshë, ndonjë i mençur mundet edhe t'ju porosisë të hiqni dorë, ju s'keni për t'u tundur nga vendimi i marrë, kështu apo jo?

— Vetëm më thoni se ç'duhet të bëj, — i fola me padurim,

— dhe të kalojmë nga fjalët në vepra.

— Me që është kështu, zoti Blek, ju duhet ta vidhni përsëri **Gurin e Hënës**. Ta vidhni pa qënë i vetëdijshëm, në prani të dëshmitarëve.

Brofa. Bëra të flas... Por vetëm e pashë ngultas.

— Them se kjo mund të arrihet, — vijoi. — Dhe do të arrihet në rast se ju do më ndihmoni. Qetësohuni. Dëgjomëni me vëmendje. Ju pashë që e ndezët një cigare pak më parë, ja edhe tani e nxorët një tjetër. Keni kohë që e pini?

— Kam ndonjë vit.

— Pini më shumë apo më pak se më parë?

— Më shumë.

— A hiqni dot dorë, kuptohet, në mënyrë të beftë, si atëherë?

E kuptova se ku donte të dilte.

— E lë që tani, — iu përgjigja.

— Në qoftë se kjo do të shoqërohet nga po ato pasoja të vtit të kaluar, domethënë se keni përsëri pagjumësi, them se e kemi bërë hapin e parë. Duhet të ndodheni përsëri në atë gjendjen e tronditur nervore që keni qënë vitin e kaluar. Nëse do të arrijmë të përtërijmë afërsisht atë mjesid, në të cilin keni qënë vitin e kaluar, nëse do të mundim ta përtërijmë tërë atë botë mendore dhe shpirtërore, në të cilën keni pas jetuar vitin

e kaluar, nëse do i kthehem mendimeve për diamantin, që aq shumë ju ka pas emocionuar, do të arrijmë të viheni fizikisht dhe moralisht sa më afër që të jetë e mundur ose në atë gjendje që ishit kur e morët atë dozë opiumi vitin e kaluar. Kësisoj mund të shpresojmë që përsëritja e po asaj doze opumi mund të çojë në një shkallë më të madhe apo më të vogël në përsëritjen e rezultateve të dozës së parë. Ja se ç'dua të provoj. Tani po ju shpjegoj përsë e quaj të mundur këtë sprovë.

Mori librin, që ishte aty pranë, dhe e hapi në vendin ku kishte vënë një copë letre.

— S'kam ndërmend t'ju lodh me mbarështrimin e gjithfarrë teorive përfisiologjinë, — më tha. — Do të përpinqem t'ju bind që të riskoni me këtë sprovë jo përfi të përligjur ndonjë teori timen. Ka mendimtarë me autoritet që i përbahen kësaj teorie shkencore. Më mjaftojnë vetëm pesë minuta përfi të vërtetuar që ky propozim imi, sado i çuditshëm që duket, mbëshitet në argumente shkencore.

Dhe shkurt më tregoi, duke cituar edhe burimet përkatëse, lidhur me këtë.

— Jam krejt i bindur në vërtetësinë e pikëpamjes suaj, — i thashë.

— Atëherë të flasim konkretisht për çështjen, — më tha. — Duhet t'ju paralajmëroj se, pavarësisht nga përpjekjet tonë, kurrë s'do ia arrijmë t'i ripërtërijmë qindpërqind rrëthanat e vijit të kaluar. Ne mund të shpresojmë përfi një përafërsi sa më të madhe. Io të mundemi ta bëjmë, unë kam besimin se po, atëherë do të mundemi ta shohim edhe përsëritjen e asaj, ç'ka keni bërë në mënyrë të pavetëdijshme atë natë të datëlindjes së zonjushës Reçell. Kjo do ta bindë këdo përfafajsinë tuaj. Ju c'mendim keni?

— Shpjegimi që më bëtë është më se i qartë. Veç s'kam si e fsheh se diç më le të habitur.

— Cfarë pikërisht?

— S'arrij dot ta kuptoj atë ndikimin e opiumit mbi mua. Si eca nëpër shkallë e koridor, si hapa e mylla dyertë, sirtarët dhe përsëri u ktheva në dhomën time. Këto janë veprime aktive. Kam menduar që opumi në fillim të mpinë, të bukos, mandej të ndjellë gjumë!

— Èshtë një moskuptim i përgjithshëm ky i veprimit të opiumit, zoti Blek! Ja unë, pér shembull, jam duke ju shtjelluar me aq qartësi tërë këto teza e procese i ndodhur nën ndikimin e laudanumit, por të një doze dhjetë herë më të madhe se ajo që morët atëherë ju. Po mos u mbështetni tek unë edhe pse kjo èshtë një përvjohje vetjake imja. E kam parashikuar këtë rezervë tuajën, ndaj dhe jam parapërgatiur pér t'ju dhënë përgjigje, madje kam siguruar dëshmi që do të jetë me peshë në sytë e miqve tuaj.

Më afroi librin tjetër që ndodhej mbi tryezë.

— Ja, titullohet «Pohime të anglezit që ka pirë opium». Merreni me vete dhe lexojeni. Në një vend thuhet se, kur de Kushkija merrte doza të mëdha opumi, shkonte pér në opera pér t'u kënaqur me muzikë, ose endej nëpër pazarin londinez dhe shihte marifetet e shëtësve pér të siguruar sa më shumë të ardhura.

— M'u përgjigjët, — i thashë, — por jo deri në fund; ende s'ma keni bërë të qartë se ç'ndikim ushtron opumi pikërisht mbi mua.

— Po mundohem t'ua shpjegoj me pak fjalë, — tha Ezra Xheningsi. — Në shumicën e rasteve ndikimi i opiumit èshtë dyfish: në fillim eksitures mandej qetësues. Në ndikimin e parë mbresat më të fuqishme, në rastin tuaj ato që lidheshin me diamantin, kanë arritur t'ia nënshtrojnë vetes arsyen, ashtu siç e bënë këtë edhe gjumi i zakonshëm. Dalëngadalë nën këtë ndikim tërë ankthi juaj pér ruajtjen e diamantit, që ju kishte munduar gjithë atë ditë, duhej të kalonte nga gjendja e dyshimit në gjendjen e besimit që ju hodhi pastaj në veprime konkrete pér ruajtjen e tij, i ka detyruar hapet tuaja pér të qëllimi në atë dhomë ku hytë, ka drejtuar dorën deri sa ajo arriti të gjejë diamantin në sirtar. Gjithçka e keni bërë në gjendje dehjeje me opium. Më pas, kur veprimi qetësues zu të dominojë mbi veprimin eksitures, dalëngadalë jeni bërë më i ngathët dhe më në fund ratë në gjendje mpirjeje. Ju kaploj një gjumë plumb i rëndë. Kur po afronte agu dhe veprimi i opiumit kishte marrë fund, ju u zguuat në një gjendje padije të plotë pér gjithë sa kishit bërë natën. Tani e keni të qartë se ç'ju ndodhi?

— Aq të qartë e kam, — i thashë, — sa që kam vetëm një

dëshirë: ta ndjekim çdo lëvizje timen deri në fund. Pasi e mora diamantin, këtë e pa edhe zonjusha Verinder, ç'bëra më tej?

— Them se kjo provë që po ndërmarrim jo vetëm do ta vërtetojë pafajsinë tuaj, por do të arrijë ta gjejë diamantin e humbur. Kur dolët nga dhoma e zonjushës Verinder me diamantin në dorë, ju, me ç'duket, u kthyet në dhomën tuaj...

— Po, e çë pastaj?

— Kjo që do ju them, zoti Blek, s'është vecse hamendje, por synimi pér ta ruajtur si duhet diamantin ju çoi te mendimi pér ta fshehur në një vend të sigurt në dhomën tuaj të gjumit. Me ju mund të ndodhë ajo që i ndodhi edhe një hamalli irlandez. Pas marrjes së dozës së dytë të opiumit ju, ndoshta, do ta ndërmendni vendin ku e keni fshehur diamantin nën ndikimin e dozës së parë.

Më erdhi radha mua tani t'i bëja të ditur Ezra Xheningsit një njoftim të ri. Ndaj dhe ia ndërprenë fillin e arsyetimeve.

— Kjo që thatë është diçka e pamundur; diamanti në këto caste gjendet në Londër.

Më pa tejet i çuditur:

— Në Londër? — përsëriti. — Po si kaloi aty nga shtëpia e zonjës Verinder?

— Këtë askush nuk e di.

— Po ju e mbajtët në duart tuaja, pasi e morët nga dhoma e zonjushës Verinder. Si t'ua kenë marrë, vallë?

— As që e kam përfytyrimin.

— E kishit diamantin kur u zgjuat në mëngjes?

— Jo.

— Iu kthyte përsëri zonjushës Verinder?

— Jo.

— Zoti Blek! Ka diçka në këtë mes që pret shpjegimin e vet. A mund t'u pyes nga e dini që diamanti ndodhet tanë në Londër?

Ia përsërita Ezra Xheningsit gjithë ç'më kish treguar pér këtë zoti Bref. Më dha të kuptoja që nuk e kënaqte kjo përgjigja ime.

— Për mendimin tim, — zuri të shpjegojë ky, — ju, nën ndikimin e opiumit, e morët diamantin pér ta fshehur në një vend më të sigurt, po nën ndikimin e tij, ju mund ta fshihnit diku në dhomën tuaj. Ju thoni se indianët s'janë nga ata që

bëjnë gabime. Ata e kontrolluan zotin Luker, pra tek ai dhe ndodhet diamanti. A keni të dhëna që të vërtetojnë se diamantin e kanë çuar në Londër? Ju s'jeni në gjendje as të hamendësoni se kush dhe si mund ta ketë çuar atë në Londër. A keni dëshmi që diamanti është lënë peng te Lukeri? Ai vetë betohet që as ka dëgjuar ndonjëherë për **Gurin e Hënës**, kurse në dëfjesën e bankierit shënohet vetëm se është lënë peng një gur i cmuar. Indianët thonë se zoti Luker gënjen, kurse ju vazhdoni të supozoni se indianët kanë të drejtë.

Gjyki mi qe i rreptë por nuk mund të thuash se qe i pадреjtë.

— T'u them të drejtën, po më bëni të lëkundem, — i thashë. — Më lejoni t'ia bëj të ditur zotit Bref gjithë sa dëgjova këtu nga ju?

— Përkundrazi, do të jem shumë i gjëzuar. Fal konsultës me një personalitet aq me përvjojë, mund t'i shohim gjërat në një dritë të re. Po le t'i kthehem sprovës sonë me opumin: u vendos që ta lini menjëherë duhanin.

— Po, kështu thamë.

— Ky është hapi i parë. Duhet përpjekur për rimëkëmbjen me sa më shumë saktësi të mjedisit.

Po si mund të arrihej kjo: zonja Verinder kishte vdekur, Reçelli dhe unë, për sa kohë që mbi mua binte dyshimi i grabitjes, qemë të ndarë, Godfri Ebluajti bënte udhëtime nëpër kontinent. Ishte krejt e pamundur të mblidheshin njerëzit siç qenë atë natë.

Po Ezra Xheningsi ndihej i qetë. Tha se grumbullimi i njerezve nuk ishte kryesore. Më të domosdoshëm, për mendimin e ij, ishin objektet e mjedisit që më rrëthonin atëherë.

— Dhe më kryesore nga të gjitha është që ju të flini në po atë dhomë ku fjetët pas darkës së ditëlindjes, që dhoma të jetë e mobiluar po ashtu, që shkallët, korridori të jenë ashtu si i keni parë për herë të fundit. Është e domosdoshme, zoti Blek, që mobiljet të vihen në po ato vende që kanë qënë atëherë. Duhet siguruar leja e zonjushës Verinder për gjithë këto.

— E kush do i drejtohet me një të tillë kërkesë? — e pyeta.

— A s'mund ta bëni këtë ju?

— As që mund të flitet për një diçka të tillë. Pas gjithë çka ndodhi mes nesh, nuk kam as si shihem me të e as si i shkruaj.

Ezra Xheningsi heshti i menduar.

— A mund t'ju bëj një pyetje delikate? — më pyeti. (Ia miratova me tundje koke). — Drejt e kam kuptuar që dikur keni shfaqur një interes të veçantë ndaj zonjushës Verinder?

— Po, drejt.

— Dhe ky interes ka qënë i ndërsjelltë?

— Jam më se i bindur për këtë.

— Atëherë po i shkruaj unë vetë zonjushës Verinder, në rast se kam pëlqimin tuaj.

— Dhe do t'i tregoni për propozimin që më bëtë.

— Do ia tregoj gjithë çka ndodhi mes nesh sot.

Eshtë tepër të theksohet se e prita i entuziazmuar shërbimin që po më ofronte.

— Arrij ta nis letrën me postën e ditës së sotme, — tha, pasi pa orën. — Mos harroni të vini në kyç paqetën e cigareve. Do vij nesër t'ju pyes si fjetët natën.

U ngrita që t'i lija lamtumirën dhe bëra shumë për t'i shprehur falenderimet më të thella për vëmëndjen dhe shpirtmirësinë që po tregonte. Ma shtrëngoi qetësisht dorën.

— Mos harroni çka ju thashë në bisedën tonë të parë zoti Frenklin, — m'u përgjigj. — Ky shërbim imi është për mua vezullimi i fundit i dritës diellore në terrin e paanë të natës.

U ndamë. Ishte data 15 qershor. Ngjarjet e këtyre ditëve të ardhshme janë të shkruara me përpikmëri të madhe në ditarin e ndihmësit të zotit Kandi. Ai tregon si kaloi prova dhe ç'rezultate u arritën.

Tregimi i katërt,

i shkruar nga ditari i Ezra Xheningsit.

Viti 1849. Data 16 Qershor. Kalova një natë pa gjumë, ndaj dhe u vonova në takimin me zotin Frenklin. E gjeta shtrirë në divan; po pinte konjak të holluar me ujë të ftontë dhe po brente ca peksimadhe.

— Fillimi është aq i mirë, sa më mirë prishet, — më tha. — Nata me gjumë të rëndë, të shqetësuar; mungesë e plotë oreksi sot në mëngjes. Tamam siç më ndodhi vitin që shkoi, kur lashë duhanin. Sa më shpejt që të jem gati të marrë atë dozën e opiumit, aq më e madhe do të jetë për mua kënaqësia.

— Do ta merrni sapo të plotësohen kushtet, — i thashë. — Tani duhet bërë çmos që t'ju ruajmë shëndetin. Po të ndiheni i pafuqishëm, prova s'ka pér të dalë. Duhet të shëtisni që t'ju vijë oreksi, ose kalëroni pak.

U ndava me zotin Blek i gjëzuar dhe optimist. Ky njeri më zgjoi në shpirt dëshirën pér të jetuar.

Data 17 qershor. Sot u nis pér në jug të Anglisë zoti Kandi. Më la gjithë ato porosi pér të sëmurët. Posta më solli përgjigjen e letrës që i dërgova zonjushës Verinder.

Letër mahnitëse! Nuk e fsheh interesin e saj pér provën tonë. Letra ime e bindi pér pafajsinë e zotit Blek. Duket që vazhdon ende ta dojë. Mos vallë po më jepet rasti fatlum të shërbet si urë bashkimi i këtyre dy të rinjve të dashuruar?

Kishte dy lutje: të mos ia tregoja këtë letër zotit Blek, vetëm t'i thosha se zonjusha Verinder pranonte të vinte në dispozicion shtëpinë pér ne, vetëm kaq. S'është vështirë të plotësohet. Lutja e dytë paraqet vështirësi jo të vogla. Ajo shprehete dëshirën të më ndihmonte personalisht pér ta sjellë dhomën e saj të pritjes dhe të gjumit në gjendjen e atëhershme. Vetëm priste fjalën time pér të ardhur në Jorkshir dhe pér të qënë njëra nga dëshmitaret e eksperimentit me opium që do përsëri te gjithë çka kishte ndodhur vitin e kaluar. Druhem se tronditja nga takimi, përtëritja e ndjenjave të dikurshme mund të cojnë në dështimin e eksperimentit. Edhe kështu është tepër e vështirë t'ia rikthesh atë humor edhe atë gjendje të përgjithshme që pati vitin që shkoi. Ndërkohë s'më bën zemra të mos ia plotësoj dëshirën. Duhet gjetur një rrugëzgjidhje e këtij problemi: t'i them «po» zonjushës Verinder dhe ta çoj deri në fund shërbimin që po i bëj zotit Frenklin Blek.

Ora dy. Këtë natë zoti Blek, siç u shpreh vetë, e kishte kaluar njëlloj si natën e mëparshme. I kishte dalë gjumi disa herë natën, por ndihej disi më mirë se dje ngaqë kishte fjetur në drekë. Nuk duhet të jetë as krejt i shëndetshëm, as krejt i sëmurë.

Ora pesë. I nisa përgjigjen zonjushës Verinder. Ajo që i propozova është në interesat e të dy palëve. Ia ndalova kategorikisht takimin me zotin Blek para provës. Do të vinte fshehtas atë mbrëmje, që do të bëhej prova. Kur zoti Blek do të jetë në dhomën e tij, ajo do të hyjë fshehur në dhomën e saj pér të qënë pastaj njëra nga dëshmitaret. Të nesërmen ajo do i tregojë zotit Blek letërkëmbimin tonë dhe ai do bindet që e kishte shpallur të pafajshëm që para provës...

Data 20 qershor. Pagjumësia po jep shenjat e para në shëndetin e zotit Blek. Sa më shpejt të marrë fund rregullimi i dhomave dhe i korridorit, aq më mirë. Kur po shkonim në çiflig, më kërkoi të këshillohej pér punën e letrës që kishte marrë nga dedektivi Kaf. I shkruante nga Irlanda. Nëse zoti Blek arrin ta bindë që të ketë bërë ndonjë gabim trashaman në hetimin e çështjes së vitit të kaluar, e quante pér detyrë të ishte në dispozicionin e zotërisë. Në rast se jo, do të parapëlqente të mbetej në vetminë e tij i rrëthuar nga trëndafilët e dashur.

Pa ngurrimin më të vogël, e këshillova zotin Blek t'i bënte të ditur dedektivit Kaf gjithë çka kishte ndodhur pas ndërprerjes së hetimeve vitin e kaluar dhe ta linte atë vetë të bënte përfundimet e duhura mbi bazën e këtyre të dhënavë.

Pasi e mendova pak, e këshillova gjithashtu ta ftonte dedektivin Kaf të ishte i pranishëm në këtë provë. Sidoqoftë do të ishte një dëshmitar i çmuar dhe, nëse mendimi im, që diamanti është fshehur në dhomën e zotit Blek, do të dilte i pavërtetë, porositë që mund të japë dedektivi do të qenë shumë të dobishme. Ishte ky mendim i fundit që e bëri, me sa duket, zotin Blek të vendoste. Pranoi të bënte si e këshillova.

Data 21 qershor. Kurrë deri më sot zoti Blek nuk kishte kaluar një natë aq të keqe. Kundër dëshirës sime qesh i detyruar t'i jepja pak ilaç. Në njerëzit me natyrë të ndjeshme si ajo e tij, ilaçet veprojnë, pér fat të mirë, shumë shpejt. U tremba mos zgërlaqej fare deri sa të vinte dita e provës.

Data 22 qershor. Shpresat pér suksesin m'u përtërinë. Tensioni nervor i zotit Blek ra në mënyrë të ndjeshme. Fjeti pak natën që shkoi si vitin e kaluar. Beterexhi ia doli mbanë detyrës. Kam marrë masa që dëshmitarë gjatë provës të janë: zoti Bref, që s'para beson në suksesin e kësaj ndërmarrjeje, si i tillë ai është një dëshmitiar me peshë; dedektivi Kaf; zonjusha

Verinder; plakoshi Beterexh, një person shumë i rëndësishëm në këtë familje.

Data 23 qershor. Zoti Blek sot nuk po ndihet mirë. Më tha vetë se në ora dy të mëngjesit kishte hapur sirtarin ku kishte fshehur cigaret. Iu desh të thërriste në ndihmë të gjithë forcën e vullnetit që ta mbyllte përsëri. Pastaj e kishte flakur çelësin nga dritarja.

Data 24 qershor. Bëra me zotin Blek një shëtitje të gjatë në një karrocë të hapur. Na flladiti ajri i freskët veror. Hëngrëm drekë në hotel. Për kënaqësinë time të madhe, edhe pse në mëngjes ndihej i shqetësuar dhe i emocionuar, fjeti nja dy orë të mira në divan pas dreke. Tani, në qoftë se do vuaj nga pagjumësia edhe një natë, s'kam pse trembem për pasojet e këqija që mund të vijnë nga kjo.

Data 25 qershor, e hënë. Dita e provës! Ora pesë e pasdites. Jemi në shtëpi. Çështja më kryesore, që më preokuponte, ishte shëndeti i zotit Blek. Nga sa mund të gjykoj, premton t'i nënshtrohet ndikimit të opiumit ashtu si iu nënshtrua edhe para një viti. (Po të gjykojmë nga gjendja e tij e përgjithshme fizike). Ndodhet në një gjendje nervore ndjeshmërie, që s'është larg gjendjes nervore të çrregulluar. Një fytyrë i vjen e një fytyrë i shkon, i dridhen duart. Rrënqethet nga zhurmat e befta, nga takimet e papritura. Janë rrjedhoja të pagjumësisë, që, nga ana e vet, i shkaktohet nga gjendja e përgjithshme nervore e çrregulluar pas heqjes së duhanit, që e kishte pas pirë aq shumë. Janë po ato shkaqe që patën ndikuar edhe vitin e kaluar, me ç'duket, edhe rrjedhojat kanë për të qënë po ata. A do të vazhdojë kjo gjendje deri në fund të provës? Ajo që do ndodhë këtë natë, ia vë vulën gjithçkaje.

Ndërkojë që jam duke shkruar këta rreshta, zoti Blek luan bilardo në katin e parë, siç ka pas bërë shpesh edhe atëherë kur ishte mysafir në shtëpinë Verinder. Kam marrë me vete ditarin me qëllim që të shkruaj diçka në orët e lira të natës, nisur edhe nga shpresa se do të haset ndonjë gjë që e mëriton të shënohet.

Na njoftuan për ardhjen e zonjushës Verinder dhe zotit Bref. Dedektivi Kaf s'po ndihet. Me siguri që ndodhet ende në Irlandë. Me sa duket, nuk ka për të ardhur

Erdhi Beterexhi dhe më tha që më kërkonte zoti Blek. Më duhet të shkëputem për pak kohë nga këto shënimë.

Ora shtatë. Pamë edhe një herë dhomat, korridorin dhe shkallët. Bëmë edhe një shëtitje mes postateve me trëndafila, pikërisht në atë vendin e preferuar të zotit Blek. Me këtë synoj të gjallëroj kujtesën e tij, mbresat e dikurshme nga vendi dhe mjedisi, sa më shumë që kjo është e mundur.

Tani do ulemi të hamë pikërisht në atë vend që hëngrëm vitin e kaluar në ditëlindjen e zonjushës Verinder. Kam lidhur me këtë objektet e mia mjekësore: laudanumi duhet të pihet në po ato rrrethana si dhe vitin e kaluar.

Pasi të ketë kaluar aq kohë sa duhet që t'i hapë bisedën rrëth diamantit, në një mënyrë krejt të natyrshme, do i flasë përsynimin që kishin indianët që ta grabisnin diamantin. Pasi ta kem kurdisur kësijoj tërë aparatin mendor të zotit Blek rrëth këtyre çështjeve, nga ana ime do të jetë bërë gjithçka që varet nga unë deri në atë çast kur do i japim opiumin.

Ora tetë e gjysmë. Vetëm tani po gjej një minutë të lirë për t'u marrë me njérën nga detyrat kryesore: të kërkoj në farmacinë e shtëpisë laudanumin që pat përdorur zoti Kandi. Ia shpreha para dhjetë minutash këtë dëshirën time Betere-xhit. Pa më thënë as edhe një fjalë kundërshtimi, më çoi në qilar, ku ruhet farmacia e shtëpisë. E gjeta shishëzën vulosur me tap dhe, përvëç kësaj, e lidhur dhe me rrip meshini. Ashtu si dhe e kisha parashikuar, përmante laudanim të pastër. Vendosa ta preferoja para atyre preparateve të opiumit që për çdo rast i pata marrë me vete.

Çështja e dozës më vinte para një vështirësie. Pasi e peshova mirë, vendosa ta përdor më të madhe se ajo që pat përdorur doktor Kandi. Do riskoj ta rris deri në dyzetë gran. Zoti Blek është i paralajmëruar tanimë se do të pijë laudanium e kjo do të thotë që ka për t'i bërë një qendresë të pandërgjegjshme veprimit të tij. Ndaj dhe i duhet shtuar doza që të përsëriten rrjedhojat e përdorimit të tij vitin e shkuar në dozë më të vogël.

Ora dhjetë. Dëshmitarët apo mysafirët, s'di si t'i quaj më mirë, erdhën para një ore. Rreth orës nëntë i thashë zotit Blek të vinte me mua në dhomën e gjumit, duke patur si synim që ky ta shihte përfundit herë dhe të verifikonte vetë në mun-

gonte ndonjë gjë nga mjedisi i vitit të shkuar. E kisha bërë me ijalë me Beterexhin që zotit Bref t'i shtrohej në dhomën përbri zotit Blek. Mbërritja e zotit Bref do më bëhej e ditur me një trokitje të lehtë në derë. Pesë minuta pasi ra nëntë, u dëgjua sinjali në derë, dola në korridor dhe takova zotin Bref.

— Keni ardhur bashkë me zonjushën Verinder dhe zonjën Meridju? — e pyeta.

— Po, — m'u përgjigj zoti Bref thatë.

— Zonjusha Verinder u ka vënë në dijeni të dëshirës sime që ardhja e saj dhe e zonjës Meridju të mos i bëhet e ditur zotit Blek deri sa të përfundojë prova?

— E di që duhet ta mbaj gojën kyçur, — e ngriti zërin zoti Bref. — Duke e patur për zakon të heshtë para çmendurisë njerëzore në përgjithësi, aq më tepër jam i predispozuar të mos ndihem në këtë rast. A ju kënaq kjo?

Ju përkula dhe e lashë Beterexhin ta shoqëronte në dhomën fqinje me atë të zotit Blek.

Dola që të takoja zonjat. I zbrita shkallët, s'kam si e fsheh këtë, disi i emocionuar dhe u drejtova për në dhomën e pritjes së zonjushës Verinder. Në korridorin e katit të parë më doli përpara e shoqja e kopshtarit, që ka marrë porosi të përkujdeset për rregullimin e zonjave. Kjo grua zemërmirë sillet me mua plot respekt, por që e ka burimin, me sa duket, në ndjejnjat e tmerrit që i shkakton qenia ime në këtë shtëpi. Kur e pyeta ku ndodhej atë çast zonjusha Verinder, kjo zuri të dridhet dhe të bëjë gjithfarë përkuljesh, dhe do të ishte ulur në këtë e sipër drejt e në dysheme po të mos kishte dalë nga dhoma e pritjes vetë zonjusha Verinder dhe t'i kishte dhënë fund kësaj ceremonie.

— Ju jeni zoti Xhenings? — më pyeti.

S'më la kohë t'i përgjigjem, doli në korridor. Ishim mu poshtë llambës. Kur më pa, ndali e pavendosur, por e mblođhi sakaj veten, fytyrën ia mbuloi të kuqtë e lehtë dhe me një natyrshmëri këndellëse më zgjati dorën.

— S'kam si sillem me ju si me një të huaj, zoti Xhenings, — më tha. — Sikur ta dinit se ç'gëzim të pamatë ndjeva nga ato letrat e tua!

E hetoi fytyrën time të rrudhosur, aspak tërheqëse, me një ndjenjë falenderimi të singertë aq të çmuar për mua, saqë

s'gjeta dot fjalë që t'i përgjigjesha. Vuajtjet shumëvjeçare, lavigdi Zotit, s'ma kanë egërsuar zemrën. S'dija si të mbahesha, s'dija si të sillesha në prani të kësaj vajze, si të kisha qënë një pesëmbëdhjetëvjeçar. S'isha i përgatitur të shihja një mirësi dhe bukuri të tillë.

— Ku është ai tanë? — më pyeti pa e fshehur aspak se mendja i rrinte te zoti Blek. — Ç'është duke bërë? A më ka kujtuar? Po me humor si është? Ç'pershtypje i bëri pamja e kësaj shtëpie pas gjithë asaj që ndodhi këtu vitin e kaluar? Kur do ia jepni laudanumin? A s'mund ta shohë kur t'ia shtini? Jam aq në merak, jam aq e emocionuar... Sa shumë gjëra dua t'ju tregoj, gjithfarë mendimesh ma kanë dyndur kokën, s'di nga t'ia filloj. Nuk po çuditeni me këtë sjelljen time?

— Aspak, — iu përgjigja. — Unë ju kuptoj fort mirë.

— Jeni ju ai që po më dhuron një jetë të re! — vijoi pa më të voglën shenjë të shtirjes. — Sa shumë të falënderoj. Unë atë e dashuroj, e kam dashur dhe e dua, edhe atëherë kur mendojë me pa të drejtë kundër tij. Kur të më shohë nesër në këtë shtëpi, si thoni...

Nuk e përtundoi mendimin, por vetëm më pa drejt në sy.

— Nesër do ju duhet thjesht të përsëritni gjithë sa më folët mua tanë, — i thashë.

Fytyra iu çel, m'u afroa me një hap dhe tejet e emocionuar preku petlat e lules që ishte këputur në kopsht dhe e kishte vënë në jakën e polkës.

— Keni siguri të plotë për mbarëvajtjen e provës? — më pyeti.

— Deri tanë gjithçka ka ecur sipas parashikimit, — iu përgjigja.

Biseda jonë u ndërpren nga ardhja e Beterexhit.

— Ju kërkoj ndjesë, zoti Xhenings, — më tha me një mënyrë të stërholluar. — Zoti Frenklin dëshiron të dijë ku jeni. Duke mos dashur t'i tregoj për mbërritjen e zonjave, sipas porosisë suaj, i thashë se nuk e dija ku ndodheshit. Po t'i themi gjërat me emrin e tyre, kjo që bëra s'është veçse mashtrim. Do të desha të mos përsëriteshin kësi rastesh me mua.

S'duhej humbur as edhe një minutë, s'duhej merakosur shumë për punën e normave morale të Beterexhit. Nga çasti në çast aty mund të vinte zoti Blek, duke dashur të merrte vesh

ku ndodhesha. Shkova tek ai. Zonjusha Verinder doli fill pas meje në korridor.

— Më duket se paskan rënë në ujdi që t'ju marrin shpirtin sot, — më tha. — Ç'domehënë kjo?

— S'është veçse një protestë e lehtë e shoqërisë, zonjusha Verinder, edhe pse e mikropërmasave për të kundërshtuar të renë.

Zonjusha Verinder u kthyë në dhomën e saj të pritjes, unë u n^jita lart te zoti Blek.

U habita kur e gjeta vetëm duke ecejakur nga qoshja n^c qoshe, me sa dukej, i nervozuar që kishte mbetur fillikat në dhomë.

— Ku është zoti Bref? — e pyeta.

Më bëri me shënjë nga dera e mbyllur ku ndodhej juristi. Zoti Bref kish qënë tek ai vetëm pak minuta, qe përpjekur t'i mbushte mendjen për kotësinë e provës, kishte pësuar fiasko. Zoti Blek qëndronte në të vetën. Pas kësaj zoti Bref kishte nxjerrë nga çanta e fryrë e zezë shkresat dhe qe zhytur në shqyrtimin e tyre. «Koha është para, — i kishte thënë. — Zoti Xhenings le t'i bëjë zë po t'i nevojitet prania e tij».

— Kur do ma jepni ta pi laudanumin? — më pyeti sakaq me padurim zoti Blek.

— Duhet pritur edhe pak, — i thashë. — Ndërkohë do rri këtu me ju.

Ora ende nuk kishte vajturi dhjetë. Pas bisedave që pata me Beterexhin dhe me zotin Blek, kisha arritur në përfundimin se doktor Kandi ia kishte dhënë laudanumin jo më parë se ora njëmbëdhjetë. Kisha vendosur ta respekoja këtë orë.

Biseduan për një kohë, por mendja na rrinte te prova e ardhshme. Fjalët mezi na dilnin nga goja, zoti Blek fare shkujdesur shfletonte një libër. Por koha kalonte, po afronte ora njëmbëdhjetë. Më duhet t'i lë mënjanë këto shënime dhe të fillojmë provën.

Ora dy pas mëngjesit. Prova u krye. Po bëj një përshkrim të hollësishëm të rezultatit.

Në ora njëmbëdhjetë i rashë ziles dhe thirra Beterexhin. Zotit Blek i thashë se ishte koha të binte për të fjetur. Pashë në dritare. Ishte një natë e ngrohtë, binte pak shi, krejt e ngja-

shme me atë natën e njëzet e një qershorit të vitit të kaluar. Edhe pse s'i besoja shumë veprimit të agjentëve atmosferikë, më gjëzi mungesa e ngacmuesve mbi sistemin nervor, si ngarkesat e tepërtë elektrike, shenjat e afritët të ndonjë shtrëngate etj. Beterexhi m'u afrua dhe në fshehtësi më futi nën dorë një pusullë. Aty ishte shkruar sa më poshtë:

«Zonja Meridju ra të flerë, pasi i dhashë fjalën se s'do dilja nga kjo shtëpi pa ardhur ajo vetë të më marrë. As që i shkon në mendje që vendi i veprimit ka për të qënë dhoma ime e pritjes, ndryshe s'kishte për t'u shqitur që këtej. Jam tejet e alarmuar. Ju lutem, më krijoni ndonjë mundësi të shoh si do e matni dozën e laudanumit, dua medoemos të marrë pjesë në këtë procedurë qoftë edhe në rolin modest të spektatorit. Rëgëll Verinder».

Dola nga dhoma fill pas Beterexhit dhe e urdhërova që ta çonte dollapin e ilaçeve në dhomën e pritjes të zonjushës Verinder. Ky urdhër atë e gjeti fare të papërgatitur. Më pa me dyshim mos kisha ndër mend të bëja ndonjë provë mjekësore nga ato të fshehtat me zonjushën Verinder.

— A mund t'u pyes, q'punë ka në këtë mes ai dollapi i ilaçeve në dhomën e zonjushës?

— Qëndroni dhe ju në dhomën e saj të pritjes dhe keni për ta parë, — që përgjigja që i dhashë.

M'u duk se Beterexhit s'po i mjaftonte besimi në forcat e veta për të mbikqyrur veprimet e mia.

— Po sikur të ftonim edhe zotin Bref, të ishte i pranishëm në këtë që po përgatiteni të bëni? — më pyeti.

— Duhet ta ftojmë me çdo kusht. Po shkoj t'i lutem zotit Bref të vijë me mua poshtë.

Beterexhi shkoi të merrte dollapin e ilaçeve pa thënë më as edhe një fjalë. Shkova të marrë zotin Bref.

— Më vjen keq që po ju shqetësoj, — i thashë. — Do më duhet të përgatis laudanumin për zotin Blek, prania juaj është e domosdoshme.

— Po, po! — më tha. — Domosdo.

— Do ju lutesha gjithashtu që të vinit pastaj bashkë me mua dhe të asistonit gjatë marrjes së ilaçit nga zoti Blek.

— Sigurisht. Po tjetër?

— Edhe diçka të fundit. Jam i detyruar t'ju shqetësoj me lutjen për të kaluar më pas në dhomën e zotit Blek dhe të princi aty rrjedhojat e ilaçit.

— Shumë mirë! — më tha zoti Bref. — Në do të jem në dhomën time apo në atë të zotit Blek, kjo s'ka fare rëndësi; me shkresurinat e mia mund të merrem gjithkund.

Para se t'i thosha unë diçka, iu përgjigj zoti Blek që nga shtrati i tij.

— Mos doni të thoni me këtë se jeni fare mospërfillës për këtë provën tonë? Zoti Bref, po shoh që imagjinata ju punon jo më mirë se ajo e lopës!

— Lopa éshtë kafshë dobiprurëse, zoti Blek, — iu përgjigj juristi.

Tha këtë dhe doli bashkë me mua nga dhoma, duke vazhduar të mbante ndër duar ato shkresurinat e tij.

Kur hymë në dhomën e pritjes, zonjusha Verinder e zbehëtë por e entuziazmuar, tejet e emocionuar vente e vinte nga qoshja në qoshe të dhomës. Pranë tryezës qe ulur Beterexhi sogjetar i dollapit të barnave. Zoti Bref u ul në karrigen e parë që gjeti dhe, për të mos humbur kotsëkoti kohën e shumëçmuar, u zhyt sakaq në ato shkresurinat e tij.

Zojnusha Verinder më hoqi mënjanë dhe më pyeti për atë që ia kishte pushtuar tërësisht mendimet, për zotin Blek.

— Si e ndien veten? Mos éshtë i nervozuar? Mos éshtë i zemëruar me dikë? Si thoni, a do të ketë sukses prova? A jeni i sigurt që s'ka për t'ia démtuar shëndetin kjo provë?

— Jam krejt i sigurt. Shkojmë të masim dozën e laudanumit që do i japim.

— Edhe një pyetje! Tani éshtë ora njëmbëdhjetë e ca. Sa kohë duhet të presim që të ndihet veprimi i tij?

— Nuk éshtë kollaj të thuhet... Ndoshfa ndonjë orë...

— Unë them që në dhomë të ketë errësirë të plotë, ashtu siç qe ajo vitin që shkoi.

— Patjetër.

— Do rri e do pres në dhomën time të gjumit, si vitin e shkuar. Derën do ta lë paksa të hapur, si vitin e shkuar. Do ta shoh c'ka për të bërë që prapa derës së dhomës së pritjes; sapo ajo të hapet, do ta shuaj dritën. Kështu bëra atë natë. Se çdo gjë duhet të përsëritet me përpikmërinë më të madhe, apo jo?

— Ajeni i sigurt që do të mundni ta përbani veten, zonjusha Verinder?

— Për hir të tij jam gati pér çdo gjë! — m'u përgjigj pashionshëm.

E pashë në fytyrë dhe u binda se fjalët do i shndërronte në vepra. Iu drejtova përsëri zotit Bref.

— Do t'ju lutem të shkëputeni pér disa minuta nga ato shkresurinat tuaja, — i thashë.

— Po, po, domosdo!

Më pa i hutuar, si ta kisha penguar të vazhdonte leximin në vendin më interesant. U çua dhe iu afrua dollapit të ilaqeve. Pastaj ia nguli shikimin Beterexhit dhe gogësiti moskokë-çarës.

Zonjusha Verinder m'u afruà me kanën me ujë të ftohtë. që e mori nga tryeza.

— Më lejoni që ujin në gotë ta derdh unë, — më pëshpëriti. — Duhet të kem gisht edhe unë në këtë provë!

Mata dyzetë gran laudanum nga shishja dhe e hodha në gotë.

— Mbusheni tanë gotën dëri tre të katërtat me ujë, — i thashë zonjushës Verinder duke i zgjatur gotën me ilaqin.

I thashë Beterexhit ta mbyllte dollapin, që nuk na duhej më. Fytyra e këtij shërbëtori besnik shkëlqeu nga lehtësimi. Me siguri që dyshonte se kisha bërë mendje të kryeja një eksperiment mjekësor edhe mbi zonjën e tij të re. Pasi e mbushi gotën me ujë aq sa i thashë, zonjusha Verinder gjeti një çast kur Beterexhi ishte duke mbyllur dollapin, ndërsa zoti Bref që zhytur përsëri në ato shkresurinat e veta dhe fshehtas puthi buzën e gotës.

— Kur t'ia jepni, — më pëshpëriti ajo vashë e mrekullueshme, — kthejeni gotën nga kjo anë!

Nxora nga xhepi kristalin që do të luante rolin e diamantit, ia dhashë, duke i thënë:

— Edhe këtë ju duhet ta prekni me dorën tuaj. Vëreni atje, ku e keni pas vënë vitin e kaluar **Gurin e Hënës**.

Iu afrua dollapit indian dhe e vuri në sirtar kristalin. Zoti Bref, si dhe më parë, vazhdonte të shihte me një mospëlqim të hapur. Ndryshtë qëndronte puna me plakoshin Beterexh: i dri-

dhej dora kur ndriçonte pranë dollapit 'indian dhe me zë të dridhur i pëshpëryste:

— A jeni e sigurt, zonjushë, se ka pas qënë pikërisht në këtë sirtar?

Bëra të dilja nga dera me gotën e laudanumit ndër duar. Te pragu ndala për t'i dhënë porosinë e fundit zonjushës Verinder.

— Mos harroni të shuanit në kohën e duhur qiririn.

— Do e shuaj që tani, — m'u përgjigj, — dhe po rri të pres në dhomën time vetëm me një qiri.

E mbylli pas nesh derën e dhomës së pritjes. I shoqëruar nga zoti Bref dhe Beterexhi, u ktheva në dhomën e zotit Blek.

Ky po vërtitej i merakosur në shtrat dhe i irrituar na pyeti. a do ia jepnim, më në fund, laudanumin? Në praninë e dy dëshmitarëve ia dhashë ta pinte dozën e parapërgatitur, ia rrugollova jastëkun dhe e këshillova të ishte i qetë dhe të priste.

Krevati me dy perde anash qe vënët në mes të dhomës, këshitu nga të dyja anët kishte shumë vend të lirë. Në njérën anë ia ula perden, në mënyrë që të mos e vinte re praninë e zotit Bref dhe të Beterexhit në dhomën e tij. Do prisnin këtu veprimin e laudanumit. Te këmbët e krevatit zura vend unë. Isha gati t'i gjendesha pranë për çdo rast, të fshihesha, po ta lypte nevoja, apo t'i bëja zë, po të më thërriste, pra të veproja si të më paraqitej rasti. Që më parë ma kishin thënë se flinte me dritë, andaj në komodinë te koka i kisha vënët një qiri të ndezur, por në mënyrë që drita të mos i binte në fytyrë. Një tjetër qiri ia dhashë zotit Bref, por drita e tij zbutej pasi binte mbi perden e lëshuar. Dritaren e lash pak të hapur që të kishte ajët të freskët. Gjithkund mbretëronte heshtja. Që nga jashtë dëgjohej vetëm zhurma e lehtë e shiut.

Kur çdo gjë ra fash, u ula në karrigen te këmbët e krevatit. Ishte ora njëmbëdhjetë e njëzet. Zoti Bref iu kthyte përsëri shkresave të tij dhe të dukej se qe zhytur në to si dhe më parë. Por një sy hetuesi s'e kishte të vështirë të vinte re se ky jurist s'po kishte më fuqi t'ia impononte vetes punën. Edhe atë s'kishte si të mos e bënte për vete kjo provë aq interesante që po bënim. Sa për Beterexhin, ky qe bërë i téri sy e vesh dhe priste i tendosur çdo të ndodhëte.

— Në keni perëndi, zotëri, — më përshpëriti, — a mund të më thoni, kur do filloj të duket ndikimi i ilaçit?

— Jo më parë mesnatës. — iu përgjigja po me pëshpërimë. — Mos u ndjeni, rrini i qetë.

Ma shkeli syrin me familjaritet, duke më dhënë të kuptoja se e mori vesh.

Pashë nga zoti Blek dhe vura re që kish pushuar së vërtituri në shtrat, duke llomotitur përsë ai laudanumi s'po i bënte asnjë lloj efekti. Ti thosha në atë gjendje që ndodhej se sa më shumë do e shfaqte shqetësimin dhe padurimin aq më tepër e shtynte veprimin e laudanumit, nuk ishte aspak e udhës. Më e mira e të mirave ishte t'ia largoja mendjen nga opiumi, t'ia çvendosja në mënyrë të vetvetishme në një objekt tjetër. Ia hapa muhabetin e diamantit për rrezikun e madh që i qe kanosur kur e pat sjellë nga Londra në Jorkshir, që nga çasti i marrjes nga banka, pastaj i prurjes në Jorkshir, më pas në Frizingol, pastaj sérish në shtëpinë Verinder ditën e kremitimit të ditëlinjës. Bëja enkas sikur i kisha kuptuar jo si duhet ato që më pat treguar ai vetë para disa orësh. Pra e detyrova të fliste për ato që duhej të ishin preokupimi i tij në ato çaste, kuptohet, pa i dhënë të ditur që po e bëja me paramendim. Dhe ai u mor seriozisht me korigjin e shumë thënieve të mia, në këto e sippër pushoi së vërtituri nëpër shtrat; pat harruar fare për opumin, kur nga sytë e kuptova që ky po vepron. Ishte një çast i rëndësishëm, ishte dymbëdhjetë pa pesë. Dalëngadalë laudanumi po bënte punën e tij. Sytë i shkëlqyen si ndër ethe, ftyrën ia mbuluan bula djerse. Pas pesë minutash iu trash gjuhha, fliste kot së koti, por biseda jonë vazhdonte. Fliste për diamantin, por s'arrinte t'i përfundonte frazat. Pastaj pllakosi heshtja. Befas u ul në shtrat. Duke mos e hequr mendjen nga diamanti, zuri të flasë përsëri, por tanj jo me mua por me veten e tij. Ky ndryshim më tregoi qart se fazë e parë e provës kishte kaluar me sukses. Zoti Blek gjendej i téri nën ndikimin e opiumit, ishte ky ai që ia kishte diktuar atë gjallëri.

Ora ishe dymbëdhjetë e tridhjetë e tre minuta. Gjysmora që vinte ishte vendimtare: a do të çohej nga shtrati; a do të dilte nga dhoma? I gëzuar pa masë për arritjen e parë, tejet i tendosur, harrova fare për praninë e dy dëshmitarëve. Kur pashë nga ata, vura re se tërë jurisprudanca e zotit Bref, e

përfaqësuar nga ato shkresat, kishte rrëshqitur për tokë. Vetë ai ia kishte qepur sytë kureshtarë të çarës ndërmjet perdeve të krevatit. Beterexhi, duke shkelur normat e mirësjelljes, që ngritur dhe ndiqte, që prapa shpinës së zotit Bref, çdo lëvizje të zotit Blek. Kur më panë që po i shihja, hovën të hutuar, siç bën nxënësi i kapur në flagrancë nga mësuesi për ndonjë paudhësi. U bëra me shenjë të ndiqnin shembullin tim: të zbathnin këpucët. Nëse do na duhej të ecnim pas zotit Blek, këtë duhej ta bënim pa u ndjerë. Kaluan dhjetë minuta e nuk ndodhi as gjë. Kur, pa pritur, ai hodhi tej mbulesën dhe nxori njërën këmbë nga krevati. Ndenji ashtu një hop i pavendosur...

— S'bëra mirë që e mora nga banka, — mërmëriti. — Atje ishte në vend të sigurt.

Zemra më rrihte fort, në tëmhat sikur më godisnin çekanët. Pra, mendja i rrihte te diamanti! Këtu dhe i kisha përqëndruar të gjitha shpresat për mbarëvajtjen e provës. Ishte përnervat e mia të dobta një tronditje e jashtëzakonshme.

U detyrova t'ia shqisja sytë, ndryshe mund të mos arrija dot të përbaheshë. Përsëri heshtje. Kur pashë pas pak përsëri në drejtim të tij, e gjeta në këmbë te krevati. Bebëzat e syve i qenë ngushtuar, sytë i shkëlqenin, tundte kryet sa an-dej-këtej. Diç mendonte, ishte në mëdyshje; foli përsëri.

— Ku i dihet... indianët, ndoshta, janë fshehur në shtëpi!

Heshti dhe çapëloj për në anën tjetër të dhomës, ndali aty, qëndroi pak dhe u kthye përsëri te krevati, duke thënë me vete:

— Dollapi nuk është as i myllur. Se ndodhet në atë do llapin indian ai. As çelës nuk ka!

U ul mbi krevat.

— Gjithkush mund ta marrë, — vazhdoi.

Përsëri u ngrit dhe përsëri mërmëriti ato fjalët e mëparshme:

— Ku i dihet... indianët, ndoshta, janë fshehur në shtëpi!

Dukej tejet i menduar dhe i merakosur. U fsheva prapa perdes. I hodhi dhomës një shikim të pavetëdijshëm me sytë që i shkëlqenin. E preva frymëmarrjen. Përsëri një frenim në veprimtarinë e trurit, kush mund ta përcaktonte këtë? Gjithçka do dukej në veprimet që do pasonin.

U shtri në shtrat.

Një dyshim i tmerrshëm më pushtoi të tèrin. Mos vallë ndikimi paqëtues i opiumit fillonte që tanë? Zor se gjenden në botë dy njerëz, mbi të cilët ai do të vepronë njëlloj. Mos kishëtë në organizmin e zotit Blek ndonjë të tillë vëgorie, falë së cilës ndikimi i laudanumit duhej të ishte i vëçantë? Mos po na zë derën mossuksesi në çastet e suksesit të padiskutueshëm? Jo, befas u ngrit përsëri.

— Po pse filhet me tèrë këto mendime?

Pa nga qiriri, që ishte mbi komodinë, e mori në dorë shandanin. E shua jta qiririn që ishte në anën tjetër të perdes dhe bashkë me zotin Bref dhe me Beterexhin u fshehëm në qoshen pas krevatit. U bëra me shënjë që të heshtnin. Zumë të presim, pa parë e pa dëgjuar tanimë gjë prej gjëje që prapa perdes. Qiriri që ai mbante në dorë befas lëvizi nga vendi. Kaloi pranë nesh me çap të shpejtë dhe të pandjeshëm, pa e lëshuar qiririn nga dora. Hapi derën, doli nga dhoma e tij e gjumit. E ndoqëm pas nëpër korridor, pastaj nëpër shkallë. As edhe një herë nuk e ktheu kokën, as edhe një herë nuk e ndali hapin. Hapi derën e dhomës së pritjes dhe hyri, duke e lënë derën hapur. Si të gjitha dyert e tjera, kjo kishte ca mentesha të vjetra. Ndërmjet derës dhe shkallës formohej një e çarë goxha e madhe. I bëra shenjë bashkudhëtarëve të afroheshin aty që ta shihnim ç'do të bënte, kurse ai ndërkohë duhej të mos na shihte. Aty pranë ishte një si kamare ku mund të fshiheshim po t'i mbushej mendja zotit Blek të shihte në korridor.

Kur arriti në mes të dhomës, pa përreth, por as edhe një herë nuk pa prapa. Dera e dhomës së gjumit të zonjushës Verinder ishte paksa e hapur. E kishte shuar qiririn. Po qëndronte si burrneshë. Munda të shquaj në errësirë vetëm konturet e bardha të fustanit të saj veror. S'kishte si dyshoje që në dhomë dikush është. Rinte e heshtur, asnjë lëvizje.

Ora ishte një e dhjetë minuta. Në qetësinë e thellë dëgjohej vetëm zhurma e shtuar e shiut dhe fëshfërima e fletëve të drurëve nga era e lehtë e natës. Pasi/qëndroi për disa çaste i pavendosur në mes të dhomës, zoti Blek iu afrua qoshes ku ndodhej dollapi indian. E vuri shandanin mbi dollap, dhe zuri të hapë njeri pas tjetrit sirtarët deri sa arriti te sirtari ku gjendej kristali që luante rolin e diamantit. Disa sekonda e pa i përqëndruar, pastaj e nxorri që andej me dorën e djathë dhe

me dorën e majtë mori shandanin. Pastaj u kthye përsëri në mesin e dhomës dhe përsëri ndali. Deri më tanë e kishte përsëritur me saktësi gjithë sa kishte bërë vitin e kaluar pas darkës së ditëlindjes. A do t'i përsëriste vallë me po aq përpikmëri edhe veprimet e tjera që kishte kryer vitin e kaluar? A do të dilte vallë nga dhoma? A do të kthehej vallë, ashtu si e supozojë unë, në dhomën e tij të gjumit? A do na e tregonte ç'kishte bërë me diamantin kur që kthyer në dhomën e tij?

Lëvizja e parë që bëri tanë, nuk i ngjante lëvizjes së vitit të kaluar: e la shandanin në tryezë dhe bëri disa hapa drejt fundit tje të dhomës së pritjes. Aty ishte divani. U mbësh-tet me dorën e majtë në shpinën e tij, pastaj e drejtoi trupin dhe u kthye përsëri në mes të dhomës. Ia pashë sytë. I qenë turbulluar, qepallat i qenë rënduar.

Tensionin e këtyre minutave nuk e duruan dot nervat e zonjushës Verinder. Ajo bëri disa hapa përpara dhe pastaj ndalli. Zoti Bref dhe Beterexhi për herë të parë panë nga unë. Parandjenja se shpresat s'po bëheshin realitet po i mundonte edhe ata jo më pak se mua. Por ato ende nuk qenë shuar, përderisa ai vazhdonte të qëndronte në mes të dhomës. Po prisnim me padurim ç'do të ndodhët më tej. Dhe ja seç ndodhi: e lëshoi kristalin nga dora që u rrökullis në dysheme mu pranë derës dhe mbeti aty. Zoti Blek nuk bëri asgjë që ta ngrinte: e pa me një shikim të turbullt dhe befas koka sikur iu këput dhe iu vajis në krahoror. Iu morën këmbët, erdhi përsëri në vete për caçaste dhe me hap të pasigurt iu drejtua divanit dhe u ul. Bëri edhe një sforçim të fundit: provoi të ngrihej, por përsëri u lëshua fuqiprërë. Koka i ra në jastëk. Ora ishte një e njëzet minuta. S'kisha arritur ende të viaj orën në xhep, kur e kishte zënë gjumi.

Gjithçka kishte marrë fund. Ndodhei nën ndikimin gjumëdhënës të laudanumit; prova kishte mbaruar.

Hyra në dhomë dhe u thashë zotit Bref dhe Beterexhit të vinin pas meje. S'kishte pse të trëmbeshin mos e shqetësonin. Mund të lëviznim lirisht dhe të flisnim.

— Më parë duhet vendosur, — u thashë, — ç'duhet të bëj-

më me të. Me siguri që do flejë ndonja gjashtë-shtatë orë. S'kemi pse e ngrejmë.

S'arritën këta të shprehin ndonjë mendim, kur zonjusha Verinder më thirri me zë të ulët. Kishte qëndruar në derën e dhomës së saj të gjumit dhe mbante ndër duar një shall të lehtë dhe jorganin e krevatit të saj.

— A do të qëndroni pranë tij deri sa të zgjohet? — më pyeti.

— Po, nuk dua ta lë vetëm, sepse s'i dihet ç'veprim do të ketë opumi.

Më dha shallin dhe jorganin.

— E pse ta shqetësojmë? — më pëshpëriti. — Le të flejë këtu... Unë do e mbyll derën e dhomës sime.

I fola për këtë zotit Bref dhe Beterexhit; ata e miratuan. E rregulluam si s'ka më mirë në divan. Zonjusha Verinder na uroi natën e mirë dhe mbylli derën. Iu luta që të dy dëshmitarëve të uleshin në tryezën ku ishte ndezur një qiri dhe kishte letër, penë e bojë.

Para se të largohemi që këtej, — u fola, — dua t'ju them disa fjalë lidhur me provën e posa bërë. Kishim dy pikësynime: duhej vërtetuar që vitin e kaluar zoti Blek kishte hyrë në këtë dhomë dhe e kishte marrë Gurin e Hënës në një gjendje të pavetëdijshme nën ndikimin e opiumit. Pas asaj që pamë, them se edhe ju për këtë u bindët.

Që të dy dëshmitarët pohuan me kokë.

— Pikësynimi i dytë, — vazhdova, — ishte të mësonim se ku e kishte fshehur diamantin, kur kishte dalë nga dhoma e pritjes së zonjushës Verinder. Kjo, sigurisht, do arrihej në varësi të saktësisë së riprodhimit të kushteve fizike dhe morale, në të cilat ishte vënë vitin e kaluar; e pata paralajmëruar zotin Blek se kjo ishte thuajse e pamundur. I riproduam situatat pjesërisht, për rrjedhojë edhe rezultatet e arritura qenë të pjesshme. Pra nuk mund të them se kjo s'më hidhëroi, por, ju flas sinqerisht, që nuk u habita. Ndoshta i dhashë dozë të madhe opumi, por më kryesore mbetet ajo që sapo theksova: riprodhimi i rrethanave dhe situatave psikologjike është ai faktor, të cilit i detyrojmë edhe suksesin edhe mossuksesin tonë.

Pas kësaj iu drejtova zotit Bref me lutjen, a ishte dakord ta shtjellonte me shkrim hollësishët gjithë sa kishte parë si dë-

shmitar dhe ta përforconte edhe me nënshkrimin e tij? Ky mori në çast penën dhe po bëhej gati të shkruante një raport me formulimet profesionale të domosdoshme.

— Para se t'i vihem kësaj pune, — tha, — ju kërkoj ndjesë, zoti Xhenings, për mosbesimin që shpreha. I bëtë Frenklin Blekut një shërbim të paçmueshëm. Po të shprehem në gjuhën juridike, ju e fituat gjyqin.

Pasi raporti qe nënshkruar nga zoti Bref dhe Beterexhi si dëshmitarë, zoti Bref më hoqi mënjanë dhe më pyeti:

— Sipas mendimit tuaj, zoti Frenklin Blek e ka fshehur diamantin në dhomën e tij, kështu apo jo? Për mendimin tim, ai ndodhet te bankieri i zotit Luker në Londër. S'do i futemi debatit se kush ka të drejtë. Po mjaftohemi vetëm me një pyetje: kush do ia dalë mbanë i pari ta vërtetojë në praktikë hipotezën e tij?

— Vërtetimi që prisja nuk u arrit këtu, — i thashë.

— Kurse vërtetimi im është duke u kryer. Kam dy ditë që kam pajtuar dy dedektivë për të mbikqyrur çdo veprim të zotit Luker, kam ndër mend t'i mbaj deri në fund të muajit. E di që diamantin mund ta marrë nga banka vetëm zoti Luker, personalisht ai, dhe shkoj me shpresën që njeriu që e ka lënë peng gurin e çmuar, pasi ta ketë pengun, do ta detyrojë ta tërheqë diamantin nga banka. Nëse do veprohet kështu, s'do ta kem të vështirë ta marrë vesh se kush qënka ky njeri. Atëherë do ta zbulojmë të fshehtën duke filluar nga ai çast, që sot na mbeti i errët. A jeni një mendje me mua për këtë?

Kuptohet që s'kisha pse të mos isha në njëmendje.

— Do të kthehem në Londër me trenin e mëngjesit, — vazhdoi juristi. — Ndoshta me të mbërritur kam për të marrë vesh ndonjë lajm të rëndësishëm dhe lypset që zoti Frenklin Blek të jetë diku këtu afër. Kam ndër mend t'i them me t'u zgjuar, që të vijë me mua në Londër. A mund të shpresoj që edhe ju, me respektin që gëzoni në sytë e tij, ta mbështesni këtë propozim timin?

— Domosdo! — iu përgjigja.

Zoti Bref më shtrëngoi dorën dhe doli nga dhoma. Beterexhi e ndoqi pas.

Ora shtatë e mëngjesit. Për herë të parë zoti Blek lëvizi në shtrat. Kur po gdhinte, në dhomën e pritjes hyri zonjusha

Verinder dhe m'u lut tē rinte bashkë me mua pranë tij. E lejova. Tani ajo éshtë ulur më gjunjë para divanit. E zgjodhi atë vend, në mënyrë që kur ky tē hapte sytë, gjëja e parë që tē shihët tē ishte fytyna e saj.

A t'i lë vetëm?

Sigurisht që po!

Tregimi i pestë,

i shkruar nga Franklin Blek.

1.

Kur po hanim mëngjes, zoti Bref më bëri tē ditur përsë mendonte që duhej tē vija me tē në Londër me trenin e mëngjesit. Dedektivët e bankës dhe tē dhënët e reja që mund tē përfthosheshin nga kjo ndjekje ia ngacmuani aq keq kërshérinë Recëllit saqë ajo atë çast vendosi tē nisej bashkë me ne.

Po largoheshim, duke provuar vetëm një keqardhje; do ndaheshim aq shpejt me Ezra Xheningsin. S'pranoi tē vinte me ne. I premtova se do i shkruaja, kurse Recëlli e porositi t'i vinte mysafir apo që kjo tē kthehej në Jorkshir.

S'kishim shumë që gjendeshim në zyrën e zotit Bref në Londër, kur aty erdhi një djalë me trike e pantallona tē shkurtëra tē fërkuara nga mbajtja, që tē bënte për vete me ata sytë e jashtëzakonshëm. I kishte aq tē dalë dhe aq tē shqyer, saqë dukeshin sikur nga casti në çast do kërcenin jashtë orbitës. Pasi e dëgjoi ç'i tha zoti Bref, u kërkoi falje zonjave që nuk mund t'i shoqéronte deri në shtëpi. Më rrëmbeu për krahu, pa arritur tē ndahesha si duhet nga Recëlli, dhe më futi me ngut në pajton. Djalka zuri vend pranë karrocierit dhe pajtoni u nis menjëherë në drejtim tē rrugës «Lombard».

— Ka ndonjë lajm nga banka? — e pyeta kur pajtoni u nis.

— Ka lajme për zotin Luker, — m'u përgjigj zoti Bref. — Para një ore e kanë parë të dilte nga shtëpia e tij në Lambet, në një pajton, bashkë me dy persona që dedektivët e mi thonë se janë policë të veshur civilë. Nëse frika nga indianët e detyroi zotin Luker të marrë masa sigurimi, çdo gjë është e qartë: shkon të tërheqë diamantin në bankë.

— Kurse ne jemi duke shkuar në bankë për të parë se ç'ka për të ndodhur.

— Po, apo për të dëgjuar se ç'ndodhi, në qoftë se, kur të arrijmë ne, gjithçka ka marrë fund. E sheh atë djalkën që është ulur pranë karrocierit?

— Më bënë përshtypje sytë e tij.

Zoti Bref ia plasi i të qeshurit.

— E mbaj si postjer, për besnik s'e ka shokun. Është djalë i shkathët dhe i zgjuar.

Ora ishte pesë pa njëzet e pesë, kur arritëm në bankë, në rrugën «Lombard». Djalka, duke na hapur derën e pajtonit, ia nguli sytë lutës të zotit.

— Do të vish edhe ti? — e pyeti embël zoti Bref. — Veç mos u largo nga unë pa marrë ndonjë porosi. Është zhivë e jo djalë, — më pëshpëriti. — Me dy fjalë të kupton.

Hymë në bankë. Në zyrën e parë me një banak të gjatë, ku qëndronin punonjësit e arkës, kishte shumë njerëz.

Me të hyrë aty zoti Bref, iu afrua një njeri që nga turma.

— Hé? — e pyeti juristi. — A e keni parë?

— Para një gjysmë ore, zotëri, kaloi mu pranë nesh dhe hyri në zyrën e brendshme.

— Ende nuk ka dalë?

— Jo, zotëri.

Zoti Bref u kthyte nga unë.

— Ta presim këtu, — më tha.

Bëra t'i kërkoj me sy në turmë ata të tre indianët, por më kot, s'dukeshin gjökundi. I vetmi njeri me fytyrë të zeshkët ishte një burrë shtatlartë me fanellë marinari, me kapele të rrumbullaktë, që ngjant si detar. «Mos është njëri nga ata i veshur si detar?» — thashë me vete. Por sakaq vetë u përgjigja: «E pamundur!» Ky burrë ishte më shtatlartë se tre indi-

anët, kurse fytyra në ato pjesë që s'ishte e mbuluar nga qimet e dëndura të zeza, ishte dy herë më e gjerë se fytyra e secilit prej tyre.

— Duhet të jetë këtu ndonjë nga bashkëpunëtorët tyre, — më tha zoti Bref, që po ashtu ia kishte qepur shikimin marinarit zjosh. — Dhe ka të ngjarë që të jetë ky. Po, po ky eshtë!

S'arriti të thoshte ndonjë gjë tjetër, kur djali me sytë kokërdhokë e çiku tërë respekt nga çipi i setrës. Zoti Bref pa në atë drejtim, në të cilin shihte edhe djalka.

— SHshsh.. — tha. — Ja zoti Luker!

Nga dhoma e brendshme e bankës doli fajdexhiu, kurse fill pas tij edhe ata policët e veshur civilë që e ruanin.

— Mos lini t'ju humbasë nga sytë, — pëshpëriti Brefi. — Nëse ka ndër mend t'ia japë dikujt diamantin, ka pér t'ia dhënë pikërisht këtu.

Pa na vënë re fare, zoti Luker eci ngadalë drejt derës përmes turmës. E pashë fort mirë si i lëvriu dora, kur kaloi përbri njeriut shtatvogël, shpatullan, veshur me një kostum gri të bukur. Ky u rrëngeth dhe e ndoqi me sy. Zoti Luker s'e ndaloj hapin, por vazhdoi të ecte ngadalë. Te dera policët qëndruan nga të dyja anët, ata i ndiqte njëri nga dedektivët e zotit Bref. Pas pak ata që të gjithë s'u dukën më.

Pashë nga juristi; pastaj bëra me shenjë pér nga personi me kostum gri.

— Po, — mërmëriti zoti Bref. — Edhe unë e vura re!

Ktheu kokën që të shihte se ku gjendej dedektivi tjetër. Nuk dukej gjékundi. Bëri të thërriste atë djalkën, por as ai nuk ishte.

— Dreq o punë! Q'do të thotë kjo? — tha i inatosur zoti Bref. — Na lanë në një kohë kur na ishin aq të nevojshëm...

I erdhë radha atij personit me kostum gri. Ky i zgjati arkëtarit çekun, nxorri déftesën dhe u kthye të dilte.

— Si t'ia bëjmë? — më pyeti zoti Bref. — S'kemi si e po shtërojmë veten deri në atë derexhe sa ta ndjekim nga pas.

— Unë jam gati! — i thashë. — S'duhet lënë pa u mbik-qyrur ky njeri, në asnje mënyrë!

— Epo atëherë, — ma ktheu zoti Bref, — unë po ju mbik-qyr ju. Punë e bukur kjo pér një njeri të detyrës sime! —

mërmëriti, kur që të dy dolëm fill pas personit me kostum gri.
— Veç, paçi perëndi, mos i tregoni pér këtë njeriut! Do më njollseset emri, po të merret vesh.

Me të dalë nga banka, personi me kostum gri hipi në autobusin që të çonte në pjesën perëndimore të Londrës. Ne pas tij. Zoti Bref bëri ca lëvizje prej të riu ndaj, kur hipëm në autobus, fytyrën ia mbuloi të kuqtë.

Në rrugën «Oksford» ai zbriti. Edhe ne pas tij. Hyri në farmaci. Zoti Bref u rrënqeth.

— Këtë farmaci e di e kujt është, — më tha. — Druhem se paskemi gabuar!

Hymë në farmaci. Zoti Bref shkëmbeu me të zotin disa fjalë dhe m'u afrua me një shprehje habije në fytyrë.

— Kjo na nderon pa masë, — më tha, pasi më mori nga krahu dhe më nxori që andej. — Kemi të paktën këtë si ngushëllim!

— E ç'qënka ajo që na bëka nder? — e pyeta.

— Po ja, zoti Blek, që si ti, si unë s'jemi veçse dedektivët më të këqijë që ekzistojnë. Njeriu me kostum gri na qënka prej tridhjetë vjetësh në shërbim te ky farmacist. E paska dërguar i zoti në bankë pér të derdhur paratë në emrin e tij. E ç'lidhje mund të ketë me diamantin tonë?

E pyeta se ç'duhej të bënim.

— Kthehemë tek unë në zyrë, — m'u përgjigj zoti Bref. — Ndonjë nga njerëzit e mi do të vijë të na njoftojë pér situatën. Do shkojmë me shpresë se diç do kenë vënë re.

E gjetëm aty atë dedektivin e dytë, kur erdhëm në zyrën e zotit Bref. Kishte ndonjë çerek ore që na priste.

— Hë, ç'të reja do na thuash? — iu drejtua zoti Bref.

— Duhet ta pranoj me keqardhje, zotëri, se u gabova. Zëbe që zoti Luker diç i futi nën dorë një zotëri me pallto të çelur. Ky zotëri doli që ishte një tregtar i nderuar llamarine në Istçip.

— Po djalka ku është? — e pyeti sakaj zoti Bref.

Dedektivi zgurdulloi sytë nga habija.

— Nuk e di, zotëri. S'e kem parë më që prej asaj kohe, kur dola nga banka.

Zoti Bref e la të largohej.

— Një nga të dyja, — më tha pasi ky doli. — Ose djalka

ia mbathi e s'kthehet më, ose është duke ndjekur dikë pér hesap të vet... Nuk keni gjë kundër të hamë së bashku diçka këtu, që të presim mos kthehet djali? Kam ca verë të mirë në qilar, marrim edhe ca biftekë dhe s'do ia kalojmë keq.

Héngrem në zyrën e zotit Bref. Para se ta pastronim tryezën, na raportuan që dikush donte të bisedonte me juristin. Mos ishte djalka? Jo, ishte dedektivi që ndoqi pas zotin Luker, kur doli nga banka. Edhe ajo që tregoi ky nuk qe diçka që të têrhiqtë vëmendjen. Zoti Luker qe kthyer në shtëpi dhe i kishte lënë të lirë policët e fshehtë. Nuk kishte dalë më nga shtëpia. Kur qe errur, kishte ulur grilat dhe e kishte mbyllur derën me lloz. Matanë rrugës, para shtëpisë dhe në rrugën prapa saj rinin njerëz që përgjonin. Indianët nuk qenë dukur asgjékundi. Pas këtij njoftimi, dedektivi pyeti në do udhëzohej pér ndonjë punë tjetër? Zoti Bref i tha të vinte të nesërmën.

E pritëm djalkën edhe ndonja gjysmë ore, por më kot. I lamë postjerit adresat dhe u nisëm secili në punë të vet.

Ditën tjetër në ora dhjetë më njoftuan se dikush kërkon te të më takonte. Kur u hap dera, u gjenda ballë pér ballë me... dedektivin Kaf.

— Erdha të marr vesh në jeni ende në Londër para se të nisesha në Jorkshir, zoti Blek, — tha.

E ftova të hanim bashkë mëngjesin. Ky banor fshati u fye. Kishte ngrënë bukë në ora shtatë e gjysmë, sa pér të fjetur binte me pulat.

— Mbrëmë jam kthyer nga Irlanda, — më tha dedektivi, duke kaluar menjëherë në çështje pune. — Para se të flija, lexova letrën tuaj ku më tregonit ç'kishte ndodhur pasi qe nd rprerë ndjekja e procesit të diamantit vitin që shkoi. Më mbetet të them vetëm një gjë: s'arrita dot ta kuptoj atë çështje. Nuk e them dot nëse ndonjë tjetër në këmbën tim do të mund të arrinte më tepër. Por e vërteta mbetet e vërtetë. U ngatërrova; dhe mund t'ju them se, nuk ishte hera e parë që më ndodhët kjo, zoti Blek! Vetëm në libra dedektivët nuk bëjnë kurri gabine.

— Keni ardhur në kohën e duhur që ta vini në vend reputacionin tuaj, zoti Kaf, — i thashë.

— Më falni, zoti Blek, — më kundërshtoi dedektivi. — Tani që kam dalë në lirim, as që më ha fare meraku pér repu-

tacionin. I kam dhënë fund qđo gjëje. Erdha këtu nga respekti pér kujtimin e zonjës Verinder, që u tregua aq bujare me mua. Do t'i kthehesha profesionit të mëparshëm, në rast se ju pranoni të mbështeteni tek unë. S'ju kérkoj as edhe një grosh. Pér mua kjo èshtë vetëm punë sedre... Ju lutem të më vini në dijeni, zoti Blek, në c'gjendje èshtë çështja pas letrës suaj?

I kallzova pér provën me opumin dhe pér ngjarjen në bankën në rrugën «Lombard». E mahniti lajmi pér provën, ishte diçka krejt e re në praktikën hetimore. U interesua sidomos pér supozimin e Ezra Xheningsit lidhur me veprimet që mund të kisha bërë pasi kisha dalë nga dhoma e pritjes së Reçellit.

— Nuk jam dakord me zotin Xhenings që ju e keni fshehur **Gurin e Hënës**, — tha dedektivi Kaf, — por jam dakord me të që ju duhet ta kishit çuar në dhomën tuaj.

— Mirë! Po c'ndodhi më pas? — e pyeta.

— S'u ka ardhur në mendje asnjë shpjegim?

— As edhe një.

— As zotit Bref?

— As atij.

Dedektivi Kaf u çua dhe iu afroa tryezës ku qesh ulur. Më zgjati një letër të myllur ku qe shkruar «Sekrete», që më adresohej mua. Në cep ishte nënshkrimi i dedektivit.

— U gabova atëherë, kur dyshova pér një person, — më tha. — Ndoshëta edhe tani s'po i bije dot përsëri në të. Mos u ngutni ta grisni zarfin, zoti Blek, para se ta mësoni si qëndron e vërteta. Atëherë krahasojeni emrin e fajtorit me emrin e atij që kam përmendur unë në këtë letër.

E vura letrën në xhep, pastaj i kërkova mendim lidhur me ato masat që kishim marrë në bankë.

— Shumë bukur paskeni bërë, zotëri, — m'u përgjigj Kafi. — Keni vepruar ashtu si duhet. Por përvëç Lukerit duhej ndjekur edhe një person tjeter.

— Emrin e të cililit ju e keni shkruar në letër?

— Po, zoti Blek, emrin e të cililit e keni në letër. Po tani s'ke c'bën. Në kohën e duhur diç do ju këshilloj të bëni, zotëri. Tani le të presim e të shohim, në do na sjellë ndonjë lajm ai djalka.

Ora po shkonte dhjetë e djali nuk po dukej. Kafi e çoi bisëdën në ngjarje të tjera. Më pyeti pér mikun e tij të vjetër

Beterexhin, për kopshtarin. Do ta hidhte llafin edhe tek ata trëndafilat e dashur; po të mos kishte hyrë shërbëtori e të na njoftonte se një djale aty poshtë donte të na takonte. Kur e sollien në dhomë, ky qëndroi te dera dhe ia qepi shikimin dyshimtar të panjohurit. E thirra djalin të hynte brenda.

— Mund të thoni çdo gjë në prani të këtij njeriu, — i thashë. — Ka ardhur për të më ndihmuar, është në dijeni të gjithçkaje. Zoti Kaf, — iu ktheva dedektivit, — këtë djalin e ka dërguar këtu zoti Bref.

Sapo dëgjoi emrin e këtij njeriu të shqar, djalit mend i dolën jashtë kokërdhokët e syve, aq shumë i shqeu nga habija.

— Eja këtu, mor djale, — i tha dedektivi. — Pa të dëgjojmë c'do të na thuash.

Vëmendja që tregoi ky njeri famëmadh e shtoi në vend djaloshin. Qëndroi gatitu para dedektivit dhe mori pamjen që merr nxënësi në provim.

— Si të quajnë? — e pyeti dedektivi.

— Oktavius Gaj, — iu përgjigj djali.

— Të kanë kërkuar dje në bankë. Ku ke qenë? — e pyeti tejet serioz dedektivi.

— Qesh duke ndjekur një person, zotëri.

— Cilin?

— Një burrë shtatmadh, me një mjekër të madhe të zezë sterrë, të veshur si marinar...

— Më kujtohet ky njeri! — e ndërpreva. — Unë dhe zoti Bref e kemi marrë për spiun të indianëve.

Dedektivit Kaf, me ç'pashë, s'i bëri ndonjë kushedi çfarë përshtypje ky hamendësimi ynë. Vazhdoi t'i bënte pyetje djalit.

— E pse ndoqe pikërisht atë marinarin? — e pyeti.

— Po zoti Bref, zotëri, kishte dëshirë të dinte në do i jep-te ndokujt ndonjë gjë zoti Luker, duke dalë nga banka. Pashë që zoti Luker i dha atij marinarit me mjekër të zezë diçka.

— E pse nuk e vure në dijeni menjëherë zotin Bref përgjithë sa pe?

— Nuk arrita dot, marinari doli menjëherë.

— Dhe ti iu qepe pas?

— Po, zotëri.

— Të lumtë, të punoka ajo mendja. Ke bërë ashtu si duhet.

Djali u skuq nga kënaqësia. Dedektivi Kaf vijoi:

— E ç'bëri ai marinari, kur doli në rrugë?

— I hipi një pajtoni, zotëri.

— Po ti çfarë bëre?

— Vrapova pas tij.

Në këtë kohë trokitën në derë. Dola që të mos e pengoja bisedën e dedektivit Kaf me djaloshin. Ishte një nepunës i zotit Bref që më njoftoi se ky qënka gdhirë me dhimbje të forta koke. I thashë nepunësit t'i tregonte zotit Bref se ndodhesha këtu me dedektivin Kaf dhe i dhashë fjalën se do e vija në dijeni për gjithçka që do ndodhë.

— Më falni, zoti Blek, — më tha dedektivi, kur u ktheva.

— S'kam as dyshimin më të vogël që ky djalosh qënka njeri për të qënë. Ka ndjekur pikërisht atë person që duhej ndjekur. Duhet të nisemi një orë e më parë.

Pas pesë minutash dedektivi Kaf, unë dhe djalka, që u ul pranë karrocierit për t'i déftyer rrugën, ishim duke udhëtuar nëpër rrugën «Siti». Dedektivi më bëri të ditur ç'i kishte rrëfyer djali: Marinari kishte biseduar pastaj me një nga ata të vaporit që do nisej të nesërmen për në Hollandë, kishte kërkuar të flinte atë natë në vapor, në kajutën e tij. I qenë përgjigjur që kjo nuk lejohej. Marinari qe larguar. Djali kishte vënë re se në trotuarin karshi e përgjonte një njeri i veshur si zanatçi. Marinari qe futur në një rosticëri. Djali e kishte priorit, po ashtu edhe ai zanatçiu. Qe afruar një pajton, zeshkani mjekrosh kishte biseduar që nga pajtoni me atë zanatçiu.

U duk qartë që si unë, si zoti Bref kishim gabuar: marinari me mjekrën e madhe të zezë kishte qënë spiun i indianëve. Thua të ishte ai njeriu që e kishte marrë diamantin?

— Pas do kohe, — vijoi dedektivi, — pajtoni qe larguar. Zanatçiu paska kaluar mespërmes rrugën dhe qënka futur në rosticëri. Pas pak aty kishte hyrë edhe djali. Kishte në xhep një shilingë; hëngri sa u ngop.

— E ç'pa djali në rosticëri, — e pyeta.

— Pa që marinari rrinte ulur në një tryezë dhe lexonte gazetën, kurse zanatçiu rrinte ulur në tryezën tjetër dhe po ashtu lexonte gazetën. Kur marinari po bëhej gati të dilte, ki-

shtë errur. Zanatçiu vazhdonte të rrinte në rostiçeri. Marinari ecetë dhe shihte rrerherrotull i shqetësuar, dukej sheshit që s'po dinte nga t'ia mbante. Ndërkaq në anën tjetër të rrugës përsëri ia behu ai zanatçiu. Marinari paska hyrë në hotelin «Rrota e Fatit», djali pas tij. Te sporteli kishte njerëz. Marinari kërkoi një krevat, i qenë përgjigjur që nuk kishte, por ky paska ngulur këmbë. Sportelisti deshi s'deshi i caktoi dhomën numër dhjetë. Mes njerëzve djali kishte pikasur atë zanatçiu. Njëri nga shërbëtorët e kishte shoqëruar marinarin pér në dhomën e tij, kur atë çast qenë dëgjuar zhurma, ishin duke nxjerrë pér krahu zanatçiu, që, pér çudinë e madhe të djalit, bënte sikur ishte i dehur. U sqarua se ky njeri paska zënë me dhunë dhomën numur dhjetë, duke thënë se paska qenë aty para marinarin. Kjo dehja e zanatçut e çuditit pa masë djalin. Qe turrur pas tij në rrugë. Kur kishte qenë pranë hotelit; zanatçut kishin vazduar ende t'i merreshin këmbët, por me t'u kthyer në cepin e rrugës i kishte ardhur si pér çudi drejtpe-shimi dhe po ecetë krejt normal. Djali u kthyte në hotel fare i çoroditur. Kishte pritur se mos ndodhë edhe ndonjë gjë tjetër, por nuk kishte ndodhur më asgjë. Ishte duke u kthyer në zyrën e zotit Bref, kur në anën tjetër të rrugës i kishin zënë sytë përsëri atë zanatçiu! Ky ia kishte qepur shikimin drithës sé vetme të hotelit që kishte dritë. Sikur ishte qetësuar nga kjo dhe që larguar. Djali u kthyte në zyrë, aty kishte gjetur pusullën me adresën tuaj dhe erdhi këtu. Ja si qëndrojnë punët, zoti Blek.

— Ju ç'mendim keni pér gjithë këto?

— Them se punët janë shumë keq, zotëri. Duket qartë që në këtë mes kanë gisht indianët.

— Po ky marinari kush të jetë, vallë? Apo mos është personi, të cilin zoti Luker i ka dhënë diamantin? A nuk ju duket e çuditshme që zoti Bref, unë dhe ddedektivi, i pajtuar nga zoti Bref, u gabuam në përcaktimin e personit të cilin iu dha diamanti?

— Aspak, zoti Blek. Zoti Luker me paramendim e largoi vëmendjen tuaj në ndonjë person tjetër.

— Po ato ngjarjet në hotel si duhen kuptuar? — e pyeta. — Ai zanatçiu është me siguri njeri i indianëve. Po ajo dehja ç'të ketë qenë.

— Them se ka shkuar në dhomën numër dhjetë para mërinarit për t'u njohur paraprakisht me vendndodhjen e diamantit këtë natë. Se indianëve u nevojitet përshkrimi i saktë i dhomës së hotelit, për të përcaktuar pastaj mundësinë e depërtimit në të. Ndryshe ky njeri s'do ia dilte dot në krye detyrës së marrë. Më të dalë nga hoteli, zanatçiu ua ka bërë të ditur që të gjitha indianëve, këta u kthyen përsëri për ta saktësuar në ishte aty ende marinari. Se ç'farë ndodhi natën; këtë duhej ta mësonim shumë më parë, tanë ora është njëmbëdhjetë, të shohim çka ndodhur.

Pas nja një çerek ore pajtoni ndali para hotelit «Rota e Fatit». Na ranë në sy ç'rregullime, gjendja ishte e alarmuar. Kur pyetëm për të zotin e hotelit, na u përgjigjën se ishte lart dhe nuk mund të priste njeri.

— Shkojmë atje, — më tha dedektivi Kaf, dhe gjakftohtë njiti shkallët. Djali ndoqi shembullin tonë.

Na doli përpara i zoti i hotelit tejet i irrituar.

— Po ju kush jeni? Ç'dreqin kërkon këtu? — Na foli tërë inat.

— Mos u nxehni, — ia ktheu më të qetë dedektivi Kaf. — Jua them se kush jam: dedektivi Kaf.

Emri famëmadh bëri efektin e duhur. Pronari i inatosur na hapi rrugën, duke na kërkuar ndjesë.

— Na ka ndodhur një diçka e tmerrshme, zotërinj. Një klient yni na porositi ta zgjonim në ora shtatë. Trokasim, asnje përgjigje. Derën e kishte të mbyllur nga brenda. Provuan përsëri të trokasim në ora nëntë, përsëri asnje përgjigje. Që mbrapa derës nuk dëgjohej asnje zhurmë! Dërguan të thérresin marangozin. Po të keni durim të prisni disa minuta, ai tanë duhet të vijë. Ta hapim derën e të shohim ç'ka ndodhur.

— Mos ka qënë gjë i dehur mbrëmë? — e pyeti dedektivi.

— Aspak, zotëri, ndryshe nuk do e lejoja në hotelin tim.

— Ju pagoi për dhomën qysh më parë?

— Jo.

— A mund të ikte nga dhoma nëpërmjet ndonjë dalje tjeter?

— Kjo dhomë ka një baxha në tavan. Mos mendoni, zoti Kaf, që ky maskara t'ia ketë mbathur nga baxhaja pa paguar fjetjen?

— Marinari, — iu përgjigj dedektivi Kaf, — këtë fare lehtë mund ta bënte në mëngjes herët, kur në rrugë s'ka njerëz. Se ca si ai janë të mësuar me ngjitje e me zbritje gjithfarëshe.

Ndërkaq erdhë marangozi. E pashë që dedektivi që më i vrenjtur se ngahera. M'u duk e çuditshme që djalin e urdhëroi të priste poshtë kthimin tonë. Brava u shpërthye, por dera ishte e zënë me një gjë të rëndë nga brenda. Pasi e shtymë, u futëm. I pari hyri i zoti i hotelit, i dyti dedektivi, unë i treti. Pastaj hynë edhe të tjerë.

Sytë ia qepëm shtratit dhe shtangëm. Marinari dergjej në krevat i veshur, fytyrën e kishte të mbuluar me jastëk.

— Po kjo kështu ç'të jetë? — pëshpëriti i zoti i hotelit, duke bërë me shenjë nga jastëku.

Dedektivi, pa thënë asnë fjalë, iu afroa shtratit dhe e hoqi jastëkun.

Fytyra zeshkane e marinarit ishte pa shprehje, e ngurtësuar. Flokët korb të zinj dhe mjekrën i kishte të shushpuritur. Sytë e vdekur, të ngrirë shihnin tavanin. Kjo kallkanosje e përgjithshme e ish-njeriut më kalli datën. I ktheva shpinën dhe iu afrova dritares së hapur. Të tjerët bashkë me dedektivin Kaf u mblohdhën te shtrati.

— I paska rënë të fikët, — tha pronari.

— Eshtë i vdekur, — e kundërshtoi Kafi. — Coni lajm në polici dhe thërrisni ndonjë mjek.

Kështu bënë. Seç qe një forcë magjike që s'e lëshonte dedektivin të largohej nga krevati. Një kërvshëri e çuditshme i mbante njerëzit në pritje të asaj ç'ka do të bënte dedektivi.

U largova nga dritarja. S'kaloi një minutë, kur më tërhoqën nga çipi i xhaketës dhe një zë hollak më pëshpëriti:

— Pa shihni, zotëri!

Në dhomë kishte ardhur djali, kokërdhokët sa s'i kapërcenin përsëri jashtë nga tmerri por edhe nga entuziazmi.

— Pa shihni, zotëri, — përsëriti dhe më çoi te tryeza që ndodhej në qoshe të dhomës.

Mbi tryezë qëndronte një kuti e vogël druri, e hapur bosh. Në njérën anë të kutisë kishte një shtresë pambuku, me të cilën argjendarët mbështjellin arturinat. Në anën tjeter ishte një fije letre e grisur e bardhë me një vulë në mes, pjesërisht të démtuar, dhe me një mbishkrim që fare lehtë mund të lexohej:

-Lu dorëzua zotërinjve Bush dhe Lajtjet nga Septimus Lukeri, me banim në sheshin «Midlsek» në Lambert një kuti e vogël druri e mbështjellë me letër, ku përbahet një xhevahir shumë i shtrenjtë. Kjo kuti duhet t'i kthehet nga zotërinjtë Bush dhe Lajtjet vetëm personalisht zotit Luker».

Pra s'kishte më as më të voglin dyshim që **Guri i Hënës** ishte në duart e marinat, kur kishte dalë dje nga banka.

Ndjeva që përsëri më tërroqën nga çipi i xhaketës; ishte ai djalka që më qe qepur.

— È kanë vjedhur, — më pëshpëriti duke treguar në drejtim të kutisë bosh.

— Të thanë të presësh jashtë, — i thashë. — Largoju që këtej!

— Dhe e kanë vrarë! — shtoi djali, me një entuziazëm edhe më të madh. Më bëri me shënje në drejtim të marinat që dergjoi në shtrat.

Në entuziazmin që shprehte ky djali kishte diçka aq të pështirë, saqë s'e durova dot, por ia vura dorën pas shpine dhe e shtyta jashtë dhomës. Në këtë çast dëgjova të më thërriste dekativi Kaf. Më çoi te krevati.

— Zoti Blek, — më tha, — shikojeni mirë fytyrën e këtij njeriu, e ka të grimuar. Ja, vini re.

Më tregoi me gisht një vend të mavjosur si të zbrujtur mbi ballin e zeshkët të të vdekurit, ku fillonin flokët e zinj të shprishur.

— Pa ta shohim se ç'fshihet nën këta krela, — tha dedekativi pasi ia përfshiu shpejt e shpejt me dorë.

Nuk më duruan nervat, ktheva kokën që të mos e shihja. Gjëja e parë që më ra në sy ishte djali zhivë i gjallë që kishte hipur në një karrige dhe ndiqte shumë i përqëndruar që mbi kokat e të pranishmëve të tëra lëvizjet dhe veprimet e dedekativit.

— Po ia heq parruken, — pëshpëriti djali, duke më parë me keqardhje që isha i vetmi në atë dhomë, që s'po shihja ç'po ndodhë.

Ra një heshtje habije që nuk zgjati shumë dhe u prish nga një britmë habije.

— Ia shqiti mjekrën! — thirri djali.

Përsëri ra heshtja. Dedektivi Kaf diç i tha të zotit të hotelit. Ky doli dhe u kthye shpejt me një legen të vogël plot me ujë dhe me një peshqir.

Djali u hcdh përpjetë në karrige nga entuziazmi.

— Afrohuni këtu tek unë, zotëri! Është duke ia larë bojën që ia paska mbuluar fytyrën!

Dedektivi befas i shtyti njerëzit që e kishin rrrethuar, dhe me një shprehje tmerri m'u afrua dhe më tha:

— Ejani te shtrati, zotëri! Ose më mirë jo! — M'i qepi systë zhbirues si teh thike dhe vazhdoi: — Hapeni më parë atë letren që ju dhash.

Nxora letrën dhe e hapa.

— Lexojeni, zotëri, atë emrin që ju kam shkruar aty.

E lexova emrin që kishte shkruar: **Godfri Ebluajt**.

— Ejani tanë me mua, — më tha dedektivi, — të shohim kush është ai që dergjet në atë shtrat.

Shkova pas tij dhe pashë i tronditur atë që rrintë shtrirë i vdekur: ishte **Godfri Ebluajt**.

Tregimi i gjashtë,

i shkruar nga dedektivi Kaf.

Historia e **Gurit të Hënës** po i afrohet fundit. Ka mbetur për t'u sqaruar vetëm ç'ndodhi pas darkës së shtruar me rastin e ditëlindjes së zonjushës Verinder më 21 qershor 1848.

Një ditë para se të vinte në Jorkshir, Godfri Ebluajti erdhë nga Londra te-i ati në Frizingol dhe i kérkoi treqind stërlina hua. (Këtë ma ka thënë vetë zoti Ebluajt — ati). Mbajeni mend shumën, por vini re edhe diçka tjetër: treqind stërlina ikate shuma që zoti Godfri duhej t'i paguante më 24 qershor atij xhentelmenit të mitur, tutor i të cilit kishte qënë, ndërsa kapitalin e këtij xhentelmeni të mitur zoti Ebluajt e kishte harxhuar krejt aty nga fundi i vitit 1847.

Zoti Ebluajt — ati nuk kishte pranuar t'i jepte as edhe një stërlinë hua.

Të nesërmen zoti Godfri Ebluajt u nis bashkë me ju për te zonjusha Verinder. Disa orë pas mbërritjes, siç më keni thënë ju vetë, ky i kërkoi dorën zonjushës Verinder. Kuptohet se, po të pranohej ky propozim, zoti Ebluajt kishte gjetur tapën e shpëtimit. Por zonjusha Verinder e hodhi poshtë këtë propozim. Gjendja financiare e zotit Ebluajt në këtë kohë ishte sa më poshtë: duhej të gjente borxh treqind stërlina për datën 24 qershor, dhe njëzet mijë stërlina për shkurtin e vitit 1850, kur mbaronte afati i moshës miturake të atij xhentelmenit. Po të mos i siguronte këto para, pasojat do të ishin nga më të rëndat.

Në këto kushte ç'ndodhi?

Ju e fyjet zotin Kandi, duke folur pa konsideratë për profesionin e mjekut, ai jua pagoi, duke ju dhënë atë dozën e laudanumit. Ia ngarkoi pikërisht zotit Godfri Ebluajt t'ia jepte atë dozë të preqatitur nga mjeku në një epruvetë. Zoti Godfri e ka thënë këtë me gojën e tij në ca rrëthana që tani do i mësoni se cilat qenë. Aq më tepër zoti Godfri u tregua i zellshëm, sepse ishte edhe ai nga ata që e patën pësuar atë natë nga ajo gjuha e mprehtë. E mbështeti propozimin që ju bëri Beterexhi të pinit pak konjak të holuar me ujë të flohtë, para se të binit të flinit. Zoti Godfri Ebluajt fshehtas e shtiri laudanumin në gotën tuaj me konjak të holuar. Dhe ju e pitë.

Tani të flasim cazë për zotin Luker nga Lamberi. Më parë më lejoni t'ju bëj të ditur se unë dhe zoti Bref e gjetëm mënyrën ta bënim fajdexhiun ta hapte gojën. Dhe ja ç'na tha: ditën e premte në mbrëmje vonë, për habi të zotit Luker i kishte bërë një vizitë zoti Godfri Ebluajt. Kishte mbetur gojëhapur, kur ky i kishte dëftyer **Gurin e Hënës**. Me sa dinte zoti Luker, një diamant të tillë s'e posedonte asnjë person privat në Evropë. Zoti Godfri Ebluajt i kishte bërë dy propozime modeste: t'ia shiste zotit Luker, ose në qoftë se ky s'pranonte t'ia blinte, ta mbante pëng me kusht që një pjesë të parave t'ia jepte menjëherë. Zoti Luker e kishte kqyrur mirë e mirë diamantin, e kishte peshuar, dhe ia kishte nxjerrë vlerën para se t'i jepte përgjigje. Duke patur parasysh atë bulëzën në mes të xhevahirit, e kishte vlerësuar tridhjetë mijë stërlina. Sakaq zoti Luker e kishte pyetur:

— Nga e gjetët?

Tre fjalë janë të shkretat, por sa shumë kuptim që kanë!

Zoti Godfri Ebluajt seç i kishte dërdëllitur, zoti Luker ia kishte prerë shkurt:

— S'ma mbushët mendjen!

Zoti Godfri kishte sajuar në vend një tjetër histori. Pas kësaj zoti Luker qe bindur se të gjitha pyetjet kishin qënë diçka e keqe. Qe ngritur dhe kishte thirrur shërbëtorin që ky ta përcillte zoterinë. Atëherë zoti Godfri qe detyruar t'ia rrëfenie ngjarjen në një dritë më të saktë dhe pikërisht: pasi e kishte hedhur laudanumin në gotën e konjakut të holluar, ju kishte uruar natën e mirë dhe kishte shkuar në dhomën e tij. Dhoma e tij e fjetjes ishte ngjitur me tuajën dhe komunikonte me derë. Mendimet pér vështirësitë financiare s'po e linin të flinte. Kishte ndenjur veshur me rrobënatë dhe pandofle si ndonjë orë, duke menduar pér gjendjen e vështirë në të cilën gjendej. Kur po bëhej gati të binte në shtrat, kishte dëgjuar që ju ishit duke folur me vete, i qe afruar derës, dhe e kishte parë që nuk kishte qënë e puthitur si duhej. Kishte përgjuar një hop mos ju kishte ardhur kush. Ju pa si po dilnit me shandanin në dorë nga dhoma e gjumit, si shqiptuat me zë të mekur, aspak të ngjashëm me zërin e zakonshëm:

— E ku i dihet? Indianët mund edhe të jenë fshehur brenda në shtëpi.

Deri më tanë pat menduar se, duke ju shtyrë atë laudanumin në gotën me konjak të holluar, vetëm sa kishte marrë pjesë në një shaka fare të pafajshme. Tani po e kuptonte që laudanumi kishte ndikuar fort mbi ju, saqë as mjeku, e aq më te-pér ai vetë këtë s'e kishte parashikuar. Nga frika mos u ndodhë ndonjë fatkeqësi, kishte dalë nga dhoma e tij dhe ju kishte ndjekur pas të shihte ç'po bënët. Ju ndoqi deri në dhomën e pritjes së zonjushës Verinder dhe ju pa si hytë; derën e latë hapur. E pa si e nxorrët diamantin nga dollapi, por pa ndërkaq edhe zonjushën Verinder që e heshtur ju shihte ç'po bënët. U bind që edhe ajo ju pa si e morët diamantin. Nuk dolët menjëherë nga dhoma e pritjes; këtë vonesë e shfrytëzoi zoti Godfri, u kthye në dhomën e tij të gjumit para se ju të dilnit në korridor ku mund ta diktonit. Pak pas tij u kthyet në dhomë edhe ju. Me sa duket e kishit parë kur ishte duke hyrë në derën

ndërmjet dhomës suaj dhe të tijës. Sidoqoftë i thirrët me një zë të çuditshëm, të përgjumur. Ai ju afrua. Ju e patë me ca sy të ngrirë, të huptë. Ju ia futët diamantin në dorë, dhe i thatë:

— Unë vetë s'kam si e çoj në bankë. E kam kokën të rëndë plumb, këmbët më janë mpirë, më janë bërë dru.

Koka sakaq ju ishte vajisur në shpinën e kolktukut, kishit nxjerë një pshëritimë të thellë dhe ju kishte zënë gjumi.

Zoti Godfri Ebluajt qe kthyer në dhomën e tij me diamantin në dorë. Bëri be se atë kohë nuk kishte vendosur për asgjë, përveç se do të priste e do të shihte ç'kishte pér të ndodhur në mëngjes. Mëngjesi ia bëri të qartë se ju gjëprejgjëje nuk mbani mend: as ç'kishtit thënë e as ç'kishtit bëré natën. Ndërkohë fjalët dhe sjellja e zonjushës Verinder i dhanë të kuptione se kjo kishte marrë vendim të prerë të mos tregonte (nga që i vinte keq pér ju). Dhe zoti Godfri Ebluajt e bëri mendjen top ta mbante diamantin, e pse jo, këtë ai mund ta bënte pa asnjë frikë se mund të ndëshkohej. **Guri i Hënës** do ta shpëtonte nga shkatërrimi i plotë që e priste. E vuri në xhep.

Këtë histori i pat treguar kushëriri juaj zotit Luker i shtrënguar nga nevoja. Zoti Luker e kish besuar sepse, siç u shpreh ky, zoti Godfri Ebluajt është kaq i trashë saqë kurrë s'mund ta sajonte një të tillë historie. Zoti Bref dhe unë qemë dakord me këtë mendim të tij.

Po ç'të bënин me **Gurin e Hënës?** Ranë dakord që zoti Luker t'i jepte zotit Godfri Ebluajt dy mijë stërlina borxh, duke i mbajtur peng diamantin. Nëse pas një viti zoti Godfri Ebluajt i kthente zotit Luker tre mijë stërlina do të bëhej përsëri zot i tij, pengu do i kthehej. Nëse nuk paguante dot, pengu, domethënë **Guri i Hënës**, do të bëhej pronë e zotit Luker, i cili me këtë rast do ia kthente zotit Godfri të gjithë kambialet që i kishte. Është e kotë të themi që zoti Godfri i kishte hedhur poshtë me indinjatë këto kushte përbindshore. Zoti Luker atëherë ia kishte kthyer diamantin dhe i kishte uruar natën e mirë. Kushëriri juaj kishte ecur deri te dera dhe ishte kthyer. E si mund të kishte besim se tërë kjo bisedë do ruhej në fshehtësi? Zoti Luker i qe përgjigjur se, meqë s'e kishin gjetur dot gjuhën e mirëkuptimit, do të vepronte si ia lypte leverdia. I trembur nga këto fjalë dhe i zënë ngushtë sepse 23 qershori ishte afati i fundit, kur duhej t'i jepte treqind stërlina xhen-

telmenit të mitur tutor i të cilët kishte qënë, dhe para nuk kishte ku të gjente; përjashto ato që sapo i kishte afroar zoti Luker, kishte pranuar. Po të mos e kishte patur litarin në grykë, fare mirë mund ta çonte diamantin në Amsterdam dhe ta shiste ku e ku më shtrenjtë, pasi ta kishte coptuar më parë. Tani s'kishte rrugëdalje tjetër veçse të pranonte kushtet e zotit Luker. Kishte përpara një vit të tërë për t'i siguruar ato tre mijë stërlinat, me të cilat do kthente pengun. Zoti Luker shkroi në çast dokumentin. Pasi e nënshkruan, i dha zotit Godfri Ebluajt dy çekë njérin të datuar 23 qershor për treqind stërlina, tjetrin të datuar pas një javë për një mijë e shtatëqind stërlina. Në q'mënyrë **Guri i Hënës** u dha për t'u ruajtur në bankë, ju këtë e dini. Edhe arsyen e propozimit për martesë zonjushës Verinder dhe prishjen e kësaj fejese, po ashtu e dini. Edhe sesi provoi fatin të lidhej me një vashë tjetër e nuk i shkrepit, edhe këtë kush nuk e di. Edhe që mori si trashëgimi pesë mijë stërlina nga një anëtarë e shoqërisë bamirëse, ku bënte pjesë edhe vetë, edhe këtë e dinë tërë ata që e njohin, vec duhet thënë se ishte pikërisht kjo trashëgimi, sic treguan ngjarjet e mëpas-tajme, ajo që u bë shkaktare e asaj vdekjes së tmerrshme.

Munda të mësoj që, me të shtirë në dorë ato pesë mijë stërlinat, ishte nisur për në Amsterdam. I kishte marrë të gjitha masat që ta copëtonte diamantin. Qe kthyer i veshur tjetërloj dhe i maskuar dhe, pasi kishte paguar pengun, arriti ta kthen-te diamantin. Le të kalonin disa ditë (për këtë masë sigurimi kishin rënë dakord që të dyja palët), para se ta nxirritë diamantin nga banka. Po të kishte arritur të shkonte në Amsterdam, kishte kohë të bollshme (korrik 1849-shkurt 1850, kohë kur ai zotëria adoleshent mbushte moshën për ta administruar vetë trashëgiminë) për ta coptuar diamantin dhe për ta shitur. Kuptohet sa shumë arsyë kishte të riskonte. O fitore, o vdekje, rrugë tjetër për të nuk kishte.

Para se ta mbylli këtë raportim, më mbetet të them si më poshtë: ende nuk na ka shpëtuar nga duart mundësia për të arritur indianët dhe për të kthyer **Gurin e Hënës**. Sipas të gjitha gjasave, ata tani janë duke udhëtuar për në Bombaj me një anije të shoqërisë Ost-Indi. Kjo anije, po të mos ndodhë diçka e paparashfikuar, nuk ka për të ndaluar në asnje port, kurse policia e Bombeit është vënë në dijeni, me anë të një letre

të nisur me tokë, për gjithçka dhe do t'i marrë të gjitha masat
të gjendet në vapor me të hyrë ky në port.

Kam nderin, zotëri i mirë, të jem shërbëtor i juaji i bindur.

RIÇARD KAF
ish-agjent i policisë dedektive
Skotland-Jard. LONDËR

E P I L O G

Ndihmësi, pasi mori udhëzim nga dedektivi Kaf më 27 qeror 1849, të ndiqte tre të huaj që dyshoheshin se kishin kryer një vrasje, dhe që në të parë dukeshin si indianët, i ndeshi për herë të parë në limanin e Touerit, kur po niseshin me një anije për në Roterdam. Vetë ai qe nisur për në Roterdam nga Londonra. Kapiteni i vaporit, që qe nisur nga limani i Touerit, i kishte thënë se indianët vërtet që kishin qenë pasagjerë në vaporin e tij por vetëm deri në Grejvsend. Këtu njeri nga të tre kishte pyetur, kur do mbërrinin në Kale. Kur u thanë se vaporit shkonte për në Roterdam, indianët u dëshpëruan dhe u pezmatuan shumë; doli që paskan hipur gabimisht. Iu lutën kapitenit pa kthim të hollash t'i zbriste sa më parë në breg. U lëshua një barkë që i çoi në breg.

Indianët e bënë këtë marifet për të humbur gjurmët. Ndihmësi i dedektivit Kaf u kthye menjëherë në Angli. Zbriti në Grejvsend. Këtu i thanë se indianët kishin shkuar në Plimut. Këtu mori vesh se qenë nisur për në Bombej me një anije të shoqërisë Ost-India. «Byli Kestl». Me të marrë vesh lajmin, dedektivi Kaf njoftoi me postën tokësore policinë e Bombejit që ta kontrollonte vaporin me të mbërritur në port.

Kapiteni i anijes «Byli Kestl», me tē mbérritur nē Bombej, njoftoi se, pér fat tē keq, nē afërsi tē brigjeve indiane kishin rënë nē kohë bunace ndonja tre ditë. Rryma detare sidoqoftë i afronte pér nga bregu dhe kur kishte zënë tē frynte era, kishin arritur nē port pas dy ditësh. Dihet që nē kësi rastesh disiplina e marinarëve le pér tē dëshiruar, kishin kërkuar tē lëshoheshin disa barka, shumëkush donte tē lahej. Barkat pas kësaj duheshin ngritur, por nga moskokëçarja i kishin lénë nē ujë tē lidhura pas anijes. Né mëngjes nuk i kishin gjetur asnjerën nga barkat e as tri indianët. Marinari roje s'kishte dëgjuar as zhurmë. S'kishte as dyshimin më tē vogël që tē kishin arritur shëndoshë e mirë nē breg. Pér gjithë sa ndodhi, kapiteni u kishte raportuar njerëzve tē pushtetit. Më tej kërkush nuk dinte as gjë pér tre indianët.

S'kaloi shumë dhe zoti Bref mori një letër nga udhëtarë i famshëm zoti Mertuet. Pas mërgimesh tē gjata nëpër Azinë Qendrore, zoti Mertuet kishte shkuar nē provincën indiane tē Kativarit, që njihej pak nga evropianët. Këtu dhe i ndodhi diçka që kishte tē bënte me historinë e **Gurit tē Hënës**. Në këtë vis tē egër popullata është e dhënë me mish e me shpirt pas një besimi tē lashtë indus. Mertueti kishte ardhur me mendimin t'i vizitonte domosdo rrënojat antike tē qytetit tē shenjtë tē Somnat'hës. I duhej tē ecte ndonja tri ditë më këmbë. Gjatë rrugës kishte vënë re se në tē njëjtin drejtim me tē udhëtonin edhe shumë banorë vendas. Udhëtarëve u thoshte se ishte indus budist, gjuhën e dinte mirë, pamjen e kishte ashtu si duhej. Njerëzit sa vinin e shtoheshin, tē gjithë ecnin drejt qytetit Somnat'ha. I qe paraqitur rasti tē njihej edhe me disa indu-së tē kastës më tē lartë. Nga ata kish mësuar se turma shkonte nē një kreftim tē madh. I përkushtohej perëndisë së Hënës dhe do tē bëhej natën. Mbërritën te kodra ku do tē bëhej kreftimi, kur hëna ishte ngritur lart nē kupën e qiellit. Indusët e kastës së lartë, me tē cilët shoqërohej, kishin qënë tē privilegjuar, ndaj i kishin thënë tē mos u ndahej. Në kodrinëzën me bukuri tē rrallë u doli përpara idhulli i mbuluar me perde tē mbërthyer në dy drurë tē mrekullueshëm. Te këmbët e idhullit ishte një shesh i madh shkëmbor që formonte një si platformë natyrore. Në këtë shesh zuri vend dhe Mertueti bashkë me miqtë indusë. Poshtë tyre hapej një pamje madhështore, e rra-

llë pér nga bukuria, ku edhe dora e njeriut kishte çudinë e vet në atë çudi të përgjithshme të natyrës. Faqet e poshtme të kodrinave shkriheshin ëmbël në fushat e lagura nga tre lumenjë. Nga njëra anë shpaloseshin lakadredhat piktoreske të lumenjve, nga ana tjetër oqeani i paqtuar prehej në ninullën e natës. Anembanë të zinin sytë dhjetra mijëra njerëz të veshur me të bardha, të shpërndarë bukur nëpër faqet e kodrave, në fushën poshtë dhe mes zigzakeve të lumenjve. Ndriçojini tërë këta pelegrinë me dritën flakëkuqe të pishtarëve, përfytyroni hënën e plotë në qiellin e bukur oriental, që hedh dritën e saj të artë mbi këta taborre pa fund e anë dhe do ta keni si të gjallë para syve atë tablonë e mrekullueshme që hapej para Mertuetit dhe indusëve të kastës së lartë.

Melodia e zvargur, pikëllimndjellëse që dilte nga ca vegla me harqe dhe flaute, i kishte detyruar ta drejtonin shikimin nga perdja ku fshihej idhulli. Në sheshin shkëmbor qenë dukur tre njerëz. Mertueti njoju mes tyre atë, me të cilin kishte folur në Angli, kur indianët kishin ardhur në tarracën e shtëpisë së zonjushës Verinder. Dy të tjerët, shokët e tij të atëherëshëm, edhe ata ishin pranë tij. Njëri nga indianët e kastës së lartë, që kishte qënë më pranë Mertuetit, e kishte vënë re habinë që ky s'po mundëtë dot ta fshihte. Ia kishte shpjeguar me pëshpërimë këtë shfaqje të tre indianëve në platformën shkëmbore. I tha se ishin braminë që kishin shkelur ligjet e kastës së tyre në emër të shërbimit të lartë. Zoti kishte bërë emër që të pastroheshin përmes pelegrinazhit. Këtë natë ata duhej të niseshin në tri drejtime të ndryshme në vendet e shenjtë të Indisë. Kurrë nuk duhej të takoheshin me shoshoqin, kurrë s'do të merrnin fund endjet e tyre; deri në vdekje do të mbeteshin pelegrinë.

Pas pak muzika heshti. Në platformën shkëmbore para perdes që fshihte idhullin qe mbledhur gjindje e madhe. Të tre të dënuarit u shtrinë përbys. pastaj u çuan, panë njëri-tjetrin, u përqafuan dhe u përzien me turmën. Të pranishmit u hapnin udhë heshturazi. Ecnin në tre drejtime të ndryshme deri sa nuk dukeshin më.

Një muzikë tjetër, më kumbuese dhe më e gjëzuar se e para u dëgjua që prapa perdes. Turmën e përshkuante rrënqethura. Dikush e tërhoqi perden dhe sy njerëzve u shfaq idhu-

lli, ulur në fron, kaluar mbi antilopën karakteristike. Katër krahët i kishte të shtrirë në katër anë të botës. Ishte perëndia e Hënës, i ngrysur, i tmerrshëm, që ndriçohej nga drita që binte prej qiellit. Mu në mes të ballit të perëndisë rrezëllinte diamanti i verdhemë me atë vezullimin e tij të mahnitshëm që linte pa mend cilindo që e shihte.

Po! Pas sa e sa vitesh endjeje e peripecish, **Guri i Hënës** shkëlqente përsëri aty ku e kishte patur vendin, brenda mureve të qytetit të shenjtë, aty ku pat zënë fill ky rrëfimi ynë. Se me c'rrugë të përgjakshme arriti të kthehet, përmes sa e sa sakrificave, krimeve, bëmave të çuditshme u bë e mundur, këtë ju, lexues, e dini tanimë. S'ka dyshim se në duart e këtyre besimtarëve fanatikë ai do të qëndrojë në jetë të jetëve. Vëç q'aventura e presin vallë në të ardhmen atë **Gurin e Hënës** kush mund ta profetizojë?

Tirazhi: 5.000 kopje

Shtypur në Shtypshkronjën «Sindikata» — Tiranë

Botues: Arian Lleshi, Rruga «Hamdi Vrioni» 22, Berat
Tel. në zyrë 22 44, në shtëpi 24 86

